



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**“Mbi Auditimin e Përputhshmërisë në DRT Fier”**

**Tiranë, Korrik 2024**

<b>NR.</b>	<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>10</b>
1.	Objektivat dhe qëllimi	10
2.	Identifikimi i çështjes	10
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
4.	Përgjegjësitë e audituesve	11
5.	Kriteret e vlerësimit	12
6.	Standardet e auditimit	12
7.	Metodat e auditimit	13
8.	Dokumentimi i auditimit	13
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AIUDITIMIT</b>	<b>14</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	14
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	16
2.1	Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi.	16
2.2	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor: - <i>Spektori i Kontrollit në Vend</i> - <i>Spektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.</i>	23
2.3	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Jugor).	135
2.4	Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së ekzekutimit të buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.	154
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>158</b>

## **II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Fier është një institucion buxhetor në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e ngarkuar për administrimin e taksave, tatimeve dhe kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe objektivave institucional, në funksion të promovimit të transparencës së duhur në marrëdhëniet me tatimpaguesin, duke siguruar sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë riskun e korrupsionit, dhe trajtimin e pandashëm për të gjithë tatimpaguesit. Misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar. Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) sipas programit buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1112/1 prot., datë 26.12.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua auditim në këtë drejtori lidhur me programimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Jugor), dhe vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së ekzekutimit të buxhetit për periudhën 01.01.2021-31.12.2023.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

DRT Fier është një njësi administrative e krijuar në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Organigrama e Drejtorisë Rajonale Tatimore është miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 79, datë 27.03.2020 “Për miratimin e organigramës së administratës tatimore qendrore”, në mbështetje të urdhrit nr. 33, të Kryeministrit datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, e ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve. Auditimi i këtij institucioni lidhur me realizimin e të ardhurave kundrejt planit, buxhetit, dhe vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, ka një rëndësi të veçantë, lidhur me transparencën e veprimtarisë në këtë fushë, impaktin financiar në buxhetin e shtetit. DRT Fier paraqitet në rangun e drejtorive rajonale tatimore kryesore, referuar nivelit të mbledhjes së të ardhurave kundrejt totalit të sistemit tatimore, duke u renditur e katërta, pas DTM, DRT Tiranë, dhe DRT Durrës, konkretisht me një realizim prej rreth 3% të totalit të të ardhurave tatimore.

### **c. Qëllimi i auditimit**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, nëpërmjet evidentimit të devijimeve nga standardet e pranuar, të shkeljeve të parimeve e të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë mbledhur dhe administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;

- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor e rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përkatës të përgjigjen për veprimet e tyre;

- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi.
- Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor:
  - *Spektori i Kontrollit në Vend*
  - *Spektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit*
- Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Jugor).
- Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së ekzekutimit të buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

- Verifikimi në sistemet DRT Fier (C@TS)- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

- Teknikat me ndihmën e kompjuterit - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të të dhënave për testim të mëtejshëm;

- Verifikime transaksionesh – me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

- Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 44 gjetje dhe ka dhënë 44 rekomandime, nga të cilat 21 masa organizative dhe 23 masa të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

## **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

- Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të plotësimit të strukturës organike të DRT Fier, me një numër të konsiderueshëm vakancash, ku deri në fund të periudhës objekt auditimi konstatohen 105 punonjës, nga 122 të planifikuar, duke rezultuar pa plotësuar me 12 pozicione pune: 2 përgjegjës sektori, 14 specialist dhe 1 personel mbështetës, situatë kjo që mbart riskun për të cenuar përmbushjen me sukses të detyrave funksionale të drejtorisë, ose nga ana e tjetër shfaq mangësi planifikimi në përcaktimin e numrit të punonjësve në strukturën organike .

- DVKT Rajoni Jugor përgjatë periudhës objekt auditimi 2021-2023, nuk ka qenë në eficiencë të plotë për shkak të mos shfrytëzimit efektiv të kohës së punës, si pasojë e shpërndarjes jo uniforme të planeve të punës të ardhur nga DVKT në DPT, si dhe mungesës së analizës së riskut të subjekteve për verifikim sipas planeve të punës.

- Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të projekt raportit të kontrollit tatimor dhe raportit përfundimtar të kontrollit tatimor për kontrollet tatimore të ushtruara janë konstatuar mangësi në afatet e dërgimit të projektraportit dhe raportit përfundimtar.

-Nga auditimi i raport kontrolleve tatimore është konstatuar se nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk është hartuar informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumën e mjeteve monetare të cilat kanë pretendohet se kanë kaluar si huadhënie nga ortaku drejt shoqërisë në rastet e kontrolleve në 4 subjekte.

- Në 5 raste janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, dhe nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, sipas Manualit Nr.1 “*Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret*” dhe Manualit Nr.2 “*Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave*”, duke i krahasuar me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu, janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera, në kundërshtim me përcaktimet e nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.1 datë, 16.06.2011.

- Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt marrëveshjeve për likuidimin me këste të detyrimeve të papaguara, konstatohet se në kërkesat e tatimpaguesve mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumentet se nga ana e subjektit, që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes.

- Nga analizimi i të dhënave lidhur me deklarimin e importeve dhe eksporteve që rezultojnë nga autoriteti tatimor (DRT Fier) krahasuar me të dhënat që rezultojnë të raportuara nga autoriteti doganor (DPD), sipas situatës financiare të TVSH-së, librat e blerjes dhe të shitjes, me të dhënat e deklaruara sipas doganës, janë konstatuar diferenca në të dy kahet, shkaqet e së cilave janë trajtuar më hollësisht në këtë raport.

- Nga auditimi i afateve të pagesave të kësteve të tatim fitimit, konstatohet se sistemi C@ts për këtë proces është dizenuar në një mënyrë të tillë që pagesa e tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, pavarësisht periudhës për të cilën po kryhet likuidimi. Si rezultat, në rastet kur subjektet janë penalizuar njëherë për mos pagesë në vonesë të këstit, në momentin e likuidimit të këstit pasardhës, kjo pagesë do të shkojë për mbulimin e detyrimit të parë; dhe për periudhën që ai po kryhen në kohë pagesën, do të rezultojë sërish me vonesë dhe do të jetë objekt penalizmi.

- Nga analizimi i diferencave midis qarkullimit të deklaruara në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit; si dhe në qarkullim midis xhiros së korriguar të kasës Nexus (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së, u konstatuan diferenca shkaqet e së cilave janë trajtuar më hollësisht në raport. Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra nuk dokumentohet verifikimi i kryer në raportet e kontrollit në vend, për subjektet ku janë konstatuar diferenca dhe është

propozuar kryerja e kontrollit nga sektori përkatës, me qëllim garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë në argumentimin e tyre. Ky sektor është mjaftuar me propozimin për kontroll në vend të subjekteve, apo me argumentin se subjekti ka kaluar për kontroll të plotë, pa kryer veprime verifikuese të mëtijshme për konstatimet e tyre mbi problematikat apo diferencat, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit nga Zyra, miratuar me Vendim të Komitetit Operacional nr. 29, me nr.20376 prot, datë 02.12.2022.

- Nga auditimi i raporteve të kontrollit në vend u konstatuan problematika të tilla si: Nga inspektori i kontrollit nuk është trajtuar karta teknologjike për materialet e konsumuara; nuk është kryer ndarja e shitjeve me pakicë nga ato me shumicë; ekzistojnë mosrakordime të gjendjes së inventarit; nuk është kryer analiza e lëvizjes së mallit; nuk është kryer analiza e bilancit material për periudhat përkatëse; nuk janë kryer analizat financiare të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut; nuk është analizuar normativa e konsumimit të karburantit; janë njohur si shpenzim vlerat që përbëjnë shpenzim të panjohur, pasi nuk i shërbejnë aktivitetit; ekzistojnë ndryshime në programin e kontrollit; diferenca midis të ardhurave sipas tatimit fitimit dhe të ardhurat e deklaruara në FDP e TVSH-së; nuk është llogaritur kreditimi i TVSH-së sipas udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014; shitje të përjashtuara, ndërkohë që duhet të deklarohen si shitje me 20%; janë çertifikuar investime dhe është rimbursuar TVSH, për vlera punimesh të papërfunduara pavarësisht riskut teknik, ose risqeve të tjera që mund të çënojnë funksionimin, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme; pagesa për ditët shtesë të punës nuk janë kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në RSH; janë kryer shpenzime të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare; ka parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit, si dhe për ato me numër kategorie për kontributet 2/004(6); nga kontrolli i PASH duke kryer rillogaritjet dhe rakordimet midis të dhënave të FDP, librave të blerjes, faturave dhe bilancit kontabël, kanë rezultuar diferenca të pajustificuara; janë konstatuar punime ndërtimore në ndërtim banesash dhe objekte ndërtimore të tjera, për të cilat duhet të kreditohet karburant deri në 8% të qarkullimit sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit 92/2014 “Për TVSH-në”; nuk është bërë rregullimi i TVSH së zbritshme në blerjet që i kanë shërbyer edhe shitjeve të përjashtuara në kuadër të programit të rindërtimit ; “shpenzimet neto të interesit për huatë”, nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit; kanë rezultuar faturime të situacioneve të punimeve të ndërtimit nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016”, pa justifikim në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim nga ana e subjektit, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullësi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin; gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, sipas manualeve të ndërtimit, veprime në kundërshtim me nenin 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, shitje nën çmimin fiskal minimal të qytetit të Fierit; nuk është deklaruar dhe paguar tatimi në burim për qeratë e makinerive dhe pajisjeve, etj.

- Nga përpunimi të dhënave të gjeneruara nga Raporti i gjeneruar për Këstet e Tatimit Fitimit, si dhe evidencave të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit sipas ndarjes së NIPT-eve, u konstatuan mangësi në penalitetet e aplikuara nga DRT Fier për mos pagimin në afat të kësteve të Tatimit Fitimit.

## **h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Drejtori i DRT Fier, në bashkëpunim me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” në kuadër të mbarëvajtjes së punës dhe përmirësimin e performancës institucionale.

-DVKT Rajoni Jugor, të koordinojë veprimtarinë me DPT, me qëllim planifikimin sa më efektiv të subjekteve për kontroll sipas analizës së riskut, si dhe hartimin e planeve të punës me shpërndarje të rregullt përgjatë vitit dhe ndarjen sa më racionale të grupeve të punës në terren, me qëllim që DVKT Rajoni Jugor të operojë në kushte efience dhe efektiviteti.

-Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa në vijimësi që të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për hartimin dhe dërgimin e projekt raportit dhe raportit përfundimtar të kontrollit tatimor tek tatimpaguesit objekt kontrolli, konform përcaktimeve ligjore në fuqi.

-Drejtorja Rajonale Tatimore Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të analizojë situatën e kontrollit të kryer referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

-Drejtorja e Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë Ligjore dhe Teknike dhe Sektorit të Cilësisë dhe Standartizimit të Procedurave, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një metodologji apo një manuali udhëzues, për të përcaktuar çështjet që duhet të jenë pjesë e verifikimeve të punimeve të kryera, në subjektet e fushës së ndërtimit, me qëllim standartizimin e akt konstatimit të inxhinierit të ndërtimit, si pjesë integrale e raport kontrollit tatimor.

-Inspektori përgjegjës për lidhjen e akt marrëveshjeve pranë DRT Fier, në bashkëpunim me Drejtorin Rajonal, të marrin masat për dokumentimin e analizave përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; si dhe përforcimin e procedurat aktuale të ndjekura për monitorimin e tyre, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjes së tyre si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë.

- DRT Fier të marrë masat për përcjelljen e problematikës për diferencat në raportimin tatimodogana, pranë DPT, ku strukturat përgjegjëse pranë DPT-në, në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme midis deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklaram dhe për të fokusuar punën e inspektorëve të kontrollit të zyrës në diferenca që përbëjnë realisht risk, dhe jo vetëm të atyre që vijnë vetëm si shkak i raportimit të gabuar të të dhënave sipas sistemeve.

- DPT të marrë masat për të vlerësuar zgjidhje optimale në sistemin C@TS me qëllim zgjidhjen e problematikave të trajtuara më sipër në drejtim të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit apo të pagesës për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve, apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës.

-DRT Fier të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për të shqyrtuar diferencat midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, duke intensifikuar vlerësimet dhe

rivlerësimet përkatëse, si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, si dhe për dokumentimin e vlerësimit të konstatimeve dhe rezultateve të kontrollit në vend të kryer pranë subjekteve me diferenca, me qëllim garantimin e evidentimit dhe problematikave në raportet e kontrollit, për të finalizuar procedurat monitoruese, pa u kufizuar vetëm në propozim.

-DRT Fier të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për të shqyrtuar diferencat midis xhiros së korrektuar të kasës (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

-Inspektorët e kontrollit nga zyra të marrin masat për dokumentimin e vlerësimit të konstatimeve dhe rezultateve të kontrollit në vend të kryer pranë subjekteve të cilat janë propozuar për kontroll, me qëllim garantimin e evidentimit dhe problematikave në raportet e kontrollit, për të finalizuar procedurat monitoruese, pa u kufizuar vetëm në propozimin për kontroll të plotë.

- DRT Fier për tatimpaguesit, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara nga grupi i auditimit.

-DRT Fier, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për të vendosur penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara për mos pagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

### **OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **Opinion i auditimit të përputhshmërisë.**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore nën ligjore dhe rregullative (burimi i kriterëve të paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve në lidhje me mbledhjen e të ardhurave tatimore, zbatimit të buxhetit, zbatimin e procedurave gjatë veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Jugor), etj.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave tatimore, referuar dosjeve përkatëse, si dhe të dhënave, informacionit, evidencave dhe çdo dokumenti të ndodhur në sistemin C@ts, mbështetur në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin përfaqësues mbi të cilin u kryen testet analitike.

#### **Opinion i modifikuar/kualifikuar<sup>1</sup>**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar” subjekti i audituar, DRT Fier ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

<sup>1</sup> Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura



Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, etj.), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

#### **Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:**

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionin.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar DRT Fier, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të më poshtëm:

#### **Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

Si rezultat i veprimeve të kryera dhe mosveprimeve në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjin nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj., janë konstatuar efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore gjatë auditimit të raporteve të kontrolleve të inspektorëve tatimorë, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumës së evidentuar paraprakisht në vlerën prej rreth **465,322 mijë lekë**, konkretisht si pasojë e:

Faturimeve të situacioneve të punimeve të ndërtimit nën kostot mesatare të miratuara në UKM nr.3 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016”, pa justifikim në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim nga ana e subjektit, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, duke sjellë ulje të pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin si dhe diferenca të pajustificuara në inventar të cilat janë rivlerësuar si shitjeve pa faturë tatimore.

Gjithashtu janë konstatuar kreditim i TVSH-së së karburantit jashtë normativave të lejuara, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të TVSH-së për blerjet si pasojë e shitjeve të përjashtuara sipas autorizimeve për punimet e rindërtimit, shitjeve të objekteve ndërtimore poshtë çmimit të referencës të përcaktuar me VKM nr.168, datë 27.3.2019, mos aplikimit të penaliteteve për pagesat me vonesë të kësteve të tatim fitimit si dhe mungesa e justifikimit të shumave monetare për të cilat pretendohet se janë dhënë hua nga ortakët e shoqërisë.

Problematika të tjera të konstatuara lidhen me mangësitë në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mos realizim i propozimeve për kontroll nga DRT Fier në masën 30%, mangësitë në sistemet e aplikuara duke rezultuar me diferenca në deklarimin e TVSH-së në dogana, krahasimisht me deklarimin në sistemin C@ts tatime etj.

## **I. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1112/1 prot., datë 26.12.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.12.2023 deri në datë 26.04.2024, në subjektin Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (DRT Fier), për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J.T, Përgjegjës Grupi,
2. R.Xh, Anëtar,
3. A.B, Anëtar,
4. A.H, Anëtar.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit**

Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë: Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë së DRT Fier me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit; Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT; Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash dhe ato të evazionit tatimor; Vlerësimi i përmbushjes së misionit të DRT Fier për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore; Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës; Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen; etj. Qëllimi i auditimit është evidentimi i devijimit nga standardet e pranura të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar, ku KLSH synon të promovojë transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë etj.

### **2. Identifikimi i çështjes**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 31.12.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DRT Fier të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore, masat e marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore, ecurinë e vetëdeklarimit të tatimpagueseve, saktësinë e këtyre deklaratave, monitorimin e mos deklaruesve në të gjitha llojet e tatimeve, prokurimet, përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit etj. Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm. Sa më sipër, fushat me risk më të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit dhe të trajtuara në këtë Raport Auditimi.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të DRT Fier, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë në drejtim të mirë administrimit të fondeve buxhetore. Strukturat drejtuese të DRT Fier, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave tatimore, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e kontrollit dhe vlerësimit të subjekteve tatimpaguese, shërbimin

ndaj tatimpaguesve, nxjerrjen e vendimeve etj. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme, miratuar sipas Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 22.02.2017. Drejtori përfaqëson DRT Fier dhe vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPT dhe institucionin. Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuar sipas legjisllacionit në fuqi. Drejtori i Kontrollit mban përgjegjësi në menaxhimin e sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në zbatimin e planeve mujore dhe vjetore të kësaj drejtorie, dhe merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga përgjegjësit e sektorëve. Përgatit raport për realizimin e detyrave dhe harton plane kontrolli apo vizita fiskale për inspektorët në varësi. Strukturat drejtuese të DRT Fier kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, ne kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar.

#### **5. Kriteret e vlerësimit**

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji me Nr. 92.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH" i ndryshuar ;

- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve në zbatim të tij;
- Ligji Nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave kombëtare”;
- Ligji Nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe PF”, i ndryshuar;
- VKM Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar;
- Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.
- Rregullore e brendshme me nr. 19, datë 22.02.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore”;
- Rregullore nr. 2 “Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”;
- Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Kontrollit në vend,;
- Të tjera akte ligjore, nënligjore dhe rregullative.

## **6. Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; ISSAI 4200; ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”, ISSAI 130 “Kodin Etik”, ISSAI 2315 “Risku”, ISSAI 2320-2450 “Materialiteti” , ISSAI 2500 “Dokumentimi”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t; INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

## **7. Metodat e auditimit**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemet e DRT Fier- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DRT Fier, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon:(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

## **8. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime.

Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, projektraportit dhe përgjigjeve të subjektit, u përgatit ky Raport i Auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm**

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është një njësi administrative në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe është përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, përmes procedurave të thjeshta me kosto minimale, në zbatim të Legjislacionit tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Objektivat e punës së DRT Fier fokusohen në disa drejtime, të tilla si:

- Mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor;
- Informimi, ndërgjegjësimi, edukimi i tatimpaguesve;
- Nxitja e vetëdeklarimit sipas parametrave fiskale, rritje të koeficientit të pagesës së TVSH-së;
- Rritja e cilësisë së kontrolleve;
- Ulje të borxhit tatimor, mbajtjen nën kontroll të borxhit të ri të krijuar;
- Vlerësimi i punës së inspektorëve;
- Vlerësimi i rezultateve të kontrolleve;
- Informimi dhe këshillimi i vazhdueshëm i tatimpaguesve në zbatim të procesit të fiskalizimit etj.

Në përbërje të DRT Fier janë Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Kontrollit Tatimor dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të cilat ndahen në sektorë, ku çdo strukturë mbulon një funksion të caktuar në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj.

Gjithashtu, pranë DRT Fier ushtrojnë veprimtarinë Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Jugor dhe Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren. Subjektet që kanë operuar pranë DRT Fier, të ndara sipas sektorit në të cilin bëjnë pjesë dhe statusit të tyre, për periudhën objekt auditimi, paraqiten si më poshtë:





Tabela 1.1: Numri i subjekteve në DRT Fier sipas sektorit dhe statusit 01.12.2021-31.12.2023

Sektori	01.12.2021				31.12.2021				
	Statusi								
	Aktiv	Pasiv	Kërkesë për çregjistrim	Çregjistruar	Aktiv	Pasiv	Kërkesë për çregjistrim	Çregjistruar	
Ndërtim	330	459	45	143	371	490	48	151	
Prodhim	986	1307	263	514	1,089	1375	276	538	
Shërbim	3197	2856	1181	2392	3,589	2979	1237	2444	
Transport	421	767	199	481	482	785	204	490	
Tregëti	3547	3930	1387	2642	3,886	4049	1462	2716	
Pa përcaktuar	2272			5	1			5	
<b>Total</b>	<b>10,753</b>	<b>9,319</b>	<b>3,075</b>	<b>6,177</b>	<b>9,418</b>	<b>9,678</b>	<b>3,227</b>	<b>6,344</b>	
<b>31.12.2022</b>				<b>31.12.2023</b>					
Aktiv	Pasiv	Kërkesë për çregjistrim	Çregjistruar	Aktiv	Pasiv	Kërkesë për çregjistrim	Çregjistruar		
378	510	60	153	407	283	60	159		
1168	1409	327	1531	1175	663	300	619		
3627	3158	1350	2507	3597	1290	1333	2683		
482	824	223	496	487	525	223	519		
3850	4218	1571	2798	3785	2233	1498	3056		
1			5				5		
<b>9,506</b>	<b>10,119</b>	<b>3,531</b>	<b>7,490</b>	<b>9,451</b>	<b>4,994</b>	<b>3,414</b>	<b>7,041</b>		

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Konkretisht, ecuria e numrit të subjekteve sipas sektorit ku bëjnë pjesë, paraqitet sipas grafikut të më poshtëm:

Tabela 1.2: Ecuria e subjekteve sipas sektorit për periudhën 01.12.2021-31.12.2023



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT

Për sa më sipër rezulton se numri aktiv i subjekteve ka pësuar rënie nga periudha fillestare e auditimit ku paraqiten në vlerë 10,753 subjekte, në 9,451 subjekte aktiv në 31.12.2023, ku rritja e numrit rezulton tek subjektet e ndërtimit, prodhimit, shërbimit, transportit, dhe ulje në numrin e subjekteve të tregtisë, me impakt në numrin total të tyre. Gjithashtu, numri i subjekteve pasiv rezulton në ulje, nga 9,319 subjekte në 01.12.2021, në 4,994 subjekte në fund të periudhës objekt auditimi; dhe me rritje rezultojnë subjektet që kanë paraqitur kërkesa për cregjistrim, dhe atyre të cregjistruar.

Situata lidhur me ndryshimet e përgjegjësive tatimore për subjektet që kanë operuar pranë DRT Fier, për periudhën objekt auditimi, paraqitet si më poshtë:

Tabela 1.3: Ndryshimet e përgjegjësive tatimore


Ndryshimet e përgjegjësive tatimore	2021	2022	2023
Subjekte qe kane kaluar me tatim fitimi, nga tatim fitimi i thjeshtuar	125	233	170
Subjekte qe jane regjistruar me përgjegjësinë tatimore "TVSH"	272	171	111
Subjekte qe jane regjistruar me përgjegjësinë tatimore "Tatim në burim"	304	395	235

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për sa më sipër, konstatohet se në vitin 2022 numri i subjekteve që kane kaluar me *tatim fitim*, nga tatim fitim i thjeshtuar kanë pësuar një rritje me rreth 108 subjekte nga viti 2021, duke u ulur më pas në 170 subjekte në vitin 2023, pra 63 subjekte më pak, për shkak të ndryshimit të pragjeve të TF dhe efekteve të fiskalizimit. Numri i subjekteve të regjistruar me përgjegjësinë *TVSH* ka pësuar rënie në vitin 2022 me 101 subjekte më pak nga viti 2021, duke u ulur më pas në 111 subjekte në vitin 2023, pra 60 subjekte më pak, si rezultat i fiskalizimit. Për sa i përket subjekteve që jane regjistruar me përgjegjësinë tatimore "*Tatim ne burim*", në vitin 2022 konstatohet një rritje me rreth 91 subjekte krahasuar me vitin 2021, duke rezultuar më pas me

235 subjekte në vitin 2023, pra 160 subjekte më pak se viti paraardhës. Konkretisht, paraqitur sipas grafikut të më poshtëm:

Tabela 1.4: Grafiku i ndryshimeve të përgjegjësive tatimore



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe bazuar në programin e auditimit, ky auditim ka përfshirë realizimin e të ardhurave tatimore, zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend; Sektorit të Kontrollit nga Zyra etj.

Në përfundim të auditimit, grupi i auditimit hartoi Raportin e Auditimit, bazuar në evidencat, dokumentacionin, të dhënat e sistemit, Letrat e punës, diskutimet me zyrtarët e subjektit, Akt Konstatimet, vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga DRT Fier, sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit, trajtuar më hollësisht si më poshtë.

## 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi.

#### - Auditimi i të ardhurave kryesore tatimore.

##### Për vitin 2021

Nga auditimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Fier për vitin 2021, janë konstatuar se të ardhurat bruto tatimore dhe kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 8,609,319 mijë lekë ose +1,127,793 mijë lekë, pra +4.0% më shumë se plani i rishikuar, i cili është dërguar nga DPT me shkresën nr.8446 prot., datë 12.05.2020 "Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2021". Tejkalmi vjen kryesisht nga efekti i realizimit dhe tejkalmimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore, pasi janë realizuar me +351,943 mijë lekë ose +7% se plani i rishikuar, por ndikim negativ ka pasur mosrealizimi i TVSH-së së arkëtuar bruto me -173,377 mijë lekë ose -12% të planit të rishikuar.

Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat bruto tatimore janë rritur me +1,127,783 mijë lekë ose me +15.0%, respektivisht +12% nga rritje e të ardhurave tatimore dhe +14.0% nga rritja e kontributeve të sigurimeve.

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se niveli i realizimit të të ardhurave rezulton në rritje krahasuar me planifikimin dhe realizimin e vitit të mëparshëm, disa zëra të të ardhurave paraqiten me mos realizim. Konkretisht, konstatohet se të ardhurat nga TVSH e arkëtuar bruto paraqiten në vlerën 1,218,623 mijë lekë, pra 173,377 mijë lekë më pak se plani. Të ardhurat nga TVSH neto paraqiten në vlerën 316,610 mijë lekë, pra 173,377 mijë lekë më pak se plani, shtuar këtu faktin se plani i miratuar për këtë zë rezulton në ulje krahasuar me realizimin e vitit



2020, ku më hollësisht për vitin 2021 janë planifikuar 362,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi i TVSH neto për vitin 2020 paraqitet në vlerën 471,51 mijë lekë; dhe si rezultat konstatohet se të ardhurat nga ky zë në vitin 2021 rezultojnë 155,141 mijë lekë më pak se realizimi i vitit 2020. Nga auditimi konstatohet se realizimi i të ardhurave nga rimbursimi TVSH-së rezulton me rënie krahasuar me planin (127,987 mijë lekë më pak), nga ku konstatohet një nivel planifikimi rreth dy fish më shumë se realizimi i një viti më parë.

Më poshtë po paraqesim në tabelë planin dhe faktin e të ardhurave të DRT Fier për vitet 2021-2020:

Tabela 2.1.1: Plani dhe fakti i të ardhurave të DRT Fier për vitet 2021-2020

Në mijë lekë

Emërtimi i Zërave	Realizimi viti 2020	Viti 2021		Diferenca Plan - Fakt 2021	% e	Diferenca Fakt 2021 - Fakt 2020	% e
	2020	Plani	Realizimi		realizimit		realizimit
TVSH e arkëtuar Bruto	1,161,143	1,392,000	1,218,623	173,377	88%	57,480	5%
TVSH neto	471,751	362,000	316,610	45,390	87%	-155,141	-33%
Rimbursim i TVSH-së	689,392	1,030,000	902,013	127,987	88%	212,621	31%
Tatim Fitimi	663,676	799,001	825,530	-26,529	103%	161,854	24%
Tatim të Ardhura Personale	837,891	934,500	1,069,001	-134,501	114%	231,110	28%
Taksat nacionale	44,673	59,999	42,393	17,606	71%	-2,280	-5%
Dënime pa Tatim	10,399	-	11,830			1,431	14%
Totali i te ardhurave tatimore neto	2,028,390	2,155,500	2,265,364	-109,864	105%	236,974	12%
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	4,763,754	5,089,999	5,441,942	-351,943	107%	678,188	14%
Totali neto (tatime+sigurime)	6,792,144	7,245,499	7,707,306	-461,807	106%	915,162	13%
Tatim fitimi thjeshtuar mbi biznesin e vogël	14,295	-	5,721	-5,721		-8,574	-60%
<b>NË bruto</b>	<b>7,481,536</b>	<b>8,275,499</b>	<b>8,609,319</b>	<b>-333,820</b>	<b>104%</b>	<b>1,127,783</b>	<b>15%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2021, është konstatuar realizimi në shumën 826,530 mijë lekë, me një rritje prej +26,509 mijë lekë ose +3% e planit të rishikuar. Plani i miratuar në vitin 2021 paraqitet në vlerën prej 799,001 mijë lekë ose +20.0% më shumë se realizimi i një viti më parë, ku paraqitet në vlerën prej 663,676 mijë lekë.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2021, është konstatuar se janë realizuar në masën 5,441,942 mijë lekë, me një tejkalim në realizim prej +351,943 mijë lekë ose +7% më shumë se plani i rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ku të ardhurat nga kontributet ishin 4,763,754 mijë lekë, rezultatet janë në rritje me 678,188 mijë lekë ose +14% më shumë se viti paraardhës.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2021, është konstatuar se janë realizuar në masën 1,218,623 mijë lekë, ose më një mos realizim prej - 173,377 mijë lekë ose -12% më pak se plani i rishikuar, por më një rritje prej +57,480 mijë lekë ose -5% në krahasim me realizimin e vitit 2020. Nga një analizë e zgjeruar e të dhënave në lidhje me TVSH-në, të vendosura në dispozicion për DRT Fier për vitin 2021, kanë rezultuar 2,804 subjekte deklarues të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) në përputhje me Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106.

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH-së, referuar deklaratimeve të vitit 2021, kanë rezultuar ndryshimet në rubrikat kryesore, në krahasim me vitin paraardhës si më poshtë:

- Janë rritur rubrika (9) “Shitjet e përjashtuara” me +29.0% dhe (10) “Shitjet pa TVSH” me +30%;

- Janë rritur me +9% deklarimi i (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%”;
- Është rritur me +54% deklarimi i (17) “Shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6%”;
- Janë ulur me -60% deklarimet për (28) Importe të përjashtuara të investimeve pa TVSH, impaktuar nga situata e shkaktuar nga pandemia e Covid.

Nga auditimi ka rezultuar se në analizimin e të dhënave të për vitin 2021 shihet një rritje e shitjeve total progresive me 16% krahasuar me shitjet totale të vitit 2020, rritje e cila sipas sektorëve paraqitet si më poshtë.

- Në sektorin e Ndërtimit shitjet totale janë rritur me 23%.
- Në sektorin e Prodhimit shitjet totale janë rritur me 11%.
- Në sektorin e Shërbimit shitjet totale janë rritur me 3%.
- Në sektorin e Transportit shitjet totale janë rritur me 44%.
- Në sektorin e Tregtisë shitjet totale janë rritur me 16

#### Për vitin 2022

Nga auditimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Fier për vitin 2022, janë konstatuar se të ardhurat bruto tatimore dhe kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 9,605,895 mijë lekë ose +178,895 mijë lekë, ose +2% më shumë se plani i rishikuar, i cili është dërguar nga DPT me shkresën nr.21811/1., datë 03.01.2023 “Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2022”. Ky realizim vjen kryesisht efekti rezultant i realizimit të TVSH-së që është realizuar me +145,690 mijë lekë ose +12% se plani i rishikuar, por nga auditimi konstatohet se niveli i planifikimit për këtë zë rezulton në rënie krahasuar me realizimin e vitit 2021. Gjithashtu, e njëjta situatë konstatohet edhe në planin e çelur për TVSH (neto), ku konstatohet se plani në vlerën 245,000 mijë lekë, pavarësisht se paraqitet në një realizim prej më shumë se dyfishi, plani në vetvete rezulton në rënie krahasimisht me realizimin e vitit 2021 (379,610 mijë lekë).

Ndikim negativ ka pasur mosrealizimi i Tatimit mbi Fitimin me -121,929 mijë lekë ose -11% se planit i rishikuar. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat bruto tatimore në efekt rezultat kanë ndryshuar me +933,676 mijë lekë ose me +11.0%, respektivisht +18% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe +10.0% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Më poshtë po paraqesim në tabelë planin dhe faktin e të ardhurave të DRT Fier për vitet 2021-2022:

Tabela 2.1.2: Plani dhe fakti i të ardhurave të DRT Fier për vitet 2021-2022

Në mijë lekë

Emërtimi i Zërave	Realizimi viti 2021	Viti 2022		Plan - Fakt 2022	% e realizimit	Diferenca Fakt 2022 - Fakt 2021	% e realizimit
	2021	Plani	Realizimi				
D.R.T Fier TOTAL (Bruto)	8,672,219	9,427,000	9,605,895	178,895	2%	933,676	11%
Tatimi Vlerës se Shtuar	1,281,623	1,260,000	1,405,690	145,690	12%	124,067	10%
Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	379,610	245,000	528,729	283,729	116%	149,119	39%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	902,013	1,015,000	876,961	-138,039	-14%	-25,052	-3%
Tatim mbi Fitimin	825,530	1,110,000	988,071	-121,929	-11%	162,541	20%
Ardhura Personale	1,069,001	1,100,000	1,168,696	68,696	6%	99,695	9%
Taksat Nacionale	42,293	57,000	48,014	-8,986	-16%	5,721	14%
Taksa Qarkullimit Rrugor	0		0				
Dënimet Administrative	11,830	0	11,993	11,993		163	1%
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	2,328,264	2,512,000	2,745,503	233,503	9%	417,239	18%
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	5,441,942	5,900,000	5,983,431	83,431	1%	541,489	10%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2022, është konstatuar se nuk është realizuar në shumën 988,071 mijë lekë, me rënie prej -121,929 mijë lekë ose -11% e planit të rishikuar. Realizimi i këtij zëri në fund të vitit 2021 është 825,530 mijë lekë ndërkohë që në buxhetin e vitit 2022 ky zë miratohet në nivelin 1,110,000 mijë lekë ose +34.5% më shumë se realizimi i një viti më parë.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2022, është konstatuar se janë realizuar në masën 5,983,431 mijë lekë, me një tejkalim në realizim prej +83,431 mijë lekë ose +1% më shumë se plani i rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ku të ardhurat nga kontributet ishin 5,441,942 mijë lekë, rezultatet janë në rritje me +541,489 mijë lekë ose +10% më shumë se viti paraardhës.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2022, është konstatuar se është realizuar në masën 1,405,690 mijë lekë, ose më një realizim prej +145,690 mijë lekë ose +12% më shumë se plani i rishikuar, dhe më një rritje prej +124,067 mijë lekë ose +10% në krahasim me realizimin e vitit 2021. Nga një analizë e zgjeruar e të dhënave në lidhje me TVSH-në, të vendosura në dispozicion për DRT Fier për vitin 2022, kanë rezultuar 2,653 subjekte deklarues të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) në përputhje me Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106.

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH-së, referuar deklarimeve të vitit 2021, kanë rezultuar ndryshimet në rubrikat kryesore, në krahasim me vitin paraardhës si më poshtë:

- Janë ulur (9) “Shitjet e përjashtuara” me -19% dhe rritur (10) “Shitjet pa TVSH” me +303%;
- Janë rritur me +18% deklarimi i (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%”;
- Është rritur me +7% deklarimi i (17) “Shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6%”;
- Janë ulur me -36% deklaramet për (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH”;
- Janë ulur me -17% deklaramet për (29) Import mallra të përjashtuara nga TVSH;

Nga auditimi ka rezultuar se në analizimin e të dhënave të për vitin 2022 shihet një rritje e shitjeve total progressive me 22% krahasuar me shitjet totale të vitit 2021, rritje e cila sipas sektorëve paraqitet si më poshtë.

- Në sektorin e Ndërtimit shitjet me TVSH janë rritur me 11%.
- Në sektorin e Prodhimit shitjet me TVSH janë rritur me 27%.
- Në sektorin e Shërbimit shitjet me TVSH kanë rënë me 35%.
- Në sektorin e Transportit shitjet me TVSH janë rritur me 44%.
- Në sektorin e Tregtisë shitjet me TVSH janë rritur me 21 %.

### Për vitin 2023

Nga auditimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Fier për vitin 2023, janë konstatuar se të ardhurat bruto tatimore dhe kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 10,875,275 mijë lekë ose -146,927 mijë lekë, ose -1% më pak se plani i rishikuar, i cili është dërguar nga DPT me shkresën Nr.2078, datë 10.02.2023 “Dërgohet plani i të ardhurave periudhën Janar-Shtator 2023”. Ky mosrealizim vjen nga efekti rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore që janë në ulje me -152,334 mijë lekë ose -2% se plani i rishikuar. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat bruto tatimore në efekt rezultat kanë ndryshuar me +1,269,383 mijë lekë ose me +13.0%, respektivisht +19% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe +10.0% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Gjithashtu, konstatohet Më poshtë po paraqesim në tabelë planin dhe faktin e të ardhurave të DRT Fier për vitin 2023:

Tabela 2.1.3: Plani dhe fakti i të ardhurave të DRT Fier për vitet 2023-2022

Emërtimi i Zërave	Realizimi viti 2022	Viti 2023		Plan - Fakt 2023	% e realizimit	Diferenca Fakt 2023- Fakt 2022	% e realizimit
		Plani	Realizimi				
D.R.T Fier TOTAL (Bruto)	9,605,892	11,022,202	10,875,275	-146,927	-1%	1,269,383	13%
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	3,622,464	4,316,209	4,321,616	5,407	0%	699,152	19%
Tatimi Vlerës se Shtuar	1,405,690	1,878,751	1,857,620	-21,131	-1%	451,930	32%
- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	528,508	942,034	920,903	-21,131	-2%	392,395	74%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	877,182	936,717	936,717			59,535	7%

Tatim mbi Fitimin	988,071	1,096,467	1,107,924	11,457	1%	119,853	12%
Ardhura Personale	1,168,696	1,288,100	1,301,324	13,224	1%	132,628	11%
Taksat Nacionale	48,014	52,891	39,869	-13,022	-25%	-8,145	-17%
Dënimet Administrative	11,993	3,379,492	14,879	-3,364,613		2,886	24%
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	5,983,428	6,705,993	6,553,659	-152,334	-2%	570,231	10%

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2023, është realizuar në shumën 1,107,924 mijë lekë, me një rritje prej +11,457 mijë lekë ose +1% e planit të rishikuar. Realizimi i këtij zëri në fund të vitit 2022 është 988,071 mijë lekë ndërkohë që në buxhetin e vitit 2023 ky zë miratohet në nivelin 1,096,467 mijë lekë ose +11% më shumë se realizimi i një viti më parë.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023, është konstatuar se janë realizuar në masën 6,553,659 mijë lekë, me një mos realizim prej -152,334 mijë lekë ose -2% më pak se plani i rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ku të ardhurat nga kontributet ishin 5,983,428 mijë lekë, rezultatet janë në rritje me +570,231 mijë lekë ose +10% më shumë se viti paraardhës.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2023, është konstatuar se është realizuar në masën 1,857,620 mijë lekë, ose më një mosrealizim prej -21,131 mijë lekë ose -1% më pak se plani i rishikuar, dhe më një rritje prej +451,930 mijë lekë ose +32% në krahasim me realizimin e vitit 2022. Nga një analizë e zgjeruar e të dhënave në lidhje me TVSH-në, të vendosura në dispozicion për DRT Fier për vitin 2023, kanë rezultuar 2,742 subjekte deklarues të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) në përputhje me Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106.

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH-së, referuar deklarimeve të vitit 2023, kanë rezultuar ndryshimet në rubrikat kryesore, në krahasim me vitin paraardhës si më poshtë:

- Janë ulur (9) “Shitjet e përjashtuara” me -18% dhe rritur (10) “Shitjet pa TVSH” me +38%;
- Janë rritur me +6% deklarimi i (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%”;
- Është rritur me +24% deklarimi i (17) “Shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6%”;
- Janë ulur me -40% deklarimet për (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH”;
- Janë ulur me -24% deklarimet për (29) Import mallra të përjashtuara nga TVSH;

Nga auditimi ka rezultuar se në analizimin e të dhënave të për vitin 2023 shihet një rritje e shitjeve total progressive me 7% krahasuar me shitjet totale të vitit 2022, rritje e cila sipas sektorëve paraqitet si më poshtë.

- Në sektorin e Ndërtimit shitjet me TVSH janë rritur me 14%.
- Në sektorin e Prodhimit shitjet me TVSH janë rritur me 1%.
- Në sektorin e Shërbimit shitjet me TVSH kanë rënë me 13%.
- Në sektorin e Transportit shitjet me TVSH janë rritur me 19%.
- Në sektorin e Tregtisë shitjet me TVSH janë rritur me 5 %.

**- Auditimi i të ardhurave dytësore tatimore, evidentimi dhe regjistrimi:**

DRT në zbatim të Ligjit 9632, datë 30.12.2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar me Ligjin Nr.181/2013, neni 17 “Administrimi i tatimeve”, theksohet që DPT nëpërmjet DRT rajonale janë të ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin (TFTH) mbi biznesin e vogël dhe transferimin në llogari të buxhetit të bashkive dhe sipas nenit 18 përfiton një komision në masën 1% të të ardhura të realizuara të cilën e transferon për llogari të buxhetit të shtetit, më konkretisht:

**- Të ardhurat nga Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin.**

Duke ju referuar Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 10 dhe neni 11, ku përcaktohet për shërbimin e kryer administrata tatimore rajonale përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendore të të ardhurave tatimore nga TTHF për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT. Kjo shumë (1% i TTHF) derdhet për llogari të DPT, në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor DRT nga pushteti vendor.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe evidencave me të dhëna për vitin 2021 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TTHF mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën prej 130,765 lekë. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton se shuma e palikuiduar të komisionit 1% të TTHF për llogari të DRT Fier është 30,047 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe evidencave me të dhëna për vitin 2022 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TTFH mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën prej 24,162 lekë. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton se shuma e palikuiduar të komisionit 1% të TTHF për llogari të DRT Fier është 1,002 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe evidencave me të dhëna për vitin 2023 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TTFH mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën prej 24,162 lekë. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton se shuma e palikuiduar të komisionit 1% të TTHF për llogari të DRT Fier është 1,002 lekë.

#### **- Të ardhurat nga shitja e shtypshkrimeve.**

Nga auditimi i evidencave dhe dokumentacionit mbi shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për vitin 2021 (sipas fletë-daljeve të magazinës), janë realizuar të ardhura në shumën prej 6,585,444 lekë por nga rakordimi me Degën e Thesarit rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën 6,589,142 lekë, pra nuk figuron diferencë materiale.

Nga auditimi i evidencave dhe dokumentacionit mbi shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për vitin 2022 (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar të ardhura në shumën prej 1,598,748 lekë por nga rakordimi me Degën e Thesarit rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën 1,610,148 lekë, pra nuk figuron diferencë materiale.

Nga shitja e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për vitin 2023 (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar të ardhura në shumën prej 1,352,400 lekë por nga rakordimi me Degën e Thesarit rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën 1,354,560 lekë, pra nuk figuron diferencë materiale.

*Tabela 2.1.4: Të ardhurat nga shitja e shtypshkrimeve Viti 2021-2023*

*Në lekë*

Emërtimi	Shitur viti 2021	Shitur viti 2022	Shitur viti 2023
Fature Tatimore	2,765,700	74,340	37,800
Fature Mod.4	282,240	42,840	58,800
Fature Shoqërimi	636,720	84,840	63,000
Dëftesë Tatimore	307,944	-	-
Bileta	2,592,840	1,396,728	1,192,800
<b>Shuma</b>	<b>6 585 444</b>	<b>1,598,748</b>	<b>1,352,400</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga auditimi evidencave për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës dhe akt-rakordimeve të mbajtur nga DRT Fier dhe Gjykatës, Prokurorisë së rrethit Fier, Prefekturës së Qarkut Fier, Bashkitë (Zyrat e Gjendjes civile), ZRPP, Këshilli i Qarkut për furnizim pulle me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë (i mbajtur në sasi dhe vleftë sipas institucioneve përkatëse), gjatë vitit 2021, rezulton se:

Nga auditimi rezulton se gjendja e detyrimit të pa arkëtuar për vitin 2021, pra pullë e pa përdorur gjendje në gjykatë, prokurori, zyra gjendjes civile dhe institucione të tjera, në fund të vitit 2021 është në shumën prej 10,244,263 lekë e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për t'u derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2021.

Nga auditimi evidencave për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës dhe akt-rakordimeve të mbajtur nga DRT Fier dhe Gjykatës, Prokurorisë së rrethit Fier, Prefekturës së Qarkut Fier, Bashkitë (Zyrat e Gjendjes civile), ZRPP, Këshilli i Qarkut për furnizim pulle me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë (i mbajtur në sasi dhe vleftë sipas institucioneve përkatëse), gjatë vitit 2022, rezulton se:

Nga auditimi rezulton se gjendja e detyrimit të pa arkëtuar për vitin 2022, pra pullë e pa përdorur gjendje në gjykatë, prokurori, zyra gjendjes civile dhe institucione të tjera, në fund të vitit 2022 është në shumën prej 7,603,013 lekë e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për t'u derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2022.

Nga auditimi evidencave për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës dhe akt-rakordimeve të mbajtur nga DRT Fier dhe Gjykatës, Prokurorisë së rrethit Fier, Prefekturës së Qarkut Fier, Bashkitë (Zyrat e Gjendjes civile), ZRPP, Këshilli i Qarkut për furnizim pulle me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë (i mbajtur në sasi dhe vleftë sipas institucioneve përkatëse), për vitin 2023 rezulton se:

Nga auditimi rezulton se gjendja e detyrimit të pa arkëtuar për vitin 2023, pra pullë e pa përdorur gjendje në gjykatë, prokurori, zyra gjendjes civile dhe institucione të tjera, në fund të vitit 2023 është në shumën prej 4,736,136 lekë e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për t'u derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2023.

*Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ka përgjegjësi z. A.P, në detyrë Drejtori Rajonal pranë DRT Fier.*

*Si konkluzion, konstatohet se për vitin 2021, pavarësisht se të ardhurat bruto dhe neto nga tatimet në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Fier paraqiten me një nivel realizimi mbi planit të të ardhurave, konstatohet një mosrealizim në të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore, shtuar këtu faktin se plani i miratuar për këtë zë rezulton në ulje krahasuar me realizimin e vitit 2020. E njëjta situatë rezulton edhe për vitin 2023, ku konstatohet mos realizim për këtë zë, krahasimisht me planin e rishikuar. Nga ana e DRT Fier konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë për arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri.*

*Për vitin 2022, konstatohet se realizimi i të ardhurave mbi nivelin e planifikuar vjen kryesisht si efekt i realizimit të TVSH-së, nga ku konstatohet se niveli i planifikimit për këtë zë rezulton në rënie krahasuar me realizimin e vitit 2021. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin paraqiten me mosrealizim kundrejt planit të rishikuar dhe nga ana e DRT Fier nuk janë kryer analiza për këtë qëllim.*

*Për vitin 2023, konstatohet mosrealizim i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ku konstatohet se nuk janë kryer analiza nga ana e DRT Fier për arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre zërave.*

Është paraqitur observacioni me nr.1112/29 prot., datë 27.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve lidhur me mosrealizimin e të ardhurave, nga Z. A.P, Drejtor Rajonal, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Nga DRT Fier në mënyrë peridoke mujore, progresive dhe vjetore. Të ardhurat e realizuara nga DRT Fier kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Mosrealizimi i të ardhurave në zërin e TVSH-së ka ardhur si pasjë e situatës së Covid 19. Për vitin 2023 mosrealizimi i të ardhurave në tërësi ka ardhur si pasjë e rishikimit të planit të të ardhurave për vitin 2023 në muajin nëntor, situatë për të cilën jemi vënë në djeni në muajin dhjetor 2023.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Sqarojmë se nuk janë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues që të vërtetojë me evidence kundërshtimin e ndryshimit të planit të të ardhurave nga DPT për zërin e TVSH-së. Gjithastu sqarojmë se një nga detyrat kryesore të pozicionit të Drejtorit Rajonal të DRT Fier është realizimi i planit të të ardhurave edhe sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 3 dhe 4 të nenit 4. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

## 2.2 Auditimi i përrputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor

### 2.2.1. Sektori i Kontrollit në Vend

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DRT Fier, grupi i auditimit të KLSH ka përzgjedhur dosjet e kontrollit mbi bazë risku të vlerësuar. Përzgjedhja konsistoi në respektim të parimet të proporcionalitetit dhe objektivitetit në shqyrtimin e dosjeve për çdo inspektor kontrolli duke pasur si referencë kriteret bazë, të tilla si:

- Numri i kontrolleve normale.
- Numri i kontrolleve për rimbursim.
- Xhiron (Të ardhurat pa TVSH për secilin nga vitet e periudhës objekt auditimi).
- Norma e fitimit vjetor bruto/të ardhura për secilin nga vitet objekt auditimi.
- Të dhënat e zbulimeve gjatë kontrollit.
- Sektori dhe lloji i aktivitetit ku bën pjesë subjekti etj.

***Nga auditimi i kryer, analizuar rast pas rasti u konstatua se:***

#### ***1. Subjekti: I.F.***

NIPT-i: J.....I.

Adresë Kryesore: Fier, Fshati Portëz, Rruga Fier-Berat, Banesa ne KM 2.

Aktiviteti: Prodhimi dhe tregtimi i foragjereve plotësuese, koncentrate, vitamina etj.

Inspektori: A.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2020/02 deri 2022/01.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 2020/02 deri 2022/01.
- Të Tjera periudha tatimore nga: 2020/02 deri 2022/01.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “I.F” SHPK, i cili ka volume në vlera të larta të shitjeve me shumicë dhe pakicë të ushqimit për zogj, konstatohet se:

-Nga inspektori i kontrollit nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit karta teknologjike për materialet e konsumuara, kjo në kundërshtim me programin e kontrollit Nr.6872/2 prot, datë 09/06/2022, Gërma I, pika 2 “Për ndërtimin e bilancit material të përdoren të dhënat sipas kartës teknologjike”.

-Nuk është kryer ndarja e shitjeve me pakicë nga ato me shumicë edhe pse zënë një volum mbi 25% të qarkullimit.

-Nuk është kryer analiza e lëvizjes së mallit në mënyrë të thelluar, e cila si rezultat ka sjellë mosrakordime të gjendjes së inventarit për vitet 2020 dhe 2021 në vlera të larta, për të cilat subjektit nuk i janë rivlerësuar detyrime, të cilat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

*Tabela 2.2.1.1: Diferencat e gjendjes së inventarit në vlerë të tatueshme*

Viti	2020	2021
Inventari sipas subjektit	21,584,368	44,208,666
Inventari sipas inspektorit	34,606,402	31,419,202
<b>Total</b>	<b>(13,022,034)</b>	<b>12,789,464</b>

*Burimi: Përrpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Diferencat e konstatuara për vitin 2020 trajtohen si shitje pa faturë dhe diferencat e konstatuara për vitin 2021 si blerje mallrash pa faturë tatimore, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimore në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Subjekti është objekt i penalizimit me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe i lindin detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.2: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Viti	2020	2021
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>13,022,034</b>	<b>12,789,464</b>
Detyrim TVSH 20%	2,604,407	2,557,893
Gjobë për TVSH 100%	2,604,407	2,557,893
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	1,953,305	1,918,420
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	1,953,305	1,918,420
<b>Total</b>	<b>9,115,424</b>	<b>8,952,625</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “I.F” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 3,871,725 lekë detyrime të TF dhe 3,871,725 lekë gjobë; 5,162,300 lekë detyrime të TVSH-së 5,162,300 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit janë evidentuar paraprakisht në vlerën prej 18,068,049 lekë, nga të cilat 9,034,025 lekë detyrim dhe 9,034,025 lekë penalitet.**

## 2. Subjekti: “L.S” SHPK.

NIPT-i: L.....A.

Adresë Kryesore: Divjakë, Rruga Laguna, nr 35, 9022, Lushnje.

Aktiviteti: Prodhim, tregtim të fidanëve perimore, luleve, farave, pesticideve, fungicideve, import, eksport etj.

Inspektori: E.F.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2019/12 deri ne 2021/11.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 2019/12 deri ne 2021/11.
- Të Tjera -periudha tatimore nga: 2019/12 deri ne 2021/11.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje me tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjor të subjektit.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standardeve të kontabilitetit.



- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

### 3. Subjekti: "2....G" SHPK

NIPT-i: L.....E

Adresë Kryesore: Lagjja 1 Maj, Rruga Naftëtarët, Fier.

Aktiviteti: Përpunim xhami, aksesori, lëndë e parë, përpunim duralumini, eksport import i tyre. Tregtimi dhe import – eksporti e mallrave të ndryshëm industriale.

Inspektori: G.LL.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2017/03 deri ne 2020/08.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2017-2019.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 2017/03 deri ne 2020/08.
- Të Tjera -periudha tatimore nga: 2017/03 deri ne 2020/08.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit "2....G", i cili ushtron aktivitetet përpunim xhami, aksesori, dhe përpunim duralumini, konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

1. Nuk janë zbatuar pikat e programit të kontrollit.
2. Nuk është zbatuar manuali i kontrollit tatimor në vend, pasi nga ana e inspektorit nuk janë mbajtur procesverbalet para fillimit të kontrollit, të cilat duhet të bashkëngjiten në dosjen e subjektit si dhe të ngarkohen në sistemin C@TS, kjo në kundërshtim me kapitullin II, pika 2.2 të manualit të kontrollit tatimor.
3. Nuk është kryer analiza e lëvizjes së mallit në mënyrë të thelluar, e cila si rezultat ka sjellë mosrakovime të gjendjes së inventarit për vitin 2019, ku pas analizimit të veprimeve nga ana jonë për këtë vit financiar, duke u nisur nga informacionet të cilat gjenden në deklaratat e subjektit ne sistemin tatimor C@TS, të dhënave të pasqyruara nga ana e inspektorit lidhur me blerjet dhe shitjet e mallrave analizuar në mënyrë analitike në raportin e kontrollit, dhe kryqëzimit të këtyre të dhënave nga ana e audituesve, rezultuan diferenca në bilancin material, krahasuar me rezultatet e dala në raportin e kontrollit për të cilat subjektit duhet t'i rivlerësohen të ardhurat tatimore, të cilat në mënyrë analitike sipas mallrave specifik paraqiten si më poshtë :

Tabela 2.2.1.3: Analiza e bilancit material

Nr	Artikulli	Njësia	Gjendje 01.01.2019	Blerje 2019	Shitje 2019	Gjendje 31.12.2019	Çmimi shitjes	Diferenca në sasi	Diferenca në vlerë
1	SGG -PLANITHERM 4S EVO .6mm	m <sup>2</sup>	822	0	1,236	2,349	843	1,982,455	1,980,106
2	XHAM LAMINAT 88.1 TR	m <sup>2</sup>	852	35	40	511	2,566	335	859,679
3	XHAM LAMINAT 33.1 (6.4mm)	m <sup>2</sup>	0	60	1,480	1,132	984	2,551	2,510,792
4	LAMINAT 55.1 TR	m <sup>2</sup>	2,216	12	1,970	733	1,373	474	650,998
5	LAMINAT TR 44.1 (8.4mm)	m <sup>2</sup>	253	0	1,243	673	1,177	1,662	1,955,400
	<b>Total</b>								<b>7,956,975</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

#### **Diferencat e konstatuara për vitin 2019 nuk janë trajtuar si shitje pa faturë.**

Subjekti është objekt i penalizimit 100 % gjorbë në bazë të nenit 124 "Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve" të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, dhe i lindin detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.4: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Viti	2019
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>7,956,975</b>
Detyrim TVSH 20%	1,591,395
Gjobë për TVSH 100%	1,591,395
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	1,193,546
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	1,193,546
<b>Total</b>	<b>5,569,883</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Konstatohet se në zërin n) shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale për vitet 2017-2019, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, kjo në kundërshtim me në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 21 “Shpenzime të panjohura”, gërma n.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2017 janë në shumën 583,950 lekë.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2018 janë në shumën 941,091 lekë.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2019 janë në shumën 1,645,889 lekë.

**Total shpenzime për pagat janë në shumën 3,170,930 lekë.**

Tabela 2.2.1.5: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2017-2019
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>3,170,930</b>
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	475,640
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	104,165
<b>Total</b>	<b>579,805</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ 2.....G” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 1,669,186 lekë detyrime të TF dhe 1,297,711 lekë gjobë; 1,591,395 lekë detyrime të TVSH-së 1,591,395 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 6,149,688 lekë, nga të cilat 3,260,581 lekë detyrim dhe 2,889,106 lekë penalitet.**

#### 4. Subjekti: K.D.

NIPT-i: L.....V

Adresë Kryesore: Fshati Gradisht ,rruga Spolatës, Fier.

Aktiviteti: Tregti me shumicë dhe pakicë I frutave dhe perimeve dhe Import eksport.

Inspektori: A.G.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2018/11 deri ne 2021/08.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “K.D”, i cili ushtron aktivitet tregti me shumicë dhe pakicë i frutave dhe perimeve dhe import eksport, është planifikuar për kontroll sipas kërkesës për rimbursim nr. 23094/2 date 24.01.2022 dhe lajmërimit të kontrollit nr.785/1 datë 07/02/2022, ku konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.

- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.

- Janë verifikuar kontratat e lidhura me fermerët.

- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.

- Verifikimi dhe kontrolli i deklarave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.

- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.

- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit, dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Fier me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.
- Është kryer analiza e TVSH-së, llogaritja e normës së TVSH-së, dhe është kryer krahasimi me normën mesatare të subjekteve të ngjashme.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.

### 5. Subjekti: “A....N” SHPK

NIPT-i: J.....I

Adresë Kryesore: Lagja Sheq i madh, Rruga Leonardo Murialdo, Fier.

Aktiviteti: Tregti me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare.

Inspektori: D.S.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2016.06-2021.06.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2016-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 2016.06 deri në 2021.06.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2016.06deri në 2021.06.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “A...N” SHPK, i cili ushtron aktivitet tregti me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare, konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

-Nuk është kryer një analizë e qartë dhe përmbledhëse sipas shkresës ardhur nga DPT lidhur me arsyet e daljes për kontroll të subjektit duke ju referuar rregullave të riskut të thyera, si dhe mangësitë e cituara në shkresën referuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

-Konstatohet se për artikullin stuko për vitin 2017, si dhe për artikullin pllaka+ parket për vitet 2017-2020, nga analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti në gjendjen e inventarin në çelje dhe në mbyllje, si dhe nga të dhënat e pasqyruara në raport kontrolli nga ana e inspektorit lidhur me sasinë e blerë dhe atë të shitur, rezultojnë diferencat si më poshtë:

Tabela 2.2.1.6:Diferencat për artikullin Stuko

Gjendje datë 31.12.2016	Blerje	Shitje	Gjendje 31.12.2017	Diferenca në Kg
42,608	31,130	29,800	47,548	3,610

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.7:Diferencat për artikullin pllaka + parket

Viti	Gjendje fillim periudhe	Blerje	Shitje	Gjendje fund periudhe	Diferenca ne M2	Çmim shitje	Vlera e tatueshme
2017	227,098	158,435	154,299	233,629	2,395	900	2,155,500
2018	233,629	126,434	137,700	228,230	5,867	982	5,761,394
2019	228,230	102,700	93,808	232,251	4,871	792	3,857,832
2020	232,251	84,914	71,286	230,887	14,500	880	12,760,000
<b>Total</b>							<b>24,534,726</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Diferencat e konstatuara trajtohen si shitje pa faturë, dhe si rezultat i rivlerësohen të ardhurat e subjektit :**

Stuko 3,610 kg \* 340 lekë = 1,227,400 lekë

Pllaka + parket vlerë e tatueshme totale = 24,534,726 lekë

**Total.....= 25,762,126 lekë**

Gjithashtu, nga analiza e çmimit të shitjes për artikullin stuko për vitin 2017, rezulton se çmimi i blerjes është 267 lekë, ndërkohë nga tabela e ndërtuar nga ana e inspektorit rezulton se ky artikull është shitur me çmimin 147 lekë, pra nën kosto, e cila në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.8: Analiza e çmimit

Emërtimi i artikullit	Njësi	Sasi e shitur	Çmim blerje	Çmim shitje	Çmim i shitjes me vlerë të shtuar mesatare 27%	Diferenca e çmimit	Vlera e tatueshme
STUKO FINO	KG	29,800	267	147	340	193	5,751,400

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Rivlerësimi i çmimit për artikullin stuko fino: 29,800 kg \* 193 lekë = 5,751,400 lekë.

Subjekti është objekt penalizimi me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe i lindin detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.9: Përlllogaritja e detyrimeve të subjekti

Viti	2017
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>31,513,526</b>
Detyrim TVSH 20%	6,302,705
Gjobë për TVSH 100%	6,302,705
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	4,727,029
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	4,727,029
<b>Total</b>	<b>22,059,468</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “A.....N” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 4,727,029 lekë detyrime të TF dhe 4,727,029 lekë gjobë; 6,302,705 lekë detyrime të TVSH-së 6,302,705 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 22,059,468 lekë, nga të cilat 11,029,734 lekë detyrim dhe 11,029,734 lekë penalitet.**

## 6. Subjekti: “A...O” SHPK

NIPT-i: J.....A

Adresë Kryesore: Lagja Kastriot, Fier.

Aktiviteti: Tregti me shumicë të lëndëve djegëse dhe vajrave lubrifikantë.

Inspektori: V.R.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2016.01-2021.02.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2016-2021.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 2016.01-2021.02..
- Të tjera periudha tatimore nga: 2016.01-2021.02.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “A...O”, i cili ushtron aktivitet tregti me shumicë të lëndëve djegëse dhe vajrave lubrifikantë, i cili është planifikuar për kontroll sipas kërkesës për çregjistrim dhe lajmërimin të kontrollit nr 4021/1 prot. date 14.06.2021, konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

Subjekti për periudhën e kontrolluar nuk ka ushtruar aktivitet, por janë verifikuar dhe saktësuar veprimet të cilat lidhen me:

- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.

- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Fier me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.

### 7. Subjekti: “K.I” SHPK

NIPT-i: K....P

Adresë Kryesore: Lagja Bishanak, Fier.

Aktiviteti: Ndërtimi i ndërtesave rezidente dhe jo rezidente.

Inspektori: A.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2021/06-05/2023.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2021-2022.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2021/06-05/2023.
- Të tjera periudha tatimore nga: 2021/06-05/2023.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “K.I” SHPK, i cili për periudhën e kontrolluar qershor 2021-maj 2023 ka ushtruar aktivitetin e tij në fushën e restaurimit, shërbimit dhe tregtisë konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

- Nuk është kryer analiza e bilancit material për periudhat përkatëse.
- Nuk janë kryer analizat financiare të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.
- Nuk është analizuar normativa e konsumimit të karburantit.

Subjekti për periudhën e kontrolluar qershor 2021-maj 2023 ka ushtruar aktivitetin e tij në fushën e restaurimit, shërbimit dhe tregtisë, ku një pjesë të punimeve të cilat përfshihen ato të gërmimit i ka kryer me nënkontraktor, për të cilat ka deklaruar edhe faturat e shërbimit, dhe pjesën tjetër të punimeve dhe të montimit të pajisjeve subjekti e ka kryer vetë.

Konstatohet se inspektori për këtë periudhë nuk ka analizuar normativat e konsumimit të karburantit sipas nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, normativat aplikohen mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike, që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike, ku specifikisht subjekti për qarkullimin e tatueshëm për këtë periudhë duhet të kategorizohet sipas pikës V. “Të tjera” (veprimtari të tjera jo të listuara) deri më 2%.

Sipas analizës kryer nga ana e grupit të auditimit rezultojnë diferencat si më poshtë:

Tabela 2.2.1.10: Analiza e kreditimit të karburantit.

Viti	Qarkullimi	Normativa e lejuar e kreditimit 2%	Kredituar gazoil	Diferenca Vlerë e tatueshme	TVSH
2021	85,654,117	1,713,082	12,375,548	10,662,466	2,132,493
2022	31,899,823	637,996	3,623,354	2,985,358	597,072
2023	18,997,083	379,942	1,079,312	699,370	139,874
<b>TOTALI</b>				<b>14,347,194</b>	<b>2,869,439</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Subjektit i linden detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.11: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2021-2022-2023
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>14,347,194</b>
Detyrim TVSH 20%	2,869,439
Gjobë për TVSH 21.9%	628,407
<b>Total</b>	<b>3,497,846</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Konstatohet se nga analiza e pasqyrave financiare për vitin 2021 janë deklaruar si blerje të përjashtuara për mirëmbajtje mjete 2,673,131 lekë, kur subjekti ka në inventarin e AQT një mjet pune kamionçinë me vlerën 712,883 lekë, dhe subjekti nuk duhet t'i njihet si shpenzim vlera e sipërpërmendur, pasi përbën shpenzim të panjohur, duke qenë se ky shpenzim nuk i shërben aktivitetit të subjektit, kjo në kundërshtim me ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat“ dhe udhëzimin Nr. 5, datë 18.01.2005 “Për Tatimin mbi të Ardhurat“. Subjektit i linden detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.12: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2021
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>2,673,131</b>
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	400,970
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	87,812
<b>Total</b>	<b>488,782</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ K.I ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 400,970 lekë detyrime të TF dhe 87,812 lekë gjobë; 2,869,439 lekë detyrime të TVSH-së 628,407 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 3,986,628 lekë, nga të cilat 3,270,409 lekë detyrim dhe 716,219 lekë penalitet.**

## 8. Subjekti: “V.S” SHPK

NIPT-i: L....H

Adresë Kryesore: Rruga Sheq i Madh”, Fier.

Aktiviteti: Ndërtimin e impianteve fotovoltaike, punime civile, punime elektrike etj.

Inspektori: A.G.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2021.06 deri me 2023.05.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2021-2022.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2021.06 deri me 2023.05.
- Të Tjera -periudha tatimore nga: 2021.06 deri me 2023.05.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “V.S” SHPK, i cili ushtron aktivitet ndërtimin e impianteve fotovoltaike, punime civile, punime elektrike etj, konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Janë verifikuar kontratat e lidhura me klientët dhe furnitorët.
- Është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.

- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga Drt Fier me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Konstatohet se ka diferenca në vlerën (2,124,446) lekë midis inventarit fizik deklaruar nga subjekti në sistemin C@TS dhe pasqyrave financiare të vitit 2022.

Tabela 2.2.1.13- Diferenca e inventarit

Viti	Inventari kontabël	Inventari fizik	Diferenca
2022	116,127,484	114,003,038	-2,124,446

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Diferenca në inventar e cila do të konsiderohet si shitje e padeklaruar, dhe **subjektit i lindin detyrimet si me poshtë:**

Tabela 2.2.1.14: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2022
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>2,124,446</b>
Detyrim TVSH 20%	424,889
Gjobë për TVSH 100%	424,889
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	318,667
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	318,667
<b>Total</b>	<b>1,487,112</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

***Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ V.S” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 318,667 lekë detyrime të TF dhe 318,667 lekë gjobë; 424,889 lekë detyrime të TVSH-së 424,889 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 1,487,112 lekë, nga të cilat 743,556 lekë detyrim dhe 743,556 lekë penalitet.***

## 9. Subjekti: “C....2012” SHPK

NIPT-i: L....E

Adresë Kryesore: Fshati Cakran, Fier.

Aktiviteti: Tregtim me pakicë i karburanteve.

Inspektori: V.R.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 07/2020 - 06/2022.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2020-2021.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 07/2020 - 06/2022.
- Të tjera periudha tatimore nga: 07/2020 - 06/2022.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “C....2012” SHPK, i cili ushtron aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve, konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit :

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.

- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti.

- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT Fier me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).

-Konstatohet se nuk është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për materialet e blera Brenda vendit me TVSH 20%, të cilat nga verifikimi i të dhënave të cilat gjenden në raport kontrolli për periudhën e kontrolluar, konstatohen mallrat në mënyrë të detajuar pasqyruar në tabelat më poshtë, të cilat duhet të kategorizohen nga ana e inspektorit si mallra të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit.

Tabela 2.2.1.15: Blerjet korrik-dhjetor 2020.

Nr	Subjekti	NIPTi	Vlera	Përshkrimi
1	A.S	K.....K	64,484	Profil Alumini
2	A.G	L....N	68,250	Vegla Pune
3	B..S	L....B	35,000	Telefon Celular
4	E.S	K.....J	30,650	Televizor
5	E.R	K.....P	91,667	lende druri,tjegulla betoni
6	E.R	L.....G	155,000	Boje, rrjet, Pope elektrike
7	F..s	J.....U	116,760	Granit
8	G...A	L.....L	45,056	lopata,brava,shkalle alumini,llampa led
9	K...o	K.....B	189,700	bide,pasqyra,pllaka,bolier
10	P.Sh	L.....D	132,867	boje,astar,llampa elektrike
11	V.a	K.....Q	252,000	karrige,tavoline,mbajtse televizori
<b>Totali</b>			<b>1,181,434</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.16: Blerjet janar-dhjetor 2021.

Nr	Subjekti	NIPT	Vlera	Përshkrimi
1	A.B	K....P	40,500	Granit
2	A.Ç	L....D	19,000	Riparim Dyer Alumini
3	A.S	K....K	29,010	Riparim Dritare Alumini
4	A.G	L.....N	72,000	Shkumogjen, Detergjent, Disifektant
5	E.R	L.....G	27,333	Boje Lyerje, Kartone
6	K..o SHPK	K....B	103,132	Materiale per shtrim pllake
7	V...a VR	K....Q	66,000	Blerje pjese dhe riparim mobiljesh
8	<b>Totali</b>		<b>356,975</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.17: Blerjet janar-maj 2022.

Nr	Pershkrimi	NIPT	Vlera	Pershkrimi
1	A.B	K.....P	115,000	Materiale per Riparim
2	A....l S	K.....K	122,366	Riparim Struktur Alumini
3	Ç.C	K.....N	209,300	Riparim Struktur Alumini
4	C....t SHPK	L.....O	83,971	Materiale per sherbim ne godine
5	E.R	L.....G	145,042	Boje, Dylen, Furça, Izolues, Material Kunder Ujit
6	K....o SHPK	K.....B	101,500	Bllok Dekorativ
<b>Totali</b>			<b>777,179</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Ky veprim, i cili përveç është në kundërshtim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, përveç detyrimit, subjekti do të penalizohet me gjobë 365 dite x 0.06%.

Tabela 2.2.1.18: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Korrik 2020-maj 2022
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>2,315,588</b>
Detyrim TVSH 20%	463,118
Gjobë për TVSH 21.9%	101,423
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	347,338



Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	76,067
<b>Total</b>	<b>987,946</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ C....2012 ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 347,338 lekë detyrime të TF dhe 76,067 lekë gjobë; 463,118 lekë detyrime të TVSH-së 101,423 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 987,946 lekë, nga të cilat 810,456 lekë detyrim dhe 177,490 lekë penalitet.**

#### **10. Subjekti: “G.K”.**

NIPT-i: L.....T.

Adresë Kryesore: Lagja: nr 5 , Ballsh , Mallakastër.

Aktiviteti: Ndërtimin e ndërtesave, rezidenciale dhe jo rezidenciale, Ndërtimit, studimit, projektimit, ndërtime civile, industrial, turistike, bujqësore, rikonstruksione.

Inspektori: S.Z.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2013/09-2018/08.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2013-2017.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2013/09-2018/08.
- Të Tjera -periudha tatimore nga: 2013/09-2018/08.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Subjekti është planifikuar për ri kontroll në bazë të lajmërimit të kontrollit nr.9308/1, datë 16.08.2022 si edhe programit të kontrollit me numër protokoll nr.9308/2, datë 09.09.2022 për kontrollin e periudhave të sipërcituara, nga verifikimi i praktikës së kontrollit rezulton se:

Në datën 02.11.2022 me shkresën nr.9308/4 subjekti “ **G.K** ”, i drejtohet DRT Fier me kërkesën për saktësimin e programit të kontrollit pasi periudhat e planifikuara për ri kontroll janë parashkruar.

**Nga verifikimi i raportit të ri kontrollit konstatohet se inspektori ka ndryshuar periudhën e përcaktuar për t’u kontrolluar, duke planifikuar vetëm periudhën 2017/08 – 2018/08 për TVSH-në dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe për tatimin mbi fitimin për periudhën 2017,** me arsyetimin e parashkrimit të periudha të cilat janë caktuar në programin e kontrollit.

Kjo bie ndesh me ligjin nr. 9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar Neni 48 dhe Neni 73 pika 1, e cila përcakton se: “*E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore fillestare apo të ndryshuar të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës*”, ku nga verifikimi në sistem rezulton se deklarata e fundit e ndryshuar është në datën 04.07.2019, pra parashkrimi është për periudhat 04.07.2014 e më para, si rezultat subjekti i planifikuar për ri kontroll nuk është kontrolluar për periudhën.2014/07 – 2017/07 për TVSH-në dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore si dhe nuk është kontrolluar për tatimin mbi fitimin për periudhën 2014-2016.

Për periudhën e kontrolluar konstatohet se nuk është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për materialet e blera brenda vendit me TVSH 20%, ku nga verifikimi i të dhënave të cilat gjenden në raport kontrolli për periudhën e kontrolluar, konstatohen mallrat e detajuar në tabelat më poshtë, të cilat duhet të kategorizohen nga ana e inspektorit si mallrat të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit.

Tabela 2.2.1.19: Blerjet të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit.

Nr faturës	Data e faturës	Subjekti shitës	Artikulli	Vlera e tatueshme	TVSH
1123	28.11.2017	V.S	Mobilje	1,495,000	299,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Ky veprim, i cili përveç se është në kundërshtim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, përveç detyrimit subjekti do të penalizohet me gjobë 365 dite x 0.06%.

Tabela 2.2.1.20: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Gusht-dhjetor 2017
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	1,495,000
Detyrim TVSH 20%	299,000
Gjobë për TVSH 21.9%	65,481
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	224,250
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	49,111
<b>Total</b>	<b>637,842</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ G.K ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 224,250 lekë detyrime të TF dhe 49,111 lekë gjobë; 299,000 lekë detyrime të TVSH-së 65,481 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 637,842 lekë, nga të cilat 523,250 lekë detyrim dhe 114,592 lekë penalitet.**

### 11. Subjekti: “E....I”.

NIPT-i: K.....W.

Adresë Kryesore: Rruga Hasan Tahsini, Fier.

Aktiviteti: Prerje paketim kuti kartoni, ambalazhim dhe riciklim te mbetjeve te kartonit.

Inspektori: G.V.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2020/01 deri 2021/08.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2020/01 deri 2021/08.
- Të tjera -periudha tatimore nga: 2020/01 deri 2021/08.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje Për tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

### 12. Subjekti: “R...A 04”.

NIPT-i: K....F.

Adresë Kryesore: Lagjja Kastriot, Pallati pranë Vefës, Fier.  
 Aktiviteti: Ndërtim civil, industriale dhe turistike.  
 Inspektori: A.G.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 02/2021- 09/2021.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 08/2019-07/2021.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 08/2019-07/2021.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

-Nga grupi i auditimit konstatohet se nga ana e inspektorit janë verifikuar shitjet e deklaruara nga subjekti me 6%, për të cilat subjekti është i pajisur me certifikatën e kategorizimit sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin Nr 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH, i ndryshuar, neni 49 ,pika 4 (Ligj Nr 107/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 92/2014, për TVSH-në RSH , i ndryshuar) e cila përcakton se shkalla e reduktuar e Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar 6% aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese ,të cilat disponojnë certifikatën e kategorizimit, ku rezulton se subjekti për periudhën e auditimit e disponon sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion.

Konstatohet se në vitin 2019 arkëtimet në avancë kanë diferenca midis të ardhura sipas tatim fitimit dhe të ardhurat e deklaruara në FDP e TVSH-së, dhe nuk është marrë në konsideratë arkëtimet në avancë afatgjata por vetëm aktivet afatshkurtra dhe si rrjedhojë diferenca si më poshtë:

Diferenca ndërmjet FDP-së së tatim fitimi – FDP-së së TVSH sipas raport kontrollit 13,454,357 lekë.

Diferenca nga llogaria e arkëtimeve në avancë 1,523,846 lekë.

Diferenca në vlerë në shumën 14,978,203 lekë, për shkak se të ardhurat nga TVSH duke marrë parasysh uljen e arkëtimeve në avancë përgjatë vitit me tatim fitimin janë më të ulëta, dhe për rrjedhojë duhet të deklarohen si shitje në FDP e TVSH për diferencën që sjell TVSH të munguar në masën 20% dhe gjobën përkatëse.

*Tabela 2.2.1.21: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit*

Periudha	Viti 2019
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	14,978,203
Detyrim TVSH 20%	2,995,641
Gjobë për TVSH 21.9%	656,045
<b>Total</b>	<b>3,651,686</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Konstatohet se edhe për vitin 2020, gjatë rakordimit ndërmjet FDP-së së bilancit për tatim fitimi dhe FDP së TVSH-së, diferenca ndërmjet arkëtimeve për porosi në avancë është pasqyruar në raport kontrolli në shumën 10,452,796 lekë, ndërkohë që sipas pasqyrave financiare diferenca paraqitet në shumën 20,819,795 lekë, pra të ardhurat sipas tatim fitimit janë nënvlerësuar për 10,366,999 lekë, për shkak se ulja në parapagime ndërmjet dy periudhave duhet të ishte deklaruar si e ardhur për efekt të tatim fitimit, referuar pasqyrës së rakordimit në raport kontrolli të pasqyruar nga inspektori tatimor. Për rrjedhojë subjektit i lindin detyrimet tatimore për tatim fitimi në masën 15%.

*Tabela 2.2.1.22: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit*

Periudha	Viti 2020
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	10,366,999
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	1,555,050
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	340,556
<b>Total</b>	<b>1,895,606</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga inspektori është trajtuar si kalim në llogari tjetër Parapagim për investim, e cila nuk gjendet e reflektuar në bilancin e vitit 2020. Gjithashtu, analitikisht në vitin 2019 dy parapagimet që përbëjnë diferencën janë të paraqitura në listën e arkëtimeve në avance por nuk janë të paraqitura në listën analitike për vitin 2020, rrjedhimisht duhet të kishin kaluar në të ardhur të periudhës. Konstatohet se inventari i imët në vitin 2019 dhe në vitin 2020 është paraqitur i zhvlerësuar me 50%, ndërkohë që duhet të procedohet me procesverbal nga tatimet për ta njohur si shpenzim të zbritshëm amortizimin e inventarit.

Tabela 2.2.1.23: Inventari i zhvlerësuar sipas viteve.

Viti	Vlera e inventarit të imët të zhvlerësuar
2019	2,707,390
2020	2,839,273
<b>Total</b>	<b>5,546,663</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Si rezultat subjektit do të rivlerësohen të ardhurat si më poshtë:

Tabela 2.2.1.24: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2019-2020
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>5,546,663</b>
Detyrim TVSH 20%	1,109,333
Gjobë për TVSH 100%	1,109,333
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	831,999
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	831,999
<b>Total</b>	<b>3,882,664</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

-Konstatohet se në vitin 2019 në zërin e detyrimeve të tjera analiza e huave me subjektet L...I dhe V....A janë në vlera të larta dhe nuk janë analizuar shpenzimet të interesit. E njëjta gjë edhe për vitin 2020 me shtesë kryesore sipas raportit të kontrollit me hua nga shoqëria Kontratë Huasë Xh...k-R...a 152,000,000 milion lekë.

Sipas shënimeve të pasqyrave financiare dhe analizës në raport kontrolli shtesa e aktiveve në proces ndërtim hoteli paraqitet në shumën 280,376,096 lekë, ndërkohë që referuar të ardhurave të deklaruara në shënimet shpjeguese të njëjta me analizën e inspektorit, këto të ardhura paraqiten në shumën 240,420,964 lekë, faqe 11 e raportit të kontrollit. Për rrjedhojë, të ardhurat e periudhës për vitin 2019 për punimet e kryera për ndërtimin e hotelit janë nënvlerësuar për diferencën në shumën 39,955,132 lekë. Për këto të ardhura të nënvlerësuara, është nënvlerësuar tatim fitimi i deklaruar me 15 %.

Për sa trajtohet më lartë subjektit i lindin detyrimet:

Tabela 2.2.1.25: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2019
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>39,955,132</b>
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	5,993,270
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	1,312,526
<b>Total</b>	<b>7,305,796</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për vitin 2020, sipas shënimeve të pasqyrave financiare janë pakësuar asetet në shumën 46,470,300 lekë për shkak të zjarrit në zërin ndërtesa dhe të tjera, ku lidhur me këtë çështje, kërkesa që i është drejtuar inspektorit lidhur me dokumentacionin shoqëruar nga tatimet ose institucionet përkatëse, nuk është vënë në dispozicion gjatë auditimit në terren.

Ky veprim, duke u llogaritur si shpenzim i periudhës ka ulur fitimin e tatueshëm të subjektit, dhe për rrjedhojë subjektit do t'i rriten të ardhurat për efekt të tatimit mbi fitimin për shumën fillestare 46,470,300 lekë (nga të cilat ndërtime 15,100,000 lekë dhe të tjera 31,703,00 lekë).

Për sa trajtohet më lartë subjektit i lindin detyrimet:

Tabela 2.2.1.26: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Periudha	Viti 2020
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	46,470,300
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	6,970,545
Gjobë për Tatim Fitimin 21.9%	1,526,549
<b>Total</b>	<b>8,497,094</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ R...A 04 ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 15,350,864 lekë detyrime të TF dhe 4,011,630 lekë gjobë; 4,104,974 lekë detyrime të TVSH-së 1,765,378 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 25,232,846 lekë, nga të cilat 19,455,838 lekë detyrim dhe 5,777,008 lekë penalitet.**

### 13. Subjekti: “F....a”.

NIPT-i: L....F.

Adresë Kryesore: Lagjja Tetori, Fier.

Aktiviteti: Tregti me shumice e frutave dhe perimeve.

Inspektori: B.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2021/07 - 2022/10.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2020-2021.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 2021/07 - 2022/10.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2021/07 - 2022/10.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.
- Konstatohet se nuk janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Konstatohet se nga analiza e furnitorëve nuk është llogaritur kreditimi i TVSH-së sipas udhëzuesit nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, neni 9 “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar”, pika 3, ku përcaktohet se: “Nëse fatura nuk përmban të dhënat e plota dhe të sakta, si dhe nuk përmban shënimin “Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit”, personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë dënimin, sipas nenit 128, për faturë tatimore të parregullt në përputhje me ligjin në fuqi “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 6% të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, nëse nuk provon kryerjen e kompensimit të fermerit nëpërmjet likuidimit të vlerës së faturës nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, apo nëse ky likuidim i faturës, nuk është kryer nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare.”

Për rastet e mëposhtme inspektori ka njohur kreditimin e TVSH-së, edhe pse këta fermer rezultojnë si të pa likuiduar, ku si pasojë subjektit nuk duhet ti njihet kreditimi i TVSH-së.

Tabela 2.2.1.27: Blerjet nga fermerët pa likuiduar.

Nr	Emri fermerit	Vlera e tatueshme	TVSH 6%
1	FERMER A.S	941,580	56,495
2	FERMERI"N.M"	819,330	49,160
3	FERMER K.XH	464,361	27,862
4	FERMERI"K.R"	637,600	38,256
5	FERMERI V.M	638,868	38,332
6	FERMERI A.Q	499,708	29,982
7	FERMERI E.A	859,974	51,598

8	FERMERI K.V	822,043	49,323
9	FERMERI Z.B	491,850	29,511
10	FERMER L.A	233,211	13,993
11	FERMERI A.H	1,168,707	70,122
	TOTALI	7,577,232	454,634

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu, subjekti është objekt penalizimi sipas ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)”, Neni 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, pika 1, ku përcaktohet se “*Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t’u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.*”, duke rezultuar në detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.28: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Viti	2021
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>7,577,232</b>
Detyrim TVSH 6%	454,634
Gjobë për TVSH 50%	227,317
<b>Total</b>	<b>681,951</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

***Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ F....a ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 454,634 lekë detyrime të TVSH-së, 227,317 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 681,951 lekë.***

#### **14. Subjekti: “D...a”.**

NIPT-i: J....S.

Adresë Kryesore: Lagjia 11 Nëntori, Fier.

Aktiviteti: Tregtimi i artikujve të ndryshëm të konsumit të gjerë.

Inspektori: L.C.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2019.03-2020.09.
- Për Tatim Fitimin -periudha tatimore nga: 2019-20220
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2019.03-2020.09.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2019.03-2020.09.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.
- Gjatë fazës në terren nga auditimi i të dhënave sipas sistemit C@ts, konkretisht inventarit kontabël të deklaruar në anekset e BK 2019 krahasuar me analizën e bilancit material të kryer nga inspektori i kontrollit në raport, rezultojnë diferenca, ku konkretisht: 245,978,119 lekë, e ndarë kjo në 191,120,048 lekë lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme, 50,914,635 lekë produkte të gatshme dhe 3,943,436 lekë ambalazhe; ndërsa nga deklarimi i inventarit fizik në fund të vitit 2019 deklaruar nga subjekti në sistemin tatimor C@ts në datën 10.01.2020 rezulton se inventari në fund të periudhës është 138,786,423 lekë, e ndarë kjo në 96,524,592 lekë lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme dhe 42,261,831 lekë produkte të gatshme, nga analiza e gjendjes në fillim të periudhës pasardhëse e cila është 01.01.2020-31.12.2020.

Nga administratori i shoqërisë, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare dhe për mbajtjen e kontabilitetit të shoqërisë konform standarteve të kontabilitetit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është vendosur në dispozicion inventari fizik i firmosur dhe vulosur si dhe mbështetur me analizën e kryer, ku rakordon gjendja 01.01.2020 + blerjet – shitjet me gjendjen e inventarit 31.12.2020.

Referuar dokumentacionit të ri justifikues të vendosur në dispozicion për të cilat nuk kemi pasur dijeni gjatë fazës së punës në terren, rezulton se diferencat e konstatuara në inventarin fizik me atë kontabël, vijnë si pasojë e deklarimit të pasaktë të inventarit në sistemin C@ts nga ana e subjektit.

### **15. Subjekti: “B...3”.**

NIPT-i: J...R.

Adresë Kryesore: Lagjja 8 Shkurti, Rruga Andon Doro, FIER.

Aktiviteti: Ndërtim, projektim, rikonstruksion, ndërtime industriale.

Inspektori: D.S.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2019.04-2021.12.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019-20220
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2019.04-2021.12.
- Të tjera periudha tatimore nga: 2019.04-2021.12.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor për periudhën dhjetor 2020, subjekti është pajisur me Autorizimin nr. 450 datë 29.12.2020, protokolluar në DPT me nr. 22911/1 prot. Datë 29.12.2020, bazuar në kërkesën me datë 25.11.2020 për autorizim për përjashtim nga TVSH të furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve me qëllim të procesit të rindërtimit. Shoqëria B...3 me NIPT J...R dhe B...3 II me NIPT L...O përjashtohet nga TVSH për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë procesit të rindërtimit në zbatim të kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (Marrëveshje Kuadër) Kontrata Nr.8, me nr.32730 prot, datë 04.11.2020, me objekt “Ndërtim i rrjetit rrugor dhe infrastrukturës urbane të zonës Lezhë, Njësia administrative Lezhë”.

Subjekti është pajisur me Autorizimin nr. 447 datë 29.12.2020, protokolluar në DPT me nr, 24260/1 prot. Datë 29.12.2020, bazuar në kërkesën në datën 16.12.2020, për autorizim për përjashtim nga TVSH të furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve me qëllim të procesit të rindërtimit, protokolluar në DPT me nr. 24260 prot. Datë 16.12.2020 si edhe dokumentacioni shoqëruar të kërkesës. Subjekti “ B...3” me NIPT J...R përjashtohet nga TVSH për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë procesit të rindërtimit në zbatim të kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (Marrëveshje Kuadër) Kontrata Nr.3, me nr.3073 prot. Datë 04.12.2020, me objekt: “Rindërtim i njërive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa A, Njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë.”

Shoqëria për këtë periudhë ka kryer shitje të përjashtuara në shumën 32,881,380 lekë të cilat janë të analizuar në tabelën e mëposhtme, ku për vitin 2020 rezulton se shitjet sipas faturave pasqyruara në tabelë janë deklaruar si shitje të përjashtuara, ndërkohe duhet të deklarohen si shitje me 20%, pasi janë realizuar para se subjekti të pajisej me autorizimin nga DPT.

Tabela 2.2.1.29: Faturat e deklaruara të përjashtuara.

Nr faturës	Seriali	Data	Emri blerësit	NIPT i blerësit	Shitje të përjashtuara	Përshkrimi
29	66178883	29/12/2020	A.K	K.....I	19,759,600	rindërtimi i ndërtesave ne Kavajë
39	74060860	1/12/2020	B..3	L.....O	13,121,780	ndërtimi i infrastrukturës urbane Lezhë
<b>TOTALI</b>					<b>32,881,380</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për këtë arsye subjektit do t'i kryhet sistemimi i shitjeve të përjashtuara në vlerën **32,881,380** lekë duke i kaluar në rubrikën shitje me 20%.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 1, ku përcaktohet se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. 2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar.”, rezultojnë detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.30: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Viti	2020
<b>Diferenca në vlerë të tatuashme</b>	<b>32,881,380</b>
Detyrim TVSH 20%	6,576,276
Gjobë për TVSH 21.9%	1,440,204
<b>Total</b>	<b>8,016,480</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ B...3” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 6,576,276 lekë detyrime të TVSH-së, 1,440,204 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 8,016,480 lekë.**

## 16. Subjekti: “R...R”.

NIPT-i: L....K.

Adresë Kryesore: Fshati Mize, Lagjja Nr.1, Divjakë.

Aktiviteti: Aktivitet ne fushën e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore.

Inspektori: B.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2021.10-2022-04.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2019-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2019.10- 2021.07.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2019.10- 2021.07.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.



- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.

-Konstatohet se ekzistojnë diferenca për vitin 2021 midis inventarit kontabël dhe inventarit fizik deklaruar nga subjekti, ku konkretisht rezulton se inventari kontabël në fund të periudhës 2021 është 4,057,700 lekë, ndërsa inventari fizik është 261,940 lekë, dhe diferenca ( 4,057,700 lekë – 261,940 lekë)= 3,795,760 lekë, subjektit do t'i trajtohen si shitje pa faturë tatimore.

Subjekti është objekt penalizimi me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe i lindin detyrimet si më poshtë:

Tabela 2.2.1.31: Përlllogaritja e detyrimeve të subjektit

Viti	2021
<b>Diferenca në vlerë të tatueshme</b>	<b>3,795,760</b>
Detyrim TVSH 20%	759,152
Gjobë për TVSH 100%	759,152
Detyrim për Tatim Fitimi (15%)	569,364
Gjobë për Tatim Fitimin 100%	569,364
<b>Total</b>	<b>2,657,032</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “ R...R ” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 569,364 lekë detyrime të TF dhe 569,364 lekë gjobë; 759,152 lekë detyrime të TVSH-së 759,152 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 2,657,032 lekë, nga të cilat 1,328,516 lekë detyrim dhe 1,328,516 lekë penalitet.**

### 17. Subjekti: “E...I”.

NIPT-i: K....L.

Adresë Kryesore: Sheq i Madh, Fier.

Aktiviteti: Tregtia Me Shumicë e Frutave dhe Perimeve.

Inspektori: G.V.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2016/05-2021/04.
- Për Tatim Fitimin-periudha tatimore nga: 2016-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2016/05-2021/04.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2016/05-2021/04.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepicës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje Për tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standarteve të kontabilitetit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.

- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

**18. Subjekti: "A.....R".**

NIPT-i: L.....B.

Adresë Kryesore: Lagjja "Sheq i Vogël", rruga "Leonardo Murialdo", banese private nr-36, Fier.

Aktiviteti: Import-eksport i mallrave të ndryshme ushqimore e industriale, konfeksioneve, të pajisjeve të ndryshme elektrike dhe elektronike, tregtimi i tyre me shumice e pakice.

Inspektori: J.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2020/11-2022/10.
- Për Tatim Fitimin - periudha tatimore nga: 2020-2021
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore - periudha tatimore nga: 2020/11-2022/10.
- Të Tjera- periudha tatimore nga: 2020/11-2022/10.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje Për tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standarteve të kontabilitetit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

**19. Subjekti: "D.....M".**

NIPT-i: L....F.

Adresë Kryesore: Lagjja Kastriot, Fier.

Aktiviteti: Ndërtimi i Ndërtesave Rezidenciale e Jo Rezidenciale.

Inspektori: E.M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga 2017.11-2021.02.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar furnitorët kryesorë.
- Janë analizuar blerjet e investimeve nga furnitorë vendas me shkallë 20%", ku situata është si më poshtë:

Tabela 2.2.1.32: Blerjet për investime.

Nr. Fature	Data	Emri i Shitësit	NIPT	Artikulli	Vlerë e tatueshme	TVSH
86	4/4/2019	UPT	J...T	Oponence Teknike	199,923	39,985
20	31/12/2019	R...4	K....F	Situacion Punimesh Dhjetor 2019	6,690,629	1,338,126
35	30/04/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Prill 2020	13,253,083	2,650,617
36	21/05/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Maj 2020	18,364,956	3,672,991
49	30/06/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Qershor 2020	12,558,533	2,511,707
38	31/10/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Tetor 2020	8,747,826	1,749,565
43	30/11/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Nëntor 2020	4,957,687	991,537
22	31/12/2020	R...4	K....F	Situacion Punimesh Dhjetor 2020	7,111,250	1,422,250
7	31/01/2021	R...4	K....F	Situacion Punimesh Janar 2021	23,203,158	4,640,632
10	28/02/2021	R...4	K....F	Situacion Punimesh Shkurt 2021	10,606,328	2,121,266
<b>Total</b>					<b>105,693,373</b>	<b>21,138,676</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga grupi i auditimit konstaton se nga ana e DRT Fier, janë certifikuar investime dhe është rimbursuar TVSH për vlera punimesh të papërfunduara, pavarësisht riskut teknik, ose risqeve të tjera që mund të çenojnë funksionimin, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme, të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit sipas përcaktimeve të Kreut IX “Lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. ***Për sa është trajtuar më lart, rezulton se subjektit nuk duhet t’i miratohej kërkesa për rimbursimin e TVSH-së.***

***Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “D.....M” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 21,098,674 lekë detyrime të TVSH-së.***

## 20. Subjekti: “S...I”.

NIPT: J...H.

Adresë Kryesore: Lagjja 16 Prilli , Fier.

Aktiviteti: Prodhim i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve.

Inspektori: D.S.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2020.02-2021.05.
- Për Tatim Fitimin- periudha tatimore nga: 2020-2021.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 2020.02-2021.05.
- Të tjera -periudha tatimore nga: 2020.02-2021.05.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standarteve të kontabilitetit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit.

## 21. Subjekti: “A.....4” SHPK.

NIPT: K...J.

**Adresë Kryesore:** Lagjja “1 Maj”, Fier.

**Aktiviteti:** Projektim, zbatim, ndërtim të objekteve civile, import-eksport, tregti etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** S.Z.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **06/2015-05/2020**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2015-2019**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **06/2015-05/2020**.

- Të tjera periudha tatimore nga: **06/2015-05/2020**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A...4” SHPK, ka rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet e shoqërisë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “*Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016*”, konkretisht:

*Tabela 2.2.1.33: Analiza e punimeve të ndërtimit në objektet e shoqërisë*

Periudha	Njësi të shitura	Njësia	Sipërfaqe	Kosto/m <sup>2</sup> EKB	Kosto	Dif	Dif Vlerë
2017	Apartamente	m <sup>2</sup>	2,150	31,597	23,056	8,541	18,363,150
2018	Apartamente	m <sup>2</sup>	2,151.35	31,597	22,522	9,075	19,523,501
2019	Apartamente	m <sup>2</sup>	1,843.73	31,597	26,110	5,487	10,116,547
<b>Total</b>							<b>48,003,198</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove, veprime të cilat në kundërshtim me nenin 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, ku citohet se: “*Gjithashtu, përcaktimi i kostos reale në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, përcaktohet në bazë të metodologjisë së dhënë në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Këto metodologji të llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit*”. Konkretisht nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “A...4” SHPK, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin Nr.1 “*Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret*” dhe Manualin Nr.2 “*Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave*” si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikeve 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “*Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016*”, nga ana e subjektit “A...4” SHPK, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullësi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk është

kryer rivlerësimi i situatës financiare sipas germave b dhe c të nenit 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe penalizimi për këto parregullësi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.34: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Diferenca e rivlerësuar	48,003,198
TVSH (20%)	9,600,640
Gjobë TVSH (100%)	9,600,640
Tatim Fitimi (15%)	7,200,480
Gjobë Tatim Fitimi (100%)	7,200,480
<b>Detyrime</b>	<b>33,602,239</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga grupi i auditimit u kontrolluan çmimet e shitjes të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim tek objektet e shoqërisë në Fier dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të qytetit të Fierit, të përcaktuar në tabelën nr.2 të Udhëzimit Nr.3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” dhe VKM Nr.168, datë 27.3.2019, Aneksi Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimi”.

Tabela 2.2.1.35: Analiza e punimeve të ndërtimit në objektet e shoqërisë

Periudha	Njësi të shitura	Njësi a	Sipërfaqe	Çmim Mes	Çmimi sipas Udhëzimit/VKM	Dif	Dif Vlerë
2017	Apartamente	m <sup>2</sup>	2,150	41,168	53,100	11,932	25,653,800
2018	Apartamente	m <sup>2</sup>	2,151.35	43,910	53,100	9,190	19,770,907
2019	Apartamente	m <sup>2</sup>	1,843.73	45,808	53,100	7,292	13,444,479
01-05 2020	Apartamente	m <sup>2</sup>	301.3	49,364	53,100	3,736	1,125,657
<b>Total</b>							<b>59,994,843</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në total shitje nën çmimin minimal fiskal rezultuan 59,994,843 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.36: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Diferenca totale Çmim Shitje - Çmim Referenc	59,994,843
Detyrim TVSH (20%)	11,998,969
Gjobë TVSH (50%)	5,999,484
Detyrim TF (15%)	8,999,226
Gjobë TF (50%)	4,499,613
<b>Detyrime</b>	<b>31,497,292</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “A...4” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 16,199,706 lekë detyrime të TF dhe 11,700,093 lekë gjobë; 21,599,609 lekë detyrime të TVSH-së dhe 15,600,124 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 65,099,531 lekë, nga të cilat 37,799,315 lekë detyrim dhe 27,300,217 lekë penalitet.**

## 22. Subjekti: “X...O” SHPK.

NIPT: K...C.

Adresë Kryesore: Lagja “Konferenca e Pezës”, Kompleksi Mëriti Tragjas, Pallati 4, Fier.

Aktiviteti: Ndërtim të veprave të ndryshme, Bar-kafe, Aktivitet në fushën e projektimit e ndërtimit të të gjitha llojeve të ndërtimit, civile, industriale, ristrukturim dhe modernizim i objekteve civile, industriale, ndërtimin dhe shtrimin e rrugëve në përgjithësi, import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë i mallrave të ndryshëm ushqimor, industriale, elektronike, pjese këmbimi për makina, etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: L.C.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2018-2019**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 12/2018-05/2020, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.399, datë 3.5.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nqs ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 12/2018-05/2020 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me parregullsitë e konstatuara, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.37: Përlllogaritjet e shpenzimeve për paga

Muaj	Nr pun	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH (1.7%)	Sig Sh PM (1.7%)	TAP (13%)	Paga Neto
Dhjetor 2018	67	1,665,935	1,973,074	307,139	46,071	29,178	5,221	5,221	0	272,739
Janar 2019	49	1,284,886	1,572,546	287,660	43,149	27,328	4,890	4,890	13,628	241,814
Shkurt 2019	51	1,336,658	1,641,384	304,726	45,709	28,949	5,180	5,180	14,480	256,117
Mars 2019	53	1,373,408	1,699,792	326,384	48,958	31,006	5,549	5,549	14,764	275,065
Prill 2019	54	1,323,566	1,737,936	414,370	62,156	39,365	7,044	7,044	15,332	352,629
Maj 2019	60	1,500,952	1,929,550	428,598	64,290	40,717	7,286	7,286	16,842	363,754
Qershor 2019	53	1,312,952	1,702,772	389,820	58,473	37,033	6,627	6,627	14,660	331,500
Korrik 2019	55	1,353,838	1,770,120	416,282	62,442	39,547	7,077	7,077	15,616	354,043
Gusht 2019	58	1,393,610	1,866,672	473,062	70,959	44,941	8,042	8,042	16,467	403,612
Shtator 2019	51	1,274,066	1,641,384	367,318	55,098	34,895	6,244	6,244	14,480	311,698
Tetor 2019	55	1,342,838	1,756,710	413,872	62,081	39,318	7,036	7,036	13,872	353,646
Nëntor 2019	56	1,329,496	1,802,304	472,808	70,921	44,917	8,038	8,038	15,900	403,954
Dhjetor 2019	54	1,307,860	1,737,936	430,076	64,511	40,857	7,311	7,311	15,332	366,576
Janar 2020	54	1,380,202	1,737,936	357,734	53,660	33,985	6,081	6,081	15,332	302,336
Shkurt 2020	40	990,202	1,287,360	297,158	44,574	28,230	5,052	5,052	11,357	252,520
Mars 2020	12	337,836	386,208	48,372	7,256	4,595	822	822	3,407	39,547
Prill 2020	24	675,672	754,536	78,864	11,830	7,492	1,341	1,341	4,490	65,542
Maj 2020	56	1,014,910	1,163,392	148,482	22,272	14,106	2,524	2,524	852	131,000
<b>Total</b>		<b>22,198,887</b>	<b>28,161,612</b>	<b>5,962,725</b>	<b>894,409</b>	<b>566,459</b>	<b>101,366</b>	<b>101,366</b>	<b>216,809</b>	<b>5,078,091</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.38: Rivlerësim i situatës financiare

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	22,198,887
2	Paga Bruto Rivlerësuar	28,161,612
3	Diferenca Paga Bruto	5,962,725
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>5,078,091</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	566,459
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	101,366
<b>7</b>	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>894,409</b>
<b>8</b>	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>101,366</b>
9	Diferenca TAP (13%)	216,809
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>6,073,866</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Penalizmi i subjektit nuk është kryer sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.39: Përlllogaritja e penaltetit për shpenzimet e pagave

Emërtimi	Vlera
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	894,409
Gjorbë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	894,409
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	566,459

Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	566,459
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	101,366
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	101,366
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	101,366
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	101,366
TAP (13%)	216,809
Gjobë TAP (100%)	216,809
<b>Detyrime</b>	<b>3,760,818</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar rikarakterizohet si e ardhura dhe penalizohet sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.40: Rivlerësim i shpenzimeve për paga

Emërtimi	Vlera
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	6,073,866
TVSH (20%)	1,214,773
Gjobë TVSH (21.9%)	266,035
Tatim Fitimi (15%)	911,080
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	199,526
<b>Detyrime</b>	<b>2,591,414</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli i PASH të subjektit për vitin 2019, duke kryer rillogaritjet dhe rakordimet midis të dhënave të FDP, librave të blerjes, faturave dhe bilancit kontabël, ka rezultuar se ekziston një diferencë e pajustificuar në vlerën 4,841,165lekë, konkretisht:

Tabela 2.2.1.41: Rillogaritjet dhe rakordimet midis të dhënave të FDP, librave të blerjes, faturave dhe bilancit kontabël,

Emërtimi	Vlera
Blerje brenda vendit	95,301,932
Importe mallrash	21,269,293
Ndryshimi i gjendjes (T2-T1)	4,751,468
Blerje aktivesh	- 6,350,561
<b>KMSH sipas PASH</b>	<b>114,972,132</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	101,799,774
Te tjera shpenzime	8,331,193
<b>KMSH sipas bilancit</b>	<b>110,130,967</b>
<b>Diferenca KMSH (PASH) – KMSH (Bilanc)</b>	<b>4,841,165</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Diferenca prej 4,841,165 lekë e shpenzimeve të njohura më pak në bilancin kontabël të vitit 2019, konsiderohet si shitje pa faturë dhe kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit duke e penalizuar sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela 2.2.1.42: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Diferenca e rivlerësuar KMSH	4,841,165
TVSH (20%)	968,233
Gjobë TVSH (100%)	968,233
Tatim Fitimi (15%)	726,175
Gjobë Tatim Fitimi (100%)	726,175
<b>Detyrime</b>	<b>3,388,816</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier



Nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar mangësi procedurale në trajtimin e pikave të programit të kontrollit tatimor, konkretisht:

- Nuk është kryer një analizë e plotë e faturave të blerjes dhe shitjes për periudhat objekt kontrolli sipas programit të kontrollit;
- Nuk është kryer një analizë e plotë e rritjes së çmimit të për produktet e shitura në vitin 2019;
- Nuk është kryer një analizë e plotë analitike e posteve të furnitorëve dhe kreditorëve të bilancit kontabël të shoqërisë;
- Nuk është kryer një analizë e plotë e diferencimit të çmimit të shitjes më shumicë dhe pakicë; Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

*Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “X...O” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 894,409 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 894,409 lekë gjobë 100%; 566,459 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 566,459 lekë gjobë 100%; 101,366 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 101,366 lekë gjobë 100%; 101,366 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 101,366 lekë gjobë 100%; 216,809 lekë detyrime TAP dhe 216,809 lekë gjobë 100%; 1,637,255 lekë detyrime të TF dhe 925,701 lekë gjobë; 2,183,006 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,234,268 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 9,741,048 lekë, nga të cilat 5,700,670 lekë detyrim dhe 4,040,378 lekë penalitet.*

### **23. Subjekti: “R....I” SHPK.**

NIPT: J.....O.

Adresë Kryesore: Lagjja Apollonia, Rruga Muharrem Agolli, Pasuria Nr.3/131, Fier.

Aktiviteti: Tregtim ëmbëlsirash të të gjitha llojeve, hapje lokalesh, shërbimi social, kafene, bar, pastičeri, restorant, hamburger, birrari, byrek, pite, suflaqe, bulmet, sallam, ushqimore, pjekje bluarje kafe, hoteleri, turizëm, industriale, teknik të bardhe elektronike, import-eksport të artikujve industrial, ushqimore. Ngritje linjash dhe fabrike për prodhimin e akulloreve të paketuara, dhe të gjitha ëmbëlsirat dhe çokollatat e paketuara. Furrë Buke.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: V.R.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **01/2020-05/2022**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2020-2021**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **01/2020-05/2022**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **01/2020-05/2022**.

Nga analiza e blerjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe shqyrtimi analitik i natyrës së tyre, rezulton se ato i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë dhe janë në funksion të sigurimit dhe ruajtjes së fitimit, më konkretisht:

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht lëndë e parë për procesin e prodhimit të bukës dhe ëmbëlsirave, pjesë këmbimi automjete, shërbime kontabiliteti, shërbime teknike, karburant etj dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 94% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.
- Importe investimesh me TVSH 20%, janë kryesisht makineri dhe pajisje për procesin e prodhimit të prodhimeve të brumit dhe ëmbëlsirave dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 3%-4% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer

mbi importet e deklaruar në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerje investime nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht makineri dhe pajisje për procesin e prodhimit të prodhimeve të brumit dhe ëmbëlsirave dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë 1.2%-1.8% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerje investime nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruar sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, janë kryesisht blerje nga subjekte biznesi vogël, shërbime pastrimi, taksa dhe tarifa, të cilat përbëjnë 0.1%-1% e totalit të blerjeve të kryera nga subjekti, përgjatë periudhës objekt kontrolli. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e përjashtuara nga furnitorët vendas, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruar sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga analiza e shitjeve për periudhën objekt kontrolli 01/2020-05/2022, konstatohet se subjekti ka kryer vetëm shitje të tatueshme me 20%, të prodhimeve të brumit kryesisht lloje të ndryshme buke dhe ëmbëlsira. Konkretisht ka realizuar shitje me kasë drejt individëve mbi 95%-98% të totalit të xhiros dhe 2%-5%, ka kryer shitje drejt subjekteve tregtare me NIPT. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e diferencimit të çmimit të shitjes më shumicë dhe pakicë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Nga kontrolli për kreditimin të karburantit, ka rezultuar se shoqëria është brenda normave të kreditimit, sepse objekti i veprimtarisë së subjektit klasifikohet tek veprimtaria e tregtisë dhe norma e lejuar e kreditimit të karburantit është 3% e qarkullimit vjetor sipas nenit 55 ” Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar.

*Tabela 2.2.1.43: Analiza e kreditimit të karburantit*

Periudha	Karburant kredituar	Norma e kreditimit sipas Udhëzimit Nr.6	Shitje Totale	Kreditim i lejuar
01/2020-12/2020	2,533,933	3%	108,411,124	3,252,334
01/2021-12/2021	3,581,918	3%	136,701,308	4,101,039
01/2022-05/2022	1,544,033	3%	62,275,042	1,868,251

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

- Nga analiza e bilancit material në raportin e kontrollit tatimor, për 15 artikujt e përzgjedhur nuk kanë rezultuar diferenca, por nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është përcaktuar baza e përzgjedhjes së këtyre artikujve, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilanceve kontabël të viteve 2020 dhe 2021, nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qenë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

- Nga kontrolli i PASH, janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklaratimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF, duke mos rezultuar diferenca nga raport kontrolli.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur dhe paguar saktë.

## **24. Subjekti: “C.....o” SHPK.**

NIPT: J.....E.

Adresë Kryesore: Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Vangjel Rrushku”, Godina Nr.67, Fier.

Aktiviteti: Punime gërmim në tokë, ndërtime civile dhe industrial, rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industrial veshje fasada, rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, punime nëntokësore, ura e vepra arti, diga e tunele hidroteknike, ujësjellësa, gazësjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: V.R.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **06/2021-05/2023**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2021-2022**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **06/2021-05/2023**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **06/2021-05/2023**.

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit tatimor rezulton se shoqëria për këtë periudhë ka kryer shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas Autorizimit Nr.432/1 Prot. datë 25.01.2020, në zbatim të Kontratës Nr.3221 Prot., datë 15.12.2020 me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), me objekti kontrate “Rikonstruksion i njësisve të banimit në ndërtesa në zonën e re për zhvillim Kavajë Paketa B, Objekti 2.1 Njësia Administrative Bashkia Kavajë”, në vijim të këtij autorizimi për periudhën objekt kontrolli, subjekti ka realizuar shitje të përjashtuara si nënkontraktor i “J.” SHPK, konkretisht:

Tabela 2.2.1.44: Shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas Autorizimit Nr.432/1 Prot. datë 25.01.2020

Nr	Emri blerësit	Rrethi	NIPT	Totali i Shitjeve	Shitje të përjashtuara
1	J.k SHPK	Lezhë	J...L	205,718,990	205,718,990

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “C....o” SHPK, konstatohet se nuk është bërë rregullimi i TVSH-së, në blerje për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, sepse shoqëria ka kryer shitje të përjashtuara për rindërtimin gjatë kësaj periudhe. Veprime këto që nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 69 “Zbritja e TVSH-së” të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për lejimin e plotë të kreditimit të TVSH-së në blerje, kur kryen aktivitetet të përzier.

Tabela 2.2.1.45: Analiza e TVSH-se 2021/06-2021/12-2021/01-2021/05

Përshkrimi i rubrikës	Shuma Progressive		Totali
	2021/06-2021/12	2021/01-2021/05	
Shitje të përjashtuara	205,718,990	29,388,427	235,107,417
Shitje të tatueshme me shkallë 20%	125,114,356	39,465,351	164,579,707
<b>Totali i shitjeve</b>			<b>399,687,124</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, rilogarisim koeficientin e zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve të nenit 72 “Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.46: Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së

Emërtimi	Vlera
Shitje të përjashtuara	235,107,417
Shitje të tatueshme me shkallë 20%	164,579,707
<b>Koef zbritjes TVSH-së</b>	<b>41.18%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli analitik i rubrikave “Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas” dhe “Blerje të përjashtuar” për vitin 2021, nuk janë evidentuar blerjet të cilat u kanë shërbyer të aktiviteteve nga të cilat janë gjeneruar shitjet e përjashtuara dhe mbi të cilat duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së.

Tabela 2.2.1.47: Blerje mbi të cilat duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së

Përshkrimi i rubrikës	Shuma Progressive		Totali
	2021/06-2021/12	2021/01-2021/05	
Blerje të përjashtuara	68,260,206	42,258,378	110,518,584
Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%	106,717,055	31,627,108	138,344,163
<b>Totali i blerjeve</b>			<b>248,862,747</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.48: Përlogaritja e zbritjes së TVSH sipas Koeficientit

Emërtimi	Vlera
Zbritja e TVSH sipas Koeficientit përfundimtar të TVSH	21,343,420
(-) zbritja e TVSH sipas Koeficientit fillestar të TVSH	13,553,842
<b>(=) Rregullimi i Zbritjes së TVSH</b>	<b>(7,789,578)</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu është kryer penalizmi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.49: Penaliteti për uljen e gjendjes kreditore të TVSH

Zëri i bilancit	2020
Ulje e gjendjes kreditore të TVSH	7,789,578
Gjobë TVSH (21.9%)	1,705,918
<b>Detyrime</b>	<b>9,495,496</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga analiza e bilancit kontabël të shoqërisë “C....o” SHPK, konkretisht e zërave “Dëftesa të pagueshme” dhe “Të ardhura të shtyra” të pasivit, të cilat sipas raport kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori, përfaqësojnë “Detyrimet ndaj Ortakut”, konkretisht në vlerat respektive:

Tabela 2.2.1.50: Analiza e bilancit kontabël të shoqërisë

Zëri	2022	2021	2020	2019
Dëftesa të pagueshme	61,954,711	3,165,681	19,143,397	0
Të ardhura të shtyra	0	22,811,884	0	0
	<b>61,956,733</b>	<b>25,979,586</b>	<b>19,145,417</b>	<b>0</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut, kushtet e vendosura, normat e interesit të aplikuara, plani i shlyerjes së huasë, përcaktimi i këstit, principalit dhe llogaritja e interesit, të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël, por vetëm është cilësuar se këto shuma kanë shërbyer për mbulimin e mungesës afatshkurtër të likuiditeteve të shoqërisë. Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se shoqëria për periudhën 2015-2022, ka kryer shpërndarjen e dividendit dhe pagesën e tatimit në burim.

Tabela 2.2.1.51: Tatimi i llogaritur për dividendët

Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016	2015
Dividentët	44,139,944			3,490,115				
Tatimi i llogaritur për dividendët	3,531,196			279,209				

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts të deklaratës individuale e të ardhurave (DIVA), ka rezultuar se ortaku i shoqërisë D.....a, për periudhën 2020-2022, nuk konstatohet të ketë të ardhura të tjera, përveç ato nga paga si administratore e shoqërisë, ku rezulton e regjistruar me pagën minimale për efekt sigurimesh si dhe të ardhurat nga dividenti si ortake. Në përfundim konstatohet se nga verifikimet dhe analizat e kryera të pasqyrave financiare të shoqërisë dhe të ardhurave individuale të ortakut se nuk justifikohen shuma e kaluara si kontribut borxhi i ortakut ndaj shoqërisë.

Tabela 2.2.1.52: Të ardhura bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit 2020-2022

Emërtimi	2022	2021	2020
Të ardhura bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit	678,546	479,545	369,454
<b>Total</b>	<b>678,546</b>	<b>479,545</b>	<b>369,454</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga ana e inspektori të kontrollit tatimor nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e mjeteve monetare të cilat kanë pretendohet se kanë kaluar si huadhënie nga ortaku drejt shoqërisë, veprime të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Në lidhje me mungesën e justifikimit nga të dhënat financiare të bilanceve kontabël, të shumave të cilat pretendohet se janë dhënë hua nga ortaku drejt shoqërisë, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin tatimor duke i konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimore në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Nga grupi i audituesve të KLSH janë kryer rillogaritjet duke rindërtuar situatën financiare të shoqërisë, duke përdorur të dhënat të cilat gjenden në pasqyrat financiare të deklaruara nga tatimpaguesi, konkretisht marzhet bruto të deklaruara në PASH për vitin 2021.

Tabela 2.2.1.53: Rillogaritje duke rindërtuar situatën financiare të shoqërisë

Zëri	Vlera
Divident i padekluar (Kontribut Ortaku)	6,843,168
Norma Dividenti (8%)	8%
Fitimi Neto i padekluar	7,390,621
Tatim Fitimi (15%)	15%
Fitimi Bruto	8,499,215
% Marzhi Bruto Mes (Viti 2021)	13.78%
<b>Të ardhurat e padeklaruara</b>	<b>9,670,406</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Është kryer penalizimi shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.54: Penalizimi shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 124 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008

Zëri	Vlera
Të ardhurat e padeklaruara	9,670,406
TVSH (20%)	1,934,081
Gjobë TVSH (100%)	1,934,081
Tatim Fitimi (15%)	1,450,561
Gjobë TF (100%)	1,450,561
Tatim mbi Dividentin (8%)	591,250
Gjobë Tatim Dividenti (100%)	591,250
<b>Detyrime</b>	<b>7,951,784</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga analiza dhe krahasimi i blerjeve të përjashtuara sipas FDP mujore me deklarimin sipas bilancit, ka rezultuar diferencë në vlerën 10,416,867 lekë e cila përbën shpenzime qeraje për shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve nga shoqëria.

Tabela 2.2.1.55: Analiza dhe krahasimi i blerjeve të përjashtuara sipas FDP mujore me deklarimin sipas bilancit

Emërtimi	Deklarimi sipas FDP mujore	Deklarimi sipas Bilancit 2022	Dif
Blerje Pa TVSH	50,706,770	61,123,637	10,416,867

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në C@ts, ka rezultuar se shoqëria nuk ka deklaruar dhe paguar tatimin në burim për qeratë e makinerive dhe pajisjeve të shfrytëzuara, në vitin 2022, konkretisht:

Tabela 2.2.1.56: Tatimi i llogaritur për pagesat për qeratë

Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2022	2021
Pagesat për qeratë	0	35,600,000
Tatimi i llogaritur për pagesat për qeratë	0	5,340,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga sa më sipër duke qenë se nuk është deklaruar dhe paguar tatimi në burim për qeratë e makinerive dhe pajisjeve, këto shpenzime do të kalojnë si shpenzime të panjohura për efekt fiskal të llogaritjes së fitimit të tatueshëm në PASH, sipas përcaktimeve të pikës II) të nenit 21 “Shpenzime të panjohura” të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Gjithashtu është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.57: Përlllogaritje e shpenzimeve të panjohura për efekt fiskal të llogaritjes së fitimit të tatueshëm në PASH

Zëri i PASH	2022
Shpenzime të panjohura (Shpenzime Qera makineri)	10,416,867
Tatim Fitim (15%)	1,562,530
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	342,194
<b>Detyrime</b>	<b>1,904,724</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “C...o” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 3,013,091 lekë detyrime të TF dhe 1,792,755 lekë gjobë, 9,723,659 lekë detyrime të TVSH-së dhe 3,639,999 lekë gjobë, 591,250 lekë**

*detyrime të Dividenti dhe 591,250 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 19,352,004 lekë, nga të cilat 13,328,000 lekë detyrim dhe 6,024,004 lekë penalitet.*

**25. Subjekti:** “H.....s” SHPK.

NIPT: L.....M.

Adresë Kryesore: Ish fabrika e tullave, Lushnje.

Aktiviteti: Ndërtim si edhe nxjerrje dhe tregti të qymyrit bituminoz.

Lloji i Kontrollit: Rimbursim TVSH.

Inspektori: A.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **07/2022 – 07/2022.**

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Shoqëria “H.....s” SHPK me kërkesën Nr.RAE0000224869, me Nr. Cështje E0000984673 datë 21.06.2022, ka kërkuar rimbursim të TVSH-së kreditore në shumën 18,837,174 lekë, për periudhën 07/2022-07/2022, në Drejtorin e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, protokolluar në DRT Fier me Nr.12508/1 datë 06.09.2022, për këtë ka dalë Programi i Kontrollit Nr.12508/1., prot., datë 07.09.2022.

Nga analiza e shitjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe kontrolli me të dhënat sipas C@ts të librave mujor të shitjeve dhe FDP të TVSH-së, ka rezultuar se:

- Eksportet e shoqërisë, përbëjnë 78% të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë me eksporte jashtë vendit të qymyrit, koksit dhe zhavorrit bituminozë. Nga verifikimi i të dhënave nga DPD në lidhjet me eksportet me deklaratimet e subjektit në sistemin C@ts, ka rezultuar një diferencë prej 287,149 lekë, deklaruar më tepër nga subjekti e cila nuk justifikohet me deklaratat doganore dhe nga ana e inspektorit të kontrollit, janë rivlerësuar shitjet e tatueshme dhe penalizuar subjekti, sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

- Shitjet e tatueshme të mallrave me TVSH 20%, përbëjnë mbi 16.9% të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë me shitjen brenda vendit të materialeve të ndërtimit dhe qymyrit koks. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është kryer kontrolli i shitje pa TVSH, përgjatë periudhës objekt kontrolli me të dhënat e sistemit informatik C@ts dhe nga ana e inspektorit të kontrollit janë rivlerësuar në ulje shitjet pa TVSH në vlerën 2,043,650, duke i kaluar si shitje të përjashtuara sepse kanë të bëjnë me dhënie qira ambientesh, rivlerësim ky që nuk ka efekt në tepricën e gjendjes kreditore të TVSH-së të kërkuar për rimbursim.

Nga analiza e blerjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe shqyrtimi analitik i natyrës së tyre, rezulton se lejohet kreditimi i TVSH-së, së blerjeve, sepse ato i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë dhe janë në funksion të sigurimit dhe ruajtjes së fitimit, më konkretisht:

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht qymyr koks, materiale ndërtimi, karburant, pjesë këmbimi, energji elektrike, shpenzime riparimi, meremetime, taksa etj, të cilat përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 73% e totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, janë kryesisht siguracione, shpenzime transporti, taksa të ndryshme etj, të cilat përbëjnë 17% e totalit të blerjeve të kryera

nga subjekti, përgjatë periudhës objekt kontrolli. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e përjashtuara nga furnitorët vendas, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Investime nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht mjete transporti si trajlera, koka tërheqëse, rimorkio etj dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë 6% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi investimet nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e mallrave nga importi me TVSH 20%, janë kryesisht materiale, përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 4% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi importet e deklaruar në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është kryer bilanci material për periudhën 07/2022-07/2022, duke u bazuar tek gjendjet kontabël të artikujve të përzgjedhur në datat 01.07.2022 dhe 31.07.2022 si dhe hyrjet/daljet përgjatë periudhës, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është kryer analiza krahasimore e çmimit të shitjes në krahasim me çmimin e blerjes dhe nuk kanë rezultuar shitje nën kosto, konkretisht marzhi i rritjes së çmimit për periudhën korrik 2022 është nga 23% në 185%.

## **26. Subjekti: "L.C" SHPK.**

NIPT: L...F.

Adresë Kryesore: Lagjja 1 Maj, Fier.

Aktiviteti: Aktivitete në fushën e ndërtimit.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: J.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 07/2019-06/2021.

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019-2020.

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 07/2019-06/2021.

- Të Tjera periudha tatimore nga: 07/2019-06/2021.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 07/2019-06/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre më përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 "Mbajtja e regjistrimeve" të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.



- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nqs ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 07/2019-06/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me parregullsitë e konstatuara, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.58: Perllogaritje për rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit

Muaj	Nr pun	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH (1.7%)	Sig Sh PM (1.7%)	TAP (13%)	Paga Neto
Korrik 2019	53	738,000	886,848	148,848	22,327	14,141	2,530	2,530	5,394	126,783
Gusht 2019	53	1,068,000	1,280,856	212,856	31,928	20,221	3,619	3,619	6,814	182,202
Shtator 2019	59	1,285,000	1,575,824	290,824	43,624	27,628	4,944	4,944	13,060	245,192
Tetor 2019	52	1,177,000	1,394,640	217,640	32,646	20,676	3,700	3,700	9,653	183,611
Nëntor 2019	34	925,000	1,094,256	169,256	25,388	16,079	2,877	2,877	9,653	140,646
Dhjetor 2019	36	991,000	1,158,624	167,624	25,144	15,924	2,850	2,850	10,221	138,629
Janar 2020	35	921,000	1,090,084	169,084	25,363	16,063	2,874	2,874	7,666	142,481
Shkurt 2020	44	1,033,000	1,214,648	181,648	27,247	17,257	3,088	3,088	7,666	153,638
Mars 2020	21	119,000	144,232	25,232	3,785	2,397	429	429	568	21,838
Prill 2020	4	54,000	64,368	10,368	1,555	985	176	176	0	9,207
Maj 2020	4	43,000	44,104	1,104	166	105	19	19	0	980
Qershor 2020	2	17,000	17,880	880	132	84	15	15	0	781
Shtator 2020	3	31,500	32,184	684	103	65	12	12	0	607
Nëntor 2020	1	20,000	20,264	264	40	25	4	4	0	234
<b>Total</b>		<b>8,422,500</b>	<b>10,018,812</b>	<b>1,596,312</b>	<b>239,447</b>	<b>151,650</b>	<b>27,137</b>	<b>27,137</b>	<b>70,695</b>	<b>1,346,830</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.59: Rivlerësim i situatës financiare

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	8,422,500
2	Paga Bruto Rivlerësuar	10,018,812
3	Diferenca Paga Bruto	1,596,312
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>1,346,830</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	151,650
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	27,137
<b>7</b>	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>239,447</b>
<b>8</b>	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>27,137</b>
9	Diferenca TAP (13%)	70,695
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>1,613,414</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Penalizimi i subjektit nuk është kryer sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.60: Penalizimi i subjektit për shpenzimet e pagave

Emërtimi	Vlera
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	239,447
Gjobë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	239,447
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	151,650
Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	151,650
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	27,137
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	27,137
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	27,137
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	27,137
TAP (13%)	70,695
Gjobë TAP (100%)	70,695
<b>Detyrime</b>	<b>1,032,132</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar rikarakterizohet si e ardhura dhe penalizohet sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.61: Rivlerësim i shpenzimit të fondit të pagave

Emërtimi	Vlera
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	1,613,414
TVSH (20%)	322,683
Gjobë TVSH (21.9%)	70,668
Tatim Fitimi (15%)	242,012
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	53,001
<b>Detyrime</b>	<b>688,364</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga analiza e bilancit kontabël të shoqërisë “L.C” SHPK, tek zërat e detyrimeve afatgjata të pasivitet, konkretisht “Të tjera të pagueshme” që sipas raport kontrollit të hartuar nga inspektori përfaqësojnë detyrimet ndaj ortakut për kontributet e derdhura në shoqëri dhe “Huamarrje afatgjata” të cila përfaqësojnë hua të marra me kontratë nga individ E. C., konkretisht në vlerat respektive:

Tabela 2.2.1.62: Analiza e detyrimeve afatgjata

Detyrimet Afatgjata	2020	2019	2018
Huamarrje afatgjata (Hua nga E.C)	203,441,197	203,441,197	0
Huamarrje afatgjata nga Ortaku	147,643,409	91,371,200	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me huanë e marrë në vlerën 203,441,197 lekë, nga individ E.C., në raportin e kontrollit është sqaruar se është marrë nëpërmjet Kontratës Nr.765, datë 08.08.2019 dhe transaksioni ka kaluar nëpërmjet bankës. Gjithashtu nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts dhe nga praktika dokumentare e vendosur në dispozicion gjatë fazën së punës audituese në terren, ka rezultuar se për individin E.C, është kryer kontroll tatimor nga Drejtoria e Kontrollit të Specializuar në DPT, dërguar në DRT Fier me shkresën Nr.10612 Prot., datë 16.06.2023, për kontabilizim, ku ka rezultuar se sipas verifikimeve dhe llogaritjeve është justifikuar shuma e dhënë hua shoqërisë “L.C” SHPK.

Tabela 2.2.1.63: Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të Ardhurat (Flukse Hyrëse)		Shpenzime (Flukset Dalëse)	
Zëri	Lek	Zëri	Lek
Gjendja Fillestare Para në dorë	11,797,335	Gjendja Përfundimtare Para në dorë	-

Kredituar llogaria e aksionarit nga llogaria e subjektit (ALL)	80,500,000	Debituar llogaria e aksionarit nga llogaria e subjektit (ALL)	-
Kredituar llogaria e aksionarit nga llogaria e subjektit (Euro)	2,991,205	Debituar llogaria e aksionarit nga llogaria e subjektit (Euro)	-
Balanca e çeljes së bankës BKT, (ALL)	32,706,025	Balanca e mbylljes së bankës BKT, (ALL)	22,647,816
Balanca e çeljes së bankës BKT, (Euro)	117,064	Balanca e mbylljes së bankës BKT, (Euro)	14,847,355
Paga Bruto	-	Tatimi mbi pagën (11.2% dhe 13%)	98,400
Shitje e obligacionit 5 vjeçar	110,000,000	Tatim mbi interesat e obligacioneve	139,416
Interesat e obligacionit	6,119,964	<b>Hua L.C</b>	<b>203,441,197</b>
Interesat e obligacionit Premium	929,440	Hua E. C.	1,500,000
Të ardhurat nga shitja e obligacionit Premium	-	Tatim nga shitja e obligacioneve Premium	-
Të ardhura të tjera	-	Tarifa noteriale	-
Trashëgimia e marrë	-	Shpenzime personale jetese	202,800
Të ardhurat nga interesat bankare	-	Komisione	30,000
Të ardhura nga dividendët	-	Komisione llogarie	4,192
<b>Totali i hyrjeve</b>	<b>245,161,033</b>	<b>Totali i daljeve</b>	<b>242,911,176</b>
<b>Teprica e të ardhurave (Hyrjeve)</b>	<b>2,249,857</b>	<b>Teprica e shpenzimeve (Dalëse)</b>	<b>-</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me huamarrjen afatgjatë nga ortaku konstatohet se në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut, kushtet e vendosura, normat e interesit të aplikuar, plani i shlyerjes së huasë, përcaktimi i kështit, principalit dhe llogaritja e interesit, të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël, por vetëm është cilësuar se këto shuma kanë shërbyer për mbulimin e mungesës së likuiditeteve të shoqërisë.

Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se shoqëria është themeluar në 29.05.2017 dhe për periudhën 2017-2020, nuk ka kryer shpërndarjen e dividendit si më poshtë:

Tabela 2.2.1.64: Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim

Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2020	2019	2018	2017
Dividentët	0	0	0	0
Tatimi i llogaritur për dividendët	0	0	0	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në C@ts dhe sipas të dhënave të QKB-së, ka rezultuar se ortakët e shoqërisë A.C, E.C, I.C, figurojnë aksionar në shoqëritë si më poshtë:

Tabela 2.2.1.65: Organizimi i shoqërisë

Ortaku/Shoqëria	L.T.E Construction	Trust Construction	Best Construction
A.C	33%	100%	50%
E.C	34%	-	-
I.C	33%	-	-

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga të dhënat e sistemit C@ts dhe QKB-së, ka rezultuar se shoqëria "T.C" SHPK e themeluar në 01.06.2020 dhe shoqëria "B.C" SHPK e themeluar në 21.01.2019, për periudhën 2019-2020, nuk kanë kryer shpërndarjen e dividendit dhe pagesën e tatimit në burim.

Tabela 2.2.1.66: Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim

Shoqëria	Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2020	2019
T....C SHPK	Dividentët	0	0
	Tatimi i llogaritur për dividendët	0	0
B.....C SHPK	Dividentët	0	0
	Tatimi i llogaritur për dividendët	0	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Përgjatë kësaj periudhe 3 ortakët e shoqërisë nuk rezultojnë të kenë të ardhura të tjera, përveç ato nga paga në shoqëri, ku konstatohet se janë të regjistruar me pagën minimale për efekt sigurimesh.

Tabela 2.2.1.67: Pozicionet dhe pagat e ortakëve të shoqërisë

Emër Mbiemër	Pozicioni	Paga		
		2019	2020	2021
A.C	Drejtor Ekzekutiv në aktivitete ndërtimi	40,000	100,000	100,000
I.C	Përgjegjës Sektori në ndërtim	26,000	26,000	30,000
E.C	Përgjegjës Sektori në ndërtim	26,000	26,000	30,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu nga kontrolli i zërave “Fitimi/humbja e periudhës”, për vitet 2017-2021, rezulton se nuk janë gjendje fitimi të akumuluar, për të justifikuar shumën e cila pretendohet se është derdhur si kontribut borxhi i ortakut.

Tabela 2.2.1.68: Fitimi/(humbja) e periudhës

Periudha	2021	2020	2019	2018	2017
Fitimi/(humbja) e periudhës	14,991,452	21,130,791	10,943,080	1,551,944	3,974,773
<b>Totali</b>	<b>14,991,452</b>	<b>21,130,791</b>	<b>10,943,080</b>	<b>1,551,944</b>	<b>3,974,773</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga ana e inspektori të kontrollit tatimor nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumën e mjeteve monetare të cilat kanë pretendohet se kanë kaluar si huadhënie nga ortakët drejt shoqërisë, veprime të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Në lidhje me mungesën e justifikimit nga të dhënat financiare të bilanceve kontabël, të shumave të cilat pretendohet se janë dhënë hua nga ortakët drejt shoqërisë, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin tatimor duke i konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Nga grupi i audituesve të KLSH janë kryer rilogaritjet duke rindërtuar situatën financiare të shoqërisë, duke përdorur të dhënat të cilat gjenden në pasqyrat financiare të deklaruara nga tatimpaguesi, konkretisht marzhet bruto të deklaruara në PASH për vitet 2019 dhe 2020.

Tabela 2.2.1.69: Të ardhurat e padeklaruara

Zëri	2020	2019
Divident i padekluar (Kontribut Ortaku)	56,272,209	91,371,200
Norma Dividenti (8%)	8%	8%
Fitimi Neto i padekluar	60,773,986	98,680,896
Tatim Fitimi (15%)	15%	15%
Fitimi Bruto	69,890,084	113,483,030
% Marzhi Bruto	5.90%	8.32%
<b>Të ardhurat e padeklaruara</b>	<b>74,013,599</b>	<b>122,924,819</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Është kryer penalizimi shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.70: Rivlerësim i situatës financiare

Zëri	2020	2019
Të ardhurat e padeklaruara	74,013,599	122,924,819
TVSH (20%)	14,802,720	24,584,964
Gjobë TVSH (100%)	14,802,720	24,584,964
Tatim Fitimi (15%)	11,102,040	18,438,723
Gjobë TF (100%)	11,102,040	18,438,723
Tatim mbi Dividentin (8%)	5,032,925	8,358,888
Gjobë Tatim Dividenti (100%)	5,032,925	8,358,888
<b>Detyrime</b>	<b>61,875,368</b>	<b>102,765,148</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “L.C” SHPK, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin Nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor për vitin 2020, ka rezultuar se shoqëria ka kryer punime si më poshtë, për të cilat janë të nevojshme makineri dhe pajisje specifike për realizimin e tyre.

Tabela 2.2.1.71: Punime të kryera nga ana e shoqërisë

Institucioni/Subjekti	Punime	Njësia	Sasi	Çmimi	Vlera
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural	Gërmim transport dheu	m <sup>3</sup>	1,251	266	332,570
UKT Tiranë (Situacion 2020)	Gërmim dheu me ekskavatorë	m <sup>3</sup>	3,963	287	1,137,080
	Hedhje, mbushje, ngjeshje dheu	m <sup>3</sup>	398	150	59,652
	Prerje asfalti	ml	6,532	219	1,433,233
	Transport dheu deri 5km	m <sup>3</sup>	3,566	250	891,548
Situacione Godinë 11 Kate	Gërmim themeleve godinë 11 kate	m <sup>3</sup>	13,500	725	6,256,664
<b>Totali</b>					<b>10,110,747</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts për vitin 2020, konkretisht tek seksioni i “Bilancit i tatimpaguesit”, “Formati i pasurive të luajtshme-Makina”, rezulton se shoqëria nuk ka makina në pronësi. Në sistemin C@ts nuk janë deklaruar kontrata qera për makineri dhe pajisje pune dhe nga kontrolli i deklaramit dhe pagesave të tatimit në burim në sistemin C@ts, rezulton vetëm për qera objekti për vitin 2020, konkretisht:

Tabela 2.2.1.72: Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim

Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2020
Pagesat për qeratë	385,000
Tatimi i llogaritur për pagesat për qeratë	57,750

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Sipas inspektorit të kontrollit është trajtuar në raport si në vijim: “Bazuar në deklaramet e subjektit dhe në shkresën e DPT-së Nr.21756/1., datë 13.12.2021, protokolluar në DRT Fier

Nr.16637., Prot datë 15.12.2021, subjekti për punimet në objekte të ndryshme ka lidhur kontrata me individë dhe subjekte tatimpagues për mjete si vijon. PAGESA në kontratë është shkruar për çdo orë pune 1,000 lek me proces-verbal në fund të muajit. Subjekti deklaroi se pavarësisht kontratës kontakti me këto subjekte ka qënë i vështirë për të filluar punën”. Në vijim inspektori ka kryer vlerësim alternativ të situatës duke supozuar se çdo kontratë qeraje për makineri me 10 orë pune, veprim ky i pa argumentuar teknikisht sepse duhet të ishte kryer zbërthimi i situacioneve të punimeve ndërtimore, ku nevojiten makineri dhe pajisje, si gërmim, transport, hedhje, mbushje dhe ngjeshje dhe sipas Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, për të përlogaritur saktë orët e punës të shfrytëzimit të makinerive dhe pajisjeve. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se tatimpaguesi ka plotësuar gabim deklaratat tatimore dhe nuk mban llogari dhe regjistrime të sakta të transaksioneve, prandaj do të kryhet vlerësimi alternativ i situatës financiare, duke qënë se plotësohen kushtet sipas përcaktimeve të gërmës b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.73: Shpenzime të padeklaruar tatim në burim

Zëri	Vlera
Të ardhurat e deklaruara nga punimet me makineri	10,110,747
Marzhi Bruto % (Viti 2020)	6%
<b>Shpenzime të padeklaruar tatim në burim</b>	<b>9,538,441</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Duke penalizuar subjektin për mos llogaritjen, mbajtën dhe pagimin e tatimit në burim për qeratë e makinerive sipas përcaktimeve të pikës c të nenit 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.74: Përlogaritja e detyrimeve për mos llogaritjen, mbajtën dhe pagimin e tatimit në burim për qeratë e makinerive

Zëri	Vlera
Shpenzime Qera Makineri-Pajisje	9,538,441
Tatim në Burim Qera (15%)	1,430,766
Gjobë Tatim në Burim Qera (100%)	1,430,766
<b>Detyrime</b>	<b>2,861,532</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me shpenzimet e qerave të makinerive të padeklaruara saktë nga ana e subjektit është kryer rivlerësimi i situatës financiare ku shpenzimet e qerave të makinerive janë rikarakterizuar si e ardhura dhe për pasojë penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.75: Rivlerësimi i situatës financiare

Zëri	Vlera
Rivlerësim shpenzimeve	9,538,441
TVSH (20%)	1,907,688
Gjobë TVSH (100%)	1,907,688
Tatim Fitimi (15%)	1,430,766
Gjobë TF (100%)	1,430,766
<b>Detyrime</b>	<b>6,676,908</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “L.C” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 239,447 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 239,447 lekë gjobë; 151,650 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe**

*151,650 lekë gjobë; 27,137 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 27,137 lekë gjobë; 27,137 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 27,137 lekë gjobë; 70,695 lekë detyrime TAP dhe 70,695 lekë gjobë; 31,213,541 lekë detyrime të TF dhe 31,024,530 lekë gjobë; 41,618,055 lekë detyrime të TVSH-së dhe 41,366,040 lekë gjobë; 13,391,813 lekë detyrime të Dividenti dhe 13,391,813 lekë gjobë, 1,430,766 lekë detyrime të Tatim në burim dhe 1,430,766 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 175,899,456 lekë, nga të cilat 88,170,241 lekë detyrim dhe 87,729,215 lekë penalitet.*

**27. Subjekti:** "F...N" SHPK.

NIPT: L...H.

Adresë Kryesore: Karbunare e Poshtme me Nr. Pasurie 607/259, Zona Kadastrale 2087, Lushnje.

Aktiviteti: Import-Eksport mallra të ndryshëm, industrial si materiale ndërtimi e të tjera të këtij lloji. Tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve industriale dhe ushqimor. Punime të ndryshme ndërtimi. Prodhim i materialeve të ndryshme të ndërtimit etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: G.M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **03/2020-02/2022**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2020-2021**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **03/2020-02/2022**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **03/2020-02/2022**.

Nga analiza e blerjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe shqyrtimi analitik i natyrës së tyre, rezulton se ato i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë dhe janë në funksion të sigurimit dhe ruajtjes së fitimit, më konkretisht:

- Blerjet e mallrave nga importi me TVSH 20%, janë kryesisht materiale ndërtimi dhe specifikisht bojëra, përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 78% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi importet e deklaruar në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD nuk kanë rezultuar diferenca ndryshe nga ato të paraqitura në raport kontrollin tatimor.

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht materiale ndërtimi dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 19% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, janë kryesisht siguracione, bileta dhe transport ndërkombëtar, të cilat përbëjnë vetëm 1% e totalit të blerjeve të kryera nga subjekti, përgjatë periudhës objekt kontrolli. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e përjashtuara nga furnitorët vendas, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Investime nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht kompjuter, makineri përzierje boje, mjete transporti, kondicioner etj dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 1% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e investimeve nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Investime nga importi me TVSH 20%, janë kryesisht aktive si makineri dhe pajisje dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 0.3% e totalit të totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi investimet nga importi me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë

rezultuar diferenca. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi importet e investimeve me TVSH 20%, të deklaruar në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD nuk kanë rezultuar diferenca.

Nga analiza e shitjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe kontrolli me të dhënat sipas C@ts të librave mujor të shitjeve dhe FDP të TVSH-së, ka rezultuar se:

- Shitjet e tatueshme të mallrave me TVSH 20%, përbëjnë mbi 99.5% të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë me shitjen e mallrave për rishitje, aktiveve të prodhuara dhe faturime të punimeve të ndërtimit. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Furnizimet me shkallë 0%, përbëjnë vetëm 0.5% të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë me bonuset e përfituara nga niveli i blerjeve të realizuara. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga analiza e bilancit material në raportin e kontrollit tatimor të 30 artikujve të përzgjedhur nga artikujt e inventarit analitik të mallrave të deklaruar në C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca, ndryshe nga ato të konstatuara nga inspektori i kontrollit, por nga inspektori nuk është përcaktuar baza e përzgjedhjes së këtyre artikujve, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Nga kontrolli për kreditimin të karburantit, ka rezultuar se shoqëria ka kredituar 0.62%-0.81% karburant në raport me qarkullimin vjetor për periudhën objekt kontrolli, kreditim ky që është brenda normave të kreditimit të lejuar, sepse objekti i veprimtarisë së subjektit klasifikohet tek veprimtaria e tregtisë dhe norma e lejuar e kreditimit të karburantit është 3% e qarkullimit vjetor sipas nenit 55 ” Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar.

- Duke u bazuar tek faturat e blerjeve dhe të shitjeve, është kryer analiza e rritjes së çmimit bruto, nga ku rezulton 8% për vitin 2020 dhe 9% për vitin 2021, mbi nivelet e industrisë ku subjekti operon.

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilanceve kontabël të viteve 2020 dhe 2021, nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qenë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

- Nga kontrolli i PASH, janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklaratimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF, duke mos rezultuar diferenca nga raport kontrolli.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur dhe paguar saktë.

**28. Subjekti:** “S.....07” SHPK.

NIPT: K....W.

Adresë Kryesore: Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Zona Kadastrale Nr.1143, Nr.Pasurie 186/7, Fier.

Aktiviteti: Në fushën e ndërtimit të çdo lloji, studimit, projektimit, ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, rikonstruksione, vepra betonarmeje të veçanta, portuale, rrugore, kanalesh e kanalizime, hekurudhore e aeroportuale, vepra arti, rrugore, hekurudhore, hidraulike, tunele të impianteve të prodhimit dhe të shpërndarjes së energjisë, instalime dhe montimi i makinerive ngritëse dhe transportuese, mirëmbajtje dhe shërbime të sistemit



komunal, studime e projektme urbanistike të çdo lloji, mirëmbajtje rutine rrugësh e objekte të ndryshme ndërtimi, etj.

Lloji i Kontrollit: Vizitë fiskale.

Inspektori: E.F.

Inspektori: A.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **01/2021-12/2021**.

- Të **TAP** nga: **01/2021-12/2021**.

**Objekt i kontrollit:** Kontroll të vetdeklarimeve mbi nivelin e pagave, llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit si dhe kontrollit në funksion të faktorëve të riskut nxjerre nga Njësia Speciale Anti Informalitet, ngritur me Urdhërin Nr.1, datë 05/01/2022 “Për ngritjen e Njesisë Speciale Anti Informalitet për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet”.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, ka rezultuar se: Nisur nga problematikat që kanë rezultuar me pagat të evidentuara nga kontrollet e Inspektoratit të Punës si nga konstatimet gjatë intervistës me punëmarrësit e shoqërisë, ku ka rezultuar mospërputhje midis pagës së përfituar të vetdeklaruar dhe pagës që paraqitet në listëpagesën që shoqëria deklaron si dhe nga fakti që shoqëria me marrjen e njoftimit për kontroll tatimor lidhur me pagat, ka ndryshuar vullnetarisht pagat për periudhën Shkurt 2022 e në vijim, qëndrimi i grupit të kontrollit ka qënë që shoqëria për aktivitetin e ndërtimit ka nëndeklaruar pagat e përfituara nga punëmarrësit. Nga grupi i kontrollit është kryer rikarakterizimi i pagave të punonjësve me pozicione pune, të cilët kanë punuar 22-31 ditë pune, me bazë vlerësimi pagën mesatare të profesionit sipas informacionit të marrë elektronikisht datë 29.06.2022 nga AKSHI, për Njësinë Speciale Anti Informalitet.

*Tabela 2.2.1.76: Rikarakterizimi i pagave të punonjësve me pozicione pune*

Kodi i profesionit	Përshkrimi i profesionit	Paga mesatare mujore deklaruar nga shoqëria	Paga mesatare mujore për Qarkun Fier	Shtesa	Shtesa në %
7131.07	Bojaxhi për ndërtesa	30,000	31,356	1,356	4.52%
8342.01	Drejtues buldozeri	30,000	35,490	5,490	18.30%
8342.02	Drejtues ekskavatori	30,000	41,464	11,464	38.21%
8342.03	Drejtues fadrome/fadromist	30,000	33,460	3,460	11.53%
8342.03	Drejtues fadrome/fadromist	30,000	33,460	3,460	11.53%
7411.01	Elektracist	30,000	36,880	6,880	22.93%
7411.13	Elektracist për ndërtesa	30,000	33,380	3,380	11.27%
7114.04	Hekurkthyes	30,000	30,520	520	1.73%
7126.03	Hidraulik	30,000	34,101	4,101	13.67%
3221.03	Infermier	30,000	58,026	28,026	93.42%
2142.03	Inxhinier hidraulik	30,000	44,579	14,579	48.60%
2142.07	Inxhinier ndërtesash	31,125	46,833	15,708	50.47%
2148.03	Inxhinier prodhimi nafte dhe gazi	30,833	45,564	14,731	47.78%
2133.13	Inxhinier pyjesh	30,000	30,814	814	2.71%
7231.06	Mekanik automjetesh	30,000	33,044	3,044	10.15%
7231.13	Mekanik servisi	30,000	30,668	668	2.23%
7112.05	Murator për mure tulle	30,000	31,584	1,584	5.28%
9312.01	Pastrues terreni	30,000	31,003	1,003	3.34%
9312.01	Pastrues terreni	30,000	31,003	1,003	3.34%
9312.02	Punëtor krahu	30,000	30,652	652	2.17%
7212.09	Saldator	30,000	36,875	6,875	22.92%
8332.14	Shofer kamioni	30,000	35,520	5,520	18.40%
3119.15	Teknik ndërtimi	30,000	36,943	6,943	23.14%
3115.22	Teknik/përgjegjës sektori	30,000	64,980	34,980	116.60%

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Tabela 2.2.1.77: Paga Bruto gjithsej në lekë pas rivlerësimit

Periudha Tatimore	Nr pun	Paga Bruto gjithsej në lekë para rivlerësimit	Shtese Pagë Bruto	Paga Bruto gjithsej në lekë pas rivlerësimit
(2101) Janar 2021	64	1,930,000	437,989	2,367,989
(2102) Shkurt 2021	63	1,900,000	432,470	2,332,470
(2103) Mars 2021	62	1,860,000	436,950	2,296,950
(2104) Prill 2021	62	1,860,000	435,590	2,295,590
(2105) Maj 2021	60	1,800,000	386,031	2,186,031
(2106) Qershor 2021	58	1,740,000	379,860	2,119,860
(2107) Korrik 2021	58	1,740,000	381,279	2,121,279
(2108) Gusht 2021	63	1,894,000	443,906	2,337,906
(2109) Shtator 2021	62	1,866,000	430,442	2,296,442
(2110) Tetor 2021	62	1,866,000	430,442	2,296,442
(2111) Nëntor 2021	60	1,804,000	410,090	2,214,090
(2112) Dhjetor 2021	64	1,924,000	426,741	2,350,741
<b>Totali</b>		<b>22,184,000</b>	<b>5,031,790</b>	<b>27,215,790</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Subjekti “S.....07” SHPK përgjatë periudhës së auditimit ka qenë objekt kontrolli në vend nga DRT Fier, në bazë të programit të kontrollit të vizitës fiskale “Kontroll të vetdeklarimeve mbi nivelin e pagave, llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit si dhe kontrollit në funksion të faktorëve të riskut nxjerre nga Njësia Speciale Anti Informalitet, ngritur me Urdhërin Nr.1, datë 05/01/2022 “Për ngritjen e Njesisë Speciale Anti Informalitet për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet“, në të cilin konstatohet se nuk janë përfshirë si drejtime kontrolli përgjegjësi tatimore të TVSH-së dhe TF-së. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “S.....07” SHPK, është konstatuar nga ana e inspektorëve se subjekti ka nëndeklaruar pagat reale të punonjësve, por nuk është kryer rivlerësimi i situatës financiare, për të rikarakterizuar si të ardhura shpenzimet e fondit të pagave të rivlerësuar, në vlerën 4,655,753 lekë, referuar faktit se subjekti ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a, b të nenit 72 dhe penalizim sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.78: Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	22,184,000
2	Paga Bruto Rivlerësuar	27,215,790
3	Diferenca Paga Bruto	5,031,790
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>3,811,770</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	480,346
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	85,541
<b>7</b>	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>758,442</b>
<b>8</b>	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>85,541</b>
9	Diferenca TAP (13%)	654,133
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>4,655,753</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

## 29. Subjekti: “S.....A” SHPK.

NIPT: K.....P.

Adresë Kryesore: Rruga Nacionale Levan-Vlorë Km 3, Magazinë 1 katëshe, Zona Kadastrale 2436, Nr pasurie 414/20, Vol 22, fq 95, Fier.

Aktiviteti: Hapja e serviseve për riparimin e automjeteve, tregtim të pjesëve të këmbimit për automjete, blerje-shitje të mjeteve të tonazheve dhe markave të ndryshme me qëllim tregtimi si pjesë këmbimi dhe skrap duke asgjësuar mjetin dhe duke bërë ç’targimin e tij, hapjen e

lavazhove, import-eksport për tregtimin me shumicë e pakicë artikuj të ndryshëm. Blerje-shitje automjetesh, mjete transporti, mjete bujqësore etj. Makina me qera.

Lloji i Kontrollit: Rimbursim TVSH.

Inspektori: E.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 10/2020 – 04/2022.

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit tatimor rezulton se:

- Shoqëria “S...A” SHPK me kërkesën Nr.RAE0000255489, me Nr. Çështje E0001092798, datë 17.05.2023, ka kërkuar rimbursim të TVSH-së kreditore në shumën 12,029,420 lekë, për periudhën 10/2020-04/2022, në Drejtorin e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, protokolluar në DRT Fier me Nr.4538/1 datë 14.06.2023, për këtë ka dalë Programi i Kontrollit Nr.4538/2., Prot., datë 14.06.2023.

Nga analiza e blerjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe shqyrtimi analitik i natyrës së tyre, rezulton se lejohet kreditimi i TVSH së blerjeve, sepse ato i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë dhe janë në funksion të tij, më konkretisht:

- Blerjet e mallrave nga importi me TVSH 20%, janë kryesisht pjesë këmbimi dhe makina, përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 80% e totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi importet e deklaruar në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD, nuk kanë rezultuar diferenca ndryshe nga ato të paraqitura në raport kontrollin tatimor.

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht materiale dhe shpenzime të ndryshe për aktivitetin dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 9% e totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, janë kryesisht transport ndërkombëtar për importet e kryera, materiale për mirëmbajta të cilët janë regjistruar si të përjashtuar, të cilat përbëjnë rreth 7% e totalit të blerjeve të kryera nga subjekti, përgjatë periudhës objekt kontrolli. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e përjashtuara nga furnitorët vendas, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Investime nga furnitor vendas me TVSH 20%, janë kryesisht blerje aktivi dhe përgjatë periudhës objekt kontrolli, përbëjnë rreth 4% e totalit të blerjeve të subjektit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e investimeve nga furnitorët vendas me 20% TVSH, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

Nga analiza e shitjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe kontrolli me të dhënat sipas C@ts të librave mujor të shitjeve dhe FDP të TVSH-së, ka rezultuar se:

- Shitjet e tatueshme të mallrave me TVSH 20%, përbëjnë mbi 92% të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë me shitjen e pjesëve të këmbimit, makina, rafte metalike etj. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Shitjet e përjashtuara, përbëjnë 6%-8%, të totalit të shitjeve të shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe kanë të bëjnë kryesisht me dhënie ambienteve me qera. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është kryer analiza e pagesës së TVSH-së, e cila për periudhën objekt kontrolli ka rezultuar 9.24%, 4.13% dhe 2.05%. Gjithashtu është analizuar rentabiliteti i shoqërisë për periudhën objekt kontrolli dhe ka rezultuar në marzhet pozitive 7.41% dhe 6.46%.

- Në lidhje me analizën e bilancit material, në raport kontrollin tatimor është bërë sqarimi se shoqëria kryen aktivitet në fushën e tregtimit të pjesëve të këmbimit dhe është e pamundur të kryhet inventari fizik i mallrave dhe lëvizja materiale sepse subjekti inventarin e mban vetëm në vlerë dhe jo në sasi, sipas përcaktimeve të pikës 4 b të VKM Nr.783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, ku përcaktohet se inventari mund të mbahet në vlerë. Gjithashtu edhe për shkak të situatës në praktikë ku pjesët e këmbimit në shumë raste janë të bashkuara pasi importi i tyre në doganë është bërë me peshë, janë importuar motorra të cilat janë zbrërthyer në subjekt dhe janë tregtuar me pjesë të veçanta si dhe në vlerën e mallrave në inventar një pjesë janë të patregueshme, pasi janë për skrap.

**30. Subjekti:** “S....A” SHPK.

NIPT: J....Q.

Adresë Kryesore: Lagjja Xhevdet Nepravishta, Lushnje.

Aktiviteti: Ndërtimin e ndërtesave, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: V.P.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 01/2018-06/2021.

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2018-2020.

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 01/2018-06/2021.

- Të Tjera periudha tatimore nga: 01/2018-06/2021.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “S....A” SHPK, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbrërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin Nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

Nga analiza e blerjeve analitike sipas artikujve për vitin 2018, ka rezultuar se shoqëria në total ka kryer blerje të lëndës djegëse karburant si më poshtë:

*Tabela 2.2.1.79: Blerje të lëndës djegëse karburant*

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefëta pa TVSH
1	Diezel	Litër	245,042	124.29	30,457,120
2	Naftë	Litër	5,854	141.65	829,167
3	Gazoil	Litër	108,216	131.25	14,203,834
<b>Total</b>					<b>45,490,121</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Në raport kontrolli nga inspektori nuk është kryer një analizë e detajuar e punimeve ndërtimore për efekt të kreditimit të karburantit sipas përcaktimeve të nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, por vetëm është cilësuar së kreditimi është brenda normave 8%-32% të qarkullimit, ku përfshihen disa kategori veprimtari të ndryshme ndërtimi.

Nga kontrolli analitik i shitjeve sipas raport kontrollit është konstatuar se subjekti përgjatë vitit 2018, ka kryer punime ndërtimore në ndërtim banesash dhe objekte ndërtimore të tjera, për të cilat duhet të kreditojë karburant deri në 8% të qarkullimit sipas përcaktimeve të shkronjës c të nenit 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se përgjatë kësaj periudhe shoqëria ka kryer punime me nënkontraktor, për të cilat nuk duhet të kreditojë karburant si më poshtë paraqitur llogaritjet:

Tabela 2.2.1.80: Analiza e punimeve dhe % e kreditimit të karburantit

Lloji i punimeve	Shitje te tatueshme	Punime nënkontrakt	Punime nga shoqëria	% Kreditimi	Vlera e lejuar	Kredituar Faktikisht	Diferenca
Ndërtim objektesh të ndryshme	332,652,199	38,453,318	294,198,881	8%	23,535,910	45,490,121	21,954,211

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga inspektori i kontrollit duhet të ishte kryer ulja e vlerës së TVSH të karburantit të kredituar në tejkallim të normave të përcaktuara nga legjislati në fuqi si dhe penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore" të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.81: Ulja e vlerës së TVSH të karburantit të kredituar në tejkallim të normave të përcaktuara

Emërtimi	Vlerë
Kreditim i gabuar karburanti	21,954,211
Ulje e tepicës kreditore të TVSH-së	4,390,842
Gjobë TVSH (21.9%)	961,594
<b>Detyrime</b>	<b>5,352,437</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i bilancit kontabël të vitit 2020 rezulton se shoqëria ka një marrëdhënie të drejta dhe detyrimesh, pa njohur të ardhura nga interesat me ortakun, i cili sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", janë entitete me personalitet të ndarë juridikë dhe çdo marrëdhënie dhe transaksion midis tyre duhet t'u përmbahet parimeve të tregut të lirë. Për periudhën e kontrolluar u ndërtua një bilanc i këtyre të drejtave dhe detyrimeve, ku rezulton se shoqëria në total është kreditore (ka të drejta mbi të tretët) dhe njëkohësisht ka detyrime ndaj institucioneve bankare, rezulton se këto shuma të huajtura kanë një kosto që në gjykimin e grupit të auditimit janë të pajustificuara fiskalisht.

Tabela 2.2.1.82: Analiza e marrëdhënieve të drejtave dhe detyrimeve me ortakun

Emërtimi	2020
Të drejta ndaj ortakëve	25,000,000
Tituj të huamarrjes afatshkurtër	2,454,746
<b>Neto</b>	<b>22,545,254</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga sa më sipër grupi i audituesve gjykon se shpenzimet neto nga interesat për vitin 2020, janë shpenzime të panjohura sipas përcaktimeve ligjore të nenit 20 "Shpenzime të njohura" të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.83: Shpenzime interesi

Zëri PASH	2020
Të ardhura nga interesat	0
Shpenzime për interesa dhe komisione bankare	95,132
<b>Shpenzime interesi</b>	<b>-95,132</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se "Shpenzimet neto të interesit për huatë", nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklarim sipas përcaktimeve të nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore", të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.84: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Shpenzime të panjohura (Shpenzime neto të interesit)	95,132
Tatim Fitimi (15%)	14,270
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	3,125
<b>Detyrime</b>	<b>17,395</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Shoqëria “S....A” SHPK për vitin 2020, ka kryer shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas autorizimeve përkatëse me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkinë Durrës, si më poshtë:

Tabela 2.2.1.85: Shitje përjashtuara

Nr	Emri blerësit	Adresa	NIPT	Shitje përjashtuara
1	Bashkia Durrës	Durrës	K....R	42,113,888
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)	Tiranë	J....W	111,150,505
<b>Shuma</b>				<b>153,264,393</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konstatohet se nuk është bërë rregullimi i TVSH-së, për karburantin si blerje që i ka shërbyer edhe shitjeve të përjashtuara në kuadër të rindërtimit për periudhën 01.01.2020-31.12.2020. Veprime këto që nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 69 “Zbritja e TVSH-së” të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për lejimin e plotë të kreditimit të TVSH-së në blerje, kur kryen aktivitetet të përzier.

Tabela 2.2.1.86: Rregullimi i TVSH-së, për karburantin si blerje që i ka shërbyer edhe shitjeve të përjashtuara në kuadër të rindërtimit

Nr	Emërtimi	Vlera e tatueshme	TVSH
1	Shitje të përjashtuara	153,264,393	0
2	Shitje të tatueshme	733,081,347	146,616,268
<b>Totali i shitjeve</b>		<b>886,345,740</b>	<b>146,616,268</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për vitin 2020, është rillogaritur koeficienti i zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve të nenit 72 “Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.87: rillogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së

Emërtimi	Vlera
Shitje të përjashtuara	153,264,393
Shitje të tatueshme me shkallë 20%	733,081,347
<b>Koef zbritjes TVSH-së</b>	<b>82.71%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli analitik i rubrikave “Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas” konkretisht i artikujve “Benzinë” dhe “Naftë” për vitin 2020, nuk janë evidentuar blerjet e karburantit të cilat i kanë shërbyer të aktiviteteve nga të cilat janë gjeneruar shitjet e përjashtuara dhe mbi të cilat duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së.

Tabela 2.2.1.88: Blerjet e karburantit të cilat i kanë shërbyer aktiviteteve

Nr	Përshkrimi	Njësi	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH
1	Benzinë	Litra	1,800	124	222,334
2	Naftë	Litra	159,761	117	18,701,237
<b>Totali</b>					<b>18,923,571</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.89: Rregullimi i Zbritjes së TVSH

Emërtimi	Vlera
Zbritja e TVSH sipas Koeficientit përfundimtar të TVSH	3,130,272
(-) zbritja e TVSH sipas Koeficientit fillestar të TVSH	3,784,714
<b>(=) Rregullimi i Zbritjes së TVSH</b>	<b>(654,442)</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu është kryer penalizmi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.90: Penalizimi për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore

Zëri i bilancit	2020
Ulje e gjendjes kreditore të TVSH	654,442
Gjobë TVSH (21.9%)	143,323
<b>Detyrime</b>	<b>797,765</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “S...A” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 14,270 lekë detyrime të TF dhe 3,125 lekë gjobë, 5,045,284 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,104,917 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 6,167,596 lekë, nga të cilat 5,059,554 lekë detyrim dhe 1,108,042 lekë penalitet.**

### 31. Subjekti: “A....O” SHPK.

NIPT: K....C.

Adresë Kryesore: Rruga “Skenderbeu”, Lagjja “Bishanake”, Pallati Nr.18, Hyrja Nr.6, Fier.

Aktiviteti: Ndërtimin e ndërtesave, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: A.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 10/2019-10/2021.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 10/2019-10/2021.
- Të tjera periudha tatimore nga: 10/2019-10/2021.

Nga analiza e bilanceve kontabël të viteve 2019-2020, konkretisht e zërit të “Mjete Transporti”, rezulton se për vitin 2019 shoqëria nuk ka pasur mjete transporti në pronësi.

Tabela 2.2.1.91: Analiza e zërit të “Mjete Transporti”

Përshkrimi	2019	2020
Aktive afatgjata materiale (Mjete Transporti)	-	742,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.92: Analiza e asetëve të Luajtshme (Mjete Transporti)

Asetet e Luajtshme (Mjete Transporti)					
Viti 2019			Viti 2020		
			AA028JE	ATP	TATA XENON
			AB238AA	ATP	VOLKSWAGEN TRANSPORTER

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Përgjatë vitit 2019 nga verifikimi i faturave të blerjes ka rezultuar se shoqëria ka kryer blerje naftë, por në kushtet kur nuk ka në pronësi mjete transporti dhe nuk rezulton të ketë marr me qera mjete transporti, dalim në konkluzionin se karburanti i blerë nuk i shërben aktivitetit të shoqërisë dhe është shpenzime i panjohura sipas përcaktimeve ligjore të nenit 20 “Shpenzime të njohura” të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.93: Karburanti i blerë që nuk i shërben aktivitetit të shoqërisë

Emri tregtar i shitësit	NIPT-i	Përshkrimi	Totali i blerjeve	Vlera e tatueshme për blerje nga furnitorët vendas me shkallë 20%	TVSH nga furnitorët vendas me shkallë 20%
A.....L	L....T	Naftë	64,005	53,336	10,669

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se blerjet e karburantit nuk është kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklarim sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.94: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Shpenzime të panjohura (Naftë)	53,336
Ulje e gjendjes kreditore të TVSH	10,667
Gjobë TVSH (20%)	2,133
Tatim Fitimi (15%)	8,000
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	1,752
<b>Detyrime</b>	<b>22,553</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “A.....O” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 8,000 lekë detyrime të TF dhe 1,752 lekë gjobë, 10,667 lekë detyrime të TVSH-së dhe 2,133 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 22,553 lekë, nga të cilat 18,667 lekë detyrim dhe 3,885 lekë penalitet.**

### 32. Subjekti: “S.....Co” SHPK.

NIPT: L....U.

Adresë Kryesore: Lagjja “Apollonia”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese”, Apartamenti Nr.6, Fier. Aktiviteti: Shoqëria do të ketë si objekt kryerjen e gjithë aktiviteteve që legjislacioni shqiptar lejon të kryhen nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj duke përfshirë në veçanti: Injektiv me nitrogen dhe avull për trajtim termal të puseve të naftës, shpim i drejtuar i puseve të naftës, riparim e çimentim i puseve të naftës, kompletim i puseve të naftës dhe shërbime të tjera teknike, marketing i ndërmjetësuesve demulsues, demulsanteve dhe biocideve, flokulante dhe surfaktante të tjerë etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: G.M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 10/2017-05/2020.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2017-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 10/2017-05/2020.
- Të tjera periudha tatimore nga: 10/2017-05/2020.

- Nga analiza e situatës financiare për periudhën 10/2017-12/2017 rezulton se shoqëria nuk ka kryer shitje kurse blerjet janë të përjashtuara dhe kanë të bëjnë me shpenzime të natyrës administrative si qera ambienti, shërbime noteriale, energji elektrike, taksa lokale etj. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet, të deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruar sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.



Tabela 2.2.1.95: Analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet

VITI 2017				
Nr	Muaj	Shitje me shkallë 20%	Të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH	Total blerje
10	Tetor	0	0	0
11	Nëntor	0	42,160	42,160
12	Dhjetor	0	38,838	38,838
<b>Totali</b>		<b>0</b>	<b>80,998</b>	<b>80,998</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

- Nga analiza e shitjeve për vitin 2018 rezultoi se shitjet brenda vendit janë kryer drejt kompanisë “B....P” dhe janë shërbime në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, ndërsa shitjet drejt dy kompanive amerikane “K....G” LLC dhe “G...C” LLC, janë mallra (Xanthan Gum) të cilat janë blerë në Kinë dhe shitur në SHBA direkt pa u importuar në Shqipëri. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhë sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e mallrave nga importi me TVSH 20%, janë kryesisht materiale ndihmëse të cilat i shërbejnë aktivitetit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi importet e deklaruara në librin e blerjeve dhe FDP sipas të dhënave të C@ts me importet sipas DPD nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20% dhe blerje pa TVSH, janë kryesisht shërbim punëtorie, materiale ndërtimi, transport, energji elektrike, gazoil për të cilin nuk është kredituar TVSH, mjete me qera etj. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruara në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga analiza e bilancit material për vitin 2018 të materialit të vetëm të blerë dhe shitur “X.G”, nuk kanë rezultuar diferenca, 60 ton në blerje – 60 ton në shitje = 0 ton gjendja e mbetur.

Tabela 2.2.1.96: Analiza e blerjeve dhe shitjeve

Nr	Muaj	Shitje me shkallë 20%	Shitje pa TVSH	Të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH	Nga furnitorët vendas me shkallë 20%	Importe të mallrave me shkallë 20%	Investim e brenda vendit 0%	Blerje të investimeve nga furnitorë vendas me 20%	Total blerje
1	Janar	0	0	32,274	0	0	0	0	32,274
2	Shkurt	0	0	1,139,232	373,670	0	0	20,750	1,533,652
3	Mars	13,211,852	0	186,144	572,217	0	0	0	758,361
4	Prill	0	0	157,487	291,257	0	0	0	448,744
5	Maj	0	0	149,762	291,906	0	0	0	441,668
6	Qershori	4,742,955	10,524,309	1,603,072	393,624	0	0	0	1,996,696
7	Korrik	8,919,034	0	250,205	601,265	0	0	183,317	1,034,787
8	Gusht	6,655,124	0	3,187,164	938,834	0	0	0	4,125,998
9	Shtator	0	1,363,255	155,918	323,101	0	0	0	479,019
10	Tetor	0	7,562,736	9,587,347	263,086	23,940	0	0	9,874,373
11	Nëntor	0	0	206,915	301,195	16,305	0	0	524,415
12	Dhjetor	0	0	170,253	284,334	0	0	0	454,587
<b>Totali</b>		<b>33,528,965</b>	<b>19,450,300</b>	<b>16,825,773</b>	<b>4,634,489</b>	<b>40,245</b>	<b>0</b>	<b>204,067</b>	<b>21,704,574</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

- Nga analiza e situatës financiare për vitin 2019, rezulton se shoqëria nuk ka kryer shitje, sepse ka qenë në tratativa për një kontratë të re me afat 5 vjeçar me “Bankers Petroleum Albania”, gjë të cilën nuk e arriti. Nëpërmjet vendimit të asamblesë së ortakëve është bërë shpërndaja dhe ndërprerja e veprimtarisë si dhe fillimi i procedurave të likuidimit dhe emërimi i likuidatorit.

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas me TVSH 20% dhe blerje pa TVSH, janë 95% shërbim punëtorie dhe pjesa tjetër janë kryesisht materiale ndërtime, energji elektrike, qera dhe gazoil etj. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruara në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit mqs shoqëria nuk ka krijuar të ardhura dhe në kushtet kur shërbimin e fuqisë punëtore e ka blerje me TVSH, nuk është bërë njohja e kreditimit të TVSH-së dhe është kryer ulja e gjendjes kreditore me 411,184 lek.

- Për këtë periudhë shoqëria nuk ka kryer blerje mallrash për rishitje dhe për pasoje gjendja e inventarit në fillim dhe fund të periudhës është zero dhe nuk ka diferenca në bilancin material.

Tabela 2.2.1.97: Analiza e blerjeve dhe shitjeve

VITI 2019									
Nr	Muaj	Shitje me 20%	Shitje pa TVSH	Të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH	Nga furnitorët vendas me shkallë 20%	Importe të mallrave me shkallë 20%	Investi me brenda vendit 0%	Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%	Total blerje
1	Janar	0	0	438,555	289,031	0	0	0	727,586
2	Shkurt	0	0	79,312	409,299	0	0	0	488,611
3	Mars	0	0	22,334	287,653	0	0	0	309,987
4	Prill	0	0	89,168	284,744	0	0	0	373,912
5	Maj	0	0	320,135	320,715	0	0	0	640,850
6	Qershor	0	0	665,764	312,343	0	0	0	978,107
7	Korrik	0	0	76,522	51,641	0	0	0	128,163
8	Gusht	0	0	71,187	36,542	0	0	0	107,729
9	Shtator	0	0	22,740	36,219	0	0	0	58,959
10	Tetor	0	0	79,810	200	0	0	0	80,010
11	Nëntor	0	0	22,368	27,531	0	0	0	49,899
12	Dhjetor	0	0	269,408	0	0	0	0	269,408
<b>Totali</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,157,303</b>	<b>2,055,918</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4,213,221</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

- Nga analiza e situatës financiare për periudhën janar-maj 2020, rezulton se shoqëria ka kryer shitje të cilat janë mallra. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhë sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e mallrave nga furnitor vendas pa TVSH janë kryesisht shërbim konsulence, qera, gazoil dhe taksa lokale. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruara në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

Tabela 2.2.1.98: Analiza e blerjeve dhe shitjeve

VITI 2020									
Nr	Muaj	Shitje me shkallë 20%	Shitje pa TVSH	Të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH	Nga furnitorët vendas me shkallë 20%	Importe të mallrave me shkallë 20%	Investim e brenda vendit 0%	Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%	Total blerje
1	Janar	158,501	0	14,045		0	0	0	14,045
2	Shkurt	0	0	14,115		0	0	0	14,115
3	Mars	0	0	15,026		0	0	0	15,026
4	Prill	0	0	305,354		0	0	0	305,354
5	Maj	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>158,501</b>	<b>0</b>	<b>348,540</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>348,540</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilanceve kontabël të viteve 2017-2020, nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qenë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).
- Nga kontrolli i PASH, janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklaratimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF, duke mos rezultuar diferenca nga raport kontrolli.
- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur saktë.

### 33. Subjekti: "G.....A" SHPK.

NIPT: K....A.

Adresë Kryesore: Lagjja 5 Shkurti, Bulevardi 4 Heronjtë, Godina Nr.2, Apartament Nr.3, Kati 4.

Aktiviteti: Projektme dhe zbatime për punime të ndryshme ndërtimi, tregtim materiale ndërtimi, mallra të ndryshme industriale. Arsime jo publike. Grumbullim, transportim i mbetjeve inerte dhe dherave jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: A.G.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 09/2018-09/2021.
- Për Tatim Fitimitin periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 09/2018-09/2021.
- Të tjera periudha tatimore nga: 09/2018-09/2021.

Nga analiza e bilancit kontabël të shoqërisë "G.....A" SHPK, konkretisht tek zëri i detyrimeve afatgjata "Të tjera të pagueshme" të pasivit, e cila sipas raport kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori, përfaqësojnë "Detyrimet ndaj Ortaku", konkretisht në vlerat respektive:

Tabela 2.2.1.99: Analiza e zërit të detyrimeve afatgjata "Të tjera të pagueshme" të pasivit

Zëri	2020	2019	2018
Të tjera të pagueshme (Ortaku)	194,850,000	171,540,975	139,840,975
<b>Totali</b>	<b>194,850,000</b>	<b>171,540,975</b>	<b>139,840,975</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut/individëve por vetëm ka cilësuar në raport se është vendosur në dispozicion gjatë fazës së kontrollit në terren kontrata e huamarrjes, një kopje e së cilës nuk gjendet bashkangjitur raport kontrollit tatimor, kushtet e vendosura, normat e interesit të aplikuara, plani i shlyerjes së huasë, përcaktimi i kështit, principalit dhe llogaritja e interesit, të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël, por vetëm është cilësuar se këto shuma kanë shërbyer për mbulimin e mungesës afatshkurtër të likuiditeteve të shoqërisë.

Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se shoqëria, për periudhën 2015-2020, ka kryer shpërndarjen e dividendit dhe pagesën e tatimit në burim, konkretisht:

Tabela 2.2.1.100: Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim

Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim	2020	2019	2018	2017	2016	2015
Ndarja e Fitimit		3,629,762				

Tatimi i llogaritur për ndarjen e fitimit	290,381			
---	---------	--	--	--

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në C@ts dhe sipas të dhënave të QKB-së, ka rezultuar se ortakët e shoqërisë M.B, L.B dhe ish ortakë A.B, nuk figurojnë të kenë të ardhura të tjera, përveç atyre nga pagat e marrëdhëniet e punës me shoqërinë “G.....A” SHPK, ku konstatohet se janë të regjistruar me pagat për efekt sigurimesh paraqitur, konkretisht:

Tabela 2.2.1.101: Analiza e ortakëve të shoqërisë

Emër Mbiemër	Pozicioni	Paga	
		2019	2020
A.B	Drejtor Ekzekutiv	40,000	40,000
M.B	Mësuese Fizike	26,000	26,000
L.B	Punëtor Krahu	26,000	26,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga ana e inspektori të kontrollit tatimor nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e mjeteve monetare të cilat kanë pretendohet se kanë kaluar si huadhënie nga ortakë drejt shoqërisë, veprime të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Në lidhje me mungesën e justifikimit nga të dhënat financiare të bilanceve kontabël, të shumave të cilat pretendohet se janë dhënë hua nga ortakë drejt shoqërisë, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin tatimor duke i konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar. Nga grupi i audituesve të KLSH janë kryer rilogaritjet duke rindërtuar situatën financiare të shoqërisë, duke përdorur të dhënat të cilat gjenden në pasqyrat financiare të deklaruara nga tatimpaguesi, konkretisht marzhet bruto të deklaruara në PASH për vitet 2019 dhe 2020.

Tabela 2.2.1.102: Të ardhurat e padeklaruara

Zëri	2019	2020
Divident i padekluar (Kontribut Ortaku)	31,700,000	23,309,025
Norma Dividenti (8%)	8%	8%
Fitimi Neto i padekluar	34,236,000	25,173,747
Tatim Fitimi (15%)	15%	15%
Fitimi Bruto	39,371,400	28,949,809
% Marzhi Fitim Neto	4.90%	4.40%
<b>Të ardhurat e padeklaruara</b>	<b>41,300,599</b>	<b>30,223,601</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Është kryer penalizimi shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.103: Rivlerësim i situatës financiare

Zëri	2019	2020
Të ardhurat e padeklaruara	41,300,599	30,223,601
TVSH (20%)	8,260,120	6,044,720
Gjobë TVSH (100%)	8,260,120	6,044,720
Tatim Fitimi (15%)	6,195,090	4,533,540

Gjobë TF (100%)	6,195,090	4,533,540
Tatim mbi Dividentin (8%)	2,808,441	2,055,205
Gjobë Tatim Dividenti (100%)	2,808,441	2,055,205
<b>Detyrime</b>	<b>34,527,300</b>	<b>25,266,930</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 09/2018-09/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre më përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nqs ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 09/2018-09/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me parregullsitë e konstatuara, grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruar jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

*Tabela 2.2.1.104: Rivlerësimi i pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi*

Muaj	Nr pun	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH (1.7%)	Sig Sh PM (1.7%)	TAP (13%)	Paga Neto
Shtator 2018	49	538,609	838,554	299,945	44,992	28,495	5,099	5,099	15,056	251,295
Tetor 2018	46	565,968	874,413	308,445	46,267	29,302	5,244	5,244	15,056	258,843
Nëntor 2018	44	572,767	889,584	316,817	47,523	30,098	5,386	5,386	15,056	266,278
Dhjetor 2018	53	625,378	917,654	292,276	43,841	27,766	4,969	4,969	15,056	244,486
Janar 2019	49	643,000	798,640	155,640	23,346	14,786	2,646	2,646	4,543	133,666
Shkurt 2019	48	631,000	784,336	153,336	23,000	14,567	2,607	2,607	4,543	131,620
Mars 2019	49	710,000	879,696	169,696	25,454	16,121	2,885	2,885	4,827	145,863
Prill 2019	42	649,000	809,368	160,368	24,055	15,235	2,726	2,726	5,394	137,012
Maj 2019	48	746,000	903,536	157,536	23,630	14,966	2,678	2,678	4,543	135,349
Qershor 2019	47	632,000	765,264	133,264	19,990	12,660	2,265	2,265	3,975	114,364
Korrik 2019	23	451,000	549,512	98,512	14,777	9,359	1,675	1,675	3,975	83,504
Gusht 2019	37	570,000	691,360	121,360	18,204	11,529	2,063	2,063	3,975	103,793
Shtator 2019	46	656,000	796,256	140,256	21,038	13,324	2,384	2,384	4,543	120,005
Tetor 2019	45	680,231	814,136	133,905	20,086	12,721	2,276	2,276	4,543	114,365
Nëntor 2019	46	712,000	851,088	139,088	20,863	13,213	2,364	2,364	5,111	118,400
Dhjetor 2019	43	636,000	760,496	124,496	18,674	11,827	2,116	2,116	5,111	105,442
Janar 2020	40	644,000	785,528	141,528	21,229	13,445	2,406	2,406	4,259	121,418
Shkurt 2020	46	659,000	786,720	127,720	19,158	12,133	2,171	2,171	4,827	108,589
Mars 2020	47	796,000	950,024	154,024	23,104	14,632	2,618	2,618	4,827	131,947
Prill 2020	51	665,000	806,984	141,984	21,298	13,488	2,414	2,414	4,543	121,539
Maj 2020	49	639,000	774,800	135,800	20,370	12,901	2,309	2,309	4,259	116,332
Qershor 2020	48	554,000	673,480	119,480	17,922	11,351	2,031	2,031	4,259	101,839
Korrik 2020	54	739,000	894,000	155,000	23,250	14,725	2,635	2,635	4,259	133,381
Gusht 2020	51	607,000	729,504	122,504	18,376	11,638	2,083	2,083	2,555	106,228
Shtator 2020	45	540,000	649,640	109,640	16,446	10,416	1,864	1,864	2,555	94,805
Tetor 2020	53	700,000	842,148	142,148	21,322	13,504	2,417	2,417	2,839	123,388
Nëntor 2020	57	750,000	911,880	161,880	24,282	15,379	2,752	2,752	5,394	138,355
Dhjetor 2020	38	642,000	775,992	133,992	20,099	12,729	2,278	2,278	3,691	115,294
Janar 2021	48	721,155	881,998	160,843	24,127	15,280	2,734	2,734	13,845	128,984
Shkurt 2021	49	830,767	1,013,712	182,945	27,442	17,380	3,110	3,110	14,115	148,340
Mars 2021	48	720,001	881,309	161,308	24,196	15,324	2,742	2,742	13,174	130,067
Prill 2021	47	850,384	1,038,538	188,154	28,223	17,875	3,199	3,199	14,115	152,966
Maj 2021	49	788,074	965,095	177,021	26,553	16,817	3,009	3,009	15,995	141,200
Qershor 2021	49	883,841	1,086,810	202,969	30,445	19,282	3,450	3,450	20,702	159,534
Korrik 2021	41	631,155	776,490	145,335	21,800	13,807	2,471	2,471	15,056	114,001
Gusht 2021	45	784,230	947,510	163,280	24,492	15,512	2,776	2,776	15,056	129,937
Shtator 2021	46	806,543	994,403	187,860	28,179	17,847	3,194	3,194	20,702	146,118
<b>Total</b>		<b>24,970,103</b>	<b>31,090,458</b>	<b>6,120,355</b>	<b>918,053</b>	<b>581,434</b>	<b>104,046</b>	<b>104,046</b>	<b>306,329</b>	<b>5,128,545</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.105: Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	24,970,103
2	Paga Bruto Rivlerësuar	31,090,458
3	Diferenca Paga Bruto	6,120,355
4	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>5,128,545</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	581,434
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	104,046
7	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>918,053</b>
8	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>104,046</b>
9	Diferenca TAP (13%)	306,329
10	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruara nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>6,150,645</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Penalizimi i subjektit nuk është kryer sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.106: Penalizimi i subjektit

Emërtimi	Vlera
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	918,053
Gjobë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	918,053
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	581,434
Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	581,434
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	104,046
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	104,046
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	104,046
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	104,046
TAP (13%)	306,329
Gjobë TAP (100%)	306,329
<b>Detyrime</b>	<b>4,027,817</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar rikarakterizohet si e ardhura dhe penalizohet sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.107: Rivlerësimi i situatës financiare të subjektit

Emërtimi	Vlera
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	6,150,645
TVSH (20%)	1,230,129
Gjobë TVSH (21.9%)	269,398
Tatim Fitimi (15%)	922,597
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	202,049
<b>Detyrime</b>	<b>2,624,173</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli në sistemin e prokurimit publik online “Open Procurement Albania”, ka rezultuar se shoqëria “G.....A” SHPK përgjatë periudhës objekt kontrolli 09/2018-09/2021 është shpallur fituese në 16 tendera publik, paraqitur konkretisht:

Tabela 2.2.1.108: Tenderat publik te shoqërisë

A.P sipas NJ.Q.V	Objekti i Tenderit	Fondi Limit	Operator Ekonomik Kontraktues	Lidhja kontratës	Afati	Përfundim punimesh
Q.V Korçë	Ndërtim i pritave malore dhe mur mbrojtës në Barç dhe Voskop.	10,535,000	G.....A	31/08/2020	2 muaj	11/01/2020
Q.V Tiranë	Shtëmi i sipërfaqeve të Varrezave Publike Tufinë.	49,999,898	G.....A	07/06/2020	9 muaj	04/06/2021
Q.V Korçë	Rikonstruksion rrugësh në Njësitë Administrative (Faza I).	47,771,000	G.....A	31/05/2019	3 muaj	31/08/2019
Q.V Korçë	Sistemime malore.	16,940,000	G.....A	31/05/2019	3 muaj	31/08/2019
Q.V Roskovec	Rikualifikim urban në fshatin Marinëz (Rruga Llambi Marku).	10,246,746	G.....A	03/01/2019	6 muaj	10/01/2019
Q.V Shkodër	Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat Oso Kuka, Bashkia Shkodër, Ana e Malit, Oblike, At Gjon Karma, Gur i Zi.	37,585,085	G.....A	31/12/2018	3 muaj	31/03/2019
Q.V Vlorë	Vazhdim punimesh Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Kosova", "Rruga Gjergj Araniti" dhe "Bulevardi Gjergj Kastrioti".	16,870,787	G.....A	26/12/2018	3 muaj	26/03/2019
FSHZH	Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Ballsh dhe krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh.	254,315,463	BOE G.....A & E.N	10/01/2020	12 muaj	10/01/2021
Q.V Patos	Rikonstruksion i shkollës "Mustafa Matohiti"	74,258,784	BOE G.....A & SH.O	24/09/2019	6 muaj	24/03/2020
Q.V Vorë	"Sistemim, Asfaltim Rruga Mojre dhe Fioret Gjec Kodër, Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vore	22,276,283	BOE G.....A & ED K	06/05/2019		

Q.V Kavajë	Shërbimi i Mirëmbajtjes së Gjellbërimit	77,418,410	BOE G.....A & A	01/10/2020	60 muaj	01/10/2025
Ministria e Shëndetësisë	Lot.1 “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës”	105,699,372	BOE G.....A & D	19/06/2019	161 ditë	27/11/2019
Q.V Tiranë	Rindërtimi i 3 (tre) godinave të Rezidencave Studentore Universitare (RSU) në Bashkinë Tiranë, “Ndërtim i Godinës Tip në RSU NR.1 (Nr.18)” (Programi i Rindërtimit)		BOE GBK & D	05/05/2021	9 muaj	
Q.V Korçë	Loti 3- Skemat ujëtare (Rikonstruksioni I sekondareve Rezervuari i Gjancit Dega e Ventrokut)	7,208,999	BOE G.....A & E	23/12/2019	2 muaj	23/02/2020
Q.V Tiranë	Rikonstruksion i rrugës Kadri Kërçiku.	34,336,598	BOE G.....A & D	27/05/2019	6 muaj	27/11/2019
Q.V Himarë	Rikonstruksioni i rrjetit te brendshëm fshati Piqeras	3,333,333	BOE N & G	22/11/2018	3 muaj	22/02/2019

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga kontrolli i dokumenteve standarte të tenderit (DSK), janë nxjerr të dhëna mbi numrin e punonjësve të nevojshëm për të përfunduar punët e tenderuar, **që janë 32-110 punonjës** si dhe afati i kontratave për përfundimin e punimeve. Meqenëse shoqëria është shpallur fituese në këto procedura prokurimi rrjedh se detyrimisht i ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe çdo kërkesë ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit. Nga përllogaritjet rezulton se përgjatë kësaj periudhe shoqëria ka pasur angazhime në më shumë se një punë publike njëkohësisht nga logjikisht rrjedh se duhet të shfrytëzojë gjithë kapacitetin e plotë të fuqisë punëtore me qëllim përmbushjen e kushteve të kontratave të prokurimit sipas afateve kontraktuale. Sipas listëpagesave të dorëzuara përgjatë periudhës objekt kontrolli 09/2018-09/2021, në sistemin informatik tatimor C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht çdo muaj, **30-55 punonjës** të profileve të ndryshme në punët ndërtimore, mqs ka aktivitet të përzier punime ndërtimore dhe arsim jo publik. Analiza bazohet vetëm tek profili i ulët i kategorisë së ndërtimit, të cilët mund të jenë të angazhuar vetëm një projekt, në ndryshim nga pozicionet si inxhinier, arkitekt ose teknik ndërtimi, që mund të ndjekin pa pengesë disa projekte njëkohësisht, konkretisht:

Tabela 2.2.1.109: Kategoritë sipas profesioneve

Kategoria e profesionit	Emërtimi i profesionit
7112.05	Murator për mure tulle
7115.02	Karpentier
7122.07	Shtrues pllakash
7126.03	Hidraulik
7212.09	Saldator
7411.01	Elektracist
8322.01	Shofer
8322.04	Shofer Kamiocinë
8322.05	Shofer Makine
8342.01	Drejtues Buldozeri
8342.02	Drejtues Ekskavatori
8342.03	Drejtues Fadrome
9312.02	Punëtor Krahu
9312.06	Punëtor Krahu Ndërtim

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga raporti i kontrollit janë përpunuar të dhënat në lidhje me pjesën e punimeve me nënkontraktor të cilat ndikojnë në shfrytëzimin e fuqisë së brendshme të shoqërisë dhe nga rezulton se vetëm përgjatë periudhës 01/2020-12/2020, mund të justifikohet numrin i ulët i ditëve të punës në listapages për punonjësit e shoqërisë sepse ka kryer rreth 59% të punimeve me nënkontraktor.

Tabela 2.2.1.110: Analiza e punimeve sipas nënkontraktimit

Emërtimi/Periudha	09/2018-12/2018	2019	2020	01/2021-09/2021
Punime ndërtimi nënkontraktor	0	41,020,575	94,619,280	0
Totali i shitjeve	26,407,125	139,473,124	161,384,823	117,149,588



<b>% e nënkontraktimit</b>	<b>0%</b>	<b>29%</b>	<b>59%</b>	<b>0%</b>
----------------------------	-----------	------------	------------	-----------

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga analiza e mësipërme dalim në konkluzion se nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara të subjektit, kanë rezultuar mesatarisht 21 punonjës çdo muaj të cilët janë deklaruar me më pak se 22 ditë pune në muaj dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë të grafikut të punimeve si dhe vlerësime të projektit dhe preventivit të punimeve, për të përcaktuar shpërndarjen e fuqisë punëtore në kryerjen e punimeve me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale sipas kontratave të prokurimit të nënshkruara. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer një thellim i analizës së situatës financiare të subjektit gjatë fazës së kontrollit në terren, me qëllim dokumentimin fakteve që do të shërbenin si arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, sepse rezulton mospërputhje e pajustificuar teknikisht midis ditëve të punës të punonjësve të paraqitur në listëpagesa dhe ditëve të punës që janë të domosdoshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale për përfundimin e punimeve të tenderave publik, nga dalin në konkluzionin se subjekti ka nëndeklaruar pagat e përfituara nga punëmarrësit.

Tabela 2.2.1.111: Rivlerësim i pagave

Periudha	Nr punonjësve	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Dif
Shtator 2018	18	83,996	432,000	348,004
Tetor 2018	18	84,917	432,000	347,083
Nëntor 2018	18	103,381	432,000	328,619
Dhjetor 2018	27	136,612	648,000	511,388
Janar 2019	24	151,000	624,000	473,000
Shkurt 2019	23	142,000	596,000	454,000
Mars 2019	24	203,000	624,000	421,000
Prill 2019	18	124,000	468,000	344,000
Maj 2019	23	234,000	598,000	364,000
Qershor 2019	23	165,000	598,000	433,000
Gusht 2019	14	104,000	364,000	260,000
Shtator 2019	21	139,000	546,000	407,000
Tetor 2019	21	145,000	546,000	401,000
Nëntor 2019	21	150,000	546,000	396,000
Dhjetor 2019	11	51,000	286,000	235,000
Janar 2021	21	94,620	630,000	535,380
Shkurt 2021	26	294,228	780,000	485,772
Mars 2021	28	241,801	840,000	598,199
Prill 2021	29	369,229	870,000	500,771
Maj 2021	22	114,232	660,000	545,768
Qershor 2021	22	169,611	660,000	490,389
Korrik 2021	20	125,772	600,000	474,228
Gusht 2021	21	185,767	630,000	444,233
Shtator 2021	19	113,082	570,000	456,918
<b>Totali</b>	<b>512</b>	<b>3,725,248</b>	<b>13,980,000</b>	<b>10,254,752</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

***Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “G.....A” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 918,053 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 918,053 lekë gjobë; 581,434 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 581,434 lekë gjobë; 104,046 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 104,046 lekë gjobë; 104,046 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 104,046 lekë gjobë; 306,329 lekë detyrime TAP dhe 306,329 lekë gjobë; 11,651,227 lekë detyrime të TF dhe 10,930,679 lekë gjobë;***

*15,534,969 lekë detyrime të TVSH-së dhe 14,574,238 lekë gjobë; 4,863,646 lekë detyrime të Dividenti dhe 4,863,646 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 66,446,221 lekë, nga të cilat 34,063,750 lekë detyrim dhe 32,382,471 lekë penalitet.*

**34. Subjekti: “F...M” SHPK.**

NIPT: L....D.

Adresë Kryesore: Autostrada Levan-Tepelene Km 25, Z.K Nr.1945, Fier.

Aktiviteti: Ndërtim i godinave për banesa civile, ndërtesa industriale, bujqësore, tregtare, ndërtesa dhe struktura turistike, ndërtim të rrugëve dhe infrastruktura të çdo lloji, punime ndërtimi e rikonstruksioni.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: E.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 02/2021-04/2022.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2020-2021.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 02/2021-04/2022.
- Të Tjera periudha tatimore nga: 02/2021-04/2022.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “F...M” SHPK, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin Nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

- Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruar në librin e blerjeve me deklarimet në FDP sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga inspektori i kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e blerjeve sipas furnitorëve, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruar në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga inspektori i kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e shitjeve sipas klientëve dhe artikujve, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Është kryer analiza e bilancit material për materialet kryesore.

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilanceve kontabël të viteve 2020 dhe 2021, nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qenë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

- Nga kontrolli i PASH, janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklarimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Nga inspektori i kontrollit është kryer rivlerësimi i listëpagesave sipas ditëve të punës sipas versionit fillestar të deklaratës së ndryshuar si dhe penalizimi i subjektit për këto parregullësi.

- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur dhe paguar saktë.
- Është kryer analiza e llogaritjes, deklarimit dhe pagesës së rentës minerare sipas të dhënave të C@ts.

### 35. Subjekti: “G.B” SHPK.

NIPT: K.....A.

Adresë Kryesore: Rruga Fier-Patos Km 5, Kthesa e Patosit, Zona Kadastrale Nr.2890, Nr.Pasurie 59/14, kantier ndërtimi përballë Alb-Star, Fier.

Aktiviteti: Prodhim i betonit, Ndërtime civile, ekonomike, punime dheu, sistemim tarracime, prodhime elementësh të parafabrikuara, betoni, beton arme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Ndërtim rruge të kategorive të ndryshme, veshje me asfalto beton të rrugëve/ndërtim mbishtrës, sistemim dhe asfaltim sheshi. Punime beton armeje e metalike, punime karpenterie, rikonstruksione godinash civile, industriale, punime duralumini etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: G.M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 05/2018-06/2023.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2018-2022.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 05/2018-06/2023.
- Të tjera periudha tatimore nga: 05/2018-06/2023.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “G.B” SHPK, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin Nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

Nga auditimi u konstatua se referuar çmimeve të shitjes të njësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim tek objekti i shoqërisë “Godinë e kombinuar 11 kate + 1 katë nëntokë”, Lagjja “Apollonia”, Fier, rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të qytetit të Fierit, të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019 për 33 kontrata, trajtuar më hollësisht si më poshtë:

Tabela 2.2.1.112: Analiza e çmimeve të shitjeve sipas referencave

Rep	Kol	Nr Faturës	Data	Emër Klienti	m <sup>2</sup>	Sip e përbashkët	Totali	Çmimi/m <sup>2</sup>	Referenca VKM Nr.168	Dif Çmimi
254	105	88196452	26/02/2020	V.N	100.94	7.6	108.54	50,902	53,100	2,198
255	106	88196453	26/02/2020	A.M	97.85	10.27	108.12	45,883	53,100	7,217
256	107	88196454	26/02/2020	A.C	95.86	6.77	102.63	46,350	53,100	6,750
259	110	88196455	27/02/2020	A.M	99.79	7.64	107.43	46,175	53,100	6,925
266	114	88196456	28/02/2020	B.K	116.83	8.79	125.62	42,232	53,100	10,868
272	118	88196457	29/02/2020	A.C	101.29	7.95	109.24	47,775	53,100	5,325
274	120	88196458	29/02/2020	A.M	100.03	7.69	107.72	44,489	53,100	8,611
281	125	88196459	02/03/2020	B.K	100.07	7.75	107.82	46,092	53,100	7,008
275	121	88196460	02/03/2020	A.C	97.82	10.24	108.06	47,032	53,100	6,068
122	276	88196461	02/03/2020	A.M	100.5	7.69	108.19	47,672	53,100	5,428
291	132	88196462	04/03/2020	B.K	101.76	8.33	110.09	49,654	53,100	3,446
325	154	88196463	11/03/2020	A.C	101.56	8.03	109.59	46,848	53,100	6,252
332	159	88196464	26/03/2020	A.M	70.43	5.77	76.2	49,705	53,100	3,395
345	167	88196465	23/04/2020	D.K	101.09	7.93	109.02	48,693	53,100	4,407

347	169	88196466	27/04/2020	A.C	101.01	7.85	108.86	48,138	53,100	4,962
348	170	88196467	28/04/2020	V.S	71.74	5.88	77.62	46,158	53,100	6,942
395	192	88196468	20/05/2020	A.M	71.27	7.52	78.79	46,833	53,100	6,267
423	213	88196469	25/07/200	A.M	168.46	13.64	182.1	49,646	53,100	3,454
502	249	88196471	17/06/2020	B.K	98.76	8.33	107.09	49,910	53,100	3,190
700	336	76924442	05/01/2021	A.M	87.34	7.69	95.03	50,431	53,100	2,669
797	392	76924444	05/01/2021	A.C	59.75	7.49	92.34	51,044	53,100	2,056
658	319	76924446	05/01/2021	A.A	90.16	7.93	67.24	52,890	53,100	210
999	999	76924449	01/08/2021	B.K	82.35	7.59	99.03	51,415	53,100	1,685
830	436	76924450	01/08/2021	A.M	59.75	7.52	101.5	52,890	53,100	210
1216	549	92332461	31.12.2021	C.K	62.64	5.82	68.46	50,307	53,100	2,793
1068	546	4d003f46-e78c-440e-8495-e36945127144	31.05.2022	A.C	92.94	8.84	101.78	50,689	53,100	2,411
1232	614	e6f00dcd-38af-4fbd-a9a1-fff34da819ee	31.05.2022	A.M	81.58	10.23	91.81	50,630	53,100	2,470
2	2	6ffb16de-ef2a-4784-b8a2-a43bab955ac7	31.05.2022	B.H	93.24	8.59	101.83	52,460	53,100	640
1568	674	8f8d7033-e426-4fd0-ab1e-20a89bf61fcc	30/06/2022	A.M	81.58	10.23	91.81	49,200	53,100	3,900
999	999	cc0d8e33-7811-464e-ac40-a168398cbdbf	30/06/2022	B.K	84.27	8.07	92.34	50,431	53,100	2,669
999	999	120787b8-0ba6-4a5c-ab3b-94526388b487	30/06/2022	L.A	59.95	7.59	67.54	52,655	53,100	445
719	379	56f16d63-2461-4e1a-b403-872ce99776b	30.11.2022	A.M	90.43	8.24	98.67	50,076	53,100	3,024
54	11	cfee80b5-3408-45ad-8c84-f50efcb6b1d	30.12.2022	R.S	98.48	8.97	107.45	46,552	53,100	6,548

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga shqyrtimi i Lejes së Ndërtimit miratuar me Vendimin e K.RR.T Fier Nr.3, datë 29.09.2011, me afat deri në 30.01.2014, Lejes së Legalizimit Nr.2903079, datë 27.12.2019, kontratave të porosisë, kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme dhe faturave tatimore, rezulton se subjekti përpara daljes së lejes së legalizimit, në kushtet e masës së bllokimit të transaksioneve të shitjes si pasojë e procesit të legalizimit, ka lidhur kontrata premtimi/shitje të pasurive të paluajtshme në të ardhmen, ku janë përcaktuar modalitetet e pagesave më këste. Pagesa e fundit është kryer në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes duke lëshuar dhe faturën tatimore sipas saj. Nga analiza e rrethanave të transaksioneve vlerësojmë se njësia ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, në momentin e kalimit të titullit të pronësisë. Efektet e këtyre transaksioneve fillojnë në momentin e nënshkrimit të kontratave të porosisë, që janë përpara daljes së lejes së legalizimit dhe regjistrimit të objektit në ZVRRP si dhe përpara fillimit të efekteve të VKM Nr.168, datë 27.3.2019, dhe shtrihen deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes dhe kalimit të titullit të pronësisë tek blerësi.

### **36. Subjekti: “M.G” SHPK.**

**NIPT:** L.....N.

Adresë Kryesore: Fshati Delisufaj, Rruga Iliria, Pasuria me Nr.117/17, Fier.

Aktiviteti: Import-Eksport, blerje produkte bujqësore, fruta, perime, artikuj ushqimor e industrial me shumicë dhe pakicë në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Lloji i Kontrollit: Rimbursim TVSH-je.

Inspektori: V.P.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 07/2020-12/2020.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor “M.G” SHPK konkretisht i transaksioneve të blerjes nga fermerët, janë konstatuar 13 fatura tatimore të cilat janë lëshuar në të njëjtën datë me lidhjen e akt marrëveshjes me fermerët si dhe fatura nr.2394, serial 91082394 datë 30/11/2020 nga fermeri “A.S” PF me NIPT L...F me vlerë të tatueshme 140,098 lekë, e cila është lëshuar një ditë përpara datës së lidhjes së akt marrëveshjes me fermerin, e cila është kriter dhe kusht për kreditimin e TVSH për blerjet e kryera nga fermerët sipas përcaktimeve të Udhëzimit

Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”.

Tabela 2.2.1.113: Analiza e transaksioneve të blerjes nga fermerët

Nr Fat	Seriali	Data	Fermeri	Adresa	NIPTi	Marrëveshja			Dif
						Bl Fermer	Nr	Data	
2394	91082394	30/11/2020	A.S	Lushnje	L....F	140,098	12693	01/12/2020	-1
2351	91082351	26/11/2020	A.Q	Lushnje	L....L	140,840	12589	26/11/2020	0
2569	91081569	17/12/2020	A.XH	Divjake	L...U	35,802	13359	17/12/2020	0
2570	91081570	17/12/2020	A.XH	Divjake	L....U	365,066	13359	17/12/2020	0
2403	91082403	01/12/2020	A.F	Lushnje	L....F	90,148	12693	01/12/2020	0
1865	74599465	09/09/2020	E.C	Lushnje	L....I	45,675	9177	09/09/2020	0
2493	91082493	09/12/2020	I.Q	Sarande	L....P	576,830	12997	09/12/2020	0
2087	91082087	26/10/2020	K.Z	Lushnje	L....S	217,835	11298	26/10/2020	0
2081	91082081	26/10/2020	K.Z	Lushnje	L....S	471,700	11298	26/10/2020	0
2568	91081568	17/12/2020	M.K	Berat	L....S	234,057	13358	17/12/2020	0
2717	91081717	28/12/2020	N.K	Sarande	L....G	115,475	13749	28/12/2020	0
1995	88668995	08/10/2020	R.C	Berat	L...D	168,000	10585	08/10/2020	0
2720	91081720	28/12/2020	S.K	Fier	M...G	143,209	13750	28/12/2020	0
2673	91081673	24/12/2020	T.J	Sarande	L....R	67,082	13681	24/12/2020	0
<b>Totali</b>						<b>2,811,817</b>			

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga sa më sipër shuma e blerjes nga fermer vendas me 6% TVSH prej 140,098 leke, sistemohet si blerje e përjashtuara dhe në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti penalizohet me gjobë të barabarte me 20% të detyrimit.

Tabela 2.2.1.114: Sistemim si blerje e përjashtuara

Emërtimi	2020
Blerje nga fermer vendas me 6%	140,098
Ulje e gjendjes kreditore të TVSH	8,406
Gjobë TVSH (20%)	1,681
<b>Detyrime</b>	<b>10,087</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga analiza e zërit “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” të pasivit të bilancit kontabël të shoqërisë, rezulton se është në vlerën 57,469,398 lekë edhe pse me ulje nga periudha paraardhëse, nga ana e inspektorit të kontrollit duhet të ishte kryer një analizë e detajuar e kartelave analitike të llogarisë “Furnitor” mbi likuidimet e kryera për blerjet nga fermerët për periudhën që po kërkon rimbursim TVSH-je, element ky që është kusht për kreditimin sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Tabela 2.2.1.115: Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Zëri	2020	2019
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	75,065,525	86,113,824

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “M.G” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 8,406 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,681 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 10,087 lekë, nga të cilat 8,406 lekë detyrim dhe 1,681 lekë penalitet.**

**37. Subjekti: “P.F” SHPK.**

NIPT: K...E.

Adresë Kryesore: Mbrostar, Fier..

Aktiviteti: Prodhim, tregtim me shumicë e pakicë, eksport-import të polisterolit, plasmasit dhe të gjithë nënprodukteve të tyre etj.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: A.H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 08/2019-01/2022.

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019-2020.

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 08/2019-01/2022.

- Të Tjera periudha tatimore nga: 08/2019-01/2022.

- Nga auditimi i raport kontrollit tatimor është konstatuar se nga inspektori nuk ka një analizë të prodhimit të polisterolit dhe plasmasit sipas kartës teknologjike. Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts, subjekti ka ngarkuar kartën teknologjike të prodhimit në datë 01.02.2023, por e cila nuk rezulton të jetë e certifikuar institucion kompetent i fushës sipas përcaktimeve të Vendimit Nr.434, datë 20.5.2015 “Për përcaktimin e normativave për frot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj, të njohura për qëllime fiskale”.

- Nga analiza e bilancit material për 7 artikujt të përzgjedhur nuk kanë rezultuar diferenca, por nga inspektori nuk është përcaktuar baza e përzgjedhjes së këtyre artikujve, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor.

- Për vitin 2021 subjekti rezulton i pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja, për furnizimet e polisterolit të kryera si nënkontraktor. Nga kontrolli i situatës financiare sipas sistemit C@ts rezulton se subjekti ka kryer rregullimin e TVSH në fund të vitit në FDP, për këto shitje sipas autorizimeve për përjashtim që ka realizuar.

- Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruar në librin e blerjeve me deklaratimet në FDP sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga kontrolli për kreditimin të karburantit, ka rezultuar se shoqëria ka kredituar karburant në raport me qarkullimin vjetor për periudhën objekt kontrolli brenda normave të kreditimit, mqs klasifikohet tek veprimtaria e është e gjerë dhe përfshijnë tregtinë, prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe ndërtimin dhe norma e lejuar e kreditimit të karburantit është 3% - 8% e qarkullimit vjetor sipas nenit 55 ” Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar.

- Për huamarrjet nga të tretët bashkangjitur dosjes së kontrollit janë vendosur në dispozicion kontratat e nënshkruara të borxhit me individët sipas përcaktimeve ligjore të Kreut XIX “Huaja”, konkretisht nenet 1050-1055.

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilanceve kontabël të viteve 2019 dhe 2020, nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qenë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

- Nga kontrolli i PASH, janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklaratimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF, duke mos rezultuar diferenca nga raport kontrolli.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur dhe paguar saktë.

### 38. Subjekti: “I....s” SHPK.

NIPT: K.....L.

Adresë Kryesore: Ish-Uzina e Pambukut, Fier.

Aktiviteti: Import eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimore, industriale, sallameri, makinerive bujqësore, pjesëve të këmbimit, autoservis mjeteve të markave e tonazheve të ndryshme, servis mjeteve, agjensi udhëtimesh, transport udhëtaresh, ndërtim dhe projektim të objekteve sociale, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Përpunim, paketim, ambalazhim, magazinim i produkteve me origjinë shtazore dhe bimore si dhe shitje me shumicë e pakicë i tyre.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: G.LL.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 04/2019-07/2020.

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019.

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: 04/2190-07/2020.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **04/2019-07/2022.**

Nga auditimi i raport kontrollit tatimore, konkretisht nga rillogaritjet e lëvizjes së bilancit material në vlerë dhe sasi, ka rezultuar se vlera e mallit gjendje në 31.12.2019 është 15,415,237.95 lekë.

Tabela 2.2.1.116: Rillogaritjet e lëvizjes së bilancit material në vlerë dhe sasi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.04.2019	Blerjet deri 31.12.2019	Shitje deri 31.12.2019	Gjendje 31.12.2019	Çmimi mesatar	Vlera
1	Kofshe pule	Kg	13,117.89	203,786.21	213,032.01	3,872.09	95.37	369,281.22
2	Krah Pule	Kg	3,550.95	44,010.00	41,856.12	5,704.83	97.57	556,620.26
3	Stomak pule	Kg	16,890.32	143,439.17	148,930.82	11,398.67	84.67	965,125.39
4	Paste pule	Kg	41,537.93	834,300.00	814,800.40	61,037.53	47.02	2,869,984.66
5	Mëlçi Pule	Kg	8,645.68	31,840.00	36,848.68	3,637.00	61.32	223,020.84
6	Pula	Kg	2,988.37	109,266.61	92,546.87	19,708.11	111.83	2,203,957.94
7	Mish Gjeli		-	1,872.00	1,872.00	0	424.10	-
8	Wurstel (evviva)	Kg	9,989.06	73,284.00	63,828.78	19,444.28	179.59	3,491,998.25
9	Gjoks Pule ( Fileto Pule)	Kg	493.96	3,619.44	4,066.36	47.04	-	-
10	Zemra pule	Kg	800	-	800	0	79.77	-
11	Kotoleta	Kg	2,146.52	41,800.90	41,347.97	2,599.45	232.68	604,840.03
12	Lëkurë pule		-	478.64	478.64	0	-	-
13	gjel deti	Kg	0.86	39,597.96	34,452.60	5,146.22	275.54	1,417,989.46
14	Wurstel (salsicë Bonita)	Kg	775	7,280.00	7,100.00	955	-	-
15	Wurstel (salcice Djath)	Kg	540.76	3,264.00	3,053.27	751.49	-	-
16	Gordon Bleu	Kg	6,758.98	29,036.00	30,618.06	5,176.92	275.07	1,424,015.38
17	Bizele	Kg	95	-	95	0	-	-
18	Lepur	Kg	1.19	767.46	759.1	9.55	650.19	6,209.31
19	Arosto	Kg	973.31	10,627.78	10,802.56	798.53	285.08	227,644.93
20	Shkurtëza	Kg	2.4	247.91	223.53	26.78	733.82	19,651.70
21	Kofshë pule e freskët	Kg	125.56	109.3	214.65	20.21	268.50	5,426.39
22	Krahë pule e freskët	Kg	32.07	18.15	50.22	0	-	-
23	Kotoleta (pollo ripieno)	Kg	-	4.11	4.11	0	-	-
24	Kotoleta (turkey rolls)	Kg	0.62	19.14	19.76	0	-	-
25	Salsicia suino	Kg	-	359.48	354	5.48	414.83	2,273.27
26	Ortaiola	Kg	-	96.25	96.25	0	-	-
27	Chickito Pollo	Kg	-	62.4	62.4	0	-	-
28	Tachino m fusi	Kg	-	236.54	231.2	5.34	159.46	851.52
29	Anatra tradizionale	Kg	-	62.4	49	13.4	582.61	7,806.97
30	Capone	Kg	-	8.2	8.2	0	-	-
31	Bov ad Fior	Kg	-	14.24	14.24	0	-	-
32	Polo ali	Kg	-	17.73	17.73	0	-	-
33	Galleto	Kg	-	3.33	3.33	0	-	-
34	Lodra dhurate	Kg	-	960	960	0	-	-

35	Kotoleta (Le birbe 300 gr)	Kg	-	1,857.60	1,267.10	590.5	355.26	209,781.03
36	Kotoleta(croccanti 300 gr)	Kg	-	2,054.70	1,456.80	597.9	330.33	197,504.31
37	Kotoleta (Le birbe 700 gr)	Kg	-	537.6	217.3	320.3	323.33	103,562.60
38	Gordon Bleu 750 gr	Kg	-	576	168.45	407.55	366.01	149,167.38
39	Gordon Bleu 250 gr	Kg	-	945	292.7	652.3	381.15	248,624.15
40	Kotoleta (Clasica 700 gr)	Kg	-	403.2	74.6	328.6	304.02	99,900.97
41	Grudina (djathë pice)	Kg	3	-	3	0		-
42	Mish i grire	cope	120	-	-	120	50	6,000
43	Qofte	cope	80	-	-	80	50	4,000
<b>Totali</b>			<b>109,669</b>	<b>1,586,863</b>	<b>1,553,078</b>	<b>143,455</b>		<b>15,415,237.95</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.1.117: Analiza e gjendjes së mallrave të deklaruar në zërin “Mallra”

Zëri Bilanci Kontabël	2019
Mallra	15,253,915

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga bilanci kontabël sipas sistemit C@ts, rezulton se vlera e gjendjes së mallrave të deklaruar në zërin “Mallra” tek inventari është në vlerën 15,253,915 lek, pra ekziston një diferencë prej 161,322.95 lek, midis vlerës së gjendjes së mallrave sipas lëvizjes së bilancit material dhe vlerës së deklaruar në bilancin kontabël të shoqërisë, e cila përbën blerjet pa faturë tatimore. Për të cilën kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti penalizohet me gjobë të barabarte me 20% të detyrimit.

Tabela 2.2.1.118: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Gjendja në fund e mallrave (T2) sipas Bilancit Material	15,415,238
Gjendja në fund e mallrave (T2) sipas Bilancit Kontabël	15,253,915
Diferenca (Blerje pa faturë)	161,323
TVSH (20%)	32,264
Gjobë TVSH (100%)	32,264
Tatim Fitimi (15%)	24,198
Gjobë Tatim Fitimi (100%)	24,198
<b>Totali</b>	<b>112,926</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “I.....S” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 24,198 lekë detyrime të TF dhe 24,198 lekë gjobë, 32,264 lekë detyrime të TVSH-së dhe 32,264 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën prej 112,926 lekë, nga të cilat 56,462 lekë detyrim dhe 56,462 lekë penalitet.**

### 39. Subjekti: “D.....i” SHPK.

NIPT: L.....H.

Adresë Kryesore: Lagjja “Apollonia”, Rruga “Harrilla Bozo”, Pallati O&P, Kulla 2, Kati I, Fier.

Aktiviteti: Në fushën e shfrytëzimit të mineraleve të grupeve 1,2,3,4, projektim dhe ndërtim minierash dhe karrierash, prodhim i lëndëve të para të ndërtimit, konsulence, import-eksport mineralesh dhe pajisjesh për minierat e karrierat, transport nacional dhe internacional i mallrave, import-eksport, shitje me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm, makineri e pajisje, lëndë të para ndërtimi, prodhim inertesh etj.

Lloji i Kontrollit: Kontrolli i plotë.



Inspektori: E.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 11/2022-08/2023.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2022.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 11/2022-08/2023.
- Të Tjera periudha tatimore nga: 11/2022-08/2023.

- Nga analiza e blerjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe shqyrtimi analitik i natyrës së tyre, rezulton se ato i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë dhe janë në funksion të sigurimit dhe ruajtjes së fitimit. Konkretisht ka kryer blerje të përjashtuara të cilat janë siguracione dhe blerje nga furnitor vendas me TVSH 20% të cilat janë materiale të para, vaj, pjesë këmbimi dhe vegla pune në funksion të aktivitetit. Nga analiza dhe kontrolli i kryer mbi blerjet e deklaruar në librin e blerjeve me të dhënat e deklaruara sipas FDP, sipas të dhënave të C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Nga analiza e shitjeve të shoqërisë sipas raport kontrollit tatimor dhe kontrolli me të dhënat sipas C@ts të librave mujor të shitjeve dhe FDP të TVSH-së, ka rezultuar se për periudhën 11/2022-12/2022 shoqëria nuk ka kryer shitje, kurse për periudhën 01/2023-08/2023, shoqëria ka kryer shitje të tatueshme me 20% në vlerën 1,063,987 lekë, të cilat janë shitje kamioni ATQ dhe shitje gipsi. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe sipas të dhënave të sistemit C@ts, nuk kanë rezultuar diferenca.

- Për sa i përket bilancit material shoqëria kryen aktivitet në fushën e nxjerrjes së mineralit të gipsit dhe sipas raport kontrollit tatimor rezulton se gjatë kësaj periudhe subjekti ka qënë në fazën e investimeve dhe punimeve paraprake për shfrytëzimin e gurores, prandaj inventari në fund të çdo periudhe objekt kontrolli ka qënë 0.

- Nga analizimi i llogarive të aktiveve dhe pasiveve të bilancit kontabël të vitit 2022 nuk kanë rezultuar problematika dhe pasqyrat financiare kanë qënë të përgatitura konform dhe në përputhje me Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

- Nga kontrolli i PASH janë rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet sipas PASH, duke i krahasuar me deklaratimet mujore të librave blerje/shitje dhe FDP e TVSH-së, si dhe FDP të TF, duke mos rezultuar me diferenca.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli dhe analiza e situatës së tatimit në burim dhe rezultoi se është llogaritur saktë.

#### **40. Subjekti: "F.....4" SHPK.**

NIPT: K.....J.

Adresë Kryesore: Lagjja "Kastriot", tek zyrat e Albtelekomit, Kati i 3 – të, Fier.

Aktiviteti: Neni 7 kategoritë e licencës të Ligjit Nr.75/2014, datë 10.07.2014 për shërbimin privat të sigurisë si më poshtë: a) nënkategorinë 1.3.A sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private i personave si dhe veprimtarive social - kulturore, sportive, fetare e politike, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.

Lloji i Kontrollit: Kontroll i plotë.

Inspektori: Sh.N.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 01/2019-01/2022.
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2019-2020.
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 01/2019-01/2022.
- Të Tjera periudha tatimore nga: 01/2019-01/2022.

Nga kontrolli i dokumenteve standarte të tenderit (DSK) për kontratat e lidhura vetëm me Albpetrol SHA, OSHEE/Rajoni Fier dhe Spitali Rajonal Fier, janë nxjerr të dhëna mbi numrin e punonjësve të nevojshëm për të përmbushur kontratat e shërbimit të ruajtjes fizike, konkretisht:

Tabela 2.2.1.119: Analiza e numrit të nevojshëm për të përmbushur kontratat e shërbimit të ruajtjes fizik

Kontrata	Nr. Vendroje	Emërtimi i objektit dhe asetëve që ruajnë	Nr Roje
Kontratë Shërbimi Nr.3573/12 Prot, datë 31.05.2019 Albpetrol SH.A QFT Patos	Nr.1	Hyrja e QFT dhe shërbimi i tubove	4.98
	Nr.2	Magazina e QFT	4.98
Kontratë Shërbimi Nr.162/25 Prot, datë 10.05.2019 OSHEE SH.A/ Drejtoria Rajonale Fier	Nr.1	N/St Qarr	4.98
	Nr.2	N/St Fier 1	4.98
	Nr.3	N/St Fier 2	4.98
Ruajtja e godinës me roje private - Spitali Rajonal Fier	Nr.1	Spitali Godina Qendrore	4.98
	Nr.2	Godina e Pediatriisë	1.66
	Nr.3	Godina e Maternitetit	3.32
	Nr.4	Poliklinika e Specialiteteve	4.98
<b>Total</b>			<b>39.84</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Meqenëse shoqëria është shpallur fituese në këto procedura prokurimi rrjedh se detyrimisht i ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe çdo kërkesë ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit. Nga përlllogaritjet del se përgjatë kësaj periudhe shoqëria ka pasur angazhime në më shumë se një punë publike njëkohësisht, nga logjikisht rrjedh se duhet të shfrytëzojë gjithë kapacitetin e plotë të fuqisë punëtore me qëllim përmbushjen e kushteve të kontratave të prokurimit. Sipas listëpagesave të dorëzuara përgjatë periudhës objekt kontrolli 01/2019-01/2022 në sistemin informatik tatimor C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht çdo muaj 30 punonjës, konkretisht si më poshtë:

Tabela 2.2.1.120: Numri i punonjësve përgjatë çdo muaji

Periudha	Nr Punonjës Tot	Nr Roje	Personel Administrativ
Janar 2019	40	32	8
Shkurt 2019	42	34	8
Mars 2019	41	34	7
Prill 2019	32	27	5
Maj 2019	31	26	5
Qershor 2019	32	27	5
Korrik 2019	46	41	5
Gusht 2019	48	43	5
Shtator 2019	45	40	5
Tetor 2019	40	37	3
Nëntor 2019	39	36	3
Dhjetor 2019	40	36	4
Janar 2020	41	37	4
Shkurt 2020	40	36	4
Mars 2020	42	38	4
Prill 2020	42	38	4
Maj 2020	42	38	4
Qershor 2020	40	36	4
Korrik 2020	28	24	4
Gusht 2020	26	22	4
Shtator 2020	22	18	4
Tetor 2020	23	19	4
Nëntor 2020	22	18	4
Dhjetor 2020	22	18	4
Janar 2021	23	19	4

Shkurt 2021	22	18	4
Mars 2021	22	18	4
Prill 2021	20	16	4
Maj 2021	20	16	4
Qershor 2021	19	15	4
Korrik 2021	19	15	4
Gusht 2021	18	14	4
Shtator 2021	8	4	4
Tetor 2021	8	4	4
Nëntor 2021	0	0	0
Dhjetor 2021	0	0	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Analiza bazohet tek profili i kategorisë së profesionit “Roje”, të cilët mund të jenë të angazhuar vetëm një vend-roje shërbimi, në ndryshim nga pozicionet si Teknik/inxhinier telekomunikacioni, Asistent Sigurimi, Teknik/Përgjegjës Sektori etj, që mund të ndjekin pa pengesë disa projekte njëkohësisht. Nga analiza e mësipërme dalim në konkluzion se nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara të subjektit kanë rezultuar mesatarisht 30 punonjës çdo muaj të deklaruar dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë të grafikut të ekzekutimit të shërbimit të ruajtjes sipas kontratave të lidhura me institucionet publike dhe private, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale sipas kontratave të prokurimit të nënshkuara. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer një thellim i analizës së situatës financiare të subjektit gjatë fazës së kontrollit në terren, me qëllim dokumentimin fakteve që do të shërbenin si arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, sepse rezultojnë mospërputhje e pajustificuar teknike midis numrit të punonjësve të regjistruar në listëpagesa dhe punonjësve që janë të domosdoshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale sipas kontratave të prokurimit të nënshkuara.

Nga kontrolli në sistemin C@ts rezulton se subjekti nuk ka deklaruar dhe paguar tatim në burim për objektin e marrë me qera për të cilën duhet të ishte kryer rivlerësimi i situatës financiare duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të gërmës c) të nenit të 117 ”Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tabela 2.2.1.121: Rivlerësim i situatës financiare

Emërtimi	Vlera
Vlera e qerasë mujore	8,000
Nr muajve rivlerësim	32
Vlera totale e rivlerësuar	256,000
Detyrim Tatimi në burim (15%)	38,400
Gjobë (100%) Tatim në burim	38,400
<b>Total penalitet sipas KLSH</b>	<b>76,800</b>
Detyrim Tatimi në burim (15%)	38,400
Gjobë (21.9%) Tatim në burim	8,410
<b>Total penalitet sipas Inspektorit</b>	<b>46,810</b>
<b>Diferenca detyrime shtesë</b>	<b>29,990</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

**Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimore të subjektit “F.....K” SHPK, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 29,990 lekë gjobë Tatimi në burim, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 29,990 lekë, nga të cilat 0 lekë detyrim dhe 29,990 lekë penalitet.**

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:**

Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, neni 48, germa b, c të nenit 71, germa a, e të nenit 72, neni 73, neni 115, germa të nenit 117, neni 119, neni 124, neni 128;

Ligji Nr.8438 date 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 20, germa n, ll të nenit 21;

Ligjin Nr.92/2014 datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, neni 55, neni 69, neni 72, Kreu IX;

Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1;

Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 15,

Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, neni 48, germa b, c të nenit 71, germa a, e të nenit 72, neni 73, neni 115, germa të nenit 117, neni 119, neni 124, neni 128;

UMF Nr.6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, neni 20, pika V e nenit 55;

UMF Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ,

Udhëzimi Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”, pika 3 e nenit 19;

UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2;

Ligji Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në R.SH”, i ndryshuar, neni 87, 119,

Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;

Vendimi Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;

Vendimi Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

VKM Nr.168, datë 27.3.2019;

Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor”;

Rregulloren e Funkionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhërin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrisë të Financave;

Pika 1 e nenit 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.

Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8 të nenit 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.

Pikat 2, 7, 11 të nenit 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtoritë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera rajonale”.

Pikat 3, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.

**Formulari i dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale.** (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nënpunësit/titullar si person që ka dijeni dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

**Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:**

Z. A.P, me detyrë Drejtor Rajonal pranë DRT Fier;  
Z. B.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DRT Fier;  
Z. E.XH, me detyrë ish Përgjegjës i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DRT Fier;  
Z. G.LL, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. A.K, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. V.R, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. E.F, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. L.C, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. G.M, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. S.Z, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. A.G, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. A.H, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Znj. V.P, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. Sh.N, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. J.H, me detyrë ish Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. E.K, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. D.S, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. B.H, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
Z. E.M, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier.

Për sa më sipër me personat përgjegjës A.P, B.S, E.XH, G.LL, A.K, V.R, E.F, L.C, G.M, S.Z, A.G, A.H, V.P, Sh.N, J.H, E.K, D.S, B.H, E.M.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/23 prot., datë 21.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve për subjektin “A....N” SHPK, nga Z. D.S, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Diferencat e konstatuara nga ana e grupit të auditimit nuk qëndrojnë pasi ju i jeni referuar gjendjes në fillim dhe në fund të periudhës bazuar mbi inventarin analitik të dorëzuar nga subjekti duke mos i përzgjedhur të gjithë artikujt pllaka dhe parket. Bashkëlidhur inventari fizik, po e njëjta gjë ka ndodhur edhe për artikullin stuko+fino.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/30 prot., datë 01.07.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024”, referuar gjetjeve për subjektin “G.K M” SHPK, nga Z. S.Z, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Lidhur me konstatimin për afatin 5 vjeçar të kontrollit nga data e fundit e dorëzimit ose ndryshimit të deklaratës tatimore ju bëj me dije se ligji i referohet datës së fundit të deklaratës së ndryshuar nga subjekti.2. lidhur me konstatimin për faturën me nr.1123 datë 28.11.2017 për vitin 2017 nuk kemi një analizë të blerjeve të detajuara, gjithashtu ju bëj me dije se subjekti është programuar për rikontroll dhe i jam referuar konstatimeve të propozimit për rikontroll nga grupi i mëparshëm.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** 1. Pretendimi nga ana juaj se afati 5 vjeçar i parashkrimit i referohet datës së fundit të ndryshimit të deklaratës nga subjekti nuk qëndron pasi ligji shprehet qartë se e drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore fillestare apo të ndryshuar. 2. Për sa i përket kundërshtimit nga ana juaj lidhur me faturën për te cilën ju pretendoni se nuk është mobilje nuk është paraqitur e dhënë ndryshe nga ajo e trajtuar gjatë fazës së auditimit në teren. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/24 prot., datë 25.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve për subjektin “V.S” SHPK, nga Z. A.G, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Lidhur me konstatimin e diferencave midis inventarit kontabël dhe atij fizik për vitin 2021 ju bëjmë me dije se shoqëria ka deklaruar vetëm inventarin fizik të mallrave në datën 21.12.2022, ndërsa kur janë deklaruar pasqyrat financiare dhe raporti i auditimit të jashtëm rezulton se në inventarin kontabël janë shtuar edhe mjetet e punës të cilat shoqëria i ka shtuar në totalin e bilancit.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit: 1.** Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/24 prot., datë 25.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve për subjektin “R...4” SHPK, nga Z. A.G, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Lidhur me zhvlerësimin e inventarit të imët kjo ka ndodhur për shkak të skadencave dhe dëmtimeve. 2. Lidhur me diferencën në shtesën e AAM prej 39,955,132 lekë nuk është vetëm puna e kryer nga subjekti ndërtues por përfshihet edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë e cila është në shumën 28,138,089 lekë si dhe shërbimet e tjera. 3. Lidhur me diferencat e arkëtimeve afatshkurtra në avancë në fillim dhe në fund janë blerje parapagime që janë bërë që prej vitit 2015.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/19 prot., datë 11.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve për subjektin “K.I” SHPK, nga Z. A.K, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Lidhur me konstatimin për normativat e konsumimit të karburantit ju bëj me dije se blerjet e hedhura në raportin e kontrollit janë hedhur gabimisht blerjet e vitit 2021, ndërkohë blerjet e periudhës po i paraqes në këtë observacion.

2. Lidhur me blerjet për shërbimet e mirëmbajtjes ato janë shërbime për mjetet që janë blerë nga importi me qëllim rishitjen e tyre.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit: 1.** Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/19 prot., datë 11.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024 ”, referuar gjetjeve për subjektin “I.F” SHPK, nga Z. A.K, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** 1. Lidhur me konstatimin e diferencave midis inventarit kontabël dhe atij fizik për vitin 2019 dhe 2020 i jam referuar pasqyrave financiare ku pasqyrohen të detajuara pasqyra e lëvizjes së mallrave.

2. Lidhur me mos analizimin e bilancit material ju bëjmë me dije se është analizuar në raport kontrolli.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/25 prot., datë 26.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024”, referuar gjetjeve për subjektin “F...a” SHPK, nga Z. B.H, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur me konstatimin për likuidimin e furnitorëve ju bëjmë me dije se kontrolli për rimbursimin e TVSH-së është zhvilluar për periudhën 2021-.07-2022.10 rezultojnë se këta furnitor janë të likuiduar sipas trajtimit në raport kontrolli.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Grupi i auditimit i referohet deklaratave të cilat gjenden në sistemin C@ts, si dhe ato në raport kontrolli, argumentet justifikues të paraqitur nga ana juaj, nuk i referohen furnitorëve të cilat janë përmendur në Projekt Raportin e Auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Është paraqitur observacioni me nr.1112/25 prot., datë 26.06.2024 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024”, referuar gjetjeve për subjektin “R.....R” SHPK, nga Z. B.H, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Ju bëjmë me dije se kontrolli për rimbursimin e TVSH-së së zbritshme është për periudhën 2021.10-2022.04 dhe për TF 2019-2020 ku janë marr inventarët kontabël të çeljes dhe të periudhës 30.04.2022 të firmosur nga ana e subjektit, ku janë krahasuar dhe nuk rezultojnë diferenca këto pasqyrohen edhe në Aktivin dhe Pasivin e pasqyrave financiare.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Grupi i auditimit i referohet deklaratave të cilat gjenden në sistemin C@ts, të dhënavë të deklaruara nga subjekti si dhe ato të dhëna të pasqyruara në raport kontrolli, argumentet justifikues të paraqitur nga ana juaj nuk sqarojnë diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit midis inventarit fizik dhe atij kontabël. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/65 Prot dhe datë 26.06.2024 “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/26 Prot., datë 27.06.2024, nga Z. L.C, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** - Sqaron se subjekti ka lidhur kontrata pune me punonjësit për 26 ditë pune dhe ditët e punuara tepër do t’i marrin pushim pra realisht punonjësit kanë punuar 22 ditë pune në muaj. - Pretendon se ka gabim në llogaritjen e KMSH sepse vlera e blerjes së aktiveve 6,350,561 lekë e cila është edhe diferenca e aktiveve në balancë në fund dhe fillim por nuk është shtuar vlera e amortizimit për vitin në vlerën 15,031,707 lekë, ku në total blerja e aktiveve për vitin është në vlerën 21,382,268 lekë. Nuk është marr parasysh ndryshimi i gjendjes së shpenzimeve të shtyra në vlerën 410,358 lekë. Nuk është marrë parasysh ndikimi i blerjeve më lizing, e cila është deklaruar si blerje por nuk është pasqyruar në aktivet e bilancit si dhe nuk janë marrë parasysh shpenzimet e tjera pa faturë. – Është kryer analiza e plotë e rritjes së çmimit për vitin 2019, bashkangjitur këtij observacioni.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. C, për subjektin “X...O” SHPK në lidhje me problematikat e pagave të konstatuara nga grupi i auditimit, sqarojmë se nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 12/2018-05/2020, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH. Në lidhje me këto problematik nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë. - Në lidhje me pretendimet dhe rilogaritjet e KMSH të kryera nga inspektori në observacion, sqarojmë se nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë. – Në lidhje me analizën e rritjes së çmimit sqarojmë se nuk është kryer një analizë e plotë e rritjes së çmimit për produktet e shitura në vitin 2019, sipas kërkesave të Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor, kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/61 Prot dhe datë 19.06.2024 “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/22 Prot., datë 21.06.2024, nga Znj. V.P, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** 1. Për subjektin “S....A” SHPK, sqaron se ka kredituar karburant brenda normave të lejuara dhe bashkangjitur observacioni është paraqitur lista e objekteve të punimeve ndërtimore për periudhën. – Për kreditimin e gabuar të TVSH për blerje autoveturë Mercedes Benz, pretendon se është mjet transporti për personelin me 13 vende, pra furgon (Bashkangjitur ka vendosur në dispozicion deklaratën doganore të importit të mjetit). – Pretendon se nuk ka furnizime të patatueshme për periudhën 2017-2019 dhe nuk mund të llogaritet koeficienti i ndryshuar i kreditimit të TVSH si dhe pretendon se vlera e karburantit i cili ka kaluar si blerje e përjashtuar është përdorur në procesin e rindërtimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektores së kontrollit, Znj. P, për subjektin “S....A” SHPK, nuk janë vendosur në dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacioni i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit, konkretisht në observacionin e dërguar është hartuar një tabelë me listën e objekteve të punimeve të kryera nga shoqëria por jo një analizë e detajuar e punimeve ndërtimore për të ndarë në zëra specifik kategori punimesh për efekt të kreditimit të karburantit sipas përcaktimeve të nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë. - Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit tatimor rezulton se shoqëria për vitin 2020 ka kryer shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas autorizimeve përkatëse me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkinë Durrës dhe në këto kushte sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 69 “Zbritja e TVSH-së” dhe nenit 72 “Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të llogariste koeficientin e zbritjes së TVSH-së dhe të rregullonte situatën e kreditimit të blerjeve të karburantit që i kanë shërbyer të dy aktiviteteve, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë sepse nuk janë vendosur në dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacioni i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. - Në lidhje me automjetin Mercedes Benz është vendosur në dispozicion deklarata doganore R 48383 datë 25.04.2018, ku në fushën nr.31 është bërë përshkrimi “Mjet për transport personash me 13 vende, Mercedes Benz 315 CDI, viti 2006”, dokumentacioni justifikues ky i vendosur në dispozicion dhe i marrë në konsideratë në fazën e projekt raportit të auditimit ku janë kryer edhe reflektimet përkatëse.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/58 Prot dhe datë 10.06.2024 “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/19 Prot., datë 11.06.2024, nga Z. J.H, ish Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** 1. Për subjektin “L.C” SHPK, sqaron se ka kryer vlerësim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore duke ju përmbajtur programit të kontrollit. – Sqaron se huamarrjet nga ortakët nuk janë dividend dhe të ardhura të padeklaruara por janë mjete monetare që janë marrë hua me kontrata të rregullta nga individë dhe në këtë mënyrë nuk e ka parë të arsyeshme të kryer informacionin RAD si mjete të dyshimta monetare. - Në lidhje me vlerësimin për mos pagim të tatimit në burim për mjetet e punës me qera sqaron se vlerësimi i kryer nga inspektori është korrekt.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. H, për subjektin “L.C” SHPK, në lidhje me problematikat e pagave të konstatuara nga grupi i auditimit, sqarojmë se nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat dhe mangësitë procedurale në hartimin e raportit të kontrollit tatimor, të cilat shërbejnë si bazë për mbledhjen e fakteve dhe provave gjatë fazës së punës në terren me qëllim rivlerësimin e situatës financiare të tatimpaguesit, i cili ka plotësuar deklaratat tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Konkretisht problematika e konstatuara: 1. Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 07/2019-06/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës



normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH. 2. Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. 3. Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH. 4. Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. 5. Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH. 6. Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nëq ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës. 7. Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit. 8. Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 07/2019-06/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me këto problematika nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me pjesën e observacionit për llogarinë e ortakut sqarojmë se nuk janë sjellë dokumenta justifikues për vlerat monetare të cilat pretendohen se janë dhënë hua nga ortakut drejt shoqërisë, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me vlerësimin për mos pagim të tatimit në burim për mjetet e punës me qera, sqarojmë se nuk merren në konsideratë sepse nuk janë vendosur në dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit dhe janë të njëjtat të vendosur në dispozicion gjatë fazës së projekt raportit të auditimit, observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/63 Prot dhe datë 24.06.2024 “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/24 Prot., datë 25.06.2024, nga Z. A.G, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** - Sqaron se subjekti ka lidhur kontrata të rregullta pune me punonjësit, ku janë përcaktuar se orari i punës është 7 orë nga e hëna në të premte dhe 5 orë ditën e shtunë duke mos sjellë tejkalim të 174 orë pune në javë, këto kontrata janë paraqitur edhe tek Inspektorati i Punës të cilat kanë rezultuar të rregullta konform përcaktimeve të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. (Bashkangjitur observacionit janë vendosur në dispozicion kontrata pune me punëmarrësit si dokument justifikues). Gjithashtu sqaron se listëpagesa është formular i deklarimit të kontributeve dhe TAP, i miratuar me ligj ku deklarimi bëhet me ditë dhe nuk jep mundësi për deklarim të orëve të punës, për këtë arsye subjekti në deklarim ka vendosur 26 ditë punë përfshirë edhe të shtunën edhe pse punohet vetëm për 5 orë, duke zbatuar në këtë mënyrë kuadrin rregullator në fuqi. Gjithashtu pretendon se janë kryer gabim llogaritjet për punonjësit e deklaruar në listpagesës me kodin 2/004, të cilët janë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditë. – Në lidhje me kontributet e ortakut nëpërmjet huadhënies ndaj shoqërisë sqaron se shoqëria në të njëjtën periudhë ka kaluar kontroll edhe nga Hetimi Tatimor për llogarinë e ortakut, e cila nuk ka rezultuar me problematika. (Bashkangjitur observacionit është vendosur në dispozicion kontrata e huadhënies midis ortakut dhe shoqërisë si dhe komunikimet me email me Drejtorin e Hetimit Tatimor si dokument justifikues).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. G, për subjektin “G.....A” SHPK, në lidhje me problematikat e pagave të konstatuara nga grupi i auditimit, sqarojmë se nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat dhe mangësitë

procedurale në hartimin e raport kontrollit tatimor, të cilat shërbejnë si bazë për mbledhjen e fakteve dhe provave gjatë fazës së punës në terren me qëllim rivlerësimin e situatës financiare të tatimpaguesit, i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Konkretisht problematika e konstatuara: 1. Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 09/2018-09/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH. 2. Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendimi Nr.399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. 3. Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH. 4. Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. 5. Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH. 6. Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nqs ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës. 7. Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit. 8. Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 09/2018-09/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me këto problematik nuk janë vendosur dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me pjesën e observacionit për llogarinë e ortakut sqarojmë se nuk janë sjellë dokumenta justifikues për vlerat monetare të cilat pretendohen se janë dhënë hua nga ortakut drejt shoqërisë, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni pa nr prot dhe pa datë “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/30 Prot., datë 01.07.2024, nga Z. S.Z, Inspektor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** - Pretendon se shoqëria nuk është në kushtet e pikave b, c dhe dh të nenit 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të kryer rivlerësim të situatës financiare sepse marzhet e rentabilitetit të shoqërisë variojnë nga 75.4%-95% dhe nuk ka tendencë për shmangie tatimore. Bashkangjitur observacionit është vendosur në dispozicion shkresa që MFE i ka dërguar DPT për kompetencë në lidhje me “Marrëveshjen për përcaktimin e treguesve minimal për efekt të përllogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim” dakortuar midis DPT dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë. Gjithashtu bashkangjitur observacionit janë vendosur në dispozicion kontrata shitje të pasurive të paluajtshme të noterizuar për të vërtetuar se çmimet janë reale dhe likuidimet janë kryer me bank.

- Gjithashtu kundërshton faktin e llogaritjes së penaltiteve të TVSH në shitje sepse furnizimi i ndërtesave është i përjashtuar nga TVSH-ja sipas përcaktimeve të nenit 53 të Ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për TVSH në R.SH”, i ndryshuar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. Z, në lidhje me subjektin "A...4" SHPK, nuk janë vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion justifikues për të mbështetur pretendimet si vlerësime të projektit, situacione pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve, leje zhvillimore, leje ndërtimi, akt kolaudime, certifikata shfrytëzimi. Në lidhje me kontratat shitje që janë vendosur në dispozicion si dokument justifikues për çmimet e shitjes sqarojmë se kontrata e shitje-blerjeve të pasurime të paluajtshme janë akte juridike të dyanshme në të cilat negociohet çmimi i shitjes dhe ky fakt nuk e hedh poshtë konstatimin e grupit të auditimit se çmimet e shitjeve të njësive ndërtimore sipas këtyre kontratave janë poshtë çmimeve minimale për efekte fiskale të përcaktuara tek aneksi nr.2 të Udhëzimit Nr.3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016" dhe aneksi nr.2 "Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi" të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Argumenti i marzheve të larta në shitje që nuk ka tendencë për shmangie tatimore është i pa mbështetur me bazë ligjore dhe nuk do të merret në konsideratë. Në lidhje me pjesën e observacionit për koston sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: "Kostoja mesatare e ndërtimit sipas qyteteve për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi". Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me koston mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikës së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi.

- Sqarojmë se furnizimi i ndërtesave është i përjashtuar sipas përcaktimeve të nenit 53 të Ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2014 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar, në kushte normale kur vetdeklarohet saktë nga subjekti por në kushtet dhe rrethanat kur korrigjimi bëhet nga inspektori i kontrollit tatimor ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në rivlerësimin e shitjes së njësive ndërtimore poshtë çmimeve referenc sipas VKM Nr.168, datë 27.3.2019, duke kryer faturim të pasaktë me tendencë shmangie tatimore duke përfituar padrejtësisht TVSH të kreditueshme në blerje gjatë procesit të blerjes së situacioneve të ndërtimit është kryer edhe penalizimi për TVSH. Observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/60 Prot dhe datë 19.06.2024 "Observacion", protokolluar në KLSH me Nr.1112/21 Prot., datë 21.06.2024, nga Z. E.XH, ish Përgjegjës i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Sqaron se në pikën 3 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet se Raporti i kontrollit miratohet nga strukturat përkatëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore, përfshirë Përgjegjësën e Sektorit, Drejtorinë e Kontrollit dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale, pra nuk janë përgjegjës për hartimin e raportit por vetëm e miratojnë raportin kontrollin. Për këtë arsye nuk ngarkohemi me përgjegjësi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. Xh, në lidhje me gjetjet e paraqitura në raportin përfundimtar të auditimit sqarojmë se, nuk ka një kundërshtim të konkluzioneve të grupit të auditimit dhe gjithashtu sqarojmë se Përgjegjësi i Sektorit sipas Formularit të dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit, firmos dhe ka të drejtën e komenteve në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar e bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/59 Prot dhe datë 19.06.2024 "Observacion", protokolluar në KLSH me Nr.1112/20 Prot., datë 21.06.2024, nga Z. B.S, Drejtor i Kontrollit në Vend në Drejtorin e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Sqaron se në pikën 3 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet se Raporti i kontrollit miratohet nga strukturat përkatëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore, përfshirë Përgjegjësën e Sektorit, Drejtorinë e Kontrollit dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale, pra nuk janë përgjegjës për hartimin e raportit por vetëm e miratojnë raportin kontrollin. Për këtë arsye nuk ngarkohemi me përgjegjësi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. S, në lidhje me gjetjet e paraqitura në raportin përfundimtar të auditimit sqarojmë se, nuk ka një kundërshtim të konkluzioneve të grupit të auditimit dhe gjithashtu sqarojmë se Drejtor i Drejtorisë sipas Formularit të dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit, firmos dhe ka të drejtën e komenteve në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar e bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Observacioni nuk merret në konsideratë.

### **Mbi auditimin e përputhshmërisë ligjore të afateve procedurale të kontrolleve në vend**

Në lidhje me këtë çështje u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Planin e kontrolleve të plota dhe të rimbursimeve për periudhën 01.01.2021 -31.12.2022;*
- *Projekt Raport Kontrollit Tatimore dhe Raportet Përfundimtare të Kontrollit Tatimor;*
- *Çdo informacion dhe dokumentacion shtesë i vlerësuar për kontroll nga grupi i auditimit dhe i vënë në dispozicion nga Inspektorët e Kontrollit Operacional në DRT Fier.*

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DRT Fier, grupi i auditimit ka përzgjedhur dosjet e kontrollit për auditimin e përputhshmërisë ligjore të afateve procedurale në hartimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të kontrollit tatimore, në respektim të parimet të proporcionalitetit dhe objektivitetit në shqyrtimin e dosjeve për çdo inspektor kontrolli.

*Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për nxjerrjen e Akteve të Projekt Raportit të Kontrollit Tatimor dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi, u përzgjedhën për auditim dosjet fizike të raporteve të kontrolleve të periudhës 01.01.2021-31.12.2022, ku nga auditimi i kryer, analizuar rast pas rasti, u konstatua se:*

*Tabela 2.2.1.122: Informacion mbi kontrollet e kryer sipas orëve të punës*

N r	Tatimpaguesi	NIPT	Inspektori	Data e fillimit të kontrollit	Data e mbarimit të kontrollit	Orë Pune	Njoftim Kontrolli Tatimor C@ts	Shkresa e PR	Afati Ligjor PR	Dif Ditë
1	K.Z	K....R	E.F	23/03/2023	04/04/2023	61	16/03/2023	18/04/2023	11/04/2023	-7
2	R....8	K....F	D.S	14/08/2023	25/08/2023	70	04/08/2023	08/09/2023	01/09/2023	-7
3	Z....7	L....F	A.G	08/05/2023	05/06/2023	160	27/04/2023	24/07/2023	12/06/2023	-42
4	E....L	L....L	A.A	12/09/2023	13/10/2023	183	06/09/2023	10/11/2023	20/10/2023	-21
5	D....I	J....U	L.C	20/06/2022	21/07/2022	180	09/06/2022	18/08/2022	28/07/2022	-21
6	L....O	K....K	G.M	26/10/2021	10/12/2021	244	27/09/2021	17/01/2022	17/12/2021	-31
7	K....I	L....A	E.M	04/10/2023	24/10/2023	110	03/08/2023	25/10/2023	31/10/2023	6
8	P...A	K....O	Sh.N	13/09/2022	28/09/2022	86	16/08/2022	12/10/2022	05/10/2022	-7
9	L...L	K....E	J.H	04/05/2023	16/05/2023	66	27/04/2023	06/06/2023	23/05/2023	-14
10	A...O	K....M	E.K	21/07/2021	08/09/2021	270	15/07/2021	24/09/2021	15/09/2021	-9
11	A...6	K....V	V.P	02/05/2022	16/07/2022	260	28/12/2022	14/07/2022	23/07/2022	9
12	S....0	K....O	S.Z	06/12/2021	17/02/2022	400	27/10/2021	22/02/2022	24/02/2022	2
13	K...T	K....G	A.H	25/03/2023	17/05/2023	272	27/02/2023	17/05/2023	24/05/2023	7
14	P...A	K....F	V.R	03/08/2021	29/09/2021	320	15/07/2021	09/09/2021	06/10/2021	27
15	N...I	J....C	A.K	11/07/2023	03/08/2023	138	27/06/2023	14/08/2023	10/08/2023	-4
16	F...I	J....A	G.LL	08/03/2021	08/04/2021	160	19/01/2021	29/04/2021	15/04/2021	-14
17	Z...O	J....K	G.V	24/06/2021	13/08/2021	280	15/06/2021	12/11/2021	20/08/2021	-84
18	R.....I	L...T	B.H	26/08/2021	09/09/2021	72	24/08/2021	14/09/2021	16/09/2021	2

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Tabela 2.2.1.123: Informacion mbi kontrollet e kryer sipas datës së projekt raportit dhe raportit

Nr	Tatimpaguesi	NIPT	Inspektori	Projekt Raporti në C@ts	Shkresa RP	Afati Ligjor RP	Dif Ditë	Raporti Përf në C@ts
1	K.J	K.....R	E.F	12/04/2023	25/04/2023	21/05/2023	26	18/04/2023
2	R.....8	K.....F	D.S	07/09/2023	12/10/2023	11/10/2023	-1	26/09/2023
3	Z.....7	L.....F	A.G	04/07/2023	04/09/2023	22/07/2023	-44	04/08/2023
4	E.....L	L.....L	A.J	02/11/2023	19/12/2023	29/11/2023	-20	06/12/2023
5	D.I	J.....U	L.C	11/08/2022	06/09/2022	06/09/2022	0	29/08/2022
6	L...O	K.....K	G.M	24/12/2021	19/01/2022	26/01/2022	7	17/01/2022
7	K...I	L.....A	E.M	19/10/2023	10/11/2023	09/12/2023	29	09/11/2023
8	P..A	K.....O	Sh.N	04/10/2022	31/10/2022	14/11/2022	14	12/12/2022
9	L..L	K.....E	J.H	30/05/2023	12/07/2023	02/07/2023	-10	29/06/2029
10	A...O	K.....M	E.K	22/09/2021	01/11/2021	25/10/2021	-7	11/10/2021
11	A...6	K.....V	V.P	12/07/2022	06/09/2022	01/09/2022	-5	02/09/2022
12	S;...0	K.....O	S.Z	11/02/2022	28/03/2022	05/04/2022	8	16/03/2022
13	K.....T	K.....G	A.H	06/06/2023	12/07/2023	03/07/2023	-9	06/06/2023
14	P...A	K.....F	V.R	03/09/2021	11/10/2021	15/11/2021	35	27/09/2021
15	N...I	J.....C	A.K	07/08/2023	31/08/2023	19/09/2023	19	30/08/2023
16	F...I	J.....A	G.LL	30/03/2021	30/06/2021	25/05/2021	-36	25/05/2021
17	Z...O	J.....K	G.V	10/11/2021	06/12/2021	29/09/2021	-68	02/12/2021
18	R....I	L.....T	B.H	13/09/2021	27/09/2021	29/09/2021	2	20/09/2021

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

### 1. Subjekti: “K.Z” SHPK.

**NIPT:** K.....R.

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 16.03.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.14790/1 prot, datë 23.03.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.14790/2 prot, datë 23.03.2023, ku janë programuar 61 orë pune ose 8 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 23.03.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.14790/3 prot, datë 18.04.2023, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.14790/4 prot, datë 25.04.2023, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### 2. Subjekti: “R....8” SHPK.

**NIPT:** K.....F.

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 04.08.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.2829/1 prot, datë 11.08.2023 së bashku me Programin e Kontrollit pa nr protokollit dhe pa datë, ku janë programuar 70 orë pune ose 9 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 14.08.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.2829/5 prot, datë 08.09.2023, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.2829/6 prot, datë 12.10.2023, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**3. Subjekti: “Z.....7” SHPK.**

**NIPT: L....F.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.04.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.525/1 prot, datë 08.05.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.525/2 prot, datë 08.05.2023, ku janë programuar 160 orë pune ose 20 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 08.05.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.525/3 prot, datë 24.07.2023, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.525/4 prot, datë 04.09.2023, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**4. Subjekti: “E.....L” SHPK.**

**NIPT: L.....L.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 06.09.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.5250/2 prot, datë 12.09.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.5250/3 prot, datë 12.09.2023, ku janë programuar 183 orë pune ose 23 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 12.09.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.5250/4 prot, datë 10.11.2023, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.5250/5 prot, datë 19.12.2023, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**5. Subjekti: “D...I” SHPK.**

**NIPT: J....U.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 09.06.2022, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.9292/1 prot, datë 16.06.2022 së bashku me Programin e Kontrollit nr.9292/2 prot, datë 16.06.2022, ku janë programuar 180 orë pune ose 23 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 20.06.2022, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.9292/3 prot, datë 18.08.2022, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.9292/4 prot, datë 06.09.2022, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **6. Subjekti: “L...O” SHPK.**

**NIPT: K.....K.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.09.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.11986/1 prot, datë 01.10.2021 së bashku me Programin e Kontrollit nr.11986/2 prot, datë 01.10.2021, ku janë programuar 244 orë pune ose 31 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 26.10.2021, duke respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11986/6 prot, datë 17.01.2022, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11986/7 prot, datë 19.01.2022, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **7. Subjekti: “K.....I” SHPK.**

**NIPT: L.....A.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 03.08.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.1296/1 prot, datë 11.09.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.1296/2 prot, datë 11.09.2023, ku janë programuar 110 orë pune ose 14 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 04.10.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.1296/3 prot, datë 25.10.2023, e cila është brenda afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.1296/4 prot, datë 10.11.2023, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **8. Subjekti: “P..A” SHPK.**

**NIPT: K.....O.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 16.08.2022, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.11168/1 prot, datë 22.08.2022 së bashku me Programin e Kontrollit nr.11168/2 prot, datë 22.08.2022, ku janë programuar 86 orë pune ose 11 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 13.09.2022, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11168/3 prot, datë 12.10.2022, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11168/4 prot, datë 31.10.2022, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**9. Subjekti: “L...L” SHPK.**

**NIPT: K....E.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.04.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.14822/1 prot, datë 04.05.2023 së bashku me Programin e

Kontrollit nr.14822/2 prot, datë 04.05.2023, ku janë programuar 66 orë pune ose 8 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 04.05.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.14822/3 prot, datë 06.06.2023, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.14822/5 prot, datë 12.07.2023, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**10. Subjekti: “A.....O” SHPK.**

**NIPT: K.....M.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 15.07.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.8654/1 prot, datë 21.07.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.8654/2 prot, datë 21.07.2021, ku janë programuar 270 orë pune ose 34 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 21.07.2021, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8654/7 prot, datë 24.09.2021, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8654/9 prot, datë 01.11.2021, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**11. Subjekti: “A.....6” SHPK.**

**NIPT: K.....V.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 28.12.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.12842/1 prot, datë 05.04.2022 së bashku me



Programin e Kontrollit nr.12842/2 prot, datë 05.04.2022, ku janë programuar 180 orë pune ose 23 ditë pune për të përfunduar punën në terren, me shkresën nr.6812/1, datë 10.05.2022 nga DPT është miratuar shtesa e periudhës së kontrollit dhe afatit me 80 orë pune.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 02.05.2022, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.12842/7 prot, datë 14.07.2022, e cila është brenda afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.12842/8 prot, datë 06.09.2022, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **12. Subjekti: “S.....0” SHPK.**

**NIPT: K.....G.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.10.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.10041/1 prot, datë 18.11.2021 së bashku me Programin e Kontrollit nr.10041/2 prot, datë 18.11.2021, ku janë programuar 400 orë pune ose 50 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 06.12.2021, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.10041/4/3 prot, datë 22.02.2022, e cila është brenda afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.10041/5 prot, datë 28.03.2022, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **13. Subjekti: “K.I” SHPK.**

**NIPT: K.....G.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.02.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.13698/1 prot, datë 09.03.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.13698/2 prot, datë 09.03.2023, ku janë programuar 210 orë pune ose 26 ditë pune për të përfunduar punën në terren, me shkresën nr.7421/1, datë 05.05.2023 nga DPT është miratuar shtesa e periudhës së kontrollit dhe afatit me 62 orë pune.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 25.03.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.13698/5 prot, datë 17.05.2023, e cila është brenda afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.13698/7 prot, datë 12.07.2023, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **14. Subjekti: “P...A” SHPK.**

**NIPT K.....F.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 15.07.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.8644/1 prot, datë 21.07.2021 së bashku me Programin e Kontrollit nr.8644/2 prot, datë 21.07.2021, ku janë programuar 320 orë pune ose 40 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 03.08.2021, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8644/3 prot, datë 09.09.2021, e cila është brenda afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8644/4 prot, datë 11.10.2021, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**15. Subjekti: “N...I” SHPK.****NIPT: J.....C.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 27.06.2023, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.2142/1 prot, datë 03.07.2023 së bashku me Programin e Kontrollit nr.2142/2 prot, datë 03.07.2023, ku janë programuar 138 orë pune ose 17 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 11.07.2023, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.2142/3 prot, datë 14.08.2023, e cila është në tejkallim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.2142/5 prot, datë 31.08.2023, e cila është brenda afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**16. Subjekti: “F....I” SHPK.****NIPT: J.....A.**

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 19.01.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.8539/1 prot, datë 04.12.2020 së bashku me Programin e Kontrollit nr.8539/2 prot, datë 04.12.2020, ku janë programuar 160 orë pune ose 20 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 08.03.2021, duke tejkalluar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8539/3 prot, datë 29.04.2021, e cila është në tejkallim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.8539/4 prot, datë 30.06.2021, e cila është në tejkallim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**17. Subjekti: “Z....O” SHPK.****NIPT: J.....K.**

*\*\*\* Dosja fizike e subjektit nuk është vendosur në dispozicion nga Zyra e Protokoll-Arkivës sepse është transferuar nga juridiksioni i DRT Fier.*

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 15.06.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.5608/1 prot, datë 21.06.2021 së bashku me Programin e Kontrollit nr.5608/2 prot, datë 21.06.2021, ku janë programuar 160 orë pune ose 20 ditë pune për të përfunduar punën në terren, me shkresën nr.17289/1, datë 08.10.2021 nga DPT është miratuar shtesa e periudhës së kontrollit dhe afatit me 120 orë pune.

Kontrolli në subjekt ka filluar në datë 24.06.2021, duke mos respektuar afatin 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1/1 të nenit 81 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.5608/7 prot, datë 12.11.2021, e cila është në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 83 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.5608/8 prot, datë 06.12.2021, e cila është në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 84 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **18. Subjekti: “R....I” SHPK.**

**NIPT: L.....T.**

*\*\*\* Dosja fizike e subjektit nuk është vendosur në dispozicion nga Zyra e Protokoll-Arkivës sepse është transferuar nga juridiksioni i DRT Fier.*

Njoftim Kontrolli Tatimor në sistemin informatik tatimor është hedhur në datë 24.06.2021, kurse në subjekt është dërguar me shkresën nr.11678/1 prot, datë 26.08.2021 së bashku me Programin e Kontrollit nr.11678/2 prot, datë 26.08.2021, ku janë programuar 72 orë pune ose 9 ditë pune për të përfunduar punën në terren.

Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11678/3 prot, datë 14.09.2021, e cila është brenda afatit 5 ditë kalendarike, sipas përcaktimeve të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt me shkresën nr.11678/4 prot, datë 27.09.2021, e cila është brenda afatit 5 ditë kalendarike sipas përcaktimeve të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë: Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, neni 81, 83, 84.***

*UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.*

*Manuali i Kontrollit Tatimor.*

*Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhërin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave.*

*Pikat 1, 2, 9 të nenit 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.*

*Pikat, 7, 8 të nenit 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.*

*Pika 2, 12 të nenit 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera rajonale”.*

*Pikat 3, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.*

***Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:***

*Z. A.P, me detyrë Drejtor Rajonal pranë DRT Fier;*

Z. B.S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DRT Fier;  
 Z. E.XH, me detyrë ish Përgjegjës i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DRT Fier;  
 Z. G.LL, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. G.V, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. A.K, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. V.R, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. E.F, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. D.S, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. L.C, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. G.M, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. S.Z, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. A.G, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. A.H, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Znj. V.P, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. B.H, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. Sh.N, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. E.M, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. J.H, me detyrë ish Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. E.K, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;  
 Z. A.J, me detyrë Inspektorit i Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT Fier;

Për sa më sipër me personat përgjegjës A.P, B.S, E.XH, G.LL, G.V, A.K, V.R, E.F, L.C, G.M, S.Z, A.G, A.H, V.P, Sh.N, J.H, E.K, D.S, B.H, E.M, A.J.

Për këtë çështje të auditimit nuk janë paraqitur observacioni nga subjekti i audituar DRT Fier.

### **2.2.2 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit**

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit është planifikuar të funksionojë si një strukturë me 20 inspektorë dhe 1 Përgjegjës Sektori. Në fillim të vitit 2021 kjo strukturë paraqitet me 2 vakanca, përkatësisht në pozicionet e inspektorit të parë dhe inspektorit të dytë, të cilat deri në fund të vitit 2021, si dhe 2022 rezultojnë 2 vakanca në pozicionet e inspektorëve të parë. Në fund të vitit 2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra rezulton me 3 vakanca, nga të cilët 2 inspektorë të parë dhe 1 inspektor i dytë.

Manuali për Kontrollin nga Zyra, shërben për punën e përditshme të inspektorëve të kontrollit nga zyra. Ai trajton aspektet që duhen patur parasysh e ndjekur prej tyre gjatë ushtrimit të kontrollit nga zyra tek tatimpaguesit lidhur me zbatimin e Legjislacionit në fuqi. Manuali ofron mbështetjen e nevojshme teknike për arritjen e vlerësimeve më të mira të deklarimeve të tatimpaguesve në raport me faktet e konstatuara. Arsyet për ushtrimin e kontrollit tatimor nga zyra janë: verifikimi i përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrolli ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi.

Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra:

- Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjendje të lartë të vazhdueshme kreditore TVSh, tatimfitimi, mos deklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtariapo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin.
- Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes duke përcaktuar detyra për sistemime e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme.

- Në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 5 datë 30.01.2006 në zbatim të ligjit krijon në ulje apo në rritje, me kërkesë ose jo të tatimpaguesit plan të rishikuar të parapagimeve sipas modulit të krijimit të planeve të parapagimit të implementuar në sistem.
- Zbaton dhe hedh në sistem vendimet e apelimit tatimor dhe vendimet e formës së prerë të gjykatave në lidhje me detyrimet tatimore dhe penaltetet. Për detyrimin tatimor nëpërmjet rivlerësimit të deklaratave tatimore sipas vendimeve përkatëse (Moduli i kontrollit nga zyra) dhe për anulimin e penalteteve me modulin e anulimit të gjobave.
- Ndjekin procedurat e përhithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri brenda një DRT-je apo në DRT-të të ndryshme.
- Kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas kërkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së.
- Ndjekin në çdo rast kryerjen e procesit të kompensimit të detyrimeve të papaguara para kryerjes së rimbursimeve qoftë nga DPT-ja për TVSH-në, apo nga DRT-të të tatimeve të tjera, sipas manualeve të përdorimit të implementuara në sistemin informatik.
- Analizojnë dhe përgatisin planet e ndryshuara të parapagimeve sipas kërkesave të tatimpaguesve në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi gjatë gjithë vitit ushtrimor.
- Ndjek arkitimin e detyrimeve tatimore të vetë deklaruara por të papaguara deri në kalimin e tyre në borxh që duhet të mblidhet me forcë.
- Ndjek nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit tatimpaguesit të cilët nuk kanë deklaruar në afatin ligjor.

Numri i çështjeve të trajtuar nga ana e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.2.2.1: Numri i çështjeve të trajtuar nga ana e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Periudha	2020	2021	2022	2023
Çështje të trajtuara në sistem gjithsej	1,033	1,968	931	1,384
Çështje me zbulim në numër	446	787	705	612
Shume e vlerësimeve në vlerë 000/ leke	39,838	92,241	58,934	68,991

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Çështjet të cilat janë trajtuar nga inspektorët dhe nuk kanë patur rezultat vlerësimi tatimor kanë qenë kryesisht sistemimi i deklaratave të TFTH-së, diferenca të FDP TFTH – Situatë TVSH – Kase Fiskale, ku performanca e vlerësimeve tatimore sipas llojit të tatimit, paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.2.2.2: Performanca e vlerësimeve tatimore sipas llojit të tatimit të kryera me çështje nga inspektorët

TAKSA	2020	2021	2022	2023
TVSH	25,134	46,629	12999	15880
Tatim Fitimi	9125	26,376	27945	26758
Sigurime	4821	15,877	14090	19268
Të tjera	758	3,359	3900	7085
<b>Totali</b>	<b>39,838</b>	<b>92,241</b>	<b>58,934</b>	<b>68,991</b>
Ulje humbje	0	648	0	18,294

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu, nga ana e këtij sektori janë trajtuar edhe çështje të ndryshme, ku ecuria e numrit të tyre paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.2.2.3 : Pyetje të Përgjithshme të trajtuara në sistem C@TS.

Çështje/ Periudha	2020	2021	2022	2023
Pyetje e përgjithshme	4754	2828	1540	2312

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Çështjet e trajtuara janë kryesisht pyetjet e tatimpaguesve për kërkesat e ndihmës ekonomike financiare, si dhe problematika nga fiskalizimi. Gjithashtu, në proces kanë rezultuar 2 çështje për vitin 2021 dhe 2022.

Angazhimi kryesor i inspektorëve ka qenë puna në verifikimin e pasqyrave financiare, duke krijuar një databazë me njoftimet për verifikimet paraprake të PF 2020 në të cilën evidentohen të gjithë subjektet për të cilët është kryer verifikimi paraprak, duke monitoruar punën e inspektoreve.

Tabela 2.2.2.4: Verifikimi i pasqyrave financiare

Emërtimi	2021	2022	2023
Tatimpagues total për verifikim	1867	1953	2128
Tatimpagues me 0 transaksione	201	326	316
Tatimpagues me humbje	299	237	237
Tatimpagues me qarkullim mbi 14 milion leke		846	874
Tatimpagues me qarkullim nën 14 milion lekë			838
Tatimpagues te verifikuar për të cilët janë konstatuar problematika ne pasqyrat financiare dhe u është nisur shkresë zyrtare për kërkim informacion dhe sqarim te situatës	923	526	424

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për sa më sipër rezulton se numri i subjekteve të verifikuara nga ana e këtij sektori ka ardhur në rritje nga viti më vit, si dhe duke e detajuar më hollësisht klasifikimin e tatimpaguesve objekt monitorimi.

Për periudhën 2021-2023 janë kryer vlerësime tatimore në TVSH dhe TF për subjekte të konstatuar me diferenca në deklarin FDP TF- FDP TFTH – Situatë TVSH – Kasë Fiskal, si më poshtë:

Tabela 2.2.2.5 : Vlerësim për TVSH

Vlerësim për TVSH	2021	2022	2023
Çështje me zbulim ne numër	180	58	42
Shume e vlerësimeve ne vlere 000/ leke	44,752	12,999	15,880

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.6: Vlerësim për Tatim Fitimi

Vlerësim për TATIM FITIMI	2021	2022	2023
Çështje me zbulim ne numër	354	427	382
Shume e vlerësimeve ne vlere 000/ leke	26,376	27,945	26,758

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Në lidhje me verifikimin dhe vlerësimin e listëpagesave nga ana e DRT Fier është zbatuar një plan pune për të cilin janë rivlerësuar paga të punonjësve të cilët përdorin kod i punësuar rishtazi dhe deklarojnë paga më të ulëta se paga minimale; paga të deklaruara me 0 dhe 1 lekë; pagat me kodin raport mjekësor, ku janë konstatuar:

Tabela 2.2.2.7: Vlerësim Sigurime

Vlerësim Sigurime	2021	2022	2023
Çështje vlerësimi ne C@TS ne nr.	216	164	156
Shume e vlerësimeve ne vlere 000/ leke	15,877	14,090	19,268

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për sa i përket procedurave të çregjistrimeve, në vijim të e-mail të përcjellë nga Drejtoria e Shërbimit, brenda 2 ditëve çdo inspektor sipas subjektit qe ka në administrim përgatit shkresën për QKB sipas formatit standard për të konfirmuar ose jo çregjistrimin e subjektit. Subjektet BM janë propozuar për kontroll. Për monitorimin e kërkesave për çregjistrim është hartuar një regjistër i korrespondencës me QKB me qëllim të mbajtjes në monitorim të subjekteve për të cilët i është kthyer përgjigje negative nga QKB. Numri i subjekteve të verifikuara me kërkesë për çregjistrim për të cilët është nisur shkresë konfirmim situate detyrimesh për QKB në 2021 është 873 tatimpagues; 2022 në 588 tatimpagues dhe 2023 në 627 tatimpagues.

Nga auditimi u konstatua se: Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për periudhën e auditimit disponon plane mujore, por të pa konsoliduara në plane të mirëfillta vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme.

**-Mbi përzgjedhjen e subjekteve në kuadër të kontrolleve në vend të kryera pranë DRT Fier**  
 Numri i kontrolleve të kryera pranë DRT Fier, i kategorizuar sipas strukturës propozuese (DPT apo DRT Fier) paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2.2.2.8- Numri i kontrolleve të kryera nga DRT Fier

Viti	DPT	DRT Fier	Total
2021	159	57	216
2022	192	60	252
2023	228	43	271

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

E ndarë në përqindje, situata rezulton sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 2.2.2.9- Përqindja e kontrolleve të kryera nga DRT Fier sipas strukturës propozuese

DPT	DRT Fier
74%	26%
76%	24%
84%	16%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi **nuk** është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 30% me 70% të rasteve ( pra 30% të kontrolleve propozuar nga DRT Fier dhe 70% nga DPT) në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit nga Zyra (Tetor 2018), i cili parashikon si detyrë mujore të Sektorit të Kontrollit nga Zyra “*Analizojnë dhe propozojnë kontrolle të thelluara për tatimpagues të ndryshëm brenda **30 % të kontrolleve mujore që propozohen nga DRT-të**, mbas planifikimit të kontrolleve, për mbyllje, përthithje e ndarje apo të propozimeve për kontroll të sektorëve të hetimit për muajin pasardhës*”. Në Manualin e Kontrollit nga Zyra (Dhjetor 2022), konstatohet se lidhur me këtë çështje është përcaktuar se: “Në rastet kur tatimpaguesi propozohet për kontroll të plotë në vend nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, përpilohet një shkresë me të gjitha problematikat e konstatuara të detajuara, të cilat i dërgohen Sektorit të Kontrollit në Vend dhe/ose Sektorit të Riskut të vetë DRT-së. Për këto raste, Drejtori Rajonal i çdo DRT-je dhe Drejtori i Kontrollit marrin në konsideratë tatimpaguesit me problematika të konstatuara nga Sektori i Kontrollit nga Zyra, i propozojnë për kontroll në vend **në 30% e orëve në dispozicion përgjatë të gjithë periudhave tatimore deri në fund të vitit kalendarik dhe ja shpërndajnë këto problematika inspektoreve të kontrollit të caktuar për të ushtruar kontroll në vend, sipas miratimit. Në çdo program kontrolli për këto tatimpagues do të jenë të përcaktuara edhe këto problematika si çështje të veçanta për trajtim.**”

Tendencat e kontrolleve të propozuara nga DRT Fier për periudhën objekt auditimi paraqiten në rënie nga viti në vit, ku konkretisht:

-Për vitin 2021 janë realizuar 216 programe kontrolli në vend, nga të cilat 57 janë propozuar nga DRT Fier (**26%** e totalit) dhe 159 nga DPT.

-Për vitin 2022 janë realizuar 252 programe kontrolli në vend, nga të cilat 60 janë propozuar nga DRT Fier (**24%** e totalit) dhe 192 nga DPT.

-Për vitin 2023 janë realizuar 271 programe kontrolli në vend, nga të cilat 43 janë propozuar nga DRT Fier (**16%** e totalit) dhe 228 nga DPT.

**- Mbi rishikimin e kësteve të tatimit mbi fitimin.**

Në zbatim të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 3 “Parapagimet”, pika 5 e cila citon se : “Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzime të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti ka ulur këstet e

*parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatim fitimin, që rezultojn nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguaj kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrisë të Financave”; si dhe udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet”, çështja 3.13.3 “Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin” e cila citon se: “Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin mund të merren:*

*-Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kësteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.*

*-Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin.*

*-Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.*

*-Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.*

*-Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.*

**“Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit”;** si dhe Manuali i Kontrollit nga Zyra, pika 11.4 “Regjistrimi i kësteve të rishikuara të parapagesave të tatimit mbi fitimin”, ku përcaktohet se: “Në rastet kur tatimpaguesi kërkon rishikimin në ulje të kësteve të tatim fitimit dhe inspektori i kontrollit nga zyra bindet ndaj argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi, bën korrigjimin e kësteve në ulje në bazë të dokumentacionit të paraqitur”, u verifikuan rishikimet e kryera për periudhën nën auditim.

Nga ana e DRT Fier për periudhën objekt auditimi janë kryer rishikime të kësteve, trajtuar si më poshtë:

*Tabela 2.2.2.10: Rishikimi i kësteve të tatim fitimit*

<b>Këste/ Periudha</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Këste të rishikuara në ulje në nr.	16	20	16	13
Këste të rishikuara në ulje në vlerë (mijë lekë)	37,055	30,745	17,996	26,291
Këste të rishikuara në rritje në nr.	130	448	363	227
Këste të rishikuara në rritje në vlerë(mijë lekë)	24,329	76,059	80,069	70,490
Këste të zeruara në zbatim të aktit normativ nr. 2 datë 07.06.2023				15

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga rishikimi i kësteve të tatim fitimit për vitin **2021** rezultojn vetëm një rast për të cilin diferenca në vlerë paraqitet në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator cituar më sipër, dhe për të cilin nga ana e DRT Fier është kryer penalizimi në vlerën 92,899 lekë sipas shkresës nr. 10584, prot datë 07.06.2022 në masën 5 % për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit.

Nga rishikimi i kësteve të tatim fitimit për vitin **2022** rezultojnë 2 raste për të cilin diferenca në vlerë paraqitet në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator cituar më sipër, dhe për të cilin nga ana e DRT Fier është kryer penalizimi respektivisht në vlerën 82,775 lekë sipas shkresës



nr. 10602/2, prot datë 25.05.2023, dhe në vlerën 57,223 lekë sipas shkresës nr. 13267/2, prot datë 25.05.2023 , pra në masën 5 % për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit.

**-Subjekte të cilët kanë paguar me vonesë ose nuk e kanë paguar kështu e Tatim Fitimit.**

Nga auditimi u konstatuan biznese si në vijim që nuk kanë paguar kështu e Tatim Fitimit bazuar në Ligjin 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 - “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së kështit për t’u paguar.

**Për vitin 2021**

Tabela 2.2.2.11- Subjekte që nuk kanë paguar kështu e Tatim Fitimit në afat për vitin 2021

NIPTi	Subjekti	Shuma e Kësteve	Gjoha me 10%	Gjohat e Vendosur a nga DRT Fier	Diferenca	Inspektori	Koment
K.....H	B.... B	10,686,123	1,068,612	#N/A	1,068,612	#N/A	Tatimpaguesi për këtë periudhë ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi është transferuar ne DRT Fier me date 07/02/2024.
L.....A	S.....7	9,699,632	969,963	1	969,962	A.H	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 02.05.2024)
K...G	S.....A	8,221,460	822,146	#N/A	822,146	#N/A	Tatimpaguesi transferuar nga DTM në DRT Fier në 18.12.2022
L.....P	S.F	4,264,942	426,494	#N/A	426,494	#N/A	Tatimpaguesi për këtë periudhë ka qene ne administrimin e DRT Elbasan. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 28.12.2022
L.....C	P.V	5,708,490	570,849	167,399	403,450	Zh.A	
K.....K	B...E	5,074,098	507,410	198,226	309,184	A.H	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 02.05.2024)
K.....L	"I....N"	2,967,056	296,706	#N/A	296,706	D.D	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 02.05.2024)
M.....F	G...G	3,448,840	344,884	49,224	295,660	#N/A	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 03.05.2024)
L.....N	XH...L	3,730,275	373,028	88,350	284,678	A.H	
K.....D	A .... L SH P K	2,655,761	265,576	6,429	259,147	Zh.A	
J.....G	S.....I	2,624,871	262,487	43,748	218,739	Zh.A	
L.....N	A....D	2,022,652	202,265	#N/A	202,265	#N/A	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 09/04/2024.
L.....C	R...S	1,960,443	196,044	6,074	189,970	E.F	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 03.05.2024)
L.....J	B...J	1,855,881	185,588	#N/A	185,588	#N/A	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit (date 03.05.2024)
J.....V	M....A	2,165,456	216,546	48,582	167,964	F.H	
L.....B	A....I	1,300,530	130,053	#N/A	130,053	#N/A	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DRT Elbasan. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 19.03.2024
J.....H	S....I	1,613,161	161,316	41,559	119,757	Zh.A	
L.....U	G....I	3,296,814	329,681	219,786	109,895	F.H	
M.....L	A.C	1,035,727	103,573	#N/A	103,573	F.H	

L.....J	M.....a	1,900,734	190,073	87,174	102,899	E.M	
L....B	D....0	6,258,454	625,845	534,118	91,727	E.M	Penalizuar pas Akt Konstatimit te grupit te auditimit
Total					<b>4,419,672</b>		

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga përpunimi të dhënave të gjeneruara nga Raporti për Këstet e Tatim Fitimit dhe evidencave të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit sipas ndarjes së NIPT-eve u konstatuan mangësi në penalitetet e aplikuar nga DRT Fier për mos pagimin në afat të kësteve të Tatim Fitimit. Konkretisht, për vitin 2021 rezultojnë 14 raste për të cilat nuk janë përlogaritur penalitetet në masën 10% të vlerës së këstit, sipas kërkesave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, neni 114/1, duke rezultuar me diferenca në vlerën **4,419,672 lekë**.

Gjithashtu, evidentuar edhe në tabelën më sipër, konstatohen edhe 7 raste të tjera, në të cilat penaliteti i përlogaritur nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren në **vlerën 2,338,797 lekë**, rezulton të jetë sistemuar nga ana e subjektit të audituar, pas dorëzimit të Akt Konstatimeve në DRT Fier.

### Për vitin 2022

Tabela nr. 2.2.2.12 – Subjekte që nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit në afat për vitin 2022.

NIPTi	Emri	Paguar në kohë	Shuma e Kësteve	Penaliteti i llogaritur 10%	Penaliteti i vendosur nga DRT Fier	Diferenca	Inspektori
K.....H	B. B	Jo	19,894,538	1,989,454	Pa vendosur gjobe	1,989,454	Tatimpaguesi për këtë periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi është transferuar ne DRT Fier me date 07/02/2024.
L.....N	A.....g	Jo	6,611,864	661,186	Pa vendosur gjobe	661,186	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 09/04/2024.
L.....A	S.....7	Jo	7,264,531	726,453	Pa vendosur gjobe	562,623	A.H
K.....K	B.....E	Jo	5,986,587	598,659	Pa vendosur gjobe	435,500	A.H
K.....N	Sh.....i	Jo	2,272,107	227,211	Pa vendosur gjobe	168,480	A.H
M.....M	S.....E	Jo	1,157,764	115,776	Pa vendosur gjobe	115,776	A.H
L.....O	G.....E	Jo	1,142,218	114,222	Pa vendosur gjobe	114,222	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DRT Vlore. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 23.01.2024
M.....V	O.....A	Jo	1,031,011	103,101	Pa vendosur gjobe	103,101	E.F
J.....Ë	C.....I	Jo	999,926	99,993	Pa vendosur gjobe	99,993	E.F
L.....D	P.....C	Jo	915,996	91,600	Pa vendosur gjobe	91,600	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 06.04.2023
L.....B	A.....I	Jo	858,383	85,838	Pa vendosur gjobe	85,838	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DRT Elbasan. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 19.03.2024
L.....F	T.....L	Jo	605,470	60,547	Pa vendosur gjobe	60,547	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 07.02.2024
L.....R	M.....S	Jo	582,066	58,207	Pa vendosur gjobe	51,740	Z.Sh
K.....S	P.....I	Jo	508,868	50,887	Pa vendosur gjobe	50,887	Pagesa e vonuar I perket 3-mujorit I 2022 periudhe ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 20.10.2022
<b>Total</b>			<b>49,831,329</b>	<b>4,983,134</b>	<b>392,187</b>	<b>4,590,947</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga ana e Grupit të Auditimit, janë përpunuar të dhënat e marra nga Raporti i gjeneruar për Këstet e Tatim Fitimit në variantin fillestar për vitin 2022. Nga analizimi i të dhënave janë verifikuar të gjitha subjektet të cilat rezultojnë me vonesë për pagesën në kohë të këstit të tatim fitimit, të cilat janë përpunuar në vlerën totale të tyre dhe është kryer kryqëzimi i të dhënave me penalitetet e vendosura nga DRT Fier në vlerë totale gjatë vitit 2022.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2022, ka një numër të konsiderueshëm subjektesh, të cilët nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit në afat, të cilët duhet të ishin penalizuar në masën e gjobës 10% të vlerës së këstit.

**Efekt financiar:**

Gjoha TF (126,975,669 \* 10 % ) = 4,983,134 lekë  
 Gjoha të vendosura nga DRT Fier = 392,187 lekë  
**Total detyrimi = 4,590,947 lekë**

***Për vitin 2023***

*Tabela nr.2.2.2.13– Subjekte që nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit në afat për vitin 2023.*

NIPTi	Emri	Paguar në kohë	Shuma e Kësteve	Penaliteti i llogaritur 10%	Penaliteti i vendosur nga DRT Fier	Diferenca	Inspektori
K.....H	B. B	Jo	3,824,103	382,410	Pa vendosur gjore	382,410	Tatimpaguesi për këtë periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 07/02/2024.
L.....A	S.....7	Jo	3,872,534	387,253	74,474	312,779	A.H
K.....U	I....C	Jo	2,855,288	285,529	Pa vendosur gjore	285,529	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 06.02.2024
L....P	A.....P	Jo	9,732,890	973,289	733,477	239,812	Xh.P
K.....T	B....Y	Jo	2,344,069	234,407	Pa vendosur gjore	234,407	Tatimpaguesi per kete periudhe ka qene ne administrimin e DTM. Tatimpaguesi eshte transferuar ne DRT Fier me date 02/02/2024.
L.....G	V.....L	Jo	2,876,229	287,623	82,866	204,757	F.H
K.....K	B....E	Jo	4,165,864	416,586	253,428	163,158	A.H
J.....Ë	C...I	Jo	1,499,889	149,989	Pa vendosur gjore	149,989	A.H
K.....N	Sh.....i	Jo	1,493,722	149,372	Pa vendosur gjore	149,372	A.H
L.....A	E.A	Jo	2,596,844	259,684	137,649	122,035	A.H
L.....B	B.LTD	Jo	1,218,909	121,891	Pa vendosur gjore	121,891	E.S
<b>Total</b>			<b>36,480,341</b>	<b>3,648,033</b>	<b>1,281,894</b>	<b>2,366,139</b>	

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier*

Nga ana e Grupit të Auditimit, janë përpunuar të dhënat e marra nga Raporti i gjeneruar për Këstet e Tatim Fitimit në variantin fillestar për vitin 2023.

Nga analizimi i të dhënave janë verifikuar të gjitha subjektet të cilat rezultojnë me vonesë për pagesën në kohë të këstit të tatim fitimit, të cilat janë përpunuar në vlerën totale të tyre dhe është kryer kryqëzimi i të dhënave me penalitetet e vendosura nga DRT Fier në vlerë totale gjatë vitit 2023.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2023, ka një numër të konsiderueshëm subjektesh, të cilët nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit në afat, të cilët duhet të ishin penalizuar në masën e gjobës 10% të vlerës së këstit.

### **Efekt financiar:**

Gjoha TF (137,718,361 \*10 % ) = 3,648,033 lekë

Gjoha të vendosura nga DRT Fier = 1,281,894 lekë

**Total detyrimi = 2,366,139 lekë**

### ***Mbi analizimin e tepricave kreditore***

Në drejtim të përgjegjësisë së Sektorit të Kontrollit nga Zyra për analizimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjendje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSh, tatim fitimi, tatim fitim i thjeshtuar për mos deklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin; përcaktuar në Manualin për Kontrollin nga Zyra, u analizuan subjektet me tepricën më të lartë të tatim fitimit, tepricën kreditore të TVSH-së, tepricën kreditore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për të shqyrtuar rolin e sektorit të kontrollit nga zyra për kërkesat për kontroll me qëllim monitorimin dhe verifikimin e këtyre deklarimeve.

Më hollësisht:

#### **Mbi tepricat kreditore të TVSH-së**

Nga verifikimi i tepricave kreditore të TVSH-së për 100 subjektet me teprica më të larta, rezulton se:

Në 11 subjekte (11%) janë të mbartura nga periudha të hershme kohore; në 54 subjekte (54%) teprica kreditore e TVSH-së është krijuar nga referencat doganore (duke qenë se pjesa më e madhe e subjekteve të mësipërme janë eksportues); në 30 subjekte (30%) teprica kreditore e TVSH-së vjen nga blerjet për investime. Nga auditimi konstatohet se referuar analizave të inspektorëve përgjegjës, rezulton se vetëm 4 subjekte nga kampioni i përzgjedhur mbi tepricat më të larta të TVSH-së (4%) kanë kaluar për kontroll dhe vetëm 1 subjekt (1%) është propozuar për kontroll të thelluar në fillim të vitit 2024.

#### **Mbi tepricat kreditore të Tatim Fitimit**

Nga verifikimi i tepricave kreditore të TF-së për 100 subjektet me teprica më të larta, rezulton se:

Në 61 subjekte (61%) janë të mbartura nga periudha të hershme kohore; 26 subjekte (26%) ka patur ndryshim të përgjegjësisë për deklarim TF, 7 subjekte janë këste te parapaguara rishtaz (7%). Nga auditimi konstatohet se referuar analizave të inspektorëve përgjegjës, rezulton se vetëm 4 subjekte nga kampioni i përzgjedhur mbi tepricat më të larta të TF-së (4%) kanë kaluar për kontroll dhe vetëm 1 subjekt (1%) është propozuar për kontroll të thelluar në fillim të vitit 2024.

#### **Mbi tepricat kreditore për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin**

Nga verifikimi i tepricave kreditore të TTHF-së për 50 subjektet me teprica më të larta, rezulton se:

Në 35 subjekte (70%) janë të mbartura nga periudha të hershme kohore; dhe 14 subjekte (28%) ka patur ndryshim të përgjegjësisë për deklarim TTHF. Nga auditimi konstatohet se referuar analizave të inspektorëve përgjegjës, rezulton se vetëm 1 subjekt nga kampioni i përzgjedhur mbi tepricat më të larta të TTHF -së (2%) ka kaluar për kontroll në vend.

### ***-Mbi subjektet e rindërtimit***

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me mbikëqyrjen dhe monitorimin e kryer nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për subjektet e pajisura me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja në kuadër të rindërtimit, sipas kërkesës me e-mail datë 12.03.2024 tek znj. E.E në cilësinë e Përgjegjës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimeve pranë DRT Fier, dhe z. J.G, në cilësinë e personit të kontaktit në DRT Fier, si dhe rikujtesave të vazhdueshme, në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"

te Ligjit Nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "*Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake; e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.*". Në dispozicion të grupit të auditimit u vendos në datën 25.04.2024, pra vetëm 1 ditë përpara përfundimit të periudhës së auditimit në terren informacioni , duke e kufizuar kështu veprimtarinë audituese për këtë drejtim. Gjithashtu, nuk u vendos në dispozicion informacion në vijim të kërkesës së grupit të auditimit lidhur me akte ligjore apo nënligjore ku është mbështetur procesi monitorues i Sektorit të Kontrollit nga Zyra pranë DRT Fier për subjektet e rindërtimit.

Nga verifikimi i komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra lidhur me monitorimin e subjekteve të rindërtimit rezulton se: 21 subjekte (39%) janë propozuar për kontroll në vend, 16 subjekte (30%) kanë kaluar kontroll në vend, 6 subjekte (11%) janë në proces monitorimi nga zyra, dhe nuk janë identifikuar problematika, 5 subjekte (9%) kanë deklaruar vetëm shitje të përjashtuara, 3 subjekteve (6%) i janë shfuqizuar autorizimet, dhe 3 subjekte (6%) nuk kanë kryer aktivitet nën autorizimet e rindërtimit, gjatë periudhës objekt auditimi.

#### ***-Mbi shpenzimet për paga nga ana e tatimpaguesve jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së***

Grupi i auditimit kreu një analizë lidhur me numrin e subjekteve që operojnë në DRT Fier me një numër mesatar mbi 5 punonjësish dhe që figurojnë jashtë fushës së zbatimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, konsideruar si fushë me një risk të shtuar për fshehjen e xhiros të subjektit për të shmangur pagesën e TVSH-së. Nga verifikimi i analizave të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit rezulton se në 24 raste (63%), nga verifikimi i kryer nga ana e inspektorëve dokumentohet mos plotësimi i kriterëve për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore; 5 subjekte (13%) janë sezonal, dhe numri i punonjësve ka qenë dinamik përgjatë vitit për shkak të sezonit sipas së cilit aktiviteti i subjektit është më i lartë, 4 subjekte (11%) janë biznese familjare, dhe numri i lartë i punonjësve nuk është shoqëruar me rritje të aktivitetit të biznesit; 3 subjekte (8%) kanë ndryshuar përgjegjësinë përgjatë vitit 2024; 1 subjekt (3%) është pasiv, dhe 1 subjekt (3%) është larguar nga DRT Fier për në DRT Tiranë. Për sa më sipër nuk konstatohen problematika apo mangësi që shkaktojnë mangësi në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

#### ***-Mbi mos deklaruesit e pasqyrave financiare***

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua informacion lidhur me mos deklaruesit e pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe 2022, lidhur me hapat e ndërmarra nga ana e DRT Fier për këtë situatë, pra konkretisht argumentimin e shkaqeve se përse nuk është vijuar me vlerësim alternativ nga ku rezulton si më poshtë:

Viti 2021: Nga analizimi i monitorimit të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në vijim të penalizimit të kryer për çdo rast për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, rezulton se për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2021, 52 subjekte (60%) janë pasiv, 22 subjekte janë pa aktivitet përgjatë vitit (25%), 7 subjekte (8%) kanë iniciuar procedurat për çregjistrim duke paraqitur kërkesat, 2 subjekte (2%) janë OJF, dhe 1 subjekt (1%) ka deklaruar pasqyra tek dokumentet e subjektit, për shkak të një problemi në sistem, 1 subjekt (1%) është propozuar për kontroll, 1 subjekt (1%) është rivlerësuar, 1 subjekt (1%) është transferuar në DRT Tiranë.

Viti 2022: Nga analizimi i monitorimit të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në vijim të penalizimit të kryer për çdo rast për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, rezulton se për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit

2022, 22 subjekte (76%) janë pa aktivitet përgjatë vitit (25%), 3 subjekte (10%) janë OJF, 3 subjekte (10%) kanë plotësuar deklaratën e TF dhe 1 subjekt (1%) është rivlerësuar. Për sa më sipër nuk konstatohen problematika apo mangësi që shkaktojnë mangësi në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

### **-Marrëveshjet me këste**

Përgjatë vitit 2021 rezultojnë të lidhura 66 akt marrëveshje për likuidimin e detyrimeve tatimore, me një vlerë detyrimi për të cilin është lidhur marrëveshja prej 164,154,134 lekë, që i përkasin 60 subjekteve. Nga këto marrëveshje, janë përfunduar me sukses 32 prej tyre, në vlerën prej 45,253,636 lekë (nga te cilat 1 marrëveshje rezulton me detyrim të papaguar prej 159,002 lekë, por vjen si rezultat i një problemi në sistem, pasi faktikisht është paguar vlera e plotë prej 318,004 lekë); janë prishur 6 akt marrëveshje në vlerën 38,831,696 lekë bazuar me kërkesën e tatimpaguesit për zgjidhjen e saj (nga te cilat 3 marrëveshje rezultojnë me detyrime pa paguar prej 12,348,340 lekë) dhe për 28 subjekte me vlere A-M prej 80,068,802 lekë janë prishur marrëveshjet, ku specifikisht rezulton se: 2 marrëveshje në vlerën prej 695,501 lekë janë prishur për arsyen “Prishur marrëveshja për mosrespektim afati dhe përfunduar afati”, 1 marrëveshje në vlerën prej 1,570,139 lekë është prishur për arsyen “Paguar kësti por prishet A-M për mospagim të detyrimeve koherente”, 24 marrëveshje në vlerën prej 77,560,959 lekë janë prishur për arsyen “Prishur marrëveshja mosrespektim afati” dhe 1 marrëveshje në vlerën prej 242,203 lekë është prishur për arsyen “Prishur marrëveshja për mosrespektim afati, si dhe për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja”. Sa i përket marrëveshjeve që janë prishur, vlera e mbetur pa paguar është në vlerën prej 46,265,651 lekë. Analitikisht, marrëveshjet e prishura me arsyet përkatëse jepen, si me poshtë:

Tabela 2.2.2.14: A-M e prishura të vitit 2021

NIPTi	Subjekti	Vlera e Akt Marrëveshjes	Vlera e mbetur pa paguar	Arsyet për anulimin e Akt Marrëveshjes
L.....P	M.L	44,000	44,000	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....P	S.D	192,019		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
J.....B	N.....S	9,724,382	9,724,382	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....R	D.K	733,325	687,325	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....O	G.....P	1,570,139	1,043,579	Paguar kësti por prishet A-M për mospagim të detyrimeve koherente
L.....M	H.....S	5,771,597	5,231,597	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....I	H.M	659,355	659,355	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....E	L.....L SHPK	5,070,407		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....G	2 .....G	473,129	236,542	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati dhe përfunduar afati
K.....J	V.....D	222,372	111,186	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati dhe përfunduar afati
J.....A	P.....X	1,395,227		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....J	E.....T	1,630,133	428,989	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....I	P.....A	4,277,576	4,277,576	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....D	S.....P	491,511		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....U	K.H	321,269	246,269	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....O	B.....N	4,403,155	4,403,155	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....I	A.....J	9,872,195	9,872,195	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....M	H.....R	5,983,273		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....E	T.....6	2,407,768	1,156,539	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....P	E.N	386,580		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....O	G.....P	630,815		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
K.....I	T.....A	756,349		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....J	G.....L	242,203	94,149	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati, si dhe për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
L.....B	D.....0	5,933,726	298,508	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
M.....R	B.....N	1,696,891	403,951	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....L	S.....A	2,343,021		Prishur marrëveshja mosrespektim afati

L.....P	A.....P	3,660,181		Prishur marrëveshja mosrespektim afati
J.....T	R.....B	9,176,204	7,346,354	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
Total		<b>80,068,802</b>	<b>46,265,651</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Përgjatë vitit 2022 rezultojnë të lidhura 21 akt marrëveshje, me një vlerë detyrimi për të cilin është lidhur marrëveshja prej 103,949,878 lekë, që i përkasin 21 subjekteve. Nga këto marrëveshje, janë përfunduar me sukses 11 prej tyre, në vlerën prej 33,317,950 lekë; është prishur 1 akt marrëveshje në vlerën 5,391,427 lekë bazuar me kërkesën e tatimpaguesit për zgjidhjen e saj; 1 subjekt me vlerë marrëveshjeje prej 4,372,314 lekë është transferuar në DTM dhe për 8 subjekte me vlerë AK prej 60,868,187 lekë, është prishur marrëveshja për mos respektim afati, apo se nuk janë paguar detyrimet tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja, ku vlera e mbetur pa paguar paraqitet në vlerën prej 34,924,240 lekë, konkretisht:

Tabela 2.2.2.15: A-M e prishura të vitit 2022

NIPTi	Subjekti	Vlera e Akt Marrëveshjes	Vlera e mbetur pa paguar	Arsyet për anulimin e Akt Marrëveshje
K.....F	E....A	143,364	71,682	Prishur marrëveshja për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
K.....F	F....A	21,486,166	4,995,322	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....B	F.....M	14,546,611	11,702,406	Prishur marrëveshja për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
L.....I	T.....I	3,292,414	1,158,703	Prishur marrëveshja për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
L.....U	L.....0	6,688,904	2,440,306	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
L.....R	M.....s	509,068	354,161	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
M.....M	F....B	14,037,072	14,037,072	Prishur marrëveshja mosrespektim afati
M.....U	F.Y	164,588	164,588	Prishur marrëveshja për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
<b>Total</b>		<b>60,868,187</b>	<b>34,924,240</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Përgjatë vitit 2023 rezultojnë të lidhura 14 akt marrëveshje, me një vlerë detyrimi për të cilin është lidhur marrëveshja prej 56,888,961 lekë, që i përkasin 12 subjekteve. Nga këto marrëveshje, janë aktive deri në fund të vitit 2023 me afat përgjatë vitit 2024, 8 prej tyre, me një vlerë detyrimi prej 35,095,804 lekë; është përfunduar me sukses 1 prej tyre në vlerën 385,688 lekë; është prishur 1 akt marrëveshje në vlerën 4,973,073 lekë bazuar me kërkesën e tatimpaguesit për zgjidhjen e saj; 1 subjekt me vlerë marrëveshjeje prej 4,372,314 lekë është transferuar në DTM dhe për 8 subjekte me vlerë totale të Akt Marrëveshjes prej 16,434,396 lekë, është prishur marrëveshja për mos respektim afati, apo se nuk janë paguar detyrimet tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja, ku vlera e mbetur pa paguar paraqitet në vlerën prej 13,953,823 lekë, konkretisht:

Tabela 2.2.2.16: A-M e prishura të vitit 2023

NIPTi	Subjekti	Vlera e Akt Marrëveshjes	Vlera e mbetur pa paguar	Arsyet për anulimin e Akt Marrëveshje
L....C	M.C	4,499,044	3,651,096	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati, si dhe për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
L.....J	S.H	1,869,397	1,515,971	Prishur marrëveshja për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
K.....I	T....A	4,166,564	2,887,365	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati, si dhe për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
L.....G	A.P	5,899,391	5,899,391	Prishur marrëveshja për mosrespektim afati, si dhe për arsye se nuk ka paguar detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja
<b>Total</b>		<b>16,434,396</b>	<b>13,953,823</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Nga auditimi konstatohet se DRT Fier nuk dispononte informacion lidhur me marrëveshjet e përsëritura, për periudhën kur monitorimi i tyre ishte në kompetencën e drejtorive të mbledhjes

së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjëse. Gjithashtu, mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, cënon efektivitetin e vendimarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve .

Nga regjistri i vendosur në dispozicion, rezultojnë akt marrëveshjet e përsëritura për disa subjekte, duke mos kaluar në masa të tjera shtrënguese, situatë kjo e cila përbën në nga indikatorët matës për efektivitetin e analizës së kryer nga struktura përgjegjëse pranë DRT Shkodër, lidhur me përmbushjen e kushteve të nevojshme të marrëveshjes dhe situatës sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi. Referuar situatës lidhur me akt marrëveshjet e përsëritura, shoqëruar me komentin për arsyet e prishjes së A-M rezulton se për akt marrëveshjet e lidhura me subjektet: F.K A SHA me NIPT K.....F, V.....d me NIPT K.....J, E...T me NIPT K.....J, T....a me NIPT K....I, D.K me NIPT L.....R, S.G me NIPT L.....D, T....i me NIPT L.....I, H.T me NIPT L....M, I....0 me NIPT L.....U, A.C me NIPT M.....L,B.E.K C me NIPT M.....R, S.H me NIPT L.....J janë përsëritur pavarësisht se akt marrëveshjet paraardhëse janë prishur për shkak të mos respektimit të afatit të vendosur, dhe akt marrëveshja pasuese rezulton e prishur për shkak të mos respektimit të afati për subjektet: F.K A Sha me NIPT K.....F, T.....i me NIPT L....I, H.T me NIPT L....M, I....0 me NIPT L.....U, A. C me NIPT M.....L.

Marrëveshjet për subjektet: D.B me NIPT L.....R, P.V me NIPT L.....C, S.....7 me NIPT L....A janë përsëritur, pavarësisht se marrëveshjet paraardhëse të lidhura janë prishur me kërkesë të subjekteve.

Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të dosjeve për subjektet: T....i me NIPT L....I, I....0 me NIPT L.....U, A.C me NIPT M.....L, P.V me NIPT L.....C mbi akt marrëveshjet e lidhura nga DRT Fier, për të shqyrtuar procedurat e ndjekura për vlerësimin e kushteve për lidhjen e tyre shoqëruar me riskun që ato mbartin.

Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Kontrollit nga Zyra se “*Drejtori Rajonal i drejtorisë përkatëse, përcakton me anë të një Urdhri të brendshëm 1 (një) inspektor të kontrollit nga zyra (jo domosdoshmërisht i njëjtë me përcaktimin si më lart) , i cili do të mbajë një databazë me të gjitha të dhënat në lidhje me kërkesat për marrëveshje, marrëveshjet e lidhura, periudhën e shtrirjes së Akt-Marrëveshjes, shumën e secilit këst, marrëveshjet e zgjidhura sipas formës (prishje e lehtë, prishje e fortë), sipas evidencës model bashkëlidhur këtij manuali (Moduli Nr.3). Inspektori/ Inspektorët e përcaktuar me urdhër si më lart, analizojnë kërkesat e tatimpaguesve për të lidhur marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara, refuzojnë dhe/ose hartojnë marrëveshjet, bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Inspektori/ Inspektorët e përcaktuar me urdhër si më lart, pasi ka verifikuar situatën dhe kushtet që duhet të plotësojë tatimpaguesi për të lidhur marrëveshjen, me miratim të Drejtorit Rajonal të DRT-së përkatëse, harton Akt-Marrëveshjen sipas modelit të paracaktuar dhe bën hedhjen e saj në sistemin C@ts.”, në DRT Fier inspektori përgjegjës është z. L.R. Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me përcaktimet e manualit të sipërcituar, nuk janë dokumentuar analizat mbi riskun që këto akt marrëveshje mbartin, veçanërisht në rastet kur historiku i tatimpaguesit nuk e përforcon disponimin e aftësive të tyre paguese, duke vepruar kështu edhe në kundërshtim me përcaktimet e rregullores së funksionimit të DRT, neni 18 pika 2:“*struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*” dhe pika 3 “*nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore*”; gjithashtu udhëzuesi i përgjithshëm procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 përcakton se*



“Drejtoritë rajonale tatimore mund të lejojnë tatimpaguesit në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;”.

### **-BM me TF me humbje për 3 vite të njëpasnjëshme**

Nga testet e kryera dhe kryqëzimi i të dhënave të vendosura në dispozicion kanë rezultuar subjekte të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme për të cilat nga analizat e kryera nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit rezulton se 32 subjekte (47%) që rezultojnë me humbje kanë raportuar shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe nuk kanë ushtruar aktivitetet për periudhat e më sipërme, 22 subjekte (32) kanë rënie drastike të aktivitetit dhe kanë raportuar shpenzime vetëm për paga, dokumentuar edhe me deklaratat e tatim fitimit paraqitur në sistem; 7 subjekte (10%) kanë kaluar për kontroll të plotë, 3 subjekte (4%) janë pasiv; 2 subjekte (3%) janë OJF dhe 1 subjekt (1%) është propozuar për kontroll të plotë në vend. Për sa më sipër nuk konstatohen problematika apo mangësi që shkaktojnë mangësi në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

### **-Mbi analizimin e diferencave mes deklaratës se TVSH dhe TF**

#### **Viti 2021**

Tabela 2.2.2.17: Diferenca pozitive

Emërtimi	Subjekti	TVSH	Te ardhurat Deklarata e Tatim Fitimit	Diferenca
Totali	128	11,092,031,775	9,773,077,012	1,318,954,763
kampioni <sup>2</sup>	49	6,550,271,056	5,270,980,981	1,279,290,075

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.18: Diferenca negative

Emërtimi	Subjekti	TVSH	Te ardhurat Deklarata e Tatim Fitimit	Diferenca
Totali	520	18,187,400,160	20,706,845,955	-2,519,445,795
kampioni <sup>3</sup>	51	3,542,379,554	4,694,015,356	-1,151,635,802

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

#### **Viti 2022**

Tabela 2.2.2.19: Diferenca pozitive

Emërtimi	Subjekti	TVSH	Te ardhurat Deklarata e Tatim Fitimit	Diferenca
Totali	149	21,863,669,463	14,640,444,413	7,223,225,050
kampioni <sup>4</sup>	51	12,546,252,336	5,388,530,782	7,157,721,554

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.20: Diferenca negative

Emërtimi	Subjekti	TVSH	Te ardhurat Deklarata e Tatim Fitimit	Diferenca
Totali	655	28,943,573,928	33,166,469,762	-4,254,899,709
kampioni <sup>5</sup>	102	7,794,118,770	10,077,105,605	-2,305,408,019

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

<sup>2</sup>diferenca mbi 3,000 mije leke

<sup>3</sup>diferenca nën 10,000 mije leke

<sup>4</sup>diferenca mbi 3,000 mije leke

<sup>5</sup>diferenca nën 10,000 mije leke

Nga auditimi konstatohet se referuar komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier, diferencat në deklaratat e TVSH dhe TF vijnë si rezultat i:

- ndryshim i përgjegjësisë tatimore (subjekti nuk ka qenë objekt deklarimi i TVSH-së; subjekti ka qenë objekt pagese TFTH dhe më pas ka kaluar TF, etj) për 60 raste (31%);
- arkëtime në avancë për porosi për 59 raste (30%);
- të ardhura nga grantet për 17 raste (9%);
- subjektet kanë kaluar kontroll të plotë nga DRT Fier në 15 raste (8%);
- të ardhura të shtyra për 9 raste (5%);
- të ardhura të tjera për 7 raste (4%);
- sistemime pas kontrollit të KLSH-së, në 6 raste (3%);
- iniciuar kontroll në vend për 5 raste (3%);
- kaluar akt vlerësim nga zyra për 5 raste (3%);
- subjekt OJF për 4 raste (2%);
- auto ngarkesë në shitje për 2 raste (1%);
- subjekti është propozuar për kontroll në 2 raste (1%);
- subjekt fason, dhe në faturën e eksportit përfshihet vlera e mallit bashkë me punën e kryer, në 2 raste (1%);
- diferenca në vlerën e shitjes së aktivitetit në 1 rast (1%);
- diferenca vjen nga lënda e parë dhe materialet e konsumuara në 1 rast (1%);
- të ardhura ndryshim gjendje në 1 rast (1%);
- të ardhura nga kursi i këmbimit për 1 rast (1%);
- të ardhura nga transaksione bankare për 1 rast (1%);
- transferim veprimtarie ekonomike për 1 rast (1%);

Subjektet për të cilat është kryer ndryshimi i deklaratës, përgjatë periudhës së auditimit, dhe diferencat që nuk ishin monitoruar nga inspektorët përkatës paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.2.2.21- Diferenca të sistemuara përgjatë auditimit

NIPT	Subjekti	Inspektori
M.....L	S.....0	J.V
L.....O	G.....M	E.S
L.....B	S.....I	L.R
L.....Q	E.....H	L.R
K.....G	M.....T	D.D
L.....E	A.C	O.A

Burimi: DRT Fier

### ***-Mbi procedurat e kontrolleve për rimbursimin e TVSH***

Në zbatim të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet konkretisht se “Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepriçë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepriçën kreditore si të rimbursueshme...” dhe “2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është

regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para se të rimburohet. Procedura e kontrollit kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.", u kërkuar informacion nëse janë kryer kontrole për rimbursimin e TVSH-së nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra për periudhën objekt auditimi", konstatohet se në zbatim të shkresave të ardhura nga DPT, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier ka kryer procedura të kontrollit për rimbursim për vitin 2021, për 40 raste kërkesash që përfaqësojnë 32 subjekte, në vlerën totale të kërkuar prej 101,781,970 lekë, nga e cila janë miratuar rimbursimet në vlerën 99,774,919 lekë, dhe kanë mbetur për t'u rimbursuar 86,323,253 lekë, ose rreth 85% e shumës së kërkuar.

Tabela 2.2.22: Mbi kërkesat pranë DRT Fier për rimbursimin e TVSH-së

Periudha	Nr. Subjekteve	Nr. Kërkesave	Shuma e kërkuar	Shuma e miratuar	Shuma mbajtur për kompensim	Shuma e përdorur automatikisht nga sistemi për kompensim	Total kompensimi	Shuma totale e rimbursuar
2021	32	40	101,781,970	99,774,919	12,906,148	545,518	13,451,666	86,323,253

#### Burimi: DRT Fier

Për periudhën 2022-2023 nuk është kryer asnjë procedurë rimbursimi nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi, pasi janë zhvilluar programe kontrolli në vend me objekt rimbursimin, sipas propozimeve të DPT.

Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, udhëzimeve dhe rregulloreve duhet që kontrolli të kryhet në zbatim të neneve 81, 83 dhe 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Njoftimet e kontrollit të shoqëruar me programet e kontrollit për rimbursimin e TVSH-së nga Kontrolli nga Zyra që ju dërgohen tatimpaguesve **nuk** u përmbahen kërkesave ligjore sipas nenit 81 "Njoftimi i kontrollit tatimor", pika 2, gërma f e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ku konkretisht përcaktohet: "f) datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut." Nga auditimi konstatohet se nuk janë evaduar në sistemin C@ts procedurat e kontrollit sipas kërkesave dhe afateve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi, si dhe nuk është përcaktuar ora kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit nuk është përcaktuar nga të dhënat e analizës së riskut.

Gjithashtu u konstatuan veprime që lidhen me mos respektim të afateve të rimbursimit të TVSH-së dhe të cilat janë në shkelje të kërkesave ligjore të cituara si më poshtë:

-Sipas pikave të programit dhe në zbatim të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcaktohet se: "Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar "Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut. PAGESA E TEPRICËS KREDITORE TË RIMBURSUESHME KRYHET BRENDË PESË DITËVE, NËPËRMJET SISTEMIT TË THESARIT, NË BAZË TË RREGULLAVE TË PËRCAKTUARA NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË FINANCAVE. NË RAST TË KUNDËRT, PERSONIT TË TATUESHËM I LIND E DREJTA E MOS PAGESËS SË DETYRIMEVE TË TJERA TATIMORE NË MASËN E TVSH-SË SË PRETENDUAR PËR RIMBURSIM. 1/1. NË RASTIN KUR TATIMPAGUESI, I CILI KA KËRKUAR RIMBURSIM, I NËNSHTROHET KONTROLLIT, SIPAS ANALIZËS SË RISKUT, ME

qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij neni, afatet e përcaktuara nga nenet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Me qëllim respektimin e afateve të rimbursimit të TVSH-së, në rastet kur tatimpaguesi i nënshtrohet kontrollit tatimor, afati për përfundimin e Raportit 83 dhe 84 nuk do të zbatohen dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarike.

-Ndërkohë sipas nenit 75/1 pikës 2.5.2 të Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcaktohet se: "2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para se të rimbursohet. Procedura e kontrollit kryhet të Kontrollit nga inspektori/inspektorët është, jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas përfundimit të tij. Gjithashtu, edhe afati për kundërshtimin e rezultateve të kontrollit tatimor nga tatimpaguesi është jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas datës kur vlerësohet se është marrë. I njëjti afat prej 5 ditësh kalendarike zbatohet dhe për plotësimin dhe nënshkrimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.7, datë 10.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.4 datë 19.01.2017)."

-Në praktikatat e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra në DRT Fier konstatohet se nga ana e Drejtorit të Kontrollit në DRT Fier, Përgjegjësit të Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit në DRT Fier dhe inspektorëve përkatës sipas subjekteve përkatëse që kanë zhvilluar kontrollin, nuk janë zbatuar përcaktimet sipas kuadrit rregullator e ligjor në fuqi në drejtim të dorëzimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore të nenit 84, si dhe në drejtim të krijimit të kushteve të nevojshme për tatimpaguesit për të vepruar sipas së drejtës së tyre për t'i kundërshtuar rezultatet e kontrollit brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi, duke rezultuar kështu në kundërshtim me nenin 81 "Njoftimi i kontrollit tatimor", gërma f, pika 2; nenin 83 "Raport Kontrolli"; Neni 84 "Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor"; e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 75/1 pikës 2.5.2 të Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Pika 3, 10, 11, 16 të Neni 4 "Drejtori i Drejtorisë Rajonale" e Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrisë të Financave.

-Gjithashtu, nga verifikimi i procedurave të rimbursimit të kryera nga ana e sektorit të kontrollit nga zyra pranë DRT Fier u konstatua se dosjet e procedurave të rimbursimit janë të pa inventarizuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. Dosjet ishin të pajisura vetëm me shkresat për njoftim kontrolli (jo në të gjitha rastet pjesë e praktikave), raportin përfundimtar me shkresën përcjellëse, dhe shkresat përkatëse për njoftimin e operatorit mbi vlerësimin për detyrimet.

-Nga verifikimi i praktikave të rimbursimit u konstatua se për subjektet që operojnë nën regjimin e përpunimit aktiv (fasonët), nga ana e administratës tatimore nuk ishin administruar kartat teknologjike sipas së cilave përshkruhet edhe aktiviteti i operatorit, firot / rezultatet e së cilit duhet të jenë primare në analizat që do të kryhen me objekt miratimin e TVSH-së së rimbursuar, në zbatim të VKM-së nr. 434, datë 20.05.2015 "Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportit etj, të njohura për qëllimet fiskale", pika 7, dhe 8 e saj.

-Në rastet e operatorëve të operojnë me fermerët vendas, në dosje nuk disponohen kontratat përkatëse të lidhura me fermerët, likuidimet me bankë për çdo faturë, apo evidenca të tjera që vërtetojnë sasinë e përpunuar të mallit.

-Për operatorët që kanë kryer investime, në dosje nuk kishte evidenca për lejet përkatëse të këtyre investimeve, raportet e inxhinierëve të ndërtimit për kostot e ndërtimit (analiza kosto/sasi/situacion).

-Për subjektet e tjera, konstatohet sërish mungesa e evidencave për shpenzimet e kryera (transport, normativat e konsumit për km).

Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm subjektet:

1. "I.V" me NIPT "L.....D"
2. "Zh.M" me NIPT "L.....D"
3. "S.F" me NIPT "L....E"
4. "A....I" me NIPT "L.....S"
5. "M.....a" me NIPT "J.....V"
6. "E.C" person fizik
7. "T.....s" SHPK me nr NIPT L.....K"
8. "D.M" SHPK me nr NIPT L....I
9. "A.....t" me NIPT K.....I
10. "A.....N" me NIPT K.....C, ku situata paraqitet në vijim:

#### **-Subjekti "A.....K" me NIPT "L.....S"**

Aktiviteti: Import-Export fruta perime.

Inspektori i Kontrollit nga Zyra znj.D.D, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.B.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 10/2020 – 06/2021

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Subjekti ka kërkuar për rimbursim shumë prej 4,860,924 lekë. Saktësimi i kërkesës për Rimbursim të tatimpaguesit "A.....K" SHPK në DPT me shkresën Nr.16169/2 Prot, datë 16.09.2021, për periudhën tatimore Tetor 2020 – Qershor 2021, lindur nga blerjet me fermerët vendas.

Në përfundim të Raportit të Kontrollit, shuma e kërkuar për t'u rimbursuar nga subjekti ka qenë 4,860,924 lekë, dhe nga ana e Inspektorit të Kontrollit nga Zyra janë kryer ndalesa në vlerën 12,539 lekë për mos likuidim të fermerëve. Pas ndalesave të përshkruara shuma e miratuar për rimbursim të TVSH-së për subjektin është 4,848,385 lekë.

Nga auditimi i Bilancit për periudhën ushtrimore 2020 në sistemin C@ts, konkretisht Pasqyra e Pozicionit Financiar, në Pasiv paraqiten Detyrimet Afatshkurtra, llogaria "Të pagueshme ndaj furnitorëve" paraqitet në vlerën 52,222,461 lekë, shumë e cila ka ardhur në rritje krahasuar me vlerën e paraqitur në vitin 2019 prej 31,821,234 lekë.

Diferenca në rritje është në shumën 20,401,227 lekë.

Nga ana e Inspektorit të Kontrollit nga Zyra, në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk është analizuar pjesa e detyrimeve afatshkurtra të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në Pasiv, si edhe faktin që këto detyrime kanë ardhur në rritje. Gjithashtu nuk është analizuar dhe përshkruar analitikisht përbërja e detyrimeve afatshkurtra për të cilat subjekti ka ndaj të tretëve ku blerjet janë kryesisht fruta perime nga fermerë vendas.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar", neni nr.9 ku citohet se: "e drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar" pika 3: "Nëse fatura nuk përmban të dhënat e plota dhe të sakta, si dhe nuk përmban shënimin "Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit", personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë dënimin.

#### **-Subjekti "E.C" person fizik**

Aktiviteti: "Hotele dhe struktura të ngjashme, hoteleri dhe turizëm".

*Inspektori i Kontrollit nga Zyra znj.E.M, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.S.*  
Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH Shtator 2020 – Shkurt 2022

*Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:*

-Janë analizuar blerjet e detajuara sipas faturave, të cilat janë raportuar si investime të shoqëruara me preventivët dhe situacionet përkatëse; lejen e ndërtimit, duke cituar se “faza e kryerjes së punimeve është objekt i verifikimit në vend”. Nga auditimi konstatohet se në dosjen e vendosur në dispozicion nuk disponohen këto dokumentacione. Në përfundim të Raportit të Kontrollit, shuma e kërkuar për t’u rimbursuar nga subjekti në vlerën 5,671 mijë lekë është miratuar e plotë. Nga auditimi i dosjes së vendosur në dispozicion për këtë procedurë rimbursimi, konstatohet se ka një pasaktësi në dokumentacionet e hartuara, dokumentuar këto edhe me shkresën e ZV. Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve z. K.Sh, ku me shkresën e datës 12.05.2021, prot në DRT Fier datë 14.05.2021 është kërkuar përcjellja e raportit përfundimtar, pasi me shkresën nr. 4758/5 prot në DRT Fier datë 30.04.2021, në shkresë përcjellëse është cituar se është dërguar projektraporti i kontrollit. Në përgjigje të saj, me shkresën nr. 4758/8, prot DRT Fier datë 21.05.2021 është përcaktuar se akti i kontrollit përfundimtar është përcjellë me shkresën nr. 11.05.2021. Në dosjen e vendosur në dispozicion nuk disponohet raporti përfundimtar.

Konkretisht:

-shkresa nr. 4758/5, prot datë 30.04.2021 me lëndë “për procedurë rimbursimi”, përcaktohet :  
... “ju dërgojmë akt-kontrollin përfundimtar”

-shkresa nr. 4758/2, prot datë 29.04.2021 me lëndë “dërgim projekt akt kontrolli” përcaktohet;  
“..bashkëlidhur është projekt akt-kontrolli përfundimtar..”

-Raport kontrolli (projekt) i mbajtur datë 15.04.2021.

-shkresa nr. 4758/6, prot datë 11.04.2021 me lëndë “për procedurë rimbursimi”, përcaktohet :  
... “ju dërgojmë akt-kontrollin përfundimtar”

-shkresa nr. 4758/4, prot datë 30.04.2021 me lëndë “dërgim akt kontrolli përfundimtar”  
përcaktohet;

“..bashkëlidhur është projekt akt-kontrolli përfundimtar..”

-Raport kontrolli (përfundimtar) i mbajtur datë 29.04.2021.

Në dosjen e kësaj procedure kontrolli investimi nuk kishte evidenca për lejet përkatëse të investimit, raportet e inxhinierëve të ndërtimit për kostot e ndërtimit (analiza kosto/sasi/situacion).

***-Subjekti “T.C” SHPK me nr NIPT L.....K”***

Aktiviteti: Prodhim dhe tregtim të produkteve të brumit dhe ëmbëlsira të ndryshme të gjitha llojeve. Veprimtari Fason në tregtimin dhe prodhimin e produkteve të brumit dhe ëmbëlsirave të pjekura të ndryshme.

*Inspektori i Kontrollit nga Zyra znj.E.F, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.S.*  
Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 2019/12-2021/02

*Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:*

-Janë verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes në lidhje me rregullsinë dhe saktësinë regjistrimi i tyre në librat e blerjes dhe të shitjes.

-Janë kontrolluar deklarami i sakte dhe në kohë në F.D.P.

-Në dosjen e subjektit nuk disponohet karta teknologjike

-Janë kryer rakordimet midis importeve të deklaruara nga subjekti dhe deklarimeve në dogana.

-Janë kontrolluar normativat e harxhimit të karburantit të deklaruar nga subjekti.

Në përfundim të kontrollit janë identifikuar fatura të furnizimit me gazoil, të pashoqëruara me kupona kase, për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penalteti në vlerën totale prej 147,549 lekë.

Njoftimi është përcjellë me shkresën nr. 5238/1, prot datë 14.04.2021. Nga auditimi konstatohet se në dosjen e kësaj procedure rimbursimi nuk disponohet projektraporti i kontrollit, programi i kontrollit. Raporti i Kontrollit me shkresën nr.5238/2 prot DRT Fier datë 27.04.2021. Në sistem disponohet akt kontrolli nga zyra, mbajtur datë 19.04.2021.

Nga auditimi konstatohet se nuk dokumentohen analizat e kryera mbi kartat teknologjike sipas së cilave përshkruhet edhe aktiviteti i operatorit, firot / rezultatet e së cilit duhet të jenë primare në analizat që do të kryhen me objekt miratimin e TVSH-së së rimbursuar, në zbatim të VKM-së nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportit etj, të njohura për qëllimet fiskale”, pika 7, dhe 8 e saj.

Nga auditimi konstatohet se për shpenzimet për karburant nuk disponohen evidenca për shpenzimet e kryera të tilla si numri i mjeteve, normativat e konsumit për km.

**-Subjekti “D.M” SHPK me nr NIPT L.....I**

Aktiviteti: Tregtia me shumice e frutave dhe perimeve, Eksport fruta perime,etj.

*Inspektori i Kontrollit nga Zyra znj. Sh.N a, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.S.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH Mars 2020 – Dhjetor 2020

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepicës kreditore të TVSH-së
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Është përcaktuar prejardhja e tepicës së TVSh-së kreditore në fund të periudhës
- Janë përshkruar blerjet nga fermerët vendas, si edhe faturat përkatëse të blerjeve në mënyrë analitike dhe akt-marrëveshjet e subjektit me fermerët.

Subjekti ka kërkuar për rimbursim shumën prej 3,464,255 lekë, dhe nga ana e Inspektorit të Kontrollit nga Zyra janë kryer ndalesa në vlerën 123,416 lekë për mos likuidim të fermerëve. Pas ndalesave të përshkruara shuma e miratuar për rimbursim të TVSH-së për subjektin është 3,340,839 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e kësaj procedure nuk disponohej njoftimi dhe programi për kryerjen e kontrollit, por sipas njoftimit në sistemin C@TS, është përcjellë me shkresën nr. 1877/1, prot DRT Fier datë 10.02.2021. Projekt raporti i kontrollit miratuar nga znj. E. E. në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit, me shkresën nr. 1877/2, prot në DRT Fier datë 17.02.2021 nuk është firmosur nga inspektori i kontrollit, si në faqen e parë të këtij dokumenti (konceptoi.), ashtu edhe në fund të këtij dokumenti (inspektori i kontrollit...). Nga auditimi konstatohet se në shkresën e projekt raportit (datë 17.02.2021) përcaktohet se “...keni të drejtë të kundërshtoni rezultatet e kontrollit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, ku arsyet duhet të dërgohen më shkrim në DRT Fier”. Raporti përfundimtar i kontrollit është përcjellë me shkresën nr. 1877/3, prot DRT Fier datë 22.02.2021, pra vetëm 5 ditë kalendrike pas dërgimit të projekt raportit, duke mos respektuar afatin e përcaktuar në shkresën e projektraportit, për t’i dhënë të drejtën subjektit për të shprehur kundërshtitë mi këtë dokument.

**-Subjekti “A.....t” me NIPT K.....I**

Aktiviteti: “Prodhim, tregti mobilerie dhe importi, eksporti i tyre”.

*Inspektori i Kontrollit nga Zyra znj.A.M, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.S.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH Qershor 2021-Shtator 2021

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

-Është analizuar situata e deklarimeve të TVSH-së në blerje dhe shitje

-Janë verifikuar importet e mallrave dhe blerjet duke kontrolluar faturat shoqëruese të tyre.

-Janë kontrolluar deklaramet tatime-dogana.

Në përfundim të kontrollit janë konstatuar blerje mallrash që nuk janë në funksion të aktivitetit të regjistruar; rezultojnë fatura tatimore të pa deklaruara në blerje dhe shitje; janë realizuar shitje për të cilat është prerë kuponi dhe këto të dhëna janë transmetuar në kasën fiskale me vonesë; për të cilat në përfundim të kontrollit është përlogaritur ulja e tepricës kreditore të TVSH-së dhe gjoba, në vlerën totale prej 99 mijë lekë. Nga 1,259 mijë lekë të kërkuara për rimbursim, është miratuar rimbursimi në vlerën 1,233 mijë lekë.

Njoftimi i kontrollit është përcjellë me shkresën nr. 15531/1, prot datë 19.11.2021. Nga auditimi konstatohet se nuk dokumentohen analizat e kryera mbi kartat teknologjike sipas së cilave përshkruhet edhe aktiviteti i operatorit, apo kontratat me eksportuesin. Projektraporti është përcjellë me shkresën nr. 15531/2, prot datë 09.12.2021. Kontrolli përfundimtar është përcjellë me shkresën nr. 15531/6, prot datë 15.12.2021, pasi në shkresën nr. 15531/4, prot datë 13.12.2021, subjekti ka shprehur dakortësinë mbi projektraportin.

#### **-Subjekti "A.....N" me NIPT K.....C**

Aktiviteti: "Prodhim i mobiljeve të tjera".

*Inspektori i Kontrollit nga Zyra z.L.R, përgjegjës kontrolli znj.E.E, Drejtor Kontrolli z.B.S.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH Shtator 2020-Janar 2021

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

-Është analizuar situata e deklarimeve të TVSH-së në blerje dhe shitje

-Janë verifikuar importet e mallrave dhe blerjet duke kontrolluar faturat shoqëruese të tyre.

-Janë kontrolluar deklaramet tatime-dogana.

-Është kryer analiza e bilancit material për blerjet brenda vendit dhe nga importi.

Në përfundim të kontrollit janë konstatuar blerje mallrash që nuk janë në funksion të aktivitetit të regjistruar; është konstatuar se mjeti i deklaruar nga tatimpaguesi në adresat sekondare është shitur; për të cilat në përfundim të kontrollit është përlogaritur ulja e tepricës kreditore të TVSH-së dhe gjoba, në vlerën totale prej 233 mijë lekë. Nga 8,358 mijë lekë të kërkuara për rimbursim, është miratuar rimbursimi në vlerën 8,176 mijë lekë.

Njoftimi nr. 4652/1, prot datë 01.04.2021. Projektraporti është përcjellë me shkresën nr. 4652/4, prot datë 27.04.2021; raporti përfundimtar me shkresën 4652/5, prot datë 05.05.2021.

**Në lidhje me auditimin e praktikave të përzgjedhura të vizitave fiskale (kontrolle tematike nga zyra) të kryera nga Sektori i Kontrollit nga zyra për vitin 2023, për subjektet:**

1. "Sh.....Z" SHPK me NIPT L.....O

2. "V.....T" SHPK me NIPT K.....P

3. "A.....n" SHPK me NIPT J.....I

4. "M.....A," me NIPT K.....N

5. "L.....P" me NIPT L.....A

6. "U.....K me NIPT L.....D

Nga auditimi konstatohet se në raportin e subjektit "L.....P" me NIPT L.....A programi i kontrollit vizitë fiskale është përcjellë me shkresën nr. 5698/1, pa datë. Njoftimi nuk disponohet në dosje. Projektraporti i kontrollit rezulton të jetë përcjellë me shkresën nr. 5698/2, prot datë 11.08.2023 dhe sipas projektraportit rezulton të jetë mbajtur nga inspektori i kontrollit datë 08.08.2023. Raporti përfundimtar i kontrollit është dërguar me shkresën nr. 5698/3 pa datë ( i mbajtur datë 15.08.2023) me lëndë: Dërgim raport kontrolli, vizitë fiskale nga zyra (përfundimtar). Pra rezulton se raporti përfundimtar i kontrollit është mbajtur pa respektuar afatin 15 ditor për pritjen e kundërshtive nga subjekti i kontrolluar.



Në lidhje me auditimin e kontrolleve nga zyra për mbyllje të përzgjedhura për auditim (kontroll i plote nga zyra) të kryera nga Sektori i Kontrollit nga zyra për vitin 2023, për subjektet:

1. "S.....e" me NIPT "L.....P"
2. "O.....l" me NIPT "M.....C"
3. "A.B" me NIPT "M.....U"
4. "A.K" me NIPT "K.....A"
5. "S.Q" me NIPT "L.....M"
6. "R.N" me NIPT "L L.....D"

Nga auditimi i raporteve të vendosura në dispozicion nuk u konstatuan problematika.

## Mbi diferencat tatime dhe dogana

### Viti 2021

#### Në import

Tabela 2.2.2.24: Diferenca pozitive

Emër timi	Total vlera Tatime	Vlera e tatueshme tatime	TVSH Tatime	Total vlera Dogana	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca
<b>total</b>	8,523,228,381	7,841,742,147	1,568,348,421	8,490,465,805	7,406,491,647	1,507,109,970	435,250,500	61,238,451
<b>kampioni<sup>6</sup></b>	1,604,853,975	1,604,853,975	320,970,795	1,520,366,567	1,470,176,225	297,142,037	134,677,750	23,828,758

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.25: Diferenca negative

Emër timi	Total vlera Tatime	Vlera e tatueshme tatime	TVSH Tatime	Total vlera Dogana	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca
<b>total</b>	3,479,513,793	1,670,210,588	334,042,113	4,434,139,318	1,872,555,801	380,416,869	-202,345,213	-46,374,756
<b>kampioni<sup>7</sup></b>	104,761,491	76,226,803	15,245,361	135,595,880	134,334,592	27,474,213	-58,107,789	12,228,852

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

#### Në eksport

Tabela 2.2.2.26: Diferenca pozitive

Emërtimi	Numri i subjekteve	Vlera e tatueshme Tatime	Vlera dogana	Diferenca Eksporte
<b>total</b>	84	3,336,690,548	3,067,450,959	269,239,589
<b>kampioni<sup>8</sup></b>	45	3,064,581,324	2,805,521,685	259,059,639

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.27: Diferenca negative

Emërtimi	Numri i subjekteve	Vlera e tatueshme Tatime	Vlera dogana	Diferenca Eksporte
<b>total</b>	96	1,117,670,611	4,374,313,124	-3,256,642,513
<b>kampioni<sup>9</sup></b>	34	489,012,273	3,731,749,577	-3,242,737,304

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

### Viti 2022

<sup>6</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së mbi 1,000 mijë lekë

<sup>7</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

<sup>8</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

<sup>9</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

## Në import

Tabela 2.2.2.28:Diferenca pozitive

Emërtimi	Total vlera Tatime	Vlera e tatueshme tatime	TVSH Tatime	Total vlera Dogana	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca
<b>total</b>	4,548,751,476	3,622,086,203	699,454,066	4,724,225,546	3,408,697,667	665,595,479	213,388,536	33,858,587
<b>kampioni<sup>10</sup></b>	392,274,648	286,131,054	57,226,211	327,597,470	206,689,454	41,796,897	79,441,600	15,429,314

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.29:Diferenca negative

Emërtimi	Total vlera Tatime	Vlera e tatueshme tatime	TVSH Tatime	Total vlera Dogana	Vlera e tatueshme Dogana	TVSH Dogane	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH diferenca
<b>total</b>	6,177,702,903	4,670,665,031	910,299,184	6,965,272,769	4,800,407,879	953,177,145	-129,742,848	-42,877,961
<b>kampioni<sup>11</sup></b>	749,451,222	616,616,608	109,739,836	805,613,889	709,278,637	126,383,055	-92,662,029	-16,643,219

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

## Në eksport

Tabela 2.2.2.30:Diferenca pozitive

Emërtimi	Numri i subjekteve	Vlera e tatueshme Tatime	Vlera dogana	Diferenca Eksporte
<b>total</b>	90	4,594,707,571	4,445,746,660	148,960,911
<b>kampioni<sup>12</sup></b>	31	3,424,130,172	3,285,332,537	138,797,635

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.31:Diferenca negative

Emërtimi	Numri i subjekteve	Vlera e tatueshme Tatime	Vlera dogana	Diferenca Eksporte
<b>total</b>	123	3,075,012,405	7,534,768,441	(4,459,756,036)
<b>kampioni<sup>13</sup></b>	38	1,579,225,911	6,026,499,267	(4,447,273,356)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Situata referuar verifikimeve të kryera nga ana e inspektorëve përgjegjës të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit paraqitet si më poshtë:

### Diferenca në eksport

Nga verifikimi i komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit lidhur me diferencat në eksport për vitin 2021 dhe 2022 konstatohet se në 49 raste (33%) diferenca ka ardhur pasi subjekti ka qenë fason, dhe në eksport vlerës së mallit i shtohet edhe hak i punës; 40 raste (27) diferenca ka ardhur për shkak të mos rakordimit të sistemit në dogana me atë në tatime, për të pasqyruar të gjitha deklaratat doganore të tatimpaguesit në periudhat e duhura; 26 raste (18%) subjektet kanë kaluar në kontroll; në 14 raste (9%) diferenca vjen për shkak të shitjeve të përjashtuara; respektivisht me nga 5 raste (3%) diferenca ka ardhur për shkak të kursit të këmbimit; subjekti ka qenë pa përgjegjësi TVSH për periudhën; janë sistemuar gjatë auditimit; 1 rast (1) subjekti është çregjistruar nga TVSH; në 2 raste (1%) diferenca ka qenë paradhënie e subjektit dhe 1 rast (1%) diferenca është ambalazh i kthyer pas.

### Diferenca në import

<sup>10</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së mbi 1,000 mijë lekë

<sup>11</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

<sup>12</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

<sup>13</sup> Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim të mëtejshëm diferencat e TVSH-së nën -1,000 mijë lekë

Nga verifikimi i komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit lidhur me diferencat në import për vitin 2021 dhe 2022 konstatohet se në 15 raste (43%) diferenca ka ardhur për shkak të mos rakordimit të sistemit në dogana me atë në tatime, për të pasqyruar të gjitha deklaratat doganore të tatimpaguesit në periudhat e duhura; 6 raste (17%) janë importe të përjashtuara; 5 raste (14%) subjektet kanë kaluar në kontroll; në 5 raste (14%) subjekti ka qenë pa përgjegjësi TVSH për periudhën; 3 raste (9%) janë sistemuar gjatë auditimit.

Për sa më sipër nuk konstatohen problematika apo mangësi që shkaktojnë mangësi në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

### ***-Mbi analizimin e diferencave të deklarimit të kasave/ Raporti CPCM dhe të ardhurave të deklaratës së TVSH-së***

Në kuadër të auditimit për këtë drejtim, u kryqëzuan të dhënat e marra nga DRT Fier në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave për vitin 2021, 2022, 2023. Nga ana e Grupit të auditimit janë përpunuar të dhënat e gjeneruara nga Raporti CPCM për të nxjerrë xhiron e subjekteve. Për diferencat e konstatuara janë kërkuar shpjegimet nga inspektorët përgjegjës.

Ky informacion është kërkuar në fillim të auditimit sipas e-mail datë 09.01.2024 tek znj. E.E në cilësinë e Përgjegjës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier, dhe z. J.G, në cilësinë e personit të kontaktit në DRT Fier, ku konstatohet se në kundërshtim me percaktimet e Nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të Ligjit Nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "*Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake; e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.*", pavarësisht kërkesave dhe rikujtueseve të vazhdueshme, informacioni është përcjellë me komentet e inspektorëve në datën 25.05.2024, pra 1 ditë para përfundimit të fazës së auditimit në terren, duke e kufizuar kështu auditimin në këtë drejtim. Nga verifikimi i komenteve konstatohet se për një pjesë të konsiderueshme të diferencave, janë ndërmarrë veprimet për sistemimin e tyre, pas kërkesave për informacion nga grupi i auditimit, duke nxjerrë kështu në pah mangësitë për sistemimin e tyre në kohë nga ana e inspektorëve përgjatë punë për verifikimin e tyre dhe përcjelljes së kërkesave për informacion pranë tatimpaguesve. Si rezultat, konstatohet se janë sistemuar diferenca të vitit 2021, 2022 dhe 2023, përgjatë vitit 2024.

Nga verifikimi i argumenteve të inspektorëve konstatohet se në disa raste diferencat kanë ardhur si rezultat i subjekteve të cilat operojnë në fushën e fasonerisë ose tregimit të mallrave import-export. Gjithashtu në disa raste ka diferenca për subjektet që operojnë në fushën e tregimit të karburanteve ku konstatohet fenomeni i deklarimit të shitjeve gjatë muajit si edhe deklarimi në fund të çdo muaji të faturave përmbledhëse për totalin e shitjeve duke shkaktuar një duplikim të shitjeve. Nga auditimi konstatohet se subjektet kanë korrigjuar faturat duke paraqitur si argument refuzimin e shërbimeve/mallrave nga bashkitë, situatë kjo që përbën risk për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, objekt verifikimi në vend. Komentet e inspektorëve janë referuar se subjekti ka kaluar akt kontrolli, pa argumentuar konkluzionet e kontrollit në vend për të garantuar se këto diferenca janë verifikuar. Më hollësisht situata paraqitet si më poshtë:

#### **Viti 2021**

Nga analizimi i komenteve të inspektorëve lidhur me shkaqet e diferencave rezulton se në 23 raste (35%) subjekti ka qenë pa përgjegjësi tatimore për periudhën, dhe i ka ndryshuar përgjegjësia përgjatë vitit; në 15 raste (23%), subjekti është çregjistruar nga përgjegjësia e

TVSH; në 10 raste (15%) diferencat janë sistemuar; në 7 raste (11%) subjekti ka kaluar kontroll; në 3 raste (5%) diferencat janë fatura te korigjuara dhe te refuzuara nga bashkitë; dhe respektivisht me nga 1 rast (2% e totalit) diferencat vijnë për shkak se janë diferenca nga kursi këmbimit; duplikimin i xhiros te pasqyra mujore, ndërsa analitikisht si fatura nuk ka diferenca fatura pagesa doganore; fature e dublikuar e anuluar; karburant, dublikim i kuponave te shitjes ne individ me ID dhe faturës përmbledhëse mujore me NIPT; nje pjese shitje me fiskalizim dhe nje pjese me dëftesë tatimore; transferuar.

### Viti 2022

Nga analizimi i komenteve të inspektorëve lidhur me shkaqet e diferencave rezulton se në 80 raste (37%) subjekti ka qenë pa përgjegjësi tatimore për periudhën, dhe i ka ndryshuar përgjegjësia përgjatë vitit; në 50 raste (23%) ka patur dublikim fature; 28 raste (13%) diferencat janë sistemuar; 19 raste (9%) subjekti është karburant dhe shkaktohet dublikim i kuponave te shitjes ne individ me ID dhe faturës përmbledhëse mujore me NIPT; 13 raste (6%) faturat janë anuluar; 4 raste (2%) kanë kaluar për kontroll; 4 raste (2%) janë autofatura; 3 raste (1%) janë kurse këmbimi; dhe me nga 1 rast (më pak se 1%) arsyet janë se subjekti është fason; fatura doganore; faturë e refuzuar; komisione; taksa; subjekti është transferuar në 2024 pranë DRT Fier.

### Viti 2023

Nga analizimi i komenteve të inspektorëve lidhur me shkaqet e diferencave rezulton se në 47 raste (39%) subjekti ka qenë pa përgjegjësi tatimore për periudhën, dhe i ka ndryshuar përgjegjësia përgjatë vitit; 34 raste (28%) diferencat janë sistemuar; 19 raste (16%) subjekti është karburant dhe shkaktohet dublikim i kuponave te shitjes ne individ me ID dhe faturës përmbledhëse mujore me NIPT; 10 raste (8%) faturat janë anuluar; në 6 raste (5%) ka patur dublikim fature; dhe me nga 1 rast (më pak se 1%) arsyet janë autongarkesa; fason; faturë dogane; të ardhura nga komisione; transferim asetesh.

Nga sa me sipër rezulton se diferencat e sistemuara përgjatë kontrollit të grupit të KLSH, pavarësisht se nuk shoqërohen me efekte financiare të përlogaritura për shkeljet e legjislacionit tatimor në fuqi, nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e inspektorëve të Sektorit nga Zyra dhe Kontrollit për mos kryerjen e detyrave funksionale për monitorimin e vazhdueshëm të tyre:

Tabela 2.2.2.32:-Viti 2021

NIPT	Subjekti	FDP TVSH	Kasa	DIF	inspektori
L.....T	H.Sh	75,225,829	82,536,129	7,310,300	Z.SH
M.....H	D.....B	2918560	4777425	1858865	A.M
L.....M	E.....0	9273088	10856187	1583099	L.R
M.....B	E.....7	446667	1798602.5	1351935.5	E.M
L.....I	E.....8	3297806	4596866	1299060	L.R
L.....A	A.....Y	5665425	6667276	1001851	L.R
M.....G	LH	3719577	4402543	682966	A.M
M.....K	M.H	-	447202	447202	A.M
L.....L	F.G	306500	667098	360598	A.H
K.....I	F.....6 SHPK	2720016	3047063.333	327047.333	E.M
L.....B	E.D	943504	1163845	220341	E.M
<b>Total</b>		<b>104,516,972</b>	<b>120,960,237</b>	<b>16,443,265</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.33:Viti 2022

NIPT	Subjekti	FDP TVSH	Kasa	DIF	inspektori
L.....D	E..... LTD	-	26,301,840	26,301,840	E.M
L.....L	S.....A	41,954,197	47,726,135	5,771,938	Z.SH
K.....H	Z.S	40,387,839	43,279,656	2,891,817	Z.SH
<b>Total</b>		<b>82,342,036</b>	<b>117,307,631</b>	<b>34,965,595</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Tabela 2.2.2.34:Viti 2023

NIPT	Subjekti	Xhiro Kasa	Xhiro TVSH	Dif	inspektori
L.....S	B.K	31,552,380	23,392,917	8,159,463	R.V
K.....V	G.....S	6,692,807	1,938,187	4,754,620	A.M
L.....M	O.S	5,239,583	3,411,667	1,827,916	Z.SH

K.....U	Xh.M	8,542,250	6,824,249	1,718,001	A.M
L.....G	A.T	<b>3,605,764</b>	2,074,790	1,530,974	XH.P
M.....A	B.....Y	12,817,017	11,366,431	1,450,586	Z.SH
L.....H	E.M	8,247,808	6,948,983	1,298,825	Z.SH
K.....A	I.M	16,538,998	15,539,344	999,654	A.H
M.....K	B.K	931,615	-	931,615	K.K
L.....E	R.S	5,082,917	4,190,414	892,503	J.V
L.....C	A.L	4,080,887	3,279,848	801,039	A.H
L.....C	P.....2	12,831,038	12,088,036	743,002	A.M
L.....A	F.K	5,725,843	5,057,361	668,482	A.H
L.....H	O.....L	121,404,585	120,788,307	616,278	L.R
M.....D	E.N	8,303,888	7,691,859	612,029	XH.P
K.....O	S.C	9,457,167	8,875,499	581,668	L.R
J.....U	A.....U	105,228,673	104,675,168	553,505	D.D
M.....V	R.B	10,586,333	10,035,495	550,838	R.V
K.....B	D.....O	2,399,567	1,849,408	550,159	A.M
K.....R	B.....I	5,333,952	4,960,271	373,681	A.M
L.....T	D.G	2,836,525	2,511,701	324,824	L.R
K.....G	Sh.C	5,891,668	5,588,576	303,092	XH.P
L.....A	S.B	2,745,788	2,527,033	218,755	R.V
L.....B	F.SH	5,414,746	5,221,840	192,906	E.S
L.....T	F.....9	20,306,057	20,156,049	150,008	L.R
M.....A	L.H	2,205,417	2,056,260	149,157	E.S
L.....U	L.Z	6,802,836	6,662,005	140,831	A.H
M.....E	G.....3	28,417,926	28,293,255	124,671	E.S
<b>Total</b>		<b>459,224,035</b>	<b>428,004,953</b>	<b>31,219,082</b>	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Gjithashtu rezulton se disa diferenca paraqiten si autofatura, anulim faturash ose dublikim faturash nga ana e subjekteve por pavarësisht se nuk shoqërohen me efekte financiare të përlllogaritura për shkeljet e legjislacionit tatimor në fuqi, nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e inspektorëve të Sektorit nga Zyra dhe Kontrollit për mos kryerjen e detyrave funksionale për monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Diferencat që vijnë si pasojë e anulimeve të shpeshta të faturave për punime ndërtimore në sektorin publik apo privat, përbëjnë risk të shtuar dhe janë arsye për kontroll të thelluar në terren:

Tabela 2.2.2.35: Diferencat që vijnë si pasojë e anulimeve të shpeshta të faturave për punime ndërtimore në sektorin publik apo privat

NIPT	Subjekti	Xhiro Kasa	Xhiro TVSH	Dif	inspektori	koment
L.....J	Xh.C	443,965,489	434,867,942	9,097,547	XH.B	jane korrigjime dhe kthime faturash për punimet e kryera
K....N	F...O	21,866,442	14,866,108	7,000,334	D.D	Subjekti faturat I ka per vitin 2023 ne 09.01.2023 ka prere fatura te përjashtuara per efekt te vitit 2022, faturat jane te deklaruar perlllogari te vitit 2022 .
K...Ë	"S....O"	82,181,167	79,394,271	2,786,896	XH.B	jane korrigjime dhe kthime faturash per punimet e kryera

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Fier

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtori i Kontrollit Tatimor z.B.S, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra znj.E.E si edhe Inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, z.A.K, znj.A.D, z.A.H, znj.D.D, znj.E.M, z.E.F, z.F.D, z.O.D, z.L.R, znj.Xh.P, znj.E.S, znj.J.V, znj.L.F, znj.O.A, znj.R.V, z.Sh.N, znj.Xh.B, znj.Z.SH, znj.F.H, znj. Zh.A, dhe znj.A.M, si pasojë e veprimeve që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar.

Ligjin Nr.8438 date 28.12.1998 "Për tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar.

Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ligjin Nr.92/2014 datë 24.7.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH", i ndryshuar.

UMF Nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar.

UMF Nr.6, datë 30.01.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH", i ndryshuar.

UMF Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

*Manuali i Kontrollit Tatimor, Tetor 2018:*

*Pika 4. “Objekt i punës të Kontrollit Tatimor nga Zyra”, Pika 6. “Vlerësimi Tatimor nga Zyra dhe Proçedurat që ndiqen nga Drejtoria Tatimore Rajonale”, Pika 8. “Përgjegjësitë për kryerjen e funksionit të monitorimit të saktësisë së deklaratave dhe të vlerësimit të detyrimeve tatimore”; Pika 9 “Kalendari i punëve për strukturat e sektorit të kontrollit nga zyra”; Pika 11.2. “Afatet e dorëzimit dhe kontrollit e verifikimit të pasqyrave financiare”; Pika 13. “Deklarimi i On-line i librave të shitjes dhe të blerjes dhe kryqëzimi i të dhënave të tyre”.*

*Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Dhjetor 2022:*

*Pika 5. “Objekt i punës të Sektorit të Kontrollit nga Zyra”; pika 6. “Aktet e prodhuara nga Sektori i Kontrollit nga Zyra”; pika 8. “Proçedurat që ndiqen nga Drejtoria Rajonale Tatimore për Vlerësimin Tatimor nga Zyra”; pika 10 “Përgjegjësitë për kryerjen e funksionit të monitorimit të deklaratave dhe të vlerësimit të detyrimeve tatimore”.*

*Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhërin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave.*

*Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtoritë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera rajonale”.*

*Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.*

*Neni 51 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”.*

*Neni 52 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”.*

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion ndaj Projekt Raportit të Auditimit me nr.1112/18, datë 29.05.2024, me shkresën nr.9418/67, datë 26.06.2024, protokolluar në KLSH me nr.1112/28, datë 27.06.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:** Në lidhje me Kontrollin në subjektin A.....J me NUIS “L.....S”, nga ana e Inspektorese znj.D.D, sqarohet lidhur me problematikën e evidentuar në PRA, për periudhën e objekt kontrollit tetor 2020 deri dhjetor 2020, janë verifikuar të gjitha transaksionet e kryera në blerje-shitje, saktësia e faturave, likuidimi dhe mënyra e likuidimit për çdo faturë. Subjekti kryen blerje nga fermerët dhe i likujdon nëpërmjet bankës. Totali i shumës së kërkuar për periudhën tetor 2020 deri dhjetor 2020 është në vlerën 248,932 lekë. Për këtë periudhë nuk ka patur asnjë fermer të palikujduar nëpërmjet sistemit bankar. Kontrolli për Pasqyrat Financiare periudha 2020 dhe 2021 për zërin detyrime afatshkurtra, llogaria të pagueshme ndaj furnitorëve, është kryer me kontroll të plotë me lajmërim kontrolli me nr.11971/1, datë 02.11.2022 si dhe programit të kontrollit 11971/2, datë 02.11.2022. Në këtë kontroll janë verifikuar nga inspektori i kontrollit në vend të gjithë furnitorët gjendje në bilanc me 31.12.2020.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me praktikën për rimbursim të kryer për subjektin “A.....j” me NUIS “L.....S”, për periudhën tatimore 2020/10-2021/06, nga ana e Grupit të Auditimit pasi shqyrtoi dokumentacion shtesë të vënë në dispozicion nga ana juaj, ku janë dërguar edhe pasqyrat analitike të llogarisë “detyrime ndaj furnitorëve”, për periudhat ushtrimore 2020 dhe 2021, ka rezultuar se në lidhje me totalin e detyrimeve afatashkurtra sipas analitikut të dërguar nga ana juaj është në vlerën 24,159,992 lekë ndërkohë që në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, totali i kësaj llogarie paraqitet në vlerën 52,222,461 lekë, pra me një diferencë prej 28,062,469 lekë më pak të paraqitur në analitikun e dërguar nga ana juaj mbi këtë llogari, fakt i cili tregon se kryqëzimi i blerjeve të furnitorëve kryesisht “fermerë”, mbi të cilët më pas subjekti ka kërkuar kreditimin e TVSH-së, nuk është kryqëzuar në mënyrë shteruese me llogarinë “Detyrimet ndaj Furnitorëve” të paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, për rrjedhojë observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë vetëm për pjesën e pagesave të cilat janë kryer me bankë por të cilat nuk janë kryqëzuar me analitikun e detyrimeve, për rrjedhojë edhe rekomandimi i Grupit të Auditimit mbi këtë praktikë do të jetë kontrolli i thelluar i këtij subjekti mbi mangësitë e evidentuara më sipër.

### **2.3 Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, Rajoni Jugor**

Në zbatim të këtij drejtimi auditimi, për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni fizik i blloqeve të akt konstatimeve, procesverbale gjoba, procesverbale konfiskimi dhe procesverbale sekuestrimi për periudhën objekt auditimi të viteve 2021-2023, të përzgjedhura nga grupi i auditimit.

Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ushtron funksionet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.33 datë 12.02.2020 dhe Nr.69 datë 26.05.2023 “Për Miratimin e Strukturës së Organizative dhe numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”. Strukturat e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë njësi të specializuara zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe që kanë si funksion parësor:

- Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.
- Zbatimin e masave shtrënguese.

Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është e organizuar në nivel qendror dhe rajonal në përbërje të DPT, si më poshtë:

- Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT;
- Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior;
- Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror;
- Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor;

Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor, në Fier, ka në përbërje të saj 2 sektor:

- Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit (Task-Forcë);
- Sektori i Koordinimit;

- Qëllim kryesor i veprimtarisë së këtij sektori është nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve dhe të parandalimi, zbulimi dhe dënimi për shkeljet e legjislacionit tatimor të kryera nga tatimpaguesit, nëpërmjet ushtrimit të kontroleve dhe verifikimeve në vend të aktivitetit të tyre.

- Drejtimet kryesore të punës, konsistojnë në marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave dalë në zbatim të tij, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar; Mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor; Punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to; Zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara.

- Objekti i veprimtarisë dhe drejtimet kryesore të punës për strukturat e zbatimit janë verifikimi në terren i regjistrimit ose ç’regjistrimit; Verifikimi i deklaramit të punonjësve në organin tatimor; verifikimi i instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit; verifikimi i mbajtjes së dokumentacionit tatimor dhe i pajisjes së mallrave me faturë tatimore dhe Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të tjera ligjore të tatimpaguesve

Gjatë periudhës kohore 2021-2023, puna e Drejtorisë/Sektori së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren është bazuar në planet e punës që ka miratuar Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së:

**1. Plan Pune Nr.1804 Prot., datë 01.02.2021, për periudhën 01-28 Shkurt 2021, me objekt pune:**

- Verifikimi në subjekte tregtare me xhiro vjetore mbi 14 milion lekë që rezultojnë me thyerje të kritereve të përcaktuara sipas listave dërguar nga DMR.
- Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.

**2. Plan Pune Nr.3753 Prot., datë 01.03.2021, për periudhën 01-31 Mars 2021, me objekt pune:**

- Verifikimi në subjekte tregtare me xhiro vjetore mbi 14 milion lekë që rezultojnë me thyerje të kritereve të përcaktuara sipas listave dërguar nga DMR.
- Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.

**3. Plan Pune Nr.8576 Prot., datë 14.05.2021, për periudhën 14-30 Maj 2021 me objekt pune:**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së mjekësisë, të tilla si “Klinika Mjekësore”, “Depo Farmaceutike”. “Aktivitete të shërbimit spitalore” etj me kritere risku të thyera sipas listës së nisur nga DMR.
- Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së ndërtimit dhe nën-kontraktorëve të tyre sipas listave të nisura nga DMR.
- Verifikimi i subjekteve tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari ekonomike të fushës së tregtisë më rënie të qarkullimit për periudhat krahasuese Janar –Mars 2019/Janar –Mars 2021, sipas listës të nisura nga DMR.
- Monitorimi i qarkullimit të xhiros dhe/ose verifikime për subjekte tregtare me xhiro të realizuar mbi 14 milion lekë me veprimtari të shërbimit të Bar-Restorante në zonat me qarkullim me të lartë të qyteteve kryesore të vendit.
- Verifikime të transportit të mallrave në akset kryesore të vendit.
- Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera.

**4. Plan Pune Nr.17825 Prot., datë 04.10.2021, për periudhën Tetor-Dhjetor 2021, me objekt pune:**

- Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera sipas afateve respektive.
- Verifikimi i listave të tatimpaguesve ardhur nga DMR lidhur me thyerjen e moduleve të riskut.

**5. Vendim Nr.21, datë 23.11.2021 “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 22.11.2021-31.12.2021. (Nr.21126 Prot., datë 23.11.2021, me objekt pune:**

- Ezaurimi i shkresave dhe denoncimeve të ardhura nga Portali për Bashkëqeverisjen, Stop Informaliteti dhe institucione të tjera, sipas afateve respektive.
- Verifikimi i listave të tatimpaguesve ardhur nga DMR si dhe verifikimi i listave të ardhura nga DRT Rajonale.
- Kontroll në transport (Kontroll për lëvizjen e udhëtarëve dhe transportin e mallrave, kontrolle në tregje).
- Bashkëpunim me strukturat të tjera ligjzbatuese.

**6. Vendim Nr.22, datë 29.12.2021, (Nr.23249 Prot., datë 29.12.2021):**

- “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën Janar-Dhjetor 2022.
- Miratimin e Përmbushjes së Planeve Operacionale për vitin 2021. Përcaktimi i objektivave kryesore për vitin 2022.



**7. Vendim Nr.33, datë 30.12.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 4 Janar-31 Mars 2022. (Nr.21887 Prot., datë 30.12.2022):**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari “Tregti hidrokarbure” sipas situatës së veçantë të krijuar në treg në zbatim të Aktit Normativ Nr.5, datë 12.03.2022.
- Ezaurimi i shkresave nga institucionet e tjera, sipas afateve respektive.
- Administrimi i denoncimeve të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave nëpërmjet rrugëve elektronike (Whatsapp, telefon, email, rrugë postare dhe nga takimet e drejtpërdrejta); Portali për Bashkëqeverisjen; Stop Informaliteti
- Kontroll në transport (Kontroll për lëvizjen e udhëtarëve dhe transportin e mallrave, kontrolle në tregje).
- Bashkëpunim me strukturat të tjera ligjzbatuese.

**8. Plan Pune Nr.4265 Prot., datë 15.03.2022, për periudhën 15 Mars- 21 Mars, me objekt pune:**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari “Tregti hidrokarbure” në lidhje me abuzimet e çmimeve në zbatim të Aktit Normativ Nr.6, datë 15.03.2022.

**9. Plan Pune Nr.4565 Prot., datë 18.03.2022, për periudhën 21 Mars- 28 Mars, me objekt pune:**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari tregti karburanti (naftë, benzinë, gaz) si dhe tregti ushqimor me produktet e shportës (miell gruri, mielli misri, oriz, vezë, vaj ushqimor, makarona) në lidhje me abuzimet e çmimeve sipas Akteve Normative që do jenë në fuqi.

**10. Vendim Nr.24, datë 28.03.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 28 Mars-31 Maj 2022. (Nr.4825 Prot., datë 28.03.2022), me plan veprimi:**

- Identifikim i subjekteve që nuk kanë kryer ende procesin e fiskalizimit;
- Kontroll për fiskalizimin e faturave dhe monitorimin e qarkullimit, lëshimin e faturave dhe faturave shoqëruese;
- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimore si dhe të pagës reale;
- Kontroll për dokumentimin e faturës tatimore të mallrave në subjekt;
- Krahasimi i listës së çmimeve të afishuara me çmimet e shitjes.

**11. Plan Pune Nr.5341 Prot., datë 06.04.2022, për periudhën 07 Prill- 17 Prill, me objekt pune:**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari tregti karburanti në lidhje me abuzimet e çmimeve të vendosura nga Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në zbatim të Aktit Normativ Nr.05, datë 12.03.2022.

**12. Vendim Nr.25, datë 02.06.2022, “Miratimin e Planit Operacional së DPT, për periudhën 01 Qershor-30 Shtator 2022. (Nr.9355/I Prot., datë 02.06.2022), me plan veprimi:**

- Kontroll për regjistrimin e subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor;
- Kontroll për instalimin dhe përdorimin e sistemit të fiskalizimit, lëshimin e faturave të fiskalizuara (me para në dorë/me pakicë apo me bank për turistët e huaj) dhe lëshimin e biletave të udhëtarëve;
- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimor;
- Kontroll për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave që përdoren, ruhen apo transportohen;
- Monitorim të qarkullimit të xhiros;
- Kontroll për afishimin e çmimeve të shitjes për produktet dhe shërbimet e ofruara;
- Ngritja e pikave të postblloqeve;
- Kontroll për mbajtjen e librave e regjistrave;

- Kontroll për kontratat e qerasë (për tatimin në burim) apo dokument pronësie të vendushtrimit të aktivitetit;
- Monitorimi xhiros nga zyra për subjektet me risk;
- Verifikime/monitorime për aktivitetin e zhvilluar në qytetin e Korçës “Festa e Birrës”;
- Kontroll në zonën e Shëngjinit gjatë zhvillimit të festivalit UNUM 01-06- Qershor;
- Kontrolle dhe verifikime në subjektet që ushtrojnë veprimtari argëtuese të jetës së natës.

**13. Vendim Nr.26, datë 29.09.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 03 Tetor-30 Nëntor 2022. (Nr.16562/1 Prot., datë 29.09.2022):**

- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike tregti me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe të produkteve të lidhura me to në zbatim të Aktit Normativ Nr.7, datë 18.03.2022;
- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari “Tregti hidrokarbure” sipas situatës së veçantë të krijuar në treg në zbatim të Aktit Normativ Nr.5, datë 12.03.2022.
- Monitorim i xhiros së subjekteve (me përzgjedhje sipas sektorëve me risk) nëpërmjet sistemit CPCM nga Sektori i Koordinimit;
- Ezaurimi i shkresave nga institucionet e tjera, sipas afateve respektive.
- Administrimi i denoncimeve të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave nëpërmjet rrugëve elektronike (Whatsapp, telefon, email, rrugë postare dhe nga takimet e drejtpërdrejta); Portali për Bashkëqeverisjen; Stop Informaliteti
- Kontroll në transport (Kontroll për lëvizjen e udhëtarëve dhe transportin e mallrave, kontrolle në tregje).
- Bashkëpunim me strukturat të tjera ligjzbatuese.

**14. Vendim Nr.28, datë 25.11.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 01-31 Dhjetor 2022. (Nr.20019/1 Prot., datë 25.11.2022):**

- Verifikimi i listave të tatimpaguesve të ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut;
- Verifikimi i listave të ardhur nga DRT;
- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari ekonomike tregti me shumicë/pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe të produkteve të lidhura me to në zbatim të Aktit Normativ Nr.7, datë 18.03.2022;
- Verifikimi i subjekteve tregtare me veprimtari “Tregti hidrokarbure” sipas situatës së veçantë të krijuar në treg në zbatim të Aktit Normativ Nr.5, datë 12.03.2022.
- Monitorim i xhiros së subjekteve (me përzgjedhje sipas sektorëve me risk) nëpërmjet sistemit CPCM nga Sektori i Koordinimit;
- Ezaurimi i shkresave nga institucionet e tjera, sipas afateve respektive.
- Administrimi i denoncimeve të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave nëpërmjet rrugëve elektronike (Whatsapp, telefon, email, rrugë postare dhe nga takimet e drejtpërdrejta); Portali për Bashkëqeverisjen; Stop Informaliteti
- Kontroll në transport (Kontroll për lëvizjen e udhëtarëve dhe transportin e mallrave, kontrolle në tregje).
- Kontroll në zonat me frekuentim ku do të zhvillohen aktivitete festive në kuadër të festave të fundvitit;
- Bashkëpunim me strukturat të tjera ligjzbatuese.

**15. Vendim Nr.31, datë 28.12.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën Janar-Dhjetor 2023. (Nr.21719/1 Prot., datë 28.12.2022):**

- Kontroll për regjistrimin e subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor;
- Kontroll për fiskalizimin e faturave dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;
- Kontroll për lëshimin e faturave të shitjes dhe faturave shoqëruese;

- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimor;
- Kontroll për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave në subjekt;
- Monitorim të qarkullimit të xhiros;
- Kontroll i listës së çmimit të afishuar me çmimet e shitjeve;
- Ngritja e pikave të postbllloqeve;
- Inventarizimi fizik i gjendjes së mallrave me përzgjedhje ose i plotë sipas rastit;
- Monitorim i qarkullimit të xhiros ditore;
- Të tjera verifikime që mund të dalin të nevojshme gjatë ushtrimit të kontrollit;

**16. Vendim Nr.33, datë 30.12.2022, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 04 Janar – 31 Mars 2023. (Nr.21887/1 Prot., datë 30.12.2022):**

- Kontroll për regjistrimin e subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor;
- Kontroll për fiskalizimin e faturave dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;
- Kontroll për lëshimin e faturave të shitjes dhe faturave shoqëruese;
- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimor;
- Kontroll për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave në subjekt;
- Monitorim të qarkullimit të xhiros;
- Kontroll i listës së çmimit të afishuar me çmimet e shitjeve;
- Ngritja e pikave të postbllloqeve;
- Inventarizimi fizik i gjendjes së mallrave me përzgjedhje ose i plotë sipas rastit;
- Monitorim i qarkullimit të xhiros ditore;
- Të tjera verifikime që mund të dalin të nevojshme gjatë ushtrimit të kontrollit;

**17. Vendim Nr.36, datë 25.05.2023, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 01 Qershor – 30 Shtator 2023. (Nr.9345/1 Prot., datë 25.05.2023):**

- Kontroll për regjistrimin e subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor;
- Kontroll për instalimin dhe përdorimin e sistemit të fiskalizimit, lëshimin e faturave të fiskalizuara dhe lëshimin e biletave të udhëtarëve;
- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimor dhe verifikimin e nivelit të pagave për të konstatuar nëse deklaratimet kryhen për pagën reale;
- Kontroll për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave që përdoren, ruhen apo transportohen;
- Monitorim të qarkullimit të xhiros;
- Kontroll për afishimin e çmimeve të shitjes për produktet dhe shërbimet e ofruara;
- Ngritja e pikave të postbllloqeve;
- Kontroll për mbajtjen e librave e regjistrave;
- Kontroll për kontratat e qerasë (për tatimin në burim) apo dokument pronësie të vendushtrimit të aktivitetit;
- Fokus i veçantë në zonat turistike bregdetare dhe transport;

**18. Vendim Nr.37, datë 29.09.2023, “Miratimin e Planit të Punës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për periudhën 02 Tetor – 31 Dhjetor 2023. (Nr.15639/1 Prot., datë 29.09.2023):**

- Kontroll për regjistrimin e subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor;
- Kontroll për instalimin dhe përdorimin e sistemit të fiskalizimit, lëshimin e faturave të fiskalizuara;
- Kontroll për verifikimin e deklarimit të punonjësve në organin tatimor;
- Kontroll për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave që përdoren, ruhen apo transportohen;
- Kontroll për afishimin e listës së çmimeve të shitjeve për produktet dhe shërbimet e ofruara;
- Të tjera verifikime që mund të dalin të nevojshme gjatë ushtrimit të kontrollit;

Nga auditimi i veprimtarisë së DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021, ka rezultuar se janë kryer 924 verifikime në terren dhe ka vendosur penalitete për 121 raste në vlerën totale 7,745,000 lekë.

Tabela 2.3.1- Veprimtaria e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor Verifikimet në Terren	Plan 1 Janar-31 Dhjetor 2021			Efektiviteti për planin
	Verifikimet	Shkelje	Vlere	
DHT				
Rajoni Jugor	924	121	7,745,000	13%
<b>Total</b>	<b>924</b>	<b>121</b>	<b>7,745,000</b>	<b>13%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.2- Veprimtaria analitike sipas shkeljeve e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021

Shkelje e konstatuar	Plan	
	Numër	Vlerë
Moslëshim kuponi tatimor (rasti parë bi)	16	800,000
Punonjës i padeklaruar BM	9	3,400,000
Punonjës i padeklaruar BV	18	1,050,000
Nuk instalon pajisje fiskale (hera e parë ai)	7	350,000
Nuk mirëmban pajisjen fiskale në gjendje pune	12	480,000
Mosafishim të listës së çmimeve BM	1	50,000
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BM	2	100,000
Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BV	6	60,000
Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BM	1	15,000
Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BV	19	190,000
Mall pa faturë tatimore (gjobë 100% TVSH munguar)	12	100,000
Subjekt i paregjistruar në organin tatimor	15	-
Pengim kontrolli	2	1,100,000
Zhblokim aktiviteti pas regjistrimit	1	50,000
<b>Total</b>	<b>121</b>	<b>7,745,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga rastet për verifikim të ardhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, ka rezultuar se 256 raste të verifikuara kanë rezultuar shkelje në 36 raste në vlerën totale 2,700,000 lekë.

Tabela 2.3.3- Numri i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021

Emërtimi	Janar-Dhjetor 2021		
	Verifikime Listë Risku	Shkelje	Vlerë
DVKT Rajoni Jugor	256	36	2,700,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.4- Informacion analitik i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021

Nr	Shkelje	Nr Shkeljesh	Vlerë
1	Mall pa faturë tatimore	4	-
2	Mosafishim të listës së çmimeve BM	1	50,000
3	Moslëshim kuponi tatimor (rasti parë bi)	10	500,000
4	Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BV	2	20,000
5	Nuk instalon pajisje fiskale (hera e parë ai)	1	50,000
6	Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BM	2	100,000
7	Nuk mban dokumentacion tatimor, libra, BV	2	20,000
8	Punonjës i padeklaruar BM	2	1,400,000

9	Punonjës i padeklaruar BV	8	400,000
10	Nuk mirëmban pajisjen fiskale në gjendje pune	4	160,000
<b>Total</b>		<b>36</b>	<b>2,700,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga auditimi i veprimtarisë së DVKT Rajoni Jugor për vitin 2022, ka rezultuar se janë kryer 3,631 verifikime në terren dhe ka vendosur penalitete për 299 raste në vlerën totale 13,245,000 lekë.

Tabela 2.3.5- Veprimtaria e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2022

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor Verifikimet në Terren	Plan 1 Janar-31 Dhjetor 2022			Efektiviteti për planin
	Verifikimet	Shkelje	Vlere	
DHT				
Rajoni Jugor	3,631	299	13,245,000	8%
<b>Total</b>	<b>3,631</b>	<b>299</b>	<b>13,245,000</b>	<b>8%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.6- Veprimtaria analitike sipas shkeljeve e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2022

Shkelje e konstatuar	Rajoni Jugor	
	Numër	Vlerë
Moslëshim faturë BM	4	300,000
Moslëshim faturë BV	5	125,000
Punonjës i padeklaruar BM	10	2,000,000
Punonjës i padeklaruar BV	24	1,250,000
Nuk instalon pajisje fiskale (hera e parë ai)	1	25,000
Mos instalim i sistemit të fiskalizimit, BM	43	3,225,000
Mos instalim i sistemit të fiskalizimit, BV me TVSH	17	850,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BV	56	1,400,000
Mospajisje me certifikatë elektronike BM	3	225,000
Mospajisje me certifikate elektronike BV	4	100,000
Nuk mirëmban pajisjen fiskale në gjendje pune	1	40,000
Mosafishim të listës së çmimeve BM	1	100,000
Mospërditësim të dhëna për regjistrim BM	10	150,000
Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BV	27	270,000
Mall pa faturë tatimore	47	2,425,000
Lëshon faturë të pasaktë tatimore (pa efekt detyrimi)	1	10,000
Subjekt i paregjistruar në organin tatimor	22	
Prishja e shenjave dalluese	1	
Referim hetim	3	
Bllokim shitjesh/Karburant/Rafineri	4	
Zhbllokim aktiviteti pas regjistrimit	15	750,000
<b>Total</b>	<b>299</b>	<b>13,245,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga rastet për verifikim të ardhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, ka rezultuar se 2,614 raste të verifikuara kanë rezultuar shkelje në 123 raste në vlerën totale 5,450,000 lekë.

Tabela 2.3.7- Numri i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2022

Emërtimi	Janar-Dhjetor 2022		
	Verifikime Listë Risku	Shkelje	Vlerë
DVKT Rajoni Jugor	2,614	123	5,450,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.8- Informacion analitik i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2021

Nr.	Shkelje	Nr Shkeljesh	Vlerë
1	Administrim blloqesh jotatimore	-	-
2	Lëshon faturë të pasaktë tatimore (pa efekt detyrimi)	1	10,000
3	Mall pa faturë tatimore	10	425,000
4	Mos instalim i sistemit të fiskalizimit	80	3,175,000
5	Moslëshim fature	3	175,000
6	Mospajse me certifikatë elektronike	5	275,000
7	Mospërditësim të dhëna për regjistrim	8	90,000
8	Punonjës i padeklaruar BM	3	600,000
9	Punonjës i padeklaruar BV	13	700,000
<b>Total</b>		<b>123</b>	<b>5,450,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor.

Nga auditimi i veprimtarisë së DVKT Rajoni Jugor për vitin 2023, ka rezultuar se janë kryer 1,892 verifikime në terren dhe ka vendosur penalitete për 354 raste në vlerën totale 12,560,000 lekë.

Tabela 2.3.9- Veprimtaria e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2023

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor Verifikimet në Terren	Plan 1 Janar-31 Dhjetor 2023			Efektiviteti për planin
	Verifikimet	Shkelje	Vlere	
DHT				
Rajoni Jugor	1,892	354	12,560,000	19%
<b>Total</b>	<b>1,892</b>	<b>354</b>	<b>12,560,000</b>	<b>19%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.10- Veprimtaria analitike sipas shkeljeve e DVKT Rajoni Jugor për vitin 2023

Shkelje e konstatuar	Rajoni Jugor	
	Numër	Vlerë
Moslëshim fature BM	7	525,000
Moslëshim faturë BV me TVSH	6	300,000
Moslëshim faturë BV	56	1,400,000
Punonjës i padeklaruar BM	8	1,600,000
Punonjës i padeklaruar BV	28	1,600,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BM	4	300,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BV me TVSH	2	100,000
Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BV	34	850,000
Mospajse me certifikatë elektronike	40	1,300,000
Mosmbajtje të pajisjes fiskale në kushte pune	1	25,000
Mosafishim të listës së çmimeve BV	1	50,000
Mosmarrje kuponi nga klientët	1	25,000
Nuk mban dokumentacion tatimor	24	240,000
Mospërditësim të dhënave për regjistrim	81	835,000
Mall pa faturë tatimore	33	2,400,000
Lëshon faturë të pasaktë tatimore (pa efekt detyrimi)	11	710,000
Subjekt i paregjistruar në organin tatimor	10	-
Administrim blloqesh jotatimore	1	-
Zhblllokim aktiviteti pas regjistrimit	6	300,000
<b>Total</b>	<b>354</b>	<b>12,560,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga rastet për verifikim të ardhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, ka rezultuar se 943 raste të verifikuara kanë rezultuar shkelje në 112 raste në vlerën totale 4,225,000 lekë.

Tabela 2.3.11- Numri i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2023

Emërtimi	Janar-Dhjetor 2023		
	Verifikime Listë Risku	Shkelje	Vlerë
DVKT Rajoni Jugor	943	112	4,225,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Në mënyrë analitike të detajuar sipas natyrës së shkeljeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 2.3.12- Informacion analitik i shkeljeve verifikime DVKT Rajoni Jugor për vitin 2023

Nr	Shkelje	Nr Shkeljesh	Vlerë
1	Administrim blloqesh jotatimore	1	-
2	Lëshon faturë të pasaktë tatimore (pa efekt detyrimi)	10	700,000
3	Mall pa faturë tatimore	12	350,000
4	Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit	13	425,000
5	Moslëshim faturë	24	775,000
6	Mospajisje me certifikate elektronike	17	625,000
7	Mospërditësim të dhëna për regjistrim	14	140,000
8	Nuk mban dokumentacion tatimor	11	110,000
9	Punonjës i padeklaruar BM	4	800,000
10	Punonjës i padeklaruar BV	6	300,000
<b>Total</b>		<b>112</b>	<b>4,225,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer analiza e efijencës së DVKT Rajoni Jugor për periudhën objekt kontrolli të viteve 2021-2023, konkretisht janë kryer rilogaritjet duke vendosur në raport nivelin e gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara me shpenzimet e fondit të pagave të drejtorisë, ku janë përfshirë **paga neto + sigurimet shoqërore punëmarrës + sigurimet shëndetësore punëmarrës.**

Tabela 2.3.13-Shpenzime totale paga

Viti	Paga Bruto	Kontributet për Sig Shoq P.DH	Kontributet për Sig Shënde P.DH	TAP	Paga Neto
2021	18,979,259	2,836,751	321,494	1,511,803	15,342,932
2022	20,599,736	3,089,960	349,584	1,638,447	16,654,730
2023	23,121,617	3,468,242	393,057	2,037,438	18,494,568
<b>Total</b>	<b>62,700,612</b>	<b>9,394,953</b>	<b>1,064,135</b>	<b>5,187,688</b>	<b>50,492,231</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga analiza ka rezultuar se raporti shpenzime për pagat me shkeljet në vlerë është 2.39 me 1, pra për çdo 1 lek shkelje janë harxhuar 2.39 lekë shpenzime pagash për vitin 2021, 1.52 me 1 për vitin 2022 dhe 1.78 me 1 për vitin 2023, llogaritjet paraqitur si në tabelën më poshtë:

Tabela 2.3.14-Raporti shpenzime paga me shkeljet

Përshkrimi	2021	2022	2023
Shpenzime Fondi i Pagave	18,501,177	20,094,274	22,355,867
Shkelje në Vlerë	7,745,000	13,245,000	12,560,000
Raporti Shp Page/Shkeljen në vlerë	2.39	1.52	1.78
Raporti Shp Page/Shkelje në vlerë (%)	239%	152%	178%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Gjithashtu nga analiza e shfrytëzimit të kohës së punës efektive ka rezultuar se:

- Për vitin 2021 DVKTRJ ka pasur veprimtari vetëm për 112 ditë pune ose vetëm për 5 muaj të vitit sepse në periudhën mars-maj nuk ka pasur veprimtari për shkak të vendit vakant të Drejtorit të DVKTRJ, kurse për muajt shtator dhe nëntor nuk ka pasur veprimtari sepse nuk janë dërguar lista dhe ankesa nga DVKT në DPT.
- Për vitin 2022 DVKTRJ ka pasur veprimtari për 241 ditë pune, por për muajt qershor dhe korrik që kanë numër të lartë të akt konstatimeve të mbajtura në terren kanë qenë fushata sensibilizimi tek tatimpaguesit kurse në muajin tetor që ka edhe numrin më të lartë të akt konstatimeve të mbajtur në terren, fokusi i planeve të punës kanë qenë kontrolle në subjekte pasive, që në gjykimin tonë përbëjnë risk të ulët për shmangie dhe parregullësi.
- Për vitin 2023 DVKTRJ ka pasur veprimtari për 211 ditë pune, por për muajt janar dhe shkurt që kanë edhe muajt me numrin më të lartë të akt konstatimeve të mbajtur në terren, fokusi i

planeve të punës kanë qenë kontrolle në subjekte pasive, që në gjykimin tonë përbëjnë risk të ulët për shmangie dhe parregullësi.

Tabela 2.3.15- Numri i akteve sipas ditëve të punës për çdo muaj

Nr	Muaj	2021		2022		2023	
		Ditë Pune	Akt Konstatime	Ditë Pune	Akt Konstatime	Ditë Pune	Akt Konstatime
1	Janar	12	60	9	72	19	376
2	Shkurt	17	107	9	62	15	305
3	<b>Mars</b>	<b>3</b>	<b>19</b>	19	157	16	98
4	<b>Prill</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	20	273	10	69
5	<b>Maj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	20	215	10	93
6	Qershor	13	116	20	233	21	89
7	Korrik	19	150	24	477	28	270
8	Gusht	15	105	29	468	23	147
9	<b>Shtator</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	24	376	15	63
10	Tetor	14	158	24	539	19	72
11	<b>Nëntor</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	20	384	17	124
12	Dhjetor	18	208	23	375	18	186
<b>Totali</b>		<b>112</b>	<b>924</b>	<b>241</b>	<b>3,631</b>	<b>211</b>	<b>1,892</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga auditimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion dhe analizat e mësipërme grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit arrijnë në konkluzionin se DVKT Rajoni Jugor përgjatë periudhës objekt auditimi 2021-2023, ka vepruar në kushte jo efience për shkak të mosshfrytëzimit efektiv të kohës së punës si pasojë e shpërndarjes jo uniforme të planeve të punës të ardhur nga DVKT në DPT si dhe mungesës së analizës efektive të riskut të subjekteve për verifikim sipas planeve të punës, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat dhe përcaktimet e pikat ç) dhe dh) të neni 12 “Parimet e administrimit tatimor” të Kreut II “Parimet, Organizimi dhe Personeli i Administratës Tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga magazina e DRT Fier janë vendosur në dispozicion dokumentacioni fizik i blloqeve të Akt Konstatimeve, PV Gjore, PV Sekuestrimi dhe PV Konfiskimi, si më poshtë:

Tabela 2.3.16-Inormacion sipas dokumentacionit fizik të blloqeve të Akt Konstatimeve, PV Gjore, PV Sekuestrimi dhe PV Konfiskimi

Fletë Hyrje		Inspektori	Artikulli	Seria	
Nr	Datë			Fillim	Mbarim
20	28.09.2021	A.D	Akt Konstatimi	0994651	0994700
21	19.10.2021	I.A	Akt Konstatimi	0903651	0903700
12	06.04.2022	G.B	PV Gjore	308151	308200
20	15.05.2022	B.M	Akt Konstatimi	1094151	1094200
32	22.08.2022	E.D	Akt Konstatimi	1079901	10779950
36	12.09.2022	A.C	Akt Konstatimi	1063901	1063950
10	20.02.2023	A.H	Akt Konstatimi	1135001	1135050
5	22.02.2021	Xh.TH	PV Gjore	308051	308100
24	15.06.2022	I.A	PV Sekuestrimi	0004951	0005000
24	15.06.2022	I.A	PV Konfiskimi	0119351	0119400
6	06.01.2023	E.H	Akt Konstatimi	1171901	1171950
12	20.03.2023	M.C	Akt Konstatimi	1135401	1135450
29	25.09.2023	P.K	PV Gjore	0238901	0238950
26/1	11.12.2023	R.B	Akt Konstatimi	1077701	1077750
7/1	07.04.2021	G.J.S	Akt Konstatimi	0985851	0985900
14	03.08.2021	H.S	Akt Konstatimi	0903501	0903550



7	07.01.2023	R.P	Akt Konstatimi	1135251	1135300
2	27.01.2021	D.M	Akt Konstatimi	1127251	1127300

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DVKT Rajoni Jugor

Nga auditimi i blloqeve të akt konstatimeve, procesverbale gjoba, procesverbale konfiskimi dhe procesverbale sekuestrimi, ka rezultuar se:

1. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektores A.D nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0994561 dhe mbarojnë me numrin 0994687 të plotësuar, kurse pjesa tjetër deri tek numri 0994700 janë pa plotësuar sepse është bërë dorëzimi i bllokut në magazinë.

2. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit I.A nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0909651 dhe mbarojnë me numrin 0903700 të plotësuar. **Akt Konstatimi me serial 0903659 rezulton i anuluar me mbishkrimin “Anulluar për arsye se ishte agjensi funeralesh”, të firmosur nga inspektori I.A dhe punonjësi i subjektit D.B.**

3. Nga kontrolli i bllokut të procesverbal gjobe të inspektorit Xh.TH nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 308051 dhe mbarojnë me numrin 308100 të plotësuar.

4. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit GJ.S nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0994561 dhe mbarojnë me numrin 0994687, por nuk është plotësuar asnjë fletë akt konstatimi nga blloku i inspektorit.

5. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit H.S nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0903501 dhe mbarojnë me numrin 0903550 të plotësuar.

6. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit D.M nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1127251 dhe mbarojnë me numrin 1127300 të plotësuar.

7. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit A.C nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1063901 dhe mbarojnë me numrin 1063950 të plotësuar. **Akt Konstatimi me serial 1063933 rezulton i anuluar me mbishkrimin “Anulluar”, pa kryer një shpjegim për arsyen e anulimit.**

8. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektores E.D nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1079901 dhe mbarojnë me numrin 10779950 të plotësuar. **Akt Konstatimi me serial 1079937 dhe 1079938 rezultojnë të anuluar me mbishkrimin “Anulluar”, pa kryer një shpjegim për arsyen e anulimit.**

9. Nga kontrolli i bllokut të procesverbal konfiskimi të inspektorit I.A nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0119351 dhe mbarojnë me numrin 0119400, por nuk është plotësuar asnjë fletë procesverbal konfiskimi nga blloku i inspektorit.

10. Nga kontrolli i bllokut të procesverbal sekuestrimi të inspektorit I.A nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0004951 dhe mbarojnë me numrin 0005000, por janë plotësuar vetëm fletët me numër serial 0004951 dhe 0004952 të bllokut të inspektorit.

11. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit B.M nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1094151 dhe mbarojnë me numrin 1094200 të plotësuar. **Akt Konstatimi me serial 1094172 rezulton i anuluar me mbishkrimin “Anulluar”, pa kryer një shpjegim për arsyen e anulimit.**

12. Nga kontrolli i bllokut të procesverbal gjobe të inspektorit G.B nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 308151 dhe mbarojnë me numrin 308200. **PV Gjobe me serial 308190 rezulton i anuluar me mbishkrimin “Anulluar vijon nga faqja**

**me nr serie 308190” dhe PV Gjobe me serial 308200 rezulton i pa plotësuar me shënimin “X” me shkrim dore, pa asnjë shpjegim.**

13. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit M.C nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1135401 dhe mbarojnë me numrin 1135450 të plotësuar.

14. Nga kontrolli i bllokut të procesverbal gjobe të inspektorit P.K nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 0238901 dhe mbarojnë me numrin 0238950, është i plotësuar deri tek fleta e PV Gjobës me nr serial 0238947.

15. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit E.H nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1171901 dhe mbarojnë me numrin 1171950 të plotësuar.

16. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit R.P nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1135251 dhe mbarojnë me numrin 1135300 të plotësuar.

17. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit A.H nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1135001 dhe mbarojnë me numrin 1135050 të plotësuar. **Akt Konstatimi me serial 1135017 rezulton i anuluar me mbishkrimin “Anulluar”, pa kryer një shpjegim për arsyen e anulimit.**

18. Nga kontrolli i bllokut të akt konstatimit të inspektorit R.B nuk janë konstatuar problematika në numrat serial që fillojnë me numrin 1077701 dhe mbarojnë me numrin 1077750 të plotësuar.

Për periudhën objekt auditimi 2021-2023 janë përzgjedhur për auditim akt konstatimet me shkelje të konstatuara nga inspektorët në terren si dhe procesverbalet e gjobave përkatëse sipas tabelës së më poshtë:

*Tabela 2.3.17-Kampioni i përzgjedhur sipas dokumentacionit fizik te blloqeve të Akt Konstatimeve, PV Gjobe, PV Sekuestrimi dhe PV Konfiskimi*

Nr	NIPT	Subjekti	Inspektori	Lloji i shkeljes	Shkelje në vlerë
1	J.....S	A...a SHPK	A.H, E.D	Pengim Kontrolli	1,000,000
2	K.....B	A.Q	A.H, E.D	Pengim Kontrolli	100,000
3	L.....V	A.P	P.K, H.S,	Punonjës i padeklaruar BV	50,000
4	L.....N	A.D	I.A, E.D	Punonjës i padeklaruar BM	1,200,000
5	M.....R	R.A	H.S, D.B	Punonjës i padeklaruar BV	50,000
6	K.....K	L.ZH	D.M, G.K, E.M	Mospërditësim të dhëna për regjistrim, BV	10,000
7	K.....T	E.....i	Sh.D, E.H, M.C	Mosinstalim i sistemit të fiskalizimit, BM	75,000
8	K.....Q	A.B	D.M, Xh.TH	Punonjës i padeklaruar BM	200,000
9	L.....F	Th.K	Sh.D, E.H, G.B	Punonjës i padeklaruar BM	200,000
10	L.....U	L.M	I.A, A.S, I.D	Mall pa faturë tatimore	75,000
11	M.....F	M.....l	A.S, R.P	Mall pa fature tatimore	75,000
12	L.....I	M.B	M.C, A.H	Mall pa fature tatimore	50,000
13	L.....V	E.C	I.A, E.D	Mall pa fature tatimore	25,000
14	K.....H	D.N	B.M, A.C	Punonjës i padeklaruar BV	50,000
15	L.....P	A.I	D.M, Xh.TH, Xh.RR	Mospajse me certifikate elektronike	25,000

**1. Subjekti:** “A..A” SHPK.

**NIPT:** J.....S.

**Adresë Kryesore:** Rruga “Sadik Zotaj”, Lagjja “28 Nëntori”, Vlorë.

**Aktiviteti:** Prodhim sallami të llojeve të ndryshme. Tregeti me shumicë e me pakicë të sallamit dhe të produkteve të mishit.

**Grupi i kontrollit:** A.H, E.D.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.496 Prot., datë 11.08.2020, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A...A” SHPK me NIPT J....S dhe janë mbajtur akt konstatimet nr.1124639 dhe nr.1124640, datë 14.08.2020, ku na përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua dokumentacion jotatimor dhe nga grupi i punës u administrua blloku me mbishkrimin fletë-hyrje, i cili ishte i plotësuar me vlera dhe me data nga të cilat 10 fletë ishin të plotësuara. Subjekti nuk lejoi vazhdimin e kontrollit duke marrë në mënyrë të dhunshme dokumentacionin jotatimor, i cili ishte administruar nga grupi i punës. Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali i gjobës nr.303892, datë 14.08.2020, duke penalizuar subjektin me 50,000 lekë për shkelje të nenit 122, pika 1, gërma c të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Është dërguar shkresa nr.496/1 prot., datë 31.08.2020 “Kërkesë për miratim gjobe” drejtuar Znj. Pranvera Resulaj, Drejtor i DRT Vlorë, e cila nuk e ka miratuar gjobën për pengimin e kontrollit.

Është dërguar shkresa nr.677/5 prot., datë 03.12.2020 si pasojë e problemeve dhe konfliktit të kompetencave të hasura në praktikë për miratimin e gjobës për pengesën e kontrollit. Është kthyer përgjigje nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT me shkresën nr.23563/1 prot., datë 01.02.2021, ku jepet interpretimi se gjoba për pengimin e kontrollit duhet të miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, që në rastin konkret është Drejtori i DVKTRJ. Mbas interpretimit nga DPT është miratuar vendosja e gjobës nëpërmjet shkresës nr.496/3, datë 01.03.2021 dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1094301 datë 01.03.2021 si dhe procesverbali i gjobës nr.309806.

Nga sa më sipër konstatohet se ka shkelje të afateve procedurale dhe një vonesë prej 7 muajsh në miratimin e gjobës për pengimin e kontrollit sipas përcaktimeve të nenit 127, pika 2 e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligj Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për të cilën mban përgjegjësi Z. A.P, ish Drejtor i DVKTRJ.

**2. Subjekti:** A.Q.**NIPT:** K....B.**Adresë Kryesore:** Lagjja “Muzakaj”, Berat.**Aktiviteti:** Tregti peshku.**Grupi i kontrollit:** A.H, E.D.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.677 Prot., datë 09.09.2020, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A.Q” SHPK me NIPT K.....B, dhe janë mbajtur akt konstatimet nr.1124646 dhe nr.1124647, datë 11.09.2020, ku ka rezultuar se:

- Sipas përshkrimit të akt konstatimeve në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti i regjistruar në organin tatimor është me status pasiv, për këtë arsye është mbajtur procesverbali i gjobës nr.303893, datë 11.09.2022.

- Sipas përshkrimit të akt konstatimeve në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti nuk ka të instaluar pajisjen fiskale në vend biznes, për këtë arsye u mbajt procesverbali i gjobës nr.303894, datë 11.09.2020.

- Sipas përshkrimit të akt konstatimeve në momentin e kontrollit u gjend A.Q dhe V.Q e cila ishte e padeklaruar në organin tatimor, për këtë arsye u mbajt procesverbal i gjobës nr.303895, datë 11.09.2020. Në momentin e mbajtjes së procesverbalit të gjobës për punonjës të padeklaruar A.Q veproi në mënyrë agresive duke marr nga dora në mënyrë të dhunshme

dokumentin e identifikimit të V.Q dhe me tone të larta nxjerr jashtë inspektorët nga subjekti duke penguar vazhdimin e kontrollit.

- Është dërguar shkresa nr.677/1 prot., datë 22.09.2020 “Kërkesë për miratim gjobe” drejtuar Z. S.C, Drejtor i DRT Berat.

- Është kthyer përgjigje me shkresën nr.1820/1 prot., datë 29.09.2020, duke mos vepruar me miratimin e gjobës për pengimin e kontrollit.

- Është dërguar shkresa nr.677/3 prot., datë 22.10.2020 “Ridërgim shkrese për miratim gjobe” drejtuar Z. S.C, Drejtor i DRT Berat.

- Është kthyer përgjigje me shkresën nr.1820/5 prot., datë 03.09.2020, i cili nuk e ka miratuar gjobën për pengimin e kontrollit

- Është dërguar shkresa nr.677/5 prot., datë 03.12.2020 si pasojë e problemeve dhe konfliktit të kompetencave të hasura në praktikë për miratimin e gjobës për pengesën e kontrollit. Është kthyer përgjigje nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në DPT me shkresën nr.23563/1 prot., datë 01.02.2021, ku jepet interpretimi se gjoba për pengimin e kontrollit duhet të miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, që në rastin konkret është Drejtori i DVKTRJ. Mbas interpretimit nga DPT është dërguar kërkesa nr.677/7, datë 24.02.2021 “Kërkesë për miratim gjobe” dhe është miratuar vendosja e gjobës nëpërmjet shkresës nr.677/8/3, datë 01.03.2021 dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1094302 datë 01.03.2021 si dhe procesverbali i gjobës nr.309807.

Nga sa më sipër konstatohet se ka shkelje të afateve proceduriale dhe një vonesë prej 7 muajsh në miratimin e gjobës për pengimin e kontrollit sipas përcaktimeve të nenit 127, pika 2 e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligj Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, për të cilën mban përgjegjësi Z. A.P, ish Drejtor i DVKTRJ.

**3. Subjekti:** “A.P” PF.

**NIPT:** L.....V.

**Adresë Kryesore:** Rruga “Dhimitër Konomi”, Lagjja “Uji i ftohtë”, Objekt Privat Nr.9, Vlorë.

**Aktiviteti:** Hoteleri.

**Grupi i kontrollit:** P.K, H.S, D.B.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.431 Prot., datë 21.07.2021, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A.P” PF me NIPT L....V dhe është mbajtur akt konstatimi nr.0903543, datë 21.07.2021, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.309852, datë 21.07.2021, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma b të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 28.07.2021. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklarimit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësien e konstatuar padeklaruar.

**4. Subjekti:** “A.D” PF.

**NIPT:** L.....N.

**Adresë Kryesore:** Rruga “12 Perivol”, Lagjja “Drimadhes”, Objekt Nr.11, Kati 1, Dhërmi.

**Aktiviteti:** Bar-Kafe dhe dhoma plazhi me qera.

**Grupi i kontrollit:** I.A, B.K, E.D.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.512 Prot., datë 06.08.2021, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A.D” PF me NIPT L....N dhe

është mbajtur akt konstatimi nr.0903676, datë 06.08.2021, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.31000, datë 06.08.2021, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma a të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 13.08.2021. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklarimit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësën e konstatuar padeklaruar.

**5. Subjekti:** “R.A” PF.

**NIPT:** M....R.

**Adresë Kryesore:** Rruga e Kampit, Objekt 1-katesh Nr.9, Dhërmi.

**Aktiviteti:** Fast-food (Ushqim i shpejt). Stacion plazhi

**Grupi i kontrollit:** D.M, H.S, D.B.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.514 Prot., datë 06.08.2021, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “R.A” PF me NIPT M....R dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1094242, datë 07.08.2021, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.285018, datë 07.08.2021, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma b të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 13.08.2021. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklarimit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësën e konstatuar padeklaruar.

**6. Subjekti:** “L.Zh” PF.

**NIPT:** K.....K.

**Adresë Kryesore:** Lagjja "18 Shtatori", Godinë 3-kateshe, Kati 3-të, Nr.pasurie 28/92, Zona Kadastrale 8541, Gjirokastër.

**Aktiviteti:** Hotel.

**Grupi i kontrollit:** D.M, G.K, E.M.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.551 Prot., datë 30.05.2022, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “L.Zh” PF me NIPT K.....K dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1063786, datë 30.05.2022, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti nuk ka përditësuar të dhënat për regjistrim si dhe nuk mirëmban pajisjen fiskale në gjendje pune, për të cilën janë mbajtur procesverbali i gjobës nr.294694, datë 30.05.2022, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 112 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe procesverbali i gjobës nr.294695, datë 30.05.2022 duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 122 pika 1 gërma a të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 03.06.2022. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**7. Subjekti:** “E.....i” SHPK.

**NIPT:** K.....T.

**Adresë Kryesore:** Orikum, Vlorë.

**Aktiviteti:** Prodhim, tregëti me shumicë e pakicë të artikujve industriale e ushqimorë.

**Grupi i kontrollit:** E.H, Sh.D, M.C.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.143 Prot., datë 18.02.2022, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “E.....i” SHPK me NIPT K.....T dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1079965, datë 18.02.2022, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti nuk ka kryer procedurën e fiskalizimit për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.294815, datë 18.02.2022, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 124, pika 1, gërma c të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 23.02.2022. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**8. Subjekti:** “A.B” PF.

**NIPT:** K.....Q.

**Adresë Kryesore:** Lagjia "1 Maj", Rruga "Çamëria", Pallati Nr.5, Fier.

**Aktiviteti:** Laborator Biokimik-Klinik, Ekografi abdominale, Tregtim të produkteve organike dhe suplementeve të bukurisë, Klinik estetike, Vizita Mjekësore.

**Grupi i kontrollit:** D.M, Xh.TH.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.301 Prot., datë 28.03.2022, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A.B” PF me NIPT K.....Q dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1079655, datë 28.03.2022, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.294691, datë 28.03.2022, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma a të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 29.03.2022. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklarimit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësën e konstatuar padeklaruar.

**9. Subjekti:** “Th.K” PF.

**NIPT:** L.....F.

**Adresë Kryesore:** Fshati Dhërmi Lagjia" Perivol", Himarë, Vlorë.

**Aktiviteti:** Tregti me pakicë të artikujve ushqimor, Bar-Kafe.

**Grupi i kontrollit:** E.H, Sh.D, G.B.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.420 Prot., datë 21.04.2022, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “Th.K” PF me NIPT L.....F dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1094075, datë 23.04.2022, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.307852, datë 23.04.2022, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma a të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 27.04.2022. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklarimit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësën e konstatuar padeklaruar.

**10. Subjekti:** “L.M” PF.

**NIPTi:** L.....U.

**Adresë Kryesore:** Lagjja Afrim i Ri, Rruga "Seman", banesa private Nr.3 kati i I-rë, Fier.

**Aktiviteti:** Tregtim artikujsh të ndryshëm me shumicë e pakicë, tregtim mallrash ushqimore, industrial, kancelari, materiale pastrimi, sisteme sigurie, kamera, sisteme aksesi, pjesë për makina.

**Grupi i kontrollit:** I.A, A.S, I.D.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.535 Prot., datë 24.05.2022, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit "L.M" PF me NIPT L....U dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1063870, datë 24.05.2022, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua mallrat të pashoqëruara me dokumentacion/faturë tatimore për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.309729, datë 24.05.2022, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 121, pika 1, gërma c të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 27.05.2022. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**11. Subjekti:** "M.....I" SHPK.

**NIPT:** M....F.

**Adresë Kryesore:** Rruga Elbasanit, Gener 2, Tiranë.

**Aktiviteti:** Importimin, eksportimin, blerjen, shitjen, distribuomani dhe shpërndarjen e mallrave të ndryshme farmaceutike e medicinale, kozmetike, suplemente ushqimore, ngritjen për vete dhe për të tretë të dyqaneve (farmaci), pika të shitjes së këtyre mallrave.

**Grupi i kontrollit:** A.S, R.P.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.65 Prot., datë 23.01.2023, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit "M.....I" SHPK me NIPT M....F dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1171557, datë 23.01.2023, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua mallrat të pashoqëruara me dokumentacion/faturë tatimore për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.307502, datë 23.01.2023, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 121, pika 1, gërma c të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 01.02.2023. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**12. Subjekti:** "M.B" PF.

**NIPT:** L....I.

**Adresë Kryesore:** Bulevardi "Ismail Qemali", Lagjja "Isa Boletini", Vlorë.

**Aktiviteti:** Tregti me pakicë të rrobave të përdorura.

**Grupi i kontrollit:** M.C, A.H.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës me Nr.111 Prot., datë 06.02.2023, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit "M.B" SHPK me NIPT L....I dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1135435, datë 06.02.2023, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua mallrat të pashoqëruara me dokumentacion/faturë tatimore për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.309849, datë 06.02.2023, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 121, pika 2 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 14.02.2023. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**13. Subjekti:** "E.C" PF.

**NIPT:** L....V.

**Adresë Kryesore:** Lagjja "Kongresi i Përmetit", Rruga "Jakov Xoxa", Fier.

**Aktiviteti:** Shërbime celular dhe aksesore, manikyr-pedikyr.

**Grupi i kontrollit:** I.A, E.D.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.147 Prot., datë 13.02.2023, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “E.C” SHPK me NIPT L....V dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1135096, datë 13.02.2023, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua mallrat të pashoqëruara me dokumentacion/faturë tatimore për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.309915, datë 13.02.2023, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 121, pika 1, gërma a të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 21.02.2023.. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**14. Subjekti:** “D.N” PF.**NIPT:** K.....H.**Adresë Kryesore:** Rruga "Murat Tërbaçi", Pallati Beton-Vlora, Nr.pasurie 36/107+3-N1, Zona Kadastrale 8602, 9403, Vlorë.**Aktiviteti:** Suflaë, restorant.**Grupi i kontrollit:** B.M, A.C.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.90 Prot., datë 30.01.2023, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “D.N” PF me NIPT K.....H dhe është mbajtur akt konstatimi nr.1171975, datë 30.01.2023, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti ka pasur punonjës të padeklaruar për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.294896, datë 30.01.2023, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 119, pika 1, gërma b të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 07.02.2023. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren si dhe është njoftuar Drejtoria Rajonale që i përket tatimpaguesit për vazhdimin e procedurës ligjore të ndjekjes së deklaramit të punonjësit në listpagesat e ardhshme që duhet të bëjë tatimpaguesi për punonjësën e konstatuar padeklaruar.

**15. Subjekti:** “A.L” PF.**NIPT:** L....P.**Adresë Kryesore:** Lagjja “18 Shtatori”, Gjirokastër.**Aktiviteti:** Atelier, Rrobaqepësi.**Grupi i kontrollit:** D.M, Xh.TH.

Nga auditimi i dokumentacionit ka rezultuar se në zbatim të Urdhërit të Punës Nr.718 Prot., datë 03.11.2023, grupi i punës ushtroi kontroll ndaj subjektit “A.L” PF me NIPT L....P dhe është mbajtur akt konstatimi nr.0938047, datë 04.11.2023, ku nga përshkrimi rezulton se në momentin e kontrollit u konstatua se subjekti nuk është i pajisur me certifikatë elektronike për të cilën është mbajtur procesverbali i gjobës nr.294913, datë 04.11.2023, duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 124, pika 2, gërma c të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe është hedhur në sistemin C@ts njoftim vlerësimi për detyrimet në datë 07.11.2023. Nga ana e inspektorëve është vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren.

**Sektori i Koordinimit në DVKT Rajoni Jugor.**

Aktiviteti i veprimtarisë së Sektorit të Koordinimit është drejtimi metodik dhe rakordimi i veprimtarisë së DVKT me strukturat e tjera si Drejtori Rajonale Tatimore, DPT dhe strukturat e tjera në varësi. Përgjatë periudhës objekt auditimi të viteve 2021-2023, ky sektor ka kryer ndjekjen metodike dhe ka pasqyruar veprimtarinë e DVKT Rajoni Jugor konform përcaktimeve të Kapitullit IV “Sektori i Koordinimit” të Manualit të Drejtorisë së Verifikimit



dhe Koordinimit në Terren, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr.19/2, datë 28.02.2020, pasqyruar në mënyrë të detajuar sa mësipër në veprimtarinë e DVKT RJ, konkretisht ka kryer:

- Drejtimin metodologjik të veprimtarisë së DVKT RJ në terren,
- Mbledhjen e informacioneve të verifikimeve ditore nga inspektorët e koordinimit, përpunimi statistikor për të nxjerr të dhëna analitike mbi rezultatet e arritura të kontrolleve të kryera dhe masave të marra.
- Kryerja e kontrolleve nëpërmjet verifikimeve në sistemin C@ts për çështjet e hedhura në sistem nga inspektorët e terrenit.
- Koordinim dhe bashkëpunim me strukturat e tjera si Drejtori Rajonale dhe drejtori varësi të tjera në DPT.
- Monitorime të inspektorëve nëpërmjet sistemit “E-inspektor” vetëm për vitin 2021 që ka qënë aktive marrëveshja e shërbimit e kontraktuar.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë: Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, gërma ç) dhe dh) e nenit 12, neni 127;***

***UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, gërma ç) dhe dh) e pikës 12, pika 127;***

***Manual i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr.19/2, datë 28.02.2020.***

***Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:***

*Z. A.P, me detyrë ish Drejtor i DVKT Rajoni Jugor;*

*Z. V.Ç me detyrë Drejtor i DVKT Rajoni Jugor;*

*Z. E.Gj, me detyrë Përgjegjës i DVKT Rajoni Jugor;*

Për sa më sipër me personat përgjegjës A.P, V.Ç, E.Gj.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.9418/66 Prot dhe datë 26.06.2024 “Observacion”, protokolluar në KLSH me Nr.1112/27 Prot., datë 27.06.2024, nga Z. A.P, Drejtor Rajonal i DRT Fier, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Pretendon se është vepruar konform përcaktimeve ligjore të Manual i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr.19/2, datë 28.02.2020, për rastin e konstatimit të shkeljes “Pengim Kontrolli” dhe vonesat janë shkaktuar sepse Drejtori i DRT Rajonale përkatëse që ka pasur nën juridiksion subjektin që ka kryer shkeljen, nuk e ka miratuar vendosjen e gjobës dhe mbasi është bërë kërkesë për interpretim ligjor në Drejtorin Juridike në DPT dhe mbas kthimit të përgjigjes është bërë brenda dy ditëve pune miratimi i saj. Bashkangjitur observacionit është vendosur në dispozicion gjithë korrespondenca shkresore.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - *Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, Z. P, sqarojmë se observacioni nuk e kundërshton konstatimin e grupit të auditimit mbi zgjatjet e afateve për miratimin e vendosjes së gjobës për pengim kontrolli por vetëm parashtron arsyet dhe shkaqet e ndodhjes. Gjithashtu sqarojmë se nuk janë vendosur në dispozicion fakte të reja, arsyetim ligjor dhe fiskal si dhe dokumentacion i ri justifikues që mbështesin pretendimet e inspektorit në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit, por janë vendosur të njëjtat me ato të paraqitura në fazën e projekt raportit të auditimit, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.*

## **2.4 Për vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së ekzekutimit të buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim**

-Situata lidhur me fondet buxhetore të administruar nga DRT Fier sipas planit fillestar, shtesave, pakësimeve dhe realizimit, për periudhën objekt auditimi, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2.4.1- "Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të DRT Fier"

Në lekë

Llog	VITI 2021			Buxheti i rishikuar	Realizimi i buxhetit	Diferenca	Realizimi në %
	Buxheti fillestar	Shtesa	Pakësime				
600 -Paga	125,000,000		18,932,000	106,068,000	106,067,915	-85	100%
601-Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	21,000,000		3,218,000	17,782,000	17,729,740	-52,260	100%
602 –Mallra dhe shërbime	8,000,000	960,000		8,960,000	8,057,911	-902,089	90%
606 –Transferta të brendshme		206,000		206,000	206,000	0	100%
<b>Total</b>	<b>154,000,000</b>	<b>1,166,000</b>	<b>22,150,000</b>	<b>133,016,000</b>	<b>132,061,566</b>	<b>-954,434</b>	<b>99%</b>

Llog	VITI 2022			Buxheti i rishikuar	Realizimi i buxhetit	Diferenca	Realizimi në %
	Buxheti fillestar	Shtesa	Pakësime				
600 -Paga	125,000,000		16,935,000	108,065,000	108,061,831	-3,169	100%
601-Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,000,000	1,100,000	3,050,000	18,050,000	18,048,550	-1,450	100%
602 –Mallra dhe shërbime	11,000,000	2,000,000	3,000,000	10,000,000	9,876,319	-123,681	99%
606 –Transferta të brendshme		270,000		270,000	270,000	0	100%
<b>Total</b>	<b>156,000,000</b>	<b>3,370,000</b>	<b>22,985,000</b>	<b>136,385,000</b>	<b>136,256,700</b>	<b>-128,300</b>	<b>100%</b>

Llog	VITI 2023			Buxheti i rishikuar	Realizimi i buxhetit	Diferenca	Realizimi në %
	Buxheti fillestar	Shtesa	Pakësime				
600 -Paga	108,290,000	19,350,000	-	127,640,000	125,580,563	-2,059,437	98%
601-Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	21,710,000	4,526,000	-	26,236,000	20,981,806	-5,254,194	80%
602 –Mallra dhe shërbime	11,000,000	2,000,000	-	13,000,000	12,034,653	-965,347	93%
606 –Transferta të brendshme		115,000	-	115,000	115,000	0	100%
<b>Total</b>	<b>141,000,000</b>	<b>25,991,000</b>	<b>-</b>	<b>166,991,000</b>	<b>158,712,022</b>	<b>-8,278,978</b>	<b>95%</b>

Burimi: DRT Fier

Nga sa më sipër konstatohet se buxheti i DRT Fier është kufizuar në drejtim të kryerjes së shpenzimeve për aktivitetin normal të institucionit. Konkretisht janë likuiduar shpenzimet për paga (sipas elementëve përkatës), sigurime shoqërore, transferta buxhetore dhe shërbime.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DRT nuk janë hartuar dhe nuk janë përcjellë në DPT raportet 4 mujore të buxhetit, për të dokumentuar analizat e kryera nga ana e institucionit për realizimin e fondeve, duke argumentuar për çdo rast nivelin e realizimit kundrejt planit, me qëllim identifikimin në kohë të nevojave për rialokim të fondeve. Nga ane DRT Fier janë përcjellë për çdo muaj vetëm evidencat statistikore për realizimin e shpenzimeve, të pa shoqëruara me analiza.

Nga auditimi konstatohen rishikime në nivele të konsiderueshme të fondeve përgjatë vitit (shtesa/pakësime), të cilat janë përcjellë nga DPT, për zbatim nga DRT Fier. Konkretisht, për vitin 2021, fondet e çelura fillimisht për institucionin janë pakësuar me 22,150 mijë lekë për fondet e pagave dhe sigurimeve shoqërore; si dhe janë shtuar me 1,166 mijë lekë për zërat e transfertave të brendshme buxhetore dhe mallrave e shërbimeve. Për vitin 2022, fondet e çelura fillimisht për institucionin janë shtuar me 3,370 mijë lekë dhe janë pakësuar me 22,985 mijë lekë për fondet e pagave, sigurimeve shoqërore dhe mallrave e shërbimeve. Përfundimisht për vitin 2023, në të cilin konstatohet se fondet e çelura në fillim të vitit janë dukshëm më të ulëta se buxheti i periudhave paraardhëse, dhe si rezultat, deri në fund të vitit 2023 buxheti është shtuar me 25,991 mijë lekë.

Për sa i përket llogarisë 602 për vitin 2021, mosrealizimi i saj ka ardhur si rrjedhojë e nivelit të ulët të realizimit të buxhetit të dietave. Planifikimi për këtë zë është bërë në bazë të realizimit të viteve të mëparshëm, por vlera e dietave është ndikuar nga planet operationale të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren për vitin korrent, pasi rreth 93% e vlerës së dietave të këtij viti përbëhet nga punonjësit e kësaj drejtorie. Për sa i përket llogarisë 602 për vitin 2023, niveli i ulët i realizimit saj ka ardhur si rrjedhojë e mosrealizimit të dietave, postës, blerje materiale pastrimi, etj. Planifikimi për këto zëra është bërë në bazë të realizimit të viteve të

mëparshëm, por edhe nga nevojat e institucionit në vitin korrent. Gjithashtu, për vitin 2023 janë planifikuar disa blerje me vlerë të vogël si "Blerje materiale pastrimi", "Blerje dokumentacioni", të cilat nuk janë realizuar. Gjithashtu diferencë të konsiderueshme plan - fakt ka edhe në zërin "Posta", pasi detyrimi i vitit 2023 nuk ishte aq sa planifikuar (sipas realizimit të vitit të kaluar) për këtë zë.

Për sa i përket llogarisë 600 dhe 601 për vitin 2023, planifikimi bëhet në bashkëpunim me DPT, në kushtet e një strukture të plotësuar dhe page të plotë bruto mujore. Në vijim, DPT ka bërë pakësimet apo shtesat. Në datat 19 dhe 20 Qershor 2023, DRT Fier është njoftuar me e-mail nga DPT dhe Dega e Thesarit Fier për rritjen e pagave sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetëve, prefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të nënprefektit, administratës publike" dhe VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike". Rritja ishte planifikuar të fillonte në muajin Prill 2024 dhe pagesa e diferencave duhej bërë brenda muajit Qershor 2023, dhe për këtë arsye rezultojnë diferenca në planin e alokuar nga DPT, sipas tabelës më sipër.

Struktura organizative faktike e DRT Fier, krahasuar me strukturën e miratuar, ndarë sipas pozicioneve të punës, për periudhën objekt auditimi, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.2.4.2-Viti 2021

	01.01.2021		31.12.2021	
	Numri i planifikuar i punonjësve	Numri faktik i punonjësve	Numri i planifikuar i punonjësve	Numri faktik i punonjësve
Drejtor	6	6	6	6
Përgjegjës Sektori	11	10	11	9
Specialit/Inspektor	97	84	97	92
Te tjera (Personel mbështetës)	8	8	8	8
<b>Total DRT Fier</b>	<b>122</b>	<b>108</b>	<b>122</b>	<b>115</b>

Burimi: DRT Fier

Struktura organizative e DRT Fier në fillim të vitit 2021 ka funksionuar me 108 punonjës, nga 122 të planifikuar (me 14 vakanca, që përbëjnë 11% e totalit të strukturës së miratuar), ku vakancat rezultojnë në pozicionet e 1 përgjegjësi sektori dhe 13 specialistëve/inspektorëve. Në fund të vitit 2021 struktura paraqitet me 115 punonjës, (me 7 vakanca, që përbëjnë 6% e totalit të strukturës së miratuar) përkatësisht në pozicionet e 2 përgjegjësve të sektorëve dhe 5 specialistëve/inspektorëve.

Tabela nr.2.4.3-Viti 2022

	01.01.2022		31.12.2022	
	Numri i punonjësve te planifikuar	Numri i punonjësve fakt	Numri i punonjësve te planifikuar	Numri i punonjësve ve fakt
Drejtor	6	6	6	6
Përgjegjës Sektori	11	9	11	9
Specialit/Inspektor	97	92	97	87
Te tjera (Personel mbështetës)	8	8	8	8
<b>Total DRT Fier</b>	<b>122</b>	<b>115</b>	<b>122</b>	<b>110</b>

Burimi: DRT Fier

Struktura organizative e DRT Fier deri në fund të vitit 2022 rezulton të ketë funksionuar me 110 punonjës, nga 122 të planifikuar (me 12 vakanca, që përbëjnë 10% e totalit të strukturës së miratuar), me vakanca në pozicionet e 2 përgjegjësve të sektorëve dhe 10 specialistëve/inspektorëve.

Tabela nr.2.4.4-Viti 2023

	01.01.2023		31.12.2023	
	Numri i punonjësve te planifikuar	Numri i punonjësve fakt	Numri i punonjësve te planifikuar	Numri i punonjësve ve fakt
Drejtor	6	6	6	6
Përgjegjës Sektori	11	9	11	9

Specialit/Inspektor	97	86	97	83
Te tjera (Personel mbështetës)	8	8	8	7
<b>Total DRT Fier</b>	<b>122</b>	<b>109</b>	<b>122</b>	<b>105</b>

Burimi: DRT Fier

Struktura organizative e DRT Fier, deri në fund të vitit 2023 rezulton të ketë funksionuar me 105 punonjës, nga 122 të planifikuar (me 17 vakanca, që përbejnë 14% e totalit të strukturës së miratuar), me vakanca në pozicionet e 2 përgjegjëseve të sektorëve, 14 specialistëve/inspektorëve dhe 1 vakancë në personelin mbështetës.

Nga auditimi konstatohet se angazhimi i DRT Fier për plotësimin e vakancave të institucionit, nëpërmjet komunikimit me DPT, është kufizuar vetëm në 2 komunikime (shkresën për plotësimin e tyre në DPT nr.8738, prot datë 17.06.2021 dhe email datë 28.12.2021) përgjatë harkut 3 vjeçar të periudhës objekt auditimi, pavarësisht se numri i lartë i vakancave konsiderohet një faktor që përbën risk të shtuar mbi performancën institucionale. Deri në përfundim të auditimit nuk u përcoll informacioni mbi çështjet gjyqësore në proces, vendimeve gjyqësore për ish punonjës të larguar nga puna, delegimet e kryera për periudhën objekt auditimi, apo konfirmimit se nuk ka patur procedura delegimi, në kundërshtim me percaktimet e Nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" te Ligjit Nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake; e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.", pavarësisht se grupi i auditimit kërkoi informacion për këto çështje sipas kërkesës me e-mail datë 11.01.2024, dhe 21.02.2024 tek z. J.G, në cilësinë e personit të kontaktit në DRT Fier.

Grupi i auditimit shqyrtoi Urdhrat e Brendshëm të Drejtorit Rajonal të DRT Fier, z. A.P, me nr. 13304 dhe 13304/1 , prot DRT Fier datë 07.10.2022, nëpërmjet të cilëve është urdhëruar, konkretisht:

-Me urdhrin nr. 13304, prot DRT Fier datë 07.10.2022 për shkak të numrit të shtuar të vizitave fiskale, mbylljes së kontrolleve në afatet e përcaktuara dhe në pamundësi për t'i ezauruar me numrin aktual të inspektorëve dhe të detyrave specifike të ngarkuara për Sektorin e Kontrollit në Vend në DRT Fier, është urdhëruar angazhimi deri në një moment të dytë të inspektorit z. A.K, me detyrë inspektor i parë në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë detyrat e inspektorit të Sektorit të Kontrollit Operacional në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

-Me urdhrin nr. 13304/1, prot DRT Fier datë 07.10.2022 për shkak të numrit të shtuar të vizitave fiskale, mbylljes së kontrolleve në afatet e përcaktuara dhe në pamundësi për t'i ezauruar me numrin aktual të inspektorëve dhe të detyrave specifike të ngarkuara për Sektorin e Kontrollit në Vend në DRT Fier, është urdhëruar angazhimi deri në një moment të dytë të inspektorit z. E.F me detyrë inspektor i parë në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë detyrat e inspektorit të Sektorit të Kontrollit Operacional në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

Në urdhrat e mësipërm konstatohet se nuk është përcaktuar periudha kohore gjatë të cilës do të jenë të vlefshme këto transferime, dhe baza ligjore apo rregullatorë në të cilat janë mbështetur këto urdhra.

Nga auditimi konstatohet se angazhimi i punonjësve të DRT Fier në detyra të tjera funksionale, është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve në zbatim të ligjit 9920 datë

19.05.2008 "Për procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore, sikundër është vepruar me urdhrin nr. 43, prot datë 12.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, z. C.K, ku është urdhëruar ushtrimi i detyrave funksionale të inspektorit të dytë në Sektorin e Kontrollit në Vend pranë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Fier, për punonjës in z. Sh.N, i cili ishte aktualisht në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

**Këto urdhra të titullarit të DRT Fier, z. A.P, rezultojnë të pa mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përmbajnë riskun për të ndikuar në keqfunksionimin dhe performancën e dobët të institucionit,** veprim ky në kundërshtim me Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, Pika 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 "Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore".

*Për sa më sipër mban përgjegjësi z. A.P, me detyrë Drejtor Rajonal i DRT Fier.*

Për sa trajtuar në këtë raport është paraqitur observacioni me nr.1112/29 prot., datë 27.06.2024 "Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr.1112/18 prot, datë 29.05.2024", referuar gjetjeve lidhur me mosrealizimin e të ardhurave, nga Z. A.P, Drejtor Rajonal, pranë DRT Fier ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** DRT Fier ka komunikuar vazhdimisht me DPT për plotësimin e vakancave, edhe pse DPT e disponon këtë informacion në cilësinë e institucionit punëdhënës dhe epror vendimmarrës. Për sa më sipër ju vëmë në dispozicion shkresat dhe email e nisur në DPT . Lidhur me urdhrat për transferimin e përkohshëm të punonjësve nga DRT Fier sqarojmë se u zgjodhën 2 inspektorë brenda të njëjtës drejtori, për të ndihmuar në uljen e stokut të madh të kontrolleve dhe kalimin e afateve ligjore. DRT Fier është institucion varësie dhe raporton në DPT çdo muaj mbi realizimin e shpenzimeve. Plani operacional që hartohet nga DRT Fier i përcillet DPT.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Sqarojmë se evidencat e vendosura në dispozicion lidhur me plotësimin e vakancave janë paraqitur në projekt raportin dhe raportin e hartuar nga grupi i auditimit. Lidhur me urdhrat për transferimin e punonjësve të Drejtorit Rajonal të DRT Fier sqarojmë se kompetenca për kryerjen e emërimeve/transferimeve të punonjësve është kompetencë vetëm e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT. Për sa i përket procedurave të ndjekura lidhur me raportimin e shpenzimeve dhe planet operative, nuk u vendosën në dispozicion fakte apo evidence të reja nga sa trajtuar në projektraport.

#### **IV. REKOMANDIME**

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021, pavarësisht se të ardhurat bruto dhe neto nga tatimet në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Fier paraqiten me një nivel realizimi mbi planin e të ardhurave, konstatohet një mosrealizim në masën -12% në të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore, shtuar këtu faktin se plani i miratuar për këtë zë rezulton në ulje krahasuar me realizimin e vitit 2020. E njëjta situatë rezulton edhe për vitin 2023, ku konstatohet mos realizim për këtë zë në masën - 1% , krahasimisht me planin e rishikuar. Nga ana e DRT Fier konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë për arsytet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri.

Ndërsa për vitin 2022, konstatohet se realizimi i të ardhurave mbi nivelin e planifikuar vjen kryesisht si efekt i realizimit të TVSH-së, nga ku konstatohet se niveli i planifikimit për këtë

zë rezulton në rënie në masën - 2% krahasuar me realizimin e vitit 2021. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin paraqiten me mosrealizim kundrejt planit të rishikuar dhe nga ana e DRT Fier nuk janë kryer analiza për këtë qëllim.

Për vitin 2023, konstatohet mosrealizim i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën – 2%, ku konstatohet se nuk janë kryer analiza nga ana e DRT Fier për arsye të kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre zërave.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-23 të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtori i Drejtorisë e Rajonale Tatimore Fier të analizojë faktorët të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas zërave, veçanërisht për llojet e tatimeve që rezultojnë me mos realizim referuar subjekteve që operojnë nën juridiksionin e DRT Fier, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse në funksion të arritjes së objektivave institucionale për rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të plotësimit të strukturës së DRT Fier, pasi konstatohen 105 punonjës nga 122 të planifikuar, pra me një numër të konsiderueshëm vakancash prej 17 pozicioneve: 2 pozicione përgjegjës sektori, 14 specialist dhe 1 personel mbështetës, situatë kjo që mbart riskun për të cenuar përmbushjen me sukses të detyrave funksionale të drejtorisë. Nga ana e tjetër, mund të shfaqin mangësi në hartimin e strukturës organike me një numër të panevojshëm të punonjësve për plotësimin e detyrave të DRT-së. Nga verifikimi i angazhimit të DRT Fier për plotësimin e vakancave, konstatohet se në harkun 3 vjeçar të periudhës objekt auditimi, ka patur vetëm dy korrespondenca gjatë vitit 2021 me DPT për plotësimin e tyre, duke reflektuar kështu një rol pasiv të DRT Fier në zgjidhjen e këtij problemi.

Deri në përfundim të auditimit nuk është vënë në dispozicion informacion mbi çështjet gjyqësore në proces apo vendimeve gjyqësore për ish punonjës të larguar nga puna; për delegimet e kryera për periudhën objekt auditimi, apo konfirmimit se nuk ka patur procedura delegimi, edhe pas kërkesave dhe rikujtesave të vazhdueshme nga ana e grupit të auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 154-158 të Raportit të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtori i DRT Fier, në bashkëpunim me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara, në kuadër të mbarëvajtjes së punës dhe përmirësimin e performancës institucionale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 30% DRT me 70% të rasteve nga DPT, duke ndikuar negativisht në rezultatin e inspektimeve. Konkretisht, për vitin 2021 janë realizuar 216 programe kontrolli në vend, nga të cilat vetëm 26% janë propozuar nga DRT; për vitin 2022 janë realizuar 252 programe kontrolli në vend, nga të cilat 24 % janë propozuar nga DRT Fier; dhe për vitin 2023 janë realizuar 271 programe kontrolli në vend, nga të cilat vetëm 16 % janë propozuar nga DRT.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet në Manualin e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ( Tetor 2018 dhe atë të rishikuar Dhjetor 2022).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve në masën 30% të propozimeve nga

DRT, duke trajtuar e dokumentuar me përparësi në përzgjedhje subjektet që mbartin realisht risk.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT) Rajoni Jugor për periudhën 2021-2023, në drejtim të eficiencës së kësaj strukture, është konstatuar se shpenzimet për pagat janë në vlerë më të lartë se detyrimet tatimore të zbuluara. Në vitin 2021 për çdo 1 lek shkelje janë harxhuar 2.39 lekë shpenzime për paga, 1.52 për vitin 2022 dhe 1.78 për vitin 2023.

Nga analiza e mësipërme arrihet në konkluzionin se DVKT Rajoni Jugor përgjatë periudhës objekt auditimi 2021-2023, ka shfaqur mungesë efience edhe për shkak të mos shfrytëzimit të plotë të kohës së punës, si pasojë e shpërndarjes normale të planeve të punës të ardhur nga DVKT në DPT, si dhe nga mungesa e analizës së riskut të subjekteve për verifikim sipas planeve të punës. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e germave “ç” dhe “dh” të neni 12 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 135-154 të Raportit të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** DVKT Rajoni Jugor, të koordinojë me DPT, me qëllim planifikimin sa më efektiv të subjekteve për kontroll sipas analizës së riskut, si dhe hartimin e planeve të punës me shpërndarje gjithëvjetore dhe organizmin sa më racional të grupeve të punës në terren, me qëllim që DVKT Rajoni Jugor, të operojë në kushte efience dhe efektiviteti.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i akt-konstatimeve, procesverbaleve të gjobave dhe të dhënave të pasqyruara në sistemin C@TS, për kontrollin e kryera nga inspektorët e DVKT Rajoni Jugor në subjektet “A..A” SHPK dhe “A.Q” PF, të cilat kanë penguar kryerjen e kontrollit nga DRT Fier, është konstatuar shkelje e afateve procedurale dhe një vonesë prej 7 muajsh në miratimin e gjobës përkatëse nga Drejtori i DVKT, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 127, pika 2 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Manualin e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtori i Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor të zbatojë me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për të siguruar trajtim të barabartë të subjekteve tatimpaguese dhe ndëshkimin e shkelësve të ligjit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të kontrollit tatimor: të projekt raportit dhe raportit përfundimtar, nga ana e inspektorëve të kontrollit në vend në 18 tatimpagues u konstatuan problematika si më poshtë:

- Në 12 raste Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike.
- Në 9 raste Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet administrative për hartimin dhe dërgimin e projekt raportit dhe

raportit përfundimtar të kontrollit tatimor tek tatimpaguesit objekt kontrolli, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “D...a” SHPK gjatë fazës në terren nga auditimi i të dhënave sipas sistemit C@ts, konkretisht inventarit kontabël të deklaruar në anekset e BK 2019 krahasuar me analizën e bilancit material të kryer nga inspektori i kontrollit në raport, rezultojnë diferenca. Nga administratori i shoqërisë, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare dhe për mbajtjen e kontabilitetit të shoqërisë konform standardeve të kontabilitetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është vendosur në dispozicion inventari fizik i firmosur dhe vulosur, si dhe mbështetur me analizën e kryer, ku rakordon gjendja 01.01.2020 + blerjet – shitjet me gjendjen e inventarit 31.12.2020. Referuar dokumentacionit të ri justifikues të vendosur në dispozicion, rezulton se diferencat e konstatuara në inventarin fizik me atë kontabël, vijnë si pasojë e deklarimit të pasaktë të inventarit në sistemin C@ts nga ana e subjektit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**7.1. Rekomandimi:** DRT Fier, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, , të administrojë “Inventarin fizik” të saktë të vitit 2019 për tatimpaguesin “D...a” SHPK, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e bilancit material, sipas raportit të kontrollit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport kontrolleve tatimore është konstatuar se nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk është hartuar informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e mjeteve monetare të cilat pretendohet se kanë kaluar si huadhënie nga ortaku drejt shoqërisë në rastet e kontrolleve në subjektet “C...o” SHPK, “L.C” SHPK dhe “G.....A” SHPK, veprime të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar, neni 18.1, si dhe UMF nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**8.1. Rekomandimi:** DRT Fier në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrolleve të kryera në subjektet “C...o” SHPK, “L.....n” SHPK dhe “G.....A” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport kontrolleve tatimore të subjekteve “A...4” SHPK, “L.....C” SHPK, “S...A” SHPK, “F...M” SHPK dhe “G.B” SHPK, është konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin nr. 1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe Manualin nr. 2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, duke i krahasuar me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu, është konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 1 datë, 16.06.2011.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*



**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë Ligjore dhe Teknike dhe Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një metodologjie apo një manuali udhëzues, për të përcaktuar çështjet që duhet të jenë pjesë e verifikimeve të punimeve të kryera, në subjektet e fushës së ndërtimit, me qëllim standardizimin e akt konstatimit të inxhinierit të ndërtimit, si pjesë integrale e raport kontrollit tatimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Subjekti “S.....07” SHPK përgjatë periudhës së auditimit ka qenë objekt kontrolli në vend nga DRT Fier, në bazë të programit të kontrollit të vizitës fiskale, në të cilin konstatohet se nuk janë përfshirë si drejtime kontrolli përgjegjësia tatimore e TVSH-së dhe TF-së. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të këtij subjekti lidhur me nëndeklarimin e pagave reale të punonjësve, konstatohet se nuk është kryer rivlerësimi i situatës financiare, për të rikarakterizuar si të ardhura shpenzimet e fondit të pagave të rivlerësuara, në vlerën 4,655,753 lekë, referuar faktit se subjekti ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara, si dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me germën “b”, “c” të nenit 71, gërma “a”, “b” të nenit 72 dhe penalizim sipas përcaktimeve të nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të propozojë për kontroll të thelluar tatimpaguesin “S.....07” SHPK, për periudhën 01/2021-12/2021, ku të përfshihet përgjegjësia tatimore e TVSH dhe Tatim Fitimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport kontrollit të subjektit “G.B” SHPK, u konstatua se referuar çmimeve të shitjes të njërive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim tek objekti i shoqërisë “*Godinë e kombinuar 11 kate + 1 katë nëntokë*”, Lagjja “Apollonia”, Fier, rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të qytetit të Fierit, të përcaktuar në VKM nr. 168, datë 27.3.2019 për 33 kontrata.

Nga shqyrtimi i Lejes së Ndërtimit miratuar me Vendimin e KRRT Fier nr. 3, datë 29.09.2011, me afat deri në 30.01.2014, Lejes së Legalizimit nr. 2903079, datë 27.12.2019, kontratave të porosisë, kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme dhe faturave tatimore, rezulton se subjekti përpara daljes së lejes së legalizimit, në kushtet e masës së bllokimit të transaksioneve të shitjes si pasojë e procesit të legalizimit, ka lidhur kontrata premtimi/shitje të pasurive të paluajtshme në të ardhmen, ku janë përcaktuar modalitetet e pagesave më këste. Pagesa e fundit është kryer në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes duke lëshuar dhe faturën tatimore sipas saj. Nga analiza e rrethanave të transaksioneve vlerësohet se njëësia ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, në momentin e kalimit të titullit të pronësisë. Efektet e këtyre transaksioneve fillojnë në momentin e nënshkrimit të kontratave të porosisë, që janë përpara daljes së lejes së legalizimit dhe regjistrimit të objektit në ZVRRP, si dhe përpara fillimit të efekteve të VKM nr. 168, datë 27.3.2019, dhe shtrihen deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes dhe kalimit të titullit të pronësisë tek blerësi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të analizojë dhe verifikojë 33 kontratat e porosisë dhe të shitjes përfundimtare tek objekti “*Godinë e kombinuar 11 kate + 1 katë nëntokë, Lagjja Apollonia, Fier*”, i shoqërisë “G.B”, si dhe të kërkojë nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore në DPT interpretim ligjor dhe fiskal për vlerësim tatimor në lidhje me çmimet mesatare referuese të shitjes në kontratat e porosisë të nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të

VKM nr. 168, datë 27.3.2019, kur objekti ndërtimor ka qenë në proces legalizimi për shtesat pa leje.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt marrëveshjeve me këste të likuidimit të detyrimeve të papaguara, konstatohet se në kërkesat e tatimpaguesve mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit, që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes, sikundër përcakton neni 77 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzuesi i përgjithshëm të procedurave të mbledhjes me forcë, datë 15.03.2018 pika 10. Nga ana e DRT Fier nuk dokumentohet analiza e pasqyrave financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet, etj, duke mos respektuar pikën 5.8 “Marrëveshjet për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara” të Manualit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

Për periudhën objekt auditimi rezultojnë 21 subjekte, për të cilat janë lidhur akt marrëveshje si një mjet për mos aplikimin e masave të tjera shtrënguese pas përfundimit të afatit për marrëveshjet ekzistuese, të pa argumentuara me dokumentacione suportuese që mund të mbështesin përsëritjen e akt marrëveshjes, pavarësisht historikut të saj. Për 12 subjekte akt marrëveshjet janë përsëritur pavarësisht se akt marrëveshjet paraardhëse janë prishur për shkak të mos respektimit të kriterëve të vendosura dhe kanë rezultuar me një vlerë detyrimi të papaguar prej 33,791 mijë lekë, nga të cilat për 5 prej tyre edhe akt marrëveshja pasuese rezulton gjithashtu e prishur sërish për shkak të mos respektimit të afatit. Për 3 subjekte marrëveshjet janë përsëritur, pavarësisht se marrëveshjet paraardhëse të lidhura janë prishur me kërkesë të subjekteve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**12.1. Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DRT Fier të përforcojnë procedurat aktuale të ndjekura për monitorimin e akt marrëveshjeve aktive në drejtim të vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitorë, si dhe të marrin masat për dokumentimin e analizave përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjes së tyre, si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese .

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i të dhënave lidhur me deklarin e importeve dhe eksporteve që rezultojnë nga autoriteti tatimor (DRT Fier) krahasuar me të dhënat që rezultojnë të raportuara nga autoriteti doganor (DPD), sipas situatës financiare të TVSH-së, librat e blerjes dhe të shitjes, me të dhënat e deklaruara sipas doganës, janë konstatuar diferenca në të dy kahet. Sipas verifikimit të komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit lidhur me diferencat në import për vitin 2021 dhe 2022, konstatohet se në 15 raste (**43%**) diferenca ka ardhur për shkak të mos rakordimit të sistemit në dogana me atë në tatime, për të pasqyruar të gjitha deklaratat doganore të tatimpaguesit në periudhat e duhura; 6 raste (17%) janë importe të përjashtuara; 5 raste (14%) subjektet kanë kaluar në kontroll; në 5 raste (14%) subjekti ka qenë pa përgjegjësi TVSH për periudhën; dhe 3 në raste (9%) diferencat janë sistemuar gjatë auditimit. Lidhur me diferencat në eksport për vitin 2021 dhe 2022 konstatohet se në 49 raste (33%) diferenca ka ardhur pasi subjekti ka qenë fason, dhe në eksport vlerës së mallit i shtohet edhe haku i punës; 40 raste (27%) diferenca ka ardhur për shkak të mos rakordimit të sistemit në dogana me atë në tatime, për të pasqyruar të gjitha deklaratat doganore të tatimpaguesit në periudhat e duhura; 26 raste (18%) subjektet kanë kaluar në kontroll; në 14 raste (9%) diferenca vjen për shkak të shitjeve të përjashtuara; respektivisht me nga 5 raste (3%) diferenca ka ardhur për shkak të kursit të këmbimit; subjekti ka qenë pa përgjegjësi TVSH për periudhën; janë sistemuar gjatë auditimit; 1 rast (1) subjekti është çregjistruar nga TVSH;

në 2 raste (1%) diferenca ka qenë paradhënie e subjektit dhe 1 rast (1%) diferenca është ambalazh i kthyer pas.

Pra, diferencat që kanë lindur mes dy deklarimeve, konstatohet se janë verifikuar dhe analizuar nga inspektorët përkatës për të gjitha rastet duke identifikuar dhe shkaqet përkatëse, të cilat konsistojnë në mangësitë e raportimit nga ana e autoritetit doganor të të gjitha deklaratave doganore të tatimpaguesve, të cilat faktikisht nga DRT Fier janë administruar dhe janë verifikuar sipas informacionit vendosur në dispozicion. Ky fenomen konstatohet se shkaktohet nga mungesa e koordinimit në sistemet tatimore dhe doganore, duke përberë kështu një risk për ekzistencën e një anomalie të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD, problematikë kjo e pa dokumentuar në korrespondencat mes DRT Fier dhe DPT, pavarësisht se pasohet me një angazhim shtesë të inspektorëve të zyrës për analizimin e diferencave, që faktikisht rezultojnë të justifikuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat për përcjelljen e kësaj problematike pranë DPT, ku strukturat përgjegjëse pranë DPT-në, në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme mes deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklarim dhe për të fokusuar punën e inspektorëve të kontrollit të zyrës në diferenca që mund të përbëjnë realisht risk, dhe jo atyre që vijnë vetëm si shkak të raportimit të gabuar të të dhënave sipas sistemeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit u konstatua se urdhri nr. 13304, prot DRT Fier datë 07.10.2022 dhe nr. 13304/1, prot DRT Fier datë 07.10.2022 i Drejtorit Rajonal të DRT Fier për angazhimin e dy inspektorëve emëruar në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, për të kryer detyrat e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, janë hartuar pa përcaktuar periudhën kohore gjatë të cilës do të jenë të vlefshme këto transferime, dhe kanë patur efekt deri në përfundim të periudhës objekt auditimi. Këto urdhra rezultojnë të pa mbështetura në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, pasi angazhimi i punonjësve në sistemin tatimor në detyra të tjera funksionale nga sa përcakton emërimi i tyre, është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe kjo situatë përmban riskun për të ndikuar në keqfunksionimin dhe performancën e dobët të institucionit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore, si dhe përcaktimet ligjore të Seksionit 3, neni 107, 108, 109 dhe 114 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 154-158 të Raportit të Auditimit)*

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për verifikimin e pasojave ekonomike administrative ligjore me efekte në të ardhurat tatimore në Buxhetin e Shtetit që kanë lindur si pasojë e veprimeve të kryera pas nxjerrjes së aktit administrativ të kundërligjshëm sipas urdhrave të mësipërm, gjatë periudhës dhe fushës materiale që ka mbuluar akti administrativ, si dhe të marrë masat për eliminimin e këtyre veprimeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i afateve të pagesave të kësteve të tatim fitimit, konstatohet se sistemi C@ts për këtë proces është dizenuar në një mënyrë të tillë që pagesa e tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, pavarësisht periudhës për të cilën po kryhet likuidimi. Si rezultat, në rastet kur subjektet janë penalizuar njëherë për

mos pagesë në vonesë të kështit, në momentin e likuidimit të kështit pasardhës, kjo pagesë do të shkojë për mbulimin e detyrimit të parë; dhe për periudhën që ai po kryhen në kohë pagesën, do të rezultojë sërish me vonesë dhe do të jetë objekt penalizmi. Përjashtim këtu bëjnë rastet kur pagesa do të mbulojë kështet e të dyja periudhave. I njëjti fenomen rezulton edhe për rastet kur kryhen rivlerësime të kësteve nga tatimpaguesit. Rivlerësimi i kësteve të tatim fitimit nuk pasqyrohet në sistemin C@TS, sipas akt-vlerësimeve të mbajtura nga inspektorët përgjegjës për çdo tatimpagues, dhe si rezultat ky dokumentacion administrohet nga vetë sektori nëpërmjet shkresave përkatëse fizike. Si rezultat, ky proces rezulton të jetë subjektiv, dhe me vështirësi për tu monitoruar lidhur me saktësinë e vlerësimit të kërkesës për korrektim të kështit, dhe transparencës apo standardizimit të këtij procesi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**15.1. Rekomandimi:** DPT të marrë masat për të vlerësuar zgjidhje optimale në sistemin C@TS me qëllim zgjidhjen e problematikave të trajtuara më sipër në drejtim të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë kështet e parapagimeve të tatim fitimit apo të pagesës për kështin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve, apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës.

*Brenda vitit 2024*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i diferencave midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, për periudhën objekt auditimi, për vitin 2021 rezultuan 128 subjekte të cilat kishin qarkullimin sipas deklaratës së TVSH-së më të lartë se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 1,318,954,763 lekë, dhe 520 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të ulët se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën -2,519,445,795 lekë; për vitin 2022 rezultuan 149 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të lartë se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 7,223,225,050 lekë; dhe 655 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të ulët se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën -4,254,899,709 lekë. Nga auditimi konstatohet se, sipas komenteve të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier, diferencat në deklaratat e TVSH dhe TF vijnë si rezultat ndryshim i përgjegjësisë tatimore (subjekti nuk ka qenë objekt deklarimi i TVSH-së; 31% subjekti ka qenë objekt pagese TFTH dhe më pas ka kaluar TF, etj); 30% arkëtime në avancë; 9% të ardhura nga grantet; 8% subjektet kanë kaluar kontroll të plotë; 5% të ardhura të shtyra; 4% të ardhura të tjera; 3% iniciuar kontroll; 3% kaluar akt vlerësim nga zyra; 2% OJF; me nga 1% paraqiten autongarkesë në shitje; propozuar për kontroll; fason, të ardhura nga kursi i këmbimit, transaksione bankare; sisteme pas kontrollit të KLSH-së, në 3%, pra duke pasqyruar mangësi në drejtim të përmbushjes së detyrimit për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, për periudhën objekt auditimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për të shqyrtuar diferencat e mësipërme midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se nga ana e DRT Fier nuk janë hartuar dhe nuk janë përcjellë në DPT raportet periodike të zbatimit të buxhetit, duke u kufizuar vetëm në përcjelljen për çdo muaj të evidencave statistikore për nivelin e realizimit të shpenzimeve, të pa shoqëruara me analiza për realizimin e fondeve dhe për të argumentuar për çdo rast nivelin e realizimit kundrejt planit, me qëllim identifikimin në kohë të nevojave për rialokim të fondeve, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika VI.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 154-158 të Raportit të Auditimit)*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të përmirësojë procedurat aktuale të zbatimit të buxhetit, duke hartuar raporte të monitorimit që përfshijnë krahas evidencave statistikore për nivelin e realizimit, edhe analizat e treguesve nga planifikimi buxhetor deri në realizim, në kuadër të përmirësimit të procedurave të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

*Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se angazhimi i inspektoreve të kontrollit nga zyra dhe monitorimit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale është mbështetur në plane mujore, të pa konsoliduara në hartimin dhe miratimin e një plani vjetor apo mujor mbi aktivitetin e sektorit, duke evidentuar kështu mangësi që përbëjnë një risk për menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore për arritjen e objektivave nga hallkat mbikëqyrëse. Nga auditimi konstatohet se një plan i tillë nuk është hartuar si në nivel Drejtorie Kontrolli, ashtu edhe në nivel institucional.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**18.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat për hartimin e planeve vjetore të punës në rang institucional dhe në nivel drejtorie/sektori, me qëllim përcaktimin e objektivave kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore në funksion të mbarëvajtjes normale të punës.

*Brenda vitit 2024*

**19. Gjetje nga auditimi:** Informacioni i diferencave në qarkullim midis xhiros së korrigjuar të kasës (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së konstatohet se është kërkuar në fillim të auditimit dhe pas kërkesave dhe rikujtueseve të vazhdueshme, është përcjellë me komentet e inspektorëve në datën 25.05.2024, pra 1 ditë para përfundimit të fazës së auditimit në terren duke u kufizuar kështu auditimin në këtë drejtim. Për vitin 2021 rezultuan 67 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e FDP e TVSH-së; për vitin 2022 rezultuan 216 subjekte dhe për vitin 2023 rezultuan 121 subjekte.

-Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 në 58% të rasteve diferenca ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të përgjegjësisë përgjatë vitit; në 15% diferencat janë sistemuar pas kontrollit; 11% subjekti ka kaluar kontroll; 5% fatura të korrigjuara dhe të refuzuara nga bashkitë; dhe respektivisht 2% janë diferenca nga kursi këmbimit; dublikimin i xhiros të pasqyra mujore; fature të dublikuar e anuluar; karburant, dublikim i kuponave të shitjes; shitje me fiskalizim dhe një pjesë me dëftesë tatimore; transferuar. Për vitin 2022 në 37% të rasteve subjektit i ka ndryshuar përgjegjësia përgjatë vitit; 23% dublikim fature; 13% diferencat janë sistemuar; 9% karburant; 6% anulime; 2% kanë kaluar për kontroll; 2% autofatura; 1% kurse këmbimi; fason; fatura doganore; faturë të refuzuara; komisione; taksa; subjekti është transferuar. Për vitin 2023 në 39% të rasteve subjekti ka qenë pa përgjegjësi tatimore për periudhën, dhe i ka ndryshuar përgjegjësia përgjatë vitit; 28% janë sistemuar; 16% karburant; 8% janë anuluar; 5% dublikim fature; 1% janë autongarkesa; fason; faturë dogane; të ardhura nga komisione; transferim asetesh. Janë sistemuar pas kërkesës së grupit të auditimit diferenca të vitit 2021 në vlerën 16,443,265 lekë, 2022 në vlerën 34,965,595 lekë dhe 2023 në vlerën 31,219,082 lekë, duke

nxjerrë kështu në pah mangësitë për sistemimin e tyre në kohë nga ana e inspektorëve përgjatë punë për verifikimin e tyre dhe përcjelljes së kërkesave për informacion pranë tatimpaguesve. -Nga auditimi konstatohen mangësi në drejtim të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për verifikimin dhe monitorimin e diferencave që paraqiten si autofatura, dublikim faturash, anulimeve të shpeshta të faturave për punime ndërtimore në sektorin publik apo privat, të cilat përbëjnë risk të shtuar dhe përbëjnë arsye për kontroll të thelluar në terren. Gjithashtu, konstatohen 4 raste ku subjektet kanë korrigjuar faturat duke paraqitur si argument refuzimin e shërbimeve/mallrave nga bashkitë, situatë kjo që përbën risk për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, objekt verifikimi në vend.

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra nuk dokumentohet verifikimi i kryer në raportet e kontrollit në vend, për subjektet ku janë konstatuar diferenca dhe është propozuar kryerja e kontrollit nga sektori përkatës, me qëllim garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë në argumentimin e tyre, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit nga Zyra, Dhjetor 2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**19.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masat e duhura administrative për të shqyrtuar diferencat midis xhiros së korrigjuar të kasës (për vitin 2021), CPCM (për vitin 2022 dhe 2023) dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së, duke intensifikuar vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe propozimeve pranë Sektorit të Kontrollit në Vend në DRT Fier për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

- Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë DRT Fier të marrë masat për të intensifikuar propozimet për kryerjen e kontrolleve në vend për subjektet që rezultojnë me diferenca të xhiros për shkak të duplikimeve, anulimeve, korrigjimeve të faturave, dhe veçanërisht rasteve kur paraqitet si argument refuzimi i shërbimeve/mallrave nga bashkitë, situatë kjo që përbën risk për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, objekt verifikimi në vend.

- Inspektorët e kontrollit nga zyra të marrin masat për dokumentimin e vlerësimit të konstatimeve dhe rezultateve të kontrollit në vend të kryer pranë subjekteve të cilat janë propozuar për kontroll, me qëllim garantimin e evidentimit dhe problematikave në raportet e kontrollit, për të finalizuar procedurat monitoruese, pa u kufizuar vetëm në propozimin për kontroll të plotë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit në vend pranë DRT Fier, u konstatuan mangësi të tilla si:

- Nga inspektori i kontrollit nuk është trajtuar karta teknologjike për materialet e konsumuara.

-Nuk është kryer ndarja e shitjeve me pakicë nga ato me shumicë, edhe pse zënë një volum të konsiderueshëm të qarkullimit.

- Nuk është zbatuar manuali i kontrollit tatimor në vend duke mos mbajtur procesverbalet para fillimit të kontrollit, të cilat duhet të bashkëngjiten në dosjen e subjektit, si dhe të ngarkohen në sistemin C@ts, kjo në kundërshtim me kapitullin II, pika 2.2 të manualit të kontrollit tatimor.

- Nuk është kryer një analizë e qartë dhe përmbledhëse duke ju referuar rregullave të riskut të thyera, si dhe mangësitë e cituara në shkresën referuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

- Nuk është kryer analiza e bilancit material për periudhat përkatëse, dhe nuk janë kryer analizat financiare të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut.

- Nuk është analizuar normativa e konsumimit të karburantit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**20.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të merren masa që çështjet e trajtuara më sipër të përfshihen në raportet e subjekteve objekt kontrolli në vend, konform përcaktimeve ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë aktuale kontrolluese.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikës së rimbursimit për subjektin “A.....j” me NIPT “L.....S”, rezulton se nga shqyrtimi i Bilancit për periudhën ushtrimore 2020 në sistemin C@ts, konkretisht Pasqyra e Pozicionit Financiar, në Pasiv paraqiten Detyrimet Afatshkurtra, llogaria “*Të pagueshme ndaj furnitorëve*” paraqitet në vlerën 52,222,461 lekë, shumë e cila ka ardhur në rritje krahasuar me vlerën e paraqitur në vitin 2019 prej 31,821,234 lekë. Diferenca në rritje është në shumën 20,401,227 lekë. Nga ana e Inspektorit të Kontrollit nga Zyra, në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk është analizuar pjesa e detyrimeve afatshkurtra të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në Pasiv, si edhe faktin që këto detyrime kanë ardhur në rritje. Gjithashtu nuk është analizuar dhe përshkruar analitikisht përbërja e detyrimeve afatshkurtra për të cilat subjekti ka ndaj të tretëve ku blerjet janë kryesisht fruta perime nga fermerë vendas. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 “*Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar*”, neni nr.9 .

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**21.1 Rekomandimi:** DRT Fier, për tatimpaguesin “A.....j”, për të cilin janë konstatuar mangësi në procedurën e rimbursimit duke mos analizuar në mënyrë shteruese situatën e blerjeve nga fermerët në raport me shumën e detyrimeve afatshkurtra të paraqitura në Pasqyrat Financiare për periudhën objekt rimbursimi, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të propozojë për kontroll të thelluar subjektin.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “I.F” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

Ekzistojnë mosrakovime të gjendjes së inventarit në vlerën 13,022,034 lekë për vitin 2020 dhe 12,789,464 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë trajtuar si shitje pa faturë, dhe diferencat e konstatuara për vitin 2021, si blerje mallrash pa faturë tatimore, si, dhe subjekti nuk është penalizuar me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “*Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve*” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*” i ndryshuar. Për sa më sipër, nga auditimi i raportit kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 3,871,725 lekë detyrime të TF dhe 3,871,725 lekë gjobë; 5,162,300 lekë detyrime të TVSH-së dhe 5,162,300 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 18,068,049 lekë, nga të cilat 9,034,025 lekë detyrim dhe 9,034,025 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për tatimpaguesin “I.F” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit me pasoja financiare, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 18,068,049 lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “2.....s” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nuk është kryer analiza e lëvizjes së mallit duke sjellë mosrakovime të gjendjes së inventarit për vitin 2019, ku pas analizimit të veprimeve për këtë vit financiar duke u nisur nga informacionet të cilat gjenden në deklaratat e subjektit në sistemin tatimor C@TS, të dhënave të pasqyruara nga ana e inspektorit lidhur me blerjet dhe shitjet e mallrave analizuar në mënyrë analitike në raport kontroll, si dhe nga kryqëzimi i këtyre të dhënave nga ana e audituesve, rezultuan diferenca në bilancin material krahasuar me rezultatet e dala në raport kontrollin, për të cilat subjektit nuk i janë rivlerësuar të ardhurat tatimore për vlerën 7,956,975 lekë, si dhe nuk është penalizuar me 100 % gjobë në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

- Konstatohet se në zërin n)shpenzime për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, për vitet 2017-2019, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, shpenzimet nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, kjo në kundërshtim me në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 21 “Shpenzime të panjohura”, germa n.

Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 1,669,186 lekë detyrime të TF dhe 1,297,711 lekë gjobë; 1,591,395 lekë detyrime të TVSH-së 1,591,395 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 6,149,688 lekë, nga të cilat 3,260,581 lekë detyrim dhe 2,889,106 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “2.....s” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 6,149,688 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A....N” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

-Konstatohet se për artikullin stuko për vitin 2017 si dhe për artikullin pllaka+ parket për vitet 2017-2020, nga analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti në gjendjen e inventarin në çelje dhe në mbyllje, si dhe nga të dhënat e pasqyruara në raport kontrolli nga ana e inspektorit lidhur me sasinë e blerë dhe atë të shitur, rezultojnë diferenca në vlerën 25,762,126 lekë.

- Nga analiza e çmimit të shitjes për artikullin stuko për vitin 2017 rezulton se çmimi i blerjes është 267 lekë, ndërkohë nga tabela e ndërtuar nga ana e inspektorit rezulton se ky artikull është shitur me çmimin 147 lekë, pra nën kosto në vlerën 5,751,400 lekë.

Për sa konstatuar subjekti është objekt penalizimi me 100 % gjobë në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 4,727,029 lekë detyrime të TF dhe 4,727,029 lekë gjobë; 6,302,705 lekë detyrime të TVSH-së 6,302,705 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 22,059,468 lekë, nga të cilat 11,029,734 lekë detyrim dhe 11,029,734 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*



**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “A...N” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimit të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 22,059,468 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “K.....T” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Për periudhën e kontrolluar qershor 2021-maj 2023 subjekti ka ushtruar aktivitetin e tij në fushën e restaurimit, shërbimit dhe tregtisë ku një pjesë të punimeve të cilat përfshihen ato të gërmimit, i ka kryer me nënkontraktor, për të cilat ka deklaruar edhe faturat e shërbimit, ku konstatohet se inspektori për këtë periudhë nuk ka analizuar normativat e konsumimit të karburantit sipas nenit 55, “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Normativat aplikohen mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike, që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike ku specifikisht subjekti për qarkullimin e tatueshëm për këtë periudhë duhet të kategorizohet sipas pikës V. “TË TJERA” (veprimtari të tjera jo të listuara) deri më 2%.

- Për vitin 2021 janë deklaruar si blerje të përjashtuara për mirëmbajtje mjete në vlerë 2,673,131 lekë, kur subjekti ka në inventarin e AQT një mjet pune Kamionçine me vlerën 712,883 lekë, e për rrjedhojë subjektit nuk duhet t’i njihej si shpenzim vlere e sipërpërmendur, pasi përbën shpenzim të panjohur dhe nuk i shërben aktivitetit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” dhe Udhëzimin nr. 5, datë 18.01.2005 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”. Për sa më sipër nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 400,970 lekë detyrime të TF dhe 87,812 lekë gjobë; 2,869,439 lekë detyrime të TVSH-së 628,407 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,986,628 lekë, nga të cilat 3,270,409 lekë detyrim dhe 716,219 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “K.I” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimit të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 3,986,628 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “V.S” SHPK, konstatohet se ka diferencë në vlerën (2,124,446) lekë midis inventarit fizik deklaruar nga subjekti në sistemin C@TS dhe pasqyrave financiare të vitit 2022, dhe si rezultat subjekti është objekt penalizimi me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar. Për sa më sipër nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 318,667 lekë detyrime të TF dhe 318,667 lekë gjobë; 424,889 lekë detyrime të TVSH-së 424,889 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,487,112 lekë, nga të cilat 743,556 lekë detyrim dhe 743,556 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “V.S” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 1,487,112 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “C....2012” SHPK, konstatohet se nuk është kryer lëvizja e materialeve dhe mallrave për materialet e blera brenda vendit me TVSH 20%, të cilat nga verifikimi i të dhënave në raport kontrolli për periudhën e kontrolluar, konstatohen si mallra të cilat duhet të kategorizohen nga ana e inspektorit si mallrat të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit, në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, ku përveç detyrimit, subjekti është objekt penalizimi me gjobë prej 365 dite x 0.06%. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 347,338 lekë detyrime të TF dhe 76,067 lekë gjobë; 463,118 lekë detyrime të TVSH-së 101,423 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 987,946 lekë, nga të cilat 810,456 lekë detyrim dhe 177,490 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “C....2012” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 987,946 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “G.....M” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Është ndryshuar periudha e përcaktuar për t’u kontrolluar duke planifikuar vetëm periudhën 2017/08-2018/08 për TVSH-në dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore si dhe për tatimin mbi fitimin për periudhën 2017, me arsyetimin e parashkrimit të periudha të cilat janë caktuar në programin e kontrollit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 48 dhe neni 73 pika 1, ku nga verifikimi në sistem rezulton se deklarata e fundit e ndryshuar është në datën 04.07.2019, pra parashkrimi është për periudhat 04.07.2014 e më para, dhe si rezultat subjekti i planifikuar për rikontroll nuk është kontrolluar për periudhën.2014/07 – 2017/07 për TVSH-në dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe nuk është kontrolluar për tatimin mbi fitimin për periudhën 2014-2016.

- Nuk është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për materialet e blera brenda vendit me TVSH 20%, të cilat nga verifikimi i të dhënave të cilat gjenden në raport kontrolli për periudhën e kontrolluar, konstatohen mallrat të cilat duhet të kategorizohen nga ana e inspektorit si mallrat të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit, në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, ku përveç detyrimit subjekti është objekt penalizimi me gjobë 365 dite x 0.06%. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 224,250 lekë detyrime të TF dhe 49,111 lekë gjobë; 299,000 lekë

detyrime të TVSH-së 65,481 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 637,842 lekë, nga të cilat 523,250 lekë detyrim dhe 114,592 lekë penalitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “G.....M” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të ri vendos në afat periudhën e planifikuar për rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 637,842 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “R....4” SHPK, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Në vitin 2019 arkëtimet në avancë kanë diferencë midis të ardhurave sipas tatim fitimit dhe të ardhurat e deklaruara në FDP e TVSH-së, pasi nuk janë marrë në konsideratë arkëtimet në avancë afatgjata, por vetëm aktivet afatshkurtra, dhe si rezultat ka diferenca ndërmjet FDP-së së tatim fitimi-FDP-së së TVSH sipas raport kontrollit 13,454,357 lekë, ka diferenca nga llogaria e arkëtimeve në avancë 1,523,846 lekë, me efekt TVSH të munguar në masën 20%.

-Në vitin 2020, gjatë rakordimit ndërmjet FDP-së së bilancit për tatim fitimi dhe FDP së TVSH-së, ka diferenca ndërmjet arkëtimeve për porosi në avancë duke nënvlerësuar të ardhurat me 10,366,999 lekë, për shkak se ulja në parapagime ndërmjet dy periudhave duhet të ishte deklaruar si e ardhur për efekt të tatim fitimit, me efekt ulje të pagesës së tatim fitimit në masën 15%.

- Është zhvlerësuar me 50% inventari i imët në vitin 2019 dhe në vitin 2020 për vlerën 5,546,663 lekë, ndërkohë që duhet të procedohet me procesverbal nga tatimet për ta njohur si shpenzim të zbritshëm amortizimin e inventarit.

- Shtesa aktiveve në proces për vitin 2019 ndërtim hoteli paraqitet në shumën 280,376,096 lekë, ndërkohë që referuar të ardhurave të deklaruara në shënimet shpjeguese të njëjta me analizën e inspektorit, këto të ardhura paraqiten në shumën 240,420,964 lekë, dhe si rezultat të ardhurat e periudhës për vitin 2019 për punimet e kryera për ndërtimin e hotelit të vetë janë nënvlerësuar për diferencën në shumën 39,955,132 lekë, duke nënvlerësuar tatim fitimin e deklaruar me 15 %.

- Për vitin 2020 janë pakësuar asetet për shkak të zjarrit në zërin ndërtesa dhe të tjera, pa dokumentacionin shoqërues nga tatimet ose institucionet përkatëse, duke u llogaritur si shpenzim i periudhës, i cili ka ulur fitimin e tatuashëm të subjektit, dhe për rrjedhojë subjektit i rriten të ardhurat për efekt të tatimit mbi fitimin për shumën fillestare 46,470,300 lekë. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 15,350,864 lekë detyrime të TF dhe 4,011,630 lekë gjobë; 4,104,974 lekë detyrime të TVSH-së 1,765,378 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 25,232,846 lekë, nga të cilat 19,455,838 lekë detyrim dhe 5,777,008 lekë penalitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “R....4” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 25,232,846 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “F.....a” SHPK, konstatohet se nuk është llogaritur kreditimi i TVSH-së sipas Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, neni 9 “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar”, pika 3. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 454,634 lekë detyrime të TVSH-së, 227,317 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 681,951 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “F.....a” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 681,951 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “B....3” SHPK, konstatohet se shoqëria periudhën e kontrolluar ka kryer shitje të përjashtuara në shumën 32,881,380 lekë, ku për vitin 2020 rezulton se shitjet sipas faturave të trajtuara më hollësisht në raport, janë deklaruar si shitje të përjashtuara, ndërkohë që duhet të deklarohen si shitje me 20%, pasi janë realizuar përpara se subjekti të pajisej me autorizimin nga DPT, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” pika 1. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 6,576,276 lekë detyrime të TVSH-së, 1,440,204 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 8,016,480 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “B....3” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 8,016,480 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “R...R” SHPK, konstatohet se ekziston një diferencë në vlerën 3,795,760 lekë, midis inventarit fizik deklaruar nga subjekti në sistemin C@TS, dhe pasqyrave financiare të vitit 2021, dhe si rezultat subjekti është objekt penalizimi me 100 % gjobë, në bazë të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 569,364 lekë detyrime të TF dhe 569,364 lekë gjobë; 759,152 lekë detyrime të TVSH-së 759,152 lekë gjobë; pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,657,032 lekë, nga të cilat 1,328,516 lekë detyrim dhe 1,328,516 lekë penalitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “R...R” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 2,657,032 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “D...M” SHPK, konstatohet se nga ana e DRT Fier, janë çertifikuar investime dhe është rimbursuar TVSH, për vlera punimesh të papërfunduara pavarësisht riskut teknik, ose risqeve të tjera që mund të çënojnë funksionimin, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme, të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit sipas përcaktimeve të Kreut IX “Lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes” të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Për sa më sipër nga auditimi i raport kontrollit tatimor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit duke sjellë si pasojë efekte tatimore të llogaritura paraprakisht në shumën 21,098,674 lekë detyrime të TVSH-së.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “D....M” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 21,098,674 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “X...O” SHPK, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 12/2018-05/2020, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune, në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar shpenzime të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në VKM nr. 399, datë 3.5.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta për të vlerësuar nëse ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 12/2018-05/2020 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër, grupi i auditimit gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues, i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban e ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Për veprimet apo mosveprimet subjekti penalizohet sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 894,409 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 894,409 lekë gjobë 100%; 566,459 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 566,459 lekë gjobë 100%; 101,366 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 101,366 lekë gjobë 100%; 101,366 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 101,366 lekë gjobë 100%; 216,809 lekë detyrime TAP dhe 216,809 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,760,818 lekë.

- Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 911,080 lekë detyrime të TF dhe 199,526 lekë gjobë 21.9%; 1,214,773 lekë detyrime të TVSH-së dhe 266,035 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,591,414 lekë.

- Nga kontrolli i PASH të subjektit për vitin 2019, duke kryer rillogaritjet dhe rakordimet midis të dhënave të FDP, librave të blerjes, faturave dhe bilancit kontabël, ka rezultuar diferenca e pajustificuar në vlerën 4,841,165 lekë, si shpenzime të njohura më pak në bilancin kontabël të vitit 2019. Nga grupi i auditimit janë konsideruar si shitje pa faturë dhe është kryer rivlerësimi i situatës financiare të subjektit duke e penalizuar sipas përcaktimeve të nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 726,175 lekë detyrime të TF dhe 726,175 lekë gjobë 100%, 968,233 lekë detyrime të TVSH-së dhe 968,233 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,388,816 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “X...O” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në

*Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në **vlerën prej 9,741,048 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “S....A” SHPK, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli analitik i shitjeve sipas raport kontrollit është konstatuar se subjekti përgjatë vitit 2018 ka kryer punime ndërtimore në ndërtim banesash dhe objekte ndërtimore të tjera, për të cilat duhet të kreditojë karburant deri në 8% të qarkullimit sipas përcaktimeve të shkronjës c të nenit 55 të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "*Për TVSH në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se, përgjatë kësaj periudhe shoqëria ka kryer punime me nënkontraktor, për të cilat nuk duhet të kreditojë karburant. Nga rillogaritjet rezulton se shoqëria duhet të kreditonte karburant vlerën 23,535,910 lekë, ndërkohë që ka kredituar faktikisht vlerën prej 45,490,121 lekë, pra ka kredituar shtesë jashtë përcaktimeve ligjore shumë prej 21,954,211 lekë, për të cilën është kryer ulja e tepicës kreditore të TVSH me 4,390,842 lekë dhe penalizimi sipas nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar me 961,594 lekë gjobë 21.9%.

- Shoqëria për vitin 2020 ka kryer shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas autorizimeve përkatëse me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkinë Durrës. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konstatohet se nuk është bërë rregullimi i TVSH-së për karburantin e blerë në vlerën 18,923,571 lekë, si blerje që i ka shërbyer edhe shitjeve të përjashtuara në kuadër të rindërtimit për vitin 2020, veprime këto që nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 69 “Zbritja e TVSH-së” të ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH në R.SH”, i ndryshuar, për lejimin e plotë të kreditimit të TVSH-së në blerje, kur kryen aktivitet të përzier. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për vitin 2020, është rillogaritur koeficienti i zbritjes së TVSH-së në vlerën 82.71% , sipas përcaktimeve të nenit 72 “Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH në R.SH”, i ndryshuar dhe është kryer rregullimi në ulje i gjendjes kreditore të TVSH në vlerën 654,442 lekë, si dhe penalizimi sipas nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar me 143,323 lekë gjobë 21.9%.

- Nga auditimi i bilancit kontabël të vitit 2020 rezulton se shoqëria ka një marrëdhënie të drejtash dhe detyrimesh, pa njohur të ardhura nga interesat me ortakun, i cili sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është entitet me personalitet të ndarë juridikë dhe çdo marrëdhënie dhe transaksion midis shoqërisë dhe ortakut duhet t’u përmbahet parimeve të tregut të lirë. Për periudhën e kontrolluar u ndërtua një bilanc i këtyre të drejtave dhe detyrimeve, ku rezulton se shoqëria në total është kreditore (ka të drejta mbi të tretët) dhe njëkohësisht ka detyrime ndaj institucioneve bankare, dhe rezulton se këto shuma të huajtura kanë një kosto që në gjykimin e grupit të auditimit janë të pajustificuara fiskalisht. Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se “Shpenzimet neto të interesit për huatë”, nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohur nenit 20 “Shpenzime të njohura” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklaram sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumë prej 14,270 lekë detyrime të TF dhe 3,125 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 17,395 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “S....A” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85

“Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 6,167,597 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A...4” SHPK, kanë rezultuar faturime të situacioneve të punimeve të ndërtimit në total në vlerën 48,003,198 lekë nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016”, pa justifikim në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim nga ana e subjektit, që të justifikojë uljen e kostove, për subjektin i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullësi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në Manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe Manualin Nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave” si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren si dhe mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikeve 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, veprime të cilat në kundërshtim me nenin 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” të Udhëzimit nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar. Nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë sipas germave b dhe c të nenit 71, si dhe penalizimi për këto parregullsi sipas nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 7,200,480 lekë detyrime të TF dhe 7,200,480 lekë gjobë 100%, 9,600,640 lekë detyrime të TVSH-së dhe 9,600,640 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 33,602,239 lekë.

- Nga grupi i auditimit u kontrolluan çmimet e shitjes të njësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim tek objektet e shoqërisë në Fier dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të qytetit të Fierit, të përcaktuar në tabelën nr.2 të Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2016” dhe VKM nr. 168, datë 27.3.2019, Aneksi nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimit”. Në total shitje nën çmimin minimal fiskal rezultuan 59,994,843 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë, duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 8,999,226 lekë detyrime të TF dhe 4,499,613 lekë gjobë 50%, 11,998,969 lekë detyrime të TVSH-së dhe 5,999,484 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 31,497,292 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**15.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “A...4” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 65,099,531 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “C....o” SHPK, kanë rezultuar problematikat:

- Shoqëria për vitin 2021 ka kryer shitje të përjashtuara në kuadër të Rindërtimit sipas Autorizimit Nr.432/1 Prot. datë 25.01.2020, në zbatim të Kontratës Nr.3221 Prot., datë 15.12.2020 me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me objekti kontrate “Rikonstruksion i njësive të banimit në ndërtesa në zonën e re për zhvillim Kavajë Paketa B, Objekti 2.1 Njësia Administrative Bashkia Kavajë”, në vijim të këtij autorizimi për periudhën objekt kontrolli, subjekti ka realizuar shitje të përjashtuara si nënkontraktor i “J.” SHPK. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konstatohet se nuk është bërë rregullimi i TVSH-së, për “Blerje nga furnitor vendas me 20% TVSH” në vlerën 138,344,163 lekë, si blerje që i ka shërbyer edhe shitjeve të përjashtuara në kuadër të rindërtimit për periudhën vitin 2021, veprime këto që nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 69 “Zbritja e TVSH-së” të ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH në R.SH”, i ndryshuar, për lejimin e plotë të kreditimit të TVSH-së në blerje, kur kryen aktivitet të përzier. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për vitin 2021, është rillogaritur koeficienti i zbritjes së TVSH-së në vlerën 41.18% , sipas përcaktimeve të nenit 72 “Llogaritja e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH në R.SH”, i ndryshuar dhe është kryer rregullimi në ulje të gjendjes kreditore të TVSH në vlerën 7,789,578 lekë dhe penalizimi sipas nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar me 1,705,918 lekë gjobë 21.9%.
- Nga analiza e bilancit kontabël për vitin 2021 të shoqërisë “C....o” SHPK, konkretisht i zërit “Detyrimet ndaj Ortakut”, ka një rritje në vlerën 6,843,168 lekë, e pajustificuar me burimet e të ardhurave të ortakut si të ardhura nga dividendët dhe të ardhurat nga punësimi si administrator në shoqërisë regjistruar me pagë minimale për efekt sigurimesh. Nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut si dhe kushtet e vendosura të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël. Nga ku grupi i audituesve vlerëson se, janë arsye themelore për të kryer rivlerësim tatimor të shumës 6,843,168 lekë të dhëna hua por të pajustificuara duke e konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimore në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shumat hua të pajustificuara janë rivlerësuar me marzhin e fitimit bruto 13.78% sipas PASH për vitin 2021, duke u rikarakterizuar si të ardhura të padeklaruara dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,450,561 lekë detyrime të TF dhe 1,450,561 lekë gjobë 100%, 1,934,081 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,934,081 lekë gjobë 100%, 591,250 lekë detyrime të Dividenti dhe 591,250 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 7,951,784 lekë.
- Nga analiza dhe krahasimi i blerjeve të përjashtuara sipas FDP mujore me deklarimin sipas bilancit për vitin 2022, ka rezultuar diferencë në vlerën 10,416,867 lekë e cila përbën shpenzime qeraje për shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve nga shoqëria. Nga kontrolli në C@ts, ka rezultuar se shoqëria nuk ka deklaruar dhe paguar tatimin në burim për qeratë e makinerive dhe pajisjeve të shfrytëzuara. Nga sa më sipër mqs nuk është deklaruar dhe paguar tatimi në burim për qeratë e makinerive dhe pajisjeve, këto shpenzime do të kalojnë si shpenzime të panjohura për efekt fiskal të llogaritjes së fitimit të tatueshëm në PASH, sipas përcaktimeve të pikës II) të nenit 21 “Shpenzime të panjohura” të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Gjithashtu është kryer penalizimi i

subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,562,530 lekë detyrime të TF dhe 342,194 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,904,724 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**16.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “C....o” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 19,352,004** lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “G.....A” SHPK, kanë rezultuar problematikat:

- Nga analiza e bilanceve kontabël për vitet 2019-2020 të shoqërisë “G.....A” SHPK, konkretisht i zërit “Detyrimet ndaj Ortakut”, ka një rritje në vlerat respektive 31,700,000 lekë dhe 23,309,025 lekë, të pajustificuar me burimet e të ardhurave të ortakëve si të ardhura nga dividendët dhe të ardhurat nga punësimi i tyre në shoqërisë të regjistruar me pagë minimale për efekt sigurimesh. Nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut si dhe kushtet e vendosura të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël. Grupi i auditimit vlerëson se këto janë arsye themelore për të kryer rivlerësim tatimor të shumave respektive 31,700,000 lekë dhe 23,309,025 lekë të dhëna hua por të pajustificuara duke i konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimore në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shumat hua të pajustificuara janë rivlerësuar me marzhet e fitimit neto 4.90% dhe 4.40% sipas PASH për vitin 2019-2020, duke u rikarakterizuar si të ardhura të padeklaruara dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 10,728,630 lekë detyrime të TF dhe 10,728,630 lekë gjobë 100%; 14,304,840 lekë detyrime të TVSH-së dhe 14,304,840 lekë gjobë 100%; 4,863,646 lekë detyrime të Dividenti dhe 4,863,646 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 59,794,232 lekë.

- Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “G.....A” SHPK, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 9/2018-09/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj, ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim nr. 809, datë

26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta nqs ndërprerjet e marrëdhënies të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 9/2018-09/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 918,053 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 918,053 lekë gjobë 100%; 581,434 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 581,434 lekë gjobë 100%; 104,046 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 104,046 lekë gjobë 100%; 104,046 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 104,046 lekë gjobë 100%; 306,329 lekë detyrime TAP dhe 306,329 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 4,027,817 lekë.

- Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,230,129 lekë detyrime të TF dhe 269,398 lekë gjobë 21.9%; 922,597 lekë detyrime të TVSH-së dhe 202,049 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,624,173 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit).*

**17.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “G.....A” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në

*Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 66,446,222 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “L.....n” SHPK, kanë rezultuar problematikat:

- Nga analiza e bilanceve kontabël për vitet 2019-2020 të shoqërisë “L.....n” SHPK, konkretisht i zërit “Detyrimet ndaj Ortakut”, ka një rritje në vlerat respektive 91,371,200 lekë dhe 56,272,209 lekë, të pajustificuar me burimet e të ardhurave të ortakëve si të ardhura nga dividendët dhe të ardhurat nga punësimi i tyre në shoqërisë të regjistruar me pagë minimale për efekt sigurimesh. Nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe ortakut si dhe kushtet e vendosura të cilat do të përbëjnë edhe dokumentat ligjore për justifikimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël. Nga ku grupi i audituesve vlerëson se janë arsye themelore për të kryer rivlerësim tatimor të shumave respektive 91,371,200 lekë dhe 56,272,209 lekë të dhëna hua por të pajustificuara duke i konsideruar si fitime të padeklaruara nga ana e shoqërisë, jo konform përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi, në lidhje me tatimpaguesin i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shumat hua të pajustificuara janë rivlerësuar me marzhet e fitimit bruto 8.32% dhe 5.90% sipas PASH për vitin 2019-2020, duke u rikarakterizuar si të ardhura të padeklaruara dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 29,540,763 lekë detyrime të TF dhe 29,540,763 lekë gjobë 100%; 39,387,684 lekë detyrime të TVSH-së dhe 39,387,684 lekë gjobë 100%; 13,391,813 lekë detyrime të Dividenti dhe 13,391,813 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 164,640,516 lekë.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “L.T.E C.” SHPK, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 07/2019-06/2021, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune sipas përcaktimeve të VKM-ve për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kreut IX të Kodit të Punës në RSH.

- Janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të kontratave individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre më përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të regjistrave që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar mungesa të analizave të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 07/2019-06/2021 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër, vlerësohet se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklaratatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën “b”, “c” të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 239,447 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 239,447 lekë gjobë 100%; 151,650 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 151,650 lekë gjobë 100%; 27,137 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 27,137 lekë gjobë 100%; 27,137 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 27,137 lekë gjobë 100%; 70,695 lekë detyrime TAP dhe 70,695 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,032,132 lekë.

- Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 242,012 lekë detyrime të TF dhe 53,001 lekë gjobë 21.9%; 322,683 lekë detyrime të TVSH-së dhe 70,668 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 688,364 lekë.

- Nga auditimi i raport kontrollit tatimor për vitin 2020, ka rezultuar se shoqëria ka kryer punime si “Gërmim, hedhje, mbushje, ngjeshje, transport dheu, prerje asfalti etj”, për të cilat janë të nevojshme makineri dhe pajisje specifike për realizimin e tyre. Nga kontrolli në sistemin informatik tatimor C@ts për vitin 2020, konkretisht tek seksioni i “Bilancit i tatimpaguesit”, “Formati i pasurive të luajtshme-Makina”, rezulton se shoqëria nuk ka makina në pronësi. Në sistemin C@ts nuk janë deklaruar kontrata qera për makineri dhe pajisje pune dhe nga kontrolli i deklarimit dhe pagesave të tatimit në burim në sistemin C@ts, rezulton vetëm për qera objekti për vitin 2020. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se tatimpaguesi ka plotësuar gabim deklaratatimore dhe nuk mban llogari dhe regjistrime të sakta të transaksioneve, duke qenë se plotësohen kushtet sipas përcaktimeve të gërmës b dhe c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku të ardhurat e deklaruara nga punimet me makineri të pajustificuara janë rivlerësuar me marzhin e fitimit bruto 6% sipas PASH të vitit 2020, duke u rikarakterizuar si shpenzime të padeklaruara dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 117 dhe 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën

1,430,766 lekë detyrime të TB dhe 1,430,766 lekë gjobë 100%; 1,430,766 lekë detyrime të TF dhe 1,430,766 lekë gjobë 100%; 1,907,688 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,907,688 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 9,538,440 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)

**18.1.Rekomandimi:**Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për tatimpaguesin “L.....n” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në **vlerën prej 175,899,452 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor “M.....p” SHPK, konkretisht i transaksioneve të blerjes nga fermerët, janë konstatuar 13 fatura tatimore të cilat janë lëshuar në të njëjtën datë me lidhjen e akt marrëveshjes me fermerët si dhe fatura nr. 2394, serial 91082394, datë 30/11/2020 nga fermeri “A.S.” PF me NIPT L.....F me vlerë të tatueshme 140,098 lekë, e cila është lëshuar një ditë përpara datës së lidhjes së akt marrëveshjes me fermerin, që përbën kriter dhe kusht për kreditimin e TVSH për blerjet e kryera nga fermerët sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”. Nga sa më sipër, shuma e blerjes nga fermer vendas me 6% TVSH prej 140,098 lekë, sistemohet si blerje e përjashtuar dhe në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti penalizohet me një gjobë të barabarte me 20% të detyrimit.

- Nga auditimi konstatohet se zëri “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” i pasivit të bilancit kontabël të shoqërisë, paraqitet në vlerën 57,469,398 lekë, ku edhe pse me ulje nga periudha paraardhëse, nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e kartelave analitike të llogarisë “Furnitor” mbi likuidimet e kryera për blerjet nga fermerët për periudhën që është kërkuar rimbursim i TVSH-së, element ky që përbën kusht për kreditimin sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit).

**19.1.Rekomandimi:** DRT Fier nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të marrë masat për të sistemuar në ulje gjendjen kreditore të TVSH-së prej 8,406 lekë, përfshirë penalitetin 1,681 lekë për faturën nr. 2394, serial 91082394 datë 30.11.2020 nga fermeri “A.S” PF me NIPT L....F me vlerë të tatueshme 140,098 lekë, e cila është lëshuar një ditë përpara datës së lidhjes së akt marrëveshjes me fermerin.

- Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të verifikojë njoftimin në afat të DRT-së, depozitimin dhe pajisjen më numër protokollit të akt marrëveshjeve me fermerët, për të cilat janë lëshuar 13 fatura tatimore në të njëjtën datë me datën e lidhjes së tyre, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të kryejë një analizë të detajuar e kartelave analitike të llogarisë “Furnitor” mbi likuidimet e kryera për blerjet nga fermerët për periudhën 07/2020-12/2020 të rimbursimit TVSH-së.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “L.....s” SHPK, konkretisht nga rillogaritjet e lëvizjes së bilancit material në vlerë dhe sasi, ka rezultuar se vlera e mallit gjendje në datën 31.12.2019 është 15,415,237.95 lekë. Nga bilanci kontabël sipas sistemit C@ts, rezulton se vlera e gjendjes së mallrave të deklaruara në zërin “Mallra” tek inventari paraqitet në vlerën 15,253,915 lekë, pra ekziston një diferencë prej 161,322.95 lekë, midis vlerës së gjendjes së mallrave sipas lëvizjes së bilancit material dhe vlerës së deklaruar

në bilancin kontabël të shoqërisë, e cila konsiderohet si blerje pa faturë tatimore, dhe për të cilën kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 24,198 lekë detyrime të TF dhe 24,198 lekë gjobë 100%; 32,264 lekë detyrime të TVSH-së dhe 32,264 lekë gjobë 100%; pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 112,926 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit).*

**20.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare “Inventarin Kontabël” të vitit 2019 me kosto, me qëllim vlerësimin e diferencave me lëvizjen e bilancit material sipas raport kontrollit si dhe të kryejë të gjitha veprimet administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogaritur **në vlerën 112,926 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli në sistemin C@ts i të dhënave për subjektin “F.....4” SHPK, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar dhe paguar tatim në burim për objektin e marrë me qera, për të cilën duhet të ishte kryer rivlerësimi i situatës financiare duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të germës c) të nenit të 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore shtesë të pallogaritura në shumën 29,990 lekë gjobë tatimi në burim, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 29,990 lekë.

- Nga kontrolli i dokumenteve standarde të tenderit (DSK) për kontratat e lidhura janë nxjerrë të dhëna mbi numrin e punonjësve të nevojshëm për të përmbushur kontratat e shërbimit të ruajtjes fizike për Albpetrol SH.A prej 9.96 punonjës, OSHEE/Rajoni Fier 14.96 punonjës dhe Spitali Rajonal Fier 14.96 punonjës. Meqenëse shoqëria është shpallur fituese në këto procedura prokurimi rrjedh se detyrimisht i ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe çdo kërkesë ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Nga përlllogaritjet del se, përgjatë kësaj periudhe shoqëria ka pasur angazhime në më shumë se një punë publike njëkohësisht, e logjikisht rrjedh se duhet të shfrytëzojë gjithë kapacitetin e plotë të fuqisë punëtore me qëllim përmbushjen e kushteve të kontratave të prokurimit. Sipas listëpagesave të dorëzuara përgjatë periudhës objekt kontrolli 01/2019-01/2022 në sistemin informatik tatimor C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht çdo muaj 30 punonjës. Analiza bazohet tek profili i kategorisë së profesionit “Roje”, të cilët mund të jenë të angazhuar vetëm një vend-roje shërbimi, në ndryshim nga pozicionet si Teknik/inxhinier telekomunikacioni, Asistent Sigurimi, Teknik/Përgjegjës Sektori etj, që mund të ndjekin pa pengesë disa projekte njëkohësisht. Nga analiza e mësipërme dalim në konkluzion se nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara të subjektit kanë rezultuar mesatarisht 30 punonjës çdo muaj të deklaruar dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë të grafikut të ekzekutimit të shërbimit të ruajtjes sipas kontratave të lidhura me institucionet publike dhe private, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale sipas kontratave të prokurimit të nënshkruara. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer një thellim i analizës së situatës financiare të subjektit gjatë fazës së kontrollit në terren, me qëllim dokumentimin fakteve që do të shërbenin si arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, sepse rezulton mospërputhje e pajustificuar teknikisht midis numrit të punonjësve të regjistruar në listëpagesa dhe punonjësve që janë të domosdoshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale sipas kontratave të prokurimit të nënshkruara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**21.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë të gjitha veprimet administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogaritur **në vlerën 29,990 lekë.**

- Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të propozojë për vizitë fiskale tatimpaguesin “.....4” SHPK, për periudhën 01/2019-01/2022, me objekt specifik “*Kontroll mbi saktësinë dhe rregullshmërinë e vetdeklarimeve mbi nivelin e pagave, numrit të punonjësve, llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve për nga Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë dhe TAP*”.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e bilanceve kontabël të viteve 2019-2020 të subjektit “A...O” SHPK, konkretisht e zërit “Mjete Transporti”, rezulton se për vitin 2019 shoqëria nuk ka pasur mjete transporti në pronësi. Përgjatë vitit 2019 nga verifikimi i faturave të blerjes ka rezultuar se shoqëria ka kryer blerje karburanti, por në kushtet kur nuk ka patur në pronësi mjete transporti dhe nuk rezulton të ketë marrë me qera mjete transporti, rezulton se karburanti i blerë nuk i shërben aktivitetit të shoqërisë dhe përbën shpenzime të panjohura sipas përcaktimeve ligjore të nenit 20 “*Shpenzime të njohura*” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar. Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se blerjet e karburantit nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, ato janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohura, duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullsi në deklaram, sipas përcaktimeve të nenit 115 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në R.SH*”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pa llogaritura në shumën 8,000 lekë detyrime të TF dhe 1,752 lekë gjobë 21.9%, 10,667 lekë detyrime të TVSH-së dhe 2,133 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 22,553 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-145 të Raportit të Auditimit)*

**22.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë të gjitha veprimet administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të përllogaritura **në vlerën 22,553 lekë.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga përpunimi të dhënave të gjeneruar nga Raporti i gjeneruar për kështet e Tatim Fitimit dhe evidencave të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit sipas ndarjes së NIPT-eve, u konstatuan mangësi në penalitetet e aplikuar nga DRT Fier për mos pagimin në afat të kësteve të Tatim Fitimit. Konkretisht, për vitin 2021 rezultojnë 14 raste për të cilat nuk janë përllogaritur penalitetet në masën 10% të vlerës së kështit, sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për procedurat tatimore në RSH*” i ndryshuar, neni 114/1, duke rezultuar me penalitete të pa llogaritura dhe të pa mbajtura në vlerën 4,419,672 lekë.

Për vitin 2022 konstatohen 14 raste për të cilat nuk janë llogaritur dhe mbajtur penalitete në vlerën 4,590,947 lekë dhe për vitin 2023 konstatohen 11 raste të tjera për vlerën e penalitetit prej 2,366,139 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-135 të Raportit të Auditimit)*

**23.1 Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për të vendosur penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht **në vlerën prej 11,376,758 lekë** si penalitet për mos pagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA DISIPLINORE.**

### **C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**



Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa b, c, ç të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH– së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

**I. “Vërejtje”, si më poshtë për:**

**1. Z. A.H,** në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 12 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 3,743,536 lekë.

**2. Z. E.F,** në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 3 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 393,064 lekë.

**3. Znj. F.H,** në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 4 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 586,189 lekë.

**4. Znj. E.S,** në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 213,618 lekë.

**5. Z. L.R,** në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 52, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 77, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi gjatë rilidhjes dhe monitorimit të 17 Akt Marrëveshjeve me këste për 14 tatimpagues të cilëve ju janë përsëritur marrëveshjet pavarësisht se historiku i marrëveshjeve të mëparshme të lidhura me ta ka reflektuar se nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kanë rezultuar me një vlerë detyrimesh të papaguara prej 33,791,000 lekë.

**II. "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil",** si më poshtë për:

**1. Z. A.K,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115 dhe 124, Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 55 dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 22,054,677 lekë.

**2. Z. G.LL,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115 dhe 124 dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,262,612 lekë.

**3. Z. D.S,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115 dhe 124, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 30,075,948 lekë.

**4. Z. V.R,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115 dhe 124, ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, ligjit nr. 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF nr. 16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 20,339,950 lekë.

**5. Z. A.G,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, ligjit nr. 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF nr.16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendim nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendimin nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 3 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 93,166,179 lekë.

**6. Z. S.Z,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",

i ndryshuar, neni 48, 71, 72, 73, 115, 124 dhe 128, VKM nr. 168, datë 27.3.2019, Udhëzimit nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 65,737,374 lekë.

**7. Z. B.H,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 124 dhe 128, Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”, neni 19, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 3,338,983 lekë.

**8. Z. E.M,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IX, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 1 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 21,138,676 lekë.

**9. Z. L.C,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendim nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 15, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 1 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 9,741,048 lekë.

**10. Znj. V.P,** në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet

ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, 69 dhe 72, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 55 dhe Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së", neni 19, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 2 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,177,683 lekë.

**11.** Znj. E.E, në detyrën e Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të përcaktuara në Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 51, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2018, pika 4, 6, 8, 9, 11.2, 13, Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit 2022, pika 6, 8, 10, për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë.

### **III. "Largim nga shërbimi civil", për 2 (dy) punonjës, si më poshtë:**

**1.** Z. B.S, në detyrën e Drejtor të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 2, 7 dhe 11 të nenit 57, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Kreu IX, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 21, ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15, ligjit nr. 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1, UMF nr. 16, datë 16.2.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5, Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendim nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Vendimin nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 168, datë 27.3.2019, Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 20, 55, Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së", neni 19, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 22 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 453,945,126 lekë.

- Parregullsi në zbatim të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të kontrollit tatimore, 12 raste Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike dhe 9 raste Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 84 të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatim fitimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë.

**2. Z. A.P, në detyrën e Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier;**

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e Drejtorit Rajonal, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 3, 10, 11, 18 dhe 20 të nenit 4, si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, 72, 115, 119 dhe 124, ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 69, 72 dhe Kreu IX, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat“ neni 21, ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 15, ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1, UMF nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr. 168, datë 27.3.2019, Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20, 55, Udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH-së”, neni 19, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 87 dhe 119, Manual i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII, për 22 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 453,945,126 lekë.

- Mosrealizim i të ardhurave nga TVSH për 2021 dhe 2023 në krahasim me planin e rishikuar të të ardhurave tatimor për DRT Fier, në kundërshtim me shkresën nr.8446 prot., datë 12.05.2020 “Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2021” dhe shkresën nr. 2078, datë 10.02.2023 “Dërgohet plani i të ardhurave periudhën Janar-Shtator 2023” si dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pikat 3 dhe 4 të nenit 4.

- Nxjerrja e 2 urdhrave të brendshëm nr.13304, prot datë 07.10.2022 dhe nr.1330/1 prot., datë 07.10.2022, për angazhimin e punonjësve të DRT Fier në detyra të tjera funksionale, jashtë kompetencave sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave.

- Janë konstatuar mangësi dhe parregullsi gjatë rilidhjes dhe monitorimit të 17 Akt Marrëveshjeve me këste për 14 tatimpagues të cilëve ju janë përsëritur marrëveshjet pavarësisht se historiku i marrëveshjeve të mëparshme të lidhura me ta ka reflektuar se nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kanë rezultuar me një vlerë detyrimesh të papaguara prej 33,791,000

lekë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 77.

- Për 29 raste ku janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit nga zyra të subjekteve që kanë paguar me vonesë ose nuk kanë paguar këstet e tatimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të si dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 114/1, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 6,628,657 lekë

- Parregullsi në zbatimin të procedurave dhe afateve administrative për hartimin e akteve të kontrollit tatimore, 12 raste Projekt Raporti i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 7 ditë kalendarike dhe 9 raste Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor është dërguar në subjekt në tejkalim të afatit 14 ditë kalendarike, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 84 të ligjit nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Për 2 raste verifikimi në terren të subjekteve, ka rezultuar shkelje të afateve procedurale dhe vonesa prej 7 muajsh në miratimin e gjobës për pengimin e kontrollit në kundërshtim me përcaktimet të nenit 127, pika 2 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Manual i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 19/2, datë 28.02.2020.

**IV.** Për punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara pavarësisht se ekzistojnë, nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e një mase disiplinore, për 7 (shtatë) punonjës, si më poshtë:

1. Z. A.H, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
2. Z. Sh.N, në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
3. Znj. D.D, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
4. Znj. E.M, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;
5. Znj. Xh.P, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;
6. Znj. D.D, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier;
7. Znj. Z.SH, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

## **C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

1. J.H në detyrën e Inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, dalë në pension pleqërie.
2. Znj. ZH.A, në detyrën e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, dalë në pension pleqërie.
3. Z. E.XH në detyrën e Përgjegjës Sektorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, larguar nga Shërbimi Civil.

#### **D. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

#### **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**